

ÇORGANIZIMI TOTAL  
I BASHKËSISË  
FETARE ISLAME NË  
RMV

Tiranë 2024

1KlikLarg





Boton:

**1KlikLarg**

Biblioteka:

**Thumbi**

Redaktor:

**Mahir Rexhepi**

Recenzent:

**Samir Topi**

Lektor:

**Et'hem Erebara**

Redaktor teknik & dizajn:

**Ema.i**

**Tiranë 2024**







## ***Puçi klasik në BFI që “e detronizoi” Ali Ahmetin***

***Bashkësia Fetare Islame nuk po gjenë rehati!  
Sikur një mallkim i rëndë ka rënë mbi këtë  
Institucion dhe vetëm një Zot e di se sa gjatë  
do të rëndojë ky mallkim mbi këtë “shtëpi” të  
myslimanëve të vendit. Të paktën, nuk ka rehati  
aty përderisa brenda saj do të pështillet Shaqir  
Fetai, instalacioni i shërbimeve të huaja në krye  
të BFI-së***

***Nga Dritan Rexhepi***

Populli thotë: çka të mbjellësh atë do të korrësh! Shaqir Fetai në BFI e mbolli puçin klasik dhe, vështirë se do t'i përballojë kësaj dukurie. Me puç erdhi dhe me puç do të ikë. Në të dy rastet – skajshmërisht i turpëruar.

Natyrisht, puçin ia organizuan struktura të BDI-së si dhe struktura të shërbimeve sekrete, ndërsa e votuan pikërisht ata drejtus të organeve të BFI-së që po kontrolloheshin nga këta struktura.

Edhe kundërkandidati i Shaqir Fetait, Myftiu i Tetovës, dr. Qani Nesimi, ishte i përgëdheluri i strukturave më të larta të BDI-së (sidomos i Tetuta Arifit), ndonëse ai humbi. Dihej që do të humbiste, e rëndësishme për BDI-në ishte që Qani Nesimi t'ia sigurojë procesin demokratik e kushtetues Shaqir Fetait, të cilit i duhej qoftë edhe formalisht një kundërkandidat.

Me kohë BDI do të kuptojë se në krye të BFI-së ka sjellë një njeri katastrofal, një udbash dhe një person shumë të dëmshëm. Ali Ahmeti po e mbante gjithë e më larg duke ia shprehur haptazi pakënaqësinë ndaj tij, sidomos që nga momenti kur ai thjesht e nguli Kryetarin e Parlamentit, Talat Xhaferin, të cilin në një farë forme e detyroi të takohet me delegacionin rus të Putinit i cili kishte dalur në terren për të fituar përkrahje ndërkombëtare në prag të sulmit okupues kundër Ukrainës.

Ali Ahmeti jo njëherë haptazi e ka shprehur pakënaqësinë e vet kundër Shaqir Fetait, ndaj dhe, këtë pakënaqësi u munduan ta



shfrytëzojnë disa struktura brenda BFI-së dhe dy herë t'ia përgatisnin një puç por që në të dy rastet dështuan.

Së fundmi, të involvuar edhe struktura nga “Gupi i zjarrit” (Blerim Bexheti dhe Musa Xhaferi), por edhe struktura policore (si Zimri Qamili), së bashku me të pakënaqurit brenda BFI-së, kohë më parë ia përgatitën edhe puçin e tretë por që, grupi i Gostivarit me në krye Talat Xhaferin reagueshan dhe e shpëtuan në momentin e fundit. Shërbimi sekret që e ka ndikim më të madh brenda BFI-së e shpëtoi kësaj radhe duke “e kidnapuar” myftiun e Dibrës dhe duke e detyruar që ta tërheqë nënshkrimin e tij, akt ky që u krye diku kah ora tre e mëngjesit!

Angazhimi i këtyre puçistëve ishte që në krye të BFI-së ta sjellin (natyrisht, me pëlqimin e strukturave të BDI-së nga Tetova) Qani Nesimin! I indinjuar nga ky gjest që erdhi nga po ata që e kishin përkrahur Shaqir Fetain që të realizohet skenari i shërbimeve sekrete dhe ta instalojnë në krye të BFI-së, Shaqir Fetai këto ditë ndërmori hap kundërofensiv: largoi nga “rijaseti” tij, shkarkoi njerëz nga puna, u hidhërua me miq e me shokë “të ngushtë”, i shkarkoi nga postet drejtuese, dhe në vend të tyre solli të rinj, njerëz pa përvojë dhe marioneta që besnikërisht e verbërisht do të jenë në shërbim të Shaqir Fetait.

Natyrisht, ky dështim i strukturave policore dhe i disa besnikëve të Ali Ahmetit e ka dëshpëruar rëndë këtë të fundit, i cili, të gjithëve, sidomos grupit të Gostivarit që e tradhëtuan në këtë aksion, ua ka bërë të qartë që, Shaqir Fetai nuk e ka përkrahjen e katundarëve të vet dhe se, me këtë zgjedhje që kanë bërë shumë shpejt do t'i arrijë mallkimi i gostivarasëve të cilët edhe mund t'i ndëshkojnë me mosdhënie të votës.

Tani, BDI-ja si parti, do të duhet të kalkulojë me vota e me numra dhe, të dalë në përfundim se, sa do të fitojnë e sa do të humbin me përzjerjen e tyre brenda BFI-së, sidomos me instalimin në krye të këtij Institucioni të Shaqir Fetait, i cili, madje edhe publikisht u padit nga viktima e tij, Nexhat Ibrahim, teolog shumë i nderuar në botën shqiptare, të cilin Shaqir Fetai, nën nofkën “ORAO”, e kishte spiunuar për interesa të UDB-së deri sa kishin qenë studentë në Sarajevë.

Nëse konstatimi i Ali Ahmetit do të dalë i vërtetë, atëherë BDI-ja do të nisë të ndëshkohet që nga Çegrani dhe ndëshkimi do të shkojë me efektin domino! Populli di ta respektojë liderin por edhe di ta ndëshkojë duke e mbrojtur nga rriqërat si puna e Shaqir Fetait! Rriqëra nëse nuk shkulet në rrënjë, vazhdon e ta thithë gjakun duke ta pezmatuar vendin dhe tërë trupin, madje edhe dheun e varrit!

***/Fakte/28.05.2023/***

## ***Kryebashibuzuku i BFI-së***

***Këta të Bashkësisë Fetare Islame në RMV a dinë të punojnë me Kushtetutën e këtij Institucioni, a dinë ta lexojnë dhe a e kuptojnë këtë akt më të lartë juridik në të cilën thirren për çdo ditë, apo e interpretojnë sipas dëshirave dhe nevojave të honxho-bonxhove. Dikush duhet t'i thotë STOP anarkisë totale në BFI që u shfaq me instalimin politik të Shaqir Fetait në krye të këtij Institucioni***

***Nga Mr. Eset Shaqiri***

Këto ditë shpërtheu në BFI-në e Shaqir Fetait. Dymbëdhjetë (12) anëtarë të “rijasetit” i shprehën mosbesim Shaqir Fetait, i cili, po atë ditë, “i ruajtur dhe i siguruar” nga policë dhe njësi special, nga ora 01 e deri në ora 04 e mëngjesit, mbajti mbledhjen urgjente duke iu kërcënuar dhe duke ua kërkuar nën kërcënime përkrahjen anëtarëve të tjerë të Rijasetit, kurse ndaj “organizatorëve” mori masa duke i shkarkuar “me automatizëm” nga Rijaseti dhe duke i sistemuar degradueshëm nëpër vende të reja të punës të papërshtatshme sipas përgatitjes akademike dhe profesionale.

Shaqir Fetait thotë se nuk ishte “puç”, ndërsa atë që e bëri fiks para tri viteve kundër H. Sulejman ef. Rexhepit – çka ishte ajo? MPB prononcohet se nuk dinë gjë dhe se nuk kanë pasur kërkesë për asistencë policore në atë “mbledhje urgjente” për ta ruajtur kolltukun e Shaqir Fetait, ndërsa oborri i BFI-së, përreth dhe brenda saj, ka qenë “full” me “sigurimsa” (ekzistojnë edhe fotografitë dhe incizimet)! Shtrohet pyetja: të kujt ishin këta policë: të shtetit apo të Shaqir Fetait që i ka angazhuar privatisht. Çdo angazhim paguhet ose me para ose me kundërsërbim! Si do ta paguajë Shaqir Fetait këtë asistencë policore?

Shaqir Fetait paska thënë se “Kushtetuta është një copë letër”! Këtë e dëshmon “punëtori” Prof. Jusuf Zymeri, i cili deri më sot në BFI ka qenë DREJTOR i sektorit për arsim dhe çështje fetare në BFI!

Pra, çka thotë Kushtetuta e BFI-së, kjo farë “copë letre” sipas Shaqir Fetait? A di ta lexojë ky farë punëtori i thjeshë i BFI-së këtë Kushtetutë apo, e lexon ashtu siç i vie lezet atij! Për ndërrimin e vendit të punës dhe për shkarkimin e anëtarit të “rijasetit”, Shaqir Fetai thirret në nenin 43 dhe sjell këtë vendim, me këtë përmbajtje: Në bazë të nenit 43 të Kushtetutës së Bashkësisë Fetare Islame të RMV, Reisul Ulema i BFI sjell këtë VENDIM... Në arsyetimin e këtij vendimi që nuk është asgjë tjetër përveçse një paçavurë toaleti, thotë: “Reisul Ulma i BFI-së, në përputhje me kompetencat dhe autorizimin e tij, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi”!

## **Çka thotë neni 43 dhe ai 44 i Kushtetutës së BFI?**

Që t’ju dëshmojmë se punëtorët aktual të Shaqir Fetait, të cilët nuk marrin erë nga administrata, nuk e kuptojnë dhe nuk dinë të lexojnë dispozitivë, akte juridike, rregullore, statute, kushtetutë, madje as parimet elementare islame, duke shkaktuar plotë fallcitate, më poshtë po ua sjellim në tërësi nenin 43 të kësaj Kushtetute:

“Neni 43

Rijaseti i BFI-së zgjedh Këshill të posaçëm për dorëzimin e Menshurës.”

Ndërsa një nen më poshtë, ai 44, (në të cilën dëshirojnë të thirren punëtorët bilmeza të Shaqir Fetait), thotë:

Reisul -Ulema:

- përfaqëson Bashkësinë Fetare Islame në vend dhe jashtë;
- jep murasele (autorizim) për kryerjen e punëve fetare, pa të cilën tërheq kontest të legjitimitetit;

- emëron dekanët, drejtorët dhe mësimdhënësit të institucioneve arsimore të BFI-së dhe 1mësimdhënësit e lëndës së mësim-besimit në shkollat publike.

- organizon dhe mbikëqyr punën e shërbimeve profesionale të BFI-së.

- konvokon dhe udhëheq seancat e Rijasetit dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve të tij;

- ndërmjet dy mbledhjeve të Rijasetit, kryen punë të domosdoshme që janë në kompetencë të Rijasetit dhe për këtë informon Rijasetin në seancën e radhës.

- nënshkruan aktet e Rijasetit;
- nënshkruan aktet për punësim në BFI;
- ndan shpërblime për të arritura të veçanta në avansimin e jetës fetare;

- viziton regjionet në të cilët jetojnë pjesëtarët e fesë islame; që

të njihet drejtpërdrejtë me gjendjen dhe propozon masa për zhvillimin dhe avansimin e jetës fetare;

- lejon pushimet e muftive, dekanëve, drejtorëve të medreseve, drejtorëve dhe kryetarëve të institucioneve, shoqatave të cilat janë në mbikqyrje të Rijasetit;

- ka të drejtë të pengojë ekzekutimin e vendimeve të organeve dhe të institucioneve të BFI nëse konstaton se të njëjtat janë kundërshtim me ligjin dhe parimet islame dhe të njëjtat t'i kthejë në rishqyrtim, kurse vendimin përfundimtar e sjell Rijaseti i BFI-së.

- dekreton vendimet e marrura nga Rijaseti i BFI-së.

Kurse Neni që flet për kompetencat e Rijasetit, pra jo të Reisit, mes tjerash thotë: emëron, ndërron dhe shkarkon anëtarët e Rijasetit.

## Sharlatantizmi i Shaqir Fetait

Prej nga ky guxim i Shaqir Fetait që të tallet me aktet normative të BFI-së? Pse Shaqir Fetai i lexon ato sipas dëshirës së tij. Apo, këtu nuk kemi të bëjmë me dëshirë por me “forcë”! Ku e merr Shaqir Fetai tërë këtë forcë për ta bërë “copë letër” të thjeshtë Kushtetutën? Kush po i rri mbrapa, kush po e siguron derisa ky të bëjë harakiri me Kushtetutën!

Pra, sipas këtij neni dhe, përgjithësisht, sipas Kushtetutës së BFI-së, reisi nuk sjell vendime, reisi i nënshkruan aktet e Rijasetit, apo, nënshkruan vendimet e marrura nga Rijaseti i BFI-së! A e solli “rijaseti” i Shaqir Fetait një vendim të tillë? Nëse e solli, pse fshihet mbledhja në të cilën u sollën “këto vendime”! Pse Shaqir Fetai mohon se ka pasur ndonjë mbledhje të “rijasetit” të vet! Si guxon Shaqir Fetai të sillet si një autokrat klasik dhe, nga kush e mori ai këtë guxim, madje të flasë edhe fjalë të rënda, fyese dhe të pista kundër “12 apostujve të Jezu Krishtit” (siç po i quan Shaqir Fetai “rrebelët”) të cilët nënshkruan mosbesim kundër tij! A mund të vlejné vendimet e një “organi kolektiv” fetar kur aty të mungojnë 12 anëtarë të përjashtuar të organit? Shaqir Fetai “mburret” duke thënë se nuk e kontrollon vetëm një xhami, ndërsa doli puna që ai nuk i kontrollon 12 anëtarët e “rijasetit” të vet!

Vendimet e Shaqir Fetait janë nul (zero), sepse ai nuk guxon t’ia marrë kompetencat organit kolektiv. Në një rast të tillë, Shaqir Fetai dëshmon se është njeri shumë i rrezikshëm dhe automatikisht duhet të refuzohet madje edhe si hoxhë e jo vetëm si ndonjë funksionar i BFI-së! Të manipulojë, të sillet si autokrat, si diktator, të shkelë Kushtetutë duke emërtuar anëtarë Rijaseti vetëm sa për të siguruar kuorum në “rijasetin” e vet, ndërkohë që nuk i njeh aktet normative,

kjo mjaftueshëm dëshmon për një njeri i cili tërësisht e ka humbur rrugën në oborr, duke u munduar që ta interpretojë dështueshëm një mafioz të pistë!

### ***P.s.***

Ish-reisul ulema i BFI-së, kur e përjetoi tradhëtinë e madhe, i zhgënjyer dha dorëheqje! Ai edhe pse kushtetutshmërisht mund t'i shpallte vendimet e puçistëve si “zero vendime”, ai megjithatë, i zhgënjyer nga bashkëpunëtorët e vet, nga ata në të cilët kishte plotë besim, ndjeu detyrim moral që të japë dorëheqje. Këtë moral nuk e ka Shaqir Fetai, ai ka “moral” që të ngritet mbi Kushtetutën dhe të shpërndajë rrena, mjegull dhe “vlera” inegzistente në BFI-në aktuale. Shaqir Fetai ka ardhur me mision: ta devalvojë jetën fetare islame, ta shkatërrojë BFI-në duke e shndërruar atë në filiale të thjeshtë të Ministrisë së Punëve të Brendshme! Shaqir Fetai një orë e më parë duhet të tërhiqet dhe të lëngojë i izoluar në shtratin e tij të pabesisë, të tradhëtisë dhe të mosbesimit! Këtë virus shkatërrimtar nuk guxon ta përhapë edhe më tej! ***/TetovaSot/03.06.2023/***

## ***Pse duhet të shporret Shaqir Fetai***

***Kohë më parë, 12 bashkëpunëtorë të Shaqir Fetait, ata që e bënë “reis”, i shprehën refuzim, pakënaqësi totale për punën prej hajduti dhe rrenci që e ka ushtruar për këto tri vite që kur nga struktura të dyshimta politike u instalua dhunshëm në krye të BFI-së***

***Nga Mahir Rexhepi***

A ra nga “froni” Shaqir Fetai? A mund të mbahet posti i “reisit” me përkrahje të policisë së shtetit! Ç’i duhet një post i tillë Shaqir Fetait i cili tashmë u shkarkua nga 12 anëtarë të “rijasetit” të tij, i trembëdhjeti (ai nga Dibra) u kërcënua me polici dhe u detyrua që të vijë e t’ia japë nënshkrimin përkrahës Shaqir Fetait, ndërsa i katërbëdhjeti anëtar (“myftiu” i Prilepit) nuk ka të drejtë vote, sepse ai nuk mund të jetë myfti, sepse ai është pa shkollim të lartë!

Ishin po këta anëtarë Rijaseti që u manipuluan nga Shaqir Fetai dhe e shkarkuan ish-reisin, H. Sulejman ef. Rexhepin. Të joshur nga shumë premtime, të joshur me fjalë boshe dhe pa program konkret, të joshur me ëndërra dhe pa strategji konkrete, po këta anëtarë “rijaseti” i dhanë përkrahjen Shaqir Fetait dhe votuan për lehtësimet instaluese të tij në krye të BFI-së! Natyrisht “magjia” asnjëherë nuk është e përrjetshme, një ditë lëshon dhe hapen sytë: dymbëshjetë anëtarë të “rijasetit” të Shaqir Fetait i lexuan qartë synimet e Shaqir Fetait: të vjedhë sa më shumë, ta shatërrojë sa më shumë BFI-në dhe ta degradojë tërësisht jetën fetare islame në RMV. Kjo ishte arsyeja e rebelimit të tyre dhe jo, siç deshti ta kanalizojë protestën Shaqir Fetai – “për shkak të rritjes së çmimit të Haxhit”. Çmimet janë çdo herë të ndryshueshëm dhe, varësisht nga parametrat ekonomike në shoqëri caktohen çmimet, proces ky që mund të jetë lehtësisht i arsyetueshëm.

Pra, “rrebelimi” i bashkëpunëtorëve të Shaqir Fetait nuk ishte as çmimi i haxhit dhe as puçi siç e interpreton i gjori. Rrebelimi i tyre ishte vetëm si reflektim mbi punën prej hajduti dhe rrenci, reflektim

mbi veprimet amatoreske dhe hipokrite që po i bën çdo ditë Shaqir Fetai. Tashmë të gjithë në BFI dhe në shoqërinë myslimane të vendit e kanë të qartë se Shaqir Fetai është dëmi më i madh që i ka ndodhur në historinë e vet BFI-së por edhe myslimanëve të vendit.

## **Zbërthimi i magjisë**

***Kohë më parë, 12 bashkëpunëtorë të Shaqir Fetait, ata që e bënë “reis”, i shprehën refuzim, pakënaqësi totale për punën prej hajduti dhe rrenci që e ka ushtruar për këto tri vite që kur nga struktura të dyshimta politike u instalua dhunshëm në krye të BFI-së***

***Nga Mahir Rexhepi***

A ra nga “froni” Shaqir Fetai? A mund të mbahet posti i “reisit” me përkrahje të policisë së shtetit! Ç’i duhet një post i tillë Shaqir Fetait i cili tashmë u shkarkua nga 12 anëtarë të “rijasetit” të tij, i trembëdhjeti (ai nga Dibra) u kërcënua me polici dhe u detyrua që të vijë e t’ia japë nënshkrimin përkrahës Shaqir Fetait, ndërsa i katërbëdhjeti anëtar (“myftiu” i Prilepit) nuk ka të drejtë vote, sepse ai nuk mund të jetë myfti, sepse ai është pa shkollim të lartë!

Ishin po këta anëtarë Rijaseti që u manipuluan nga Shaqir Fetai dhe e shkarkuan ish-reisin, H. Sulejman ef. Rexhepin. Të joshur nga shumë premtime, të joshur me fjalë boshe dhe pa program konkret, të joshur me ëndërra dhe pa strategji konkrete, po këta anëtarë “rijaseti” i dhanë përkrahjen Shaqir Fetait dhe votuan për lehtësimet instaluese të tij në krye të BFI-së! Natyrisht “magjia” asnjëherë nuk është e përrjetshme, një ditë lëshon dhe hapen sytë: dymbëshjetë anëtarë të “rijasetit” të Shaqir Fetait i lexuan qartë synimet e Shaqir Fetait: të vjedhë sa më shumë, ta shkatërrojë sa më shumë BFI-në dhe ta degradojë tërësisht jetën fetare islame në RMV. Kjo ishte arsyeja e rebelimit të tyre dhe jo, siç deshti ta kanalizojë protestën Shaqir Fetai – “për shkak të rritjes së çmimit të Haxhit”. Çmimet janë çdo herë të ndryshueshëm dhe, varësisht nga parametrat ekonomike në shoqëri caktohen çmimet, proces ky që mund të jetë lehtësisht i arsyetueshëm.

Pra, “rrebelimi” i bashkëpunëtorëve të Shaqir Fetait nuk ishte as çmimi i haxhit dhe as puçi siç e interpreton i gjori. Rrebelimi i tyre ishte vetëm si reflektim mbi punën prej hajduti dhe rrenci, reflektim mbi veprimet amatoreske dhe hipokrite që po i bën çdo ditë Shaqir



Fetai. Tashmë të gjithë në BFI dhe në shoqërinë myslimane të vendit e kanë të qartë se Shaqir Fetai është dëmi më i madh që i ka ndodhur në historinë e vet BFI-së por edhe myslimanëve të vendit.

## **“12 apostuj judaistë të Jezu Krishtit”**

Po kush janë këta “12 apostuj judaistë të Jezu Krishtit” siç i quan Shaqir Fetai 12 të pakënaqurit me “reisin” e tyre?

Janë po këta që i duartrokitën instalimit të Shaqir Fetait në krye të BFI-së;

janë bashkëpunëtorët më të ngushtë dhe më besnikë të Shaqir Fetait;

janë bashkëveprimtarët e tij;

janë 12 “organe” që me dekret e me autorizim të Shaqir Fetait ushtruan detyra jetike për BFI-në,

që patën qasje në lloj-lloj dokumenti dhe vendimi autokrat të Shaqir Fetait (sidomos në ato vendime që e lehtësojnë vjedhjen e buxhetit dhe të pronës së BFI-së)!

Po pra, janë edhe të dymbëdhjetët që përjetuan zhgënjim të madh, që u dëshpëruan nga karakteri i dobët dhe i ulët i Shaqir Fetait që është i prirur për rrena dhe për vjedhje. Janë po ata për të cilët sot Shaqir Fetai thotë se “janë bërë të m’i japin gratë e tyre vetëm që t’ua falë” (madje janë po ata të cilët Shaqir Fetai i etiketon me “pederastë”, me “spiunë” me “bashkëpunëtorë të UDB-së” etj.)! Dhe, asnjëherë nuk i tregoi popullit se me çfarë strukturash të prishta paska qenë i detyruar të bashkëpunojë!

Shaqir Fetai duhet të dijë se, ky është vetëm një fillim i asaj se çfarë do ta gjejë në vazhdim, sepse “të tradhëtohesh” prej 12 bashkëpunëtorëve nuk është punë që duhet të neglizhohet aq lehtësisht!

Po çka thotë Shaqir Fetai për këta 12 bashkëpunëtorë, kolegë e shokë të deridjeshëm?

## **Si e zbrërthen Shaqir Fetai vetëveten**

Në një “diçiturë” të tij, në do “aforizma” analfabetësh që mundohet t’i shkruajë Shaqir Fetai, na kishte mbajtur një “ligjeratë” mbi atë se çka do të thotë shok, si mbahet dhe si ruhet shoku etj.

“Shoku i mirë është dhuratë nga Zoti. Është nder i veçantë, por edhe përgjigjësi ndaj tij.”, thotë Shaqir Fetai në “diçiturën” e 16-të të tij! Frazë kjo tipike e një hipokriti, e një qenie të rrezikshme për të cilën shkruan edhe Kurani Famëlartë!

Sot, kur i dëgjojmë prononcimet, vlerësimet dhe konstatimet e shumta më hershme të Shaqir Fetait mbi Sulejman ef. Rexhepin, na del puna se e paskësh pasur shok më të ngushtë të jetës! Si përgjigje e kësaj “dashnie” po kaq lartësisht është prononcuar edhe Sulejman ef. Rexhepi për Shaqir Fetain! Shaqir Fetai e nderoi me përulësi prej një butaku Sulejman ef. Rexhepin, kurse përgjegjësia e tij paskësh qenë përgjegjësi e kriminelit, gjegjësisht, detyrë e pisit për t’ia ngulur thikën pas shpine shokut më të mirë që e pati dhuratë prej Zotit! Këtë akt hipokrit e soditën mbarë popullata e vendit dhe këtë fakt nuk mund ta mohojë vogëlsia e Shaqir Fetait.

Më tej, Shaqir Fetai në “diçiturën” e vet thotë: “Është obligim hyjnor të jetosh me të, me të mirat, vlerat, gëzimin, pikëllimin, hidhërimin, sikletin, vështirësitë, dhimbjet e tij në çdo moment, kohë dhe hapsirë.”! Këtë obligim hyjnor Shaqir Fetai e zbatoi deri në çastin kur iu shit shejtanit, deri në momentin kur hyri në pazaret dhe skenaret e strukturave antiislame për t’ia ngulur thikën pas shpine shokut ndaj të cilit kishte pasur “obligim hyjnor”! Në fakt Shaqir Fetai këtë sintagmë “obligim hyjnor” e nxjerr nga konteksti i sintagmës “parim islam”! Shaqir Fetai këtu nisi të shkelë obligime hyjnore e parime islame, vetëm e vetëm që t’ia rrëmbejë bashkëpunëtorët, shokët, H. Sulejman ef. Rexhepit dhe t’i fusë në aventurën e planifikuar për rrënimin e tij! A e di Shaqir Fetai se çka do të mbjellë atë edhe do ta korrrë?!

## **Kur Shaqir Fetai “flet objektivisht”**

Shaqir Fetai thotë në “diçiturën” paçavër të tij: “Andaj, më e shëmtuara është të lejosh dhe t’ia mundësosh shokut të hidhet në të keqe, në mbytje, në zjar, në humbje, në përçarje, në tradhti, etj., sepse kjo do ishte hudhja edhe e ytja në humnerë.”

Si rallë herë Shaqir Fetai na del objektiv. E pranon publikisht se veten e ka hedhur në humnerë, në rastin konkret, në shpellën e mëkatshme! Shaqir Fetai, si skuth ndenji duke e pritur momentin e kthimit të shpinës sa për t’ia ngulur thikën Sulejman ef. Rexhepit! E pat shok, bashkëmendimtar, bashkëveprimtar, udhëtar krah për krah deri në momentin kur e hutoi efendi Rexhepin! I tha, ta ngula thikën sepse tërë kohës po e shkel nenin 58 të Kushtetutës! Kurrë nuk ia tha paraprakisht një fjalë, kurrë si shok nuk e udhëzoi, nuk e kritikoi, nuk e stopoi së vepruari keq, së hedhuri në zjarr, në humbje, porse vetëm ia fërkonte shpinën, bolet, derisa në fund ia nguli thikën. Prandaj, sot, Shaqir Fetai ndjehet si i hedhur në humnerë, sepse e di se çfarë ka bërë; është plotësisht i sigurt që edhe ai duhet të pësojë po të

njëjtën siç ia bëri pararendësit të vet! Sepse, Allahu Fuqiplotë thotë: “... Nuk është kështu, por keqbërësit i premtojnë njëri-tjetrit vetëm mashtrime.” (El Fatir, 40) A ka më keqbërje se sa ta bëshë praktikë tradhëtinë dhe uzurpimin pa meritë të posteve në Bashkësinë Fetare Islame? Ata që e bëjnë këtë veprim të keq, ata edhe do të premtojnë në mes vete rrena, mashtrime, pas së cilave do të pasojë zhgënjimi. Pra, nuk bëhet fjalë këtu për dhimbjen e madhe të Shaqir Fetait sepse e paskan “tradhëtuar” do shokë të cilëve ky u paska besuar sinqerisht, por, bëhet fjalë për ndëshkimin e Zotit të Madh kundër keq-bërësve që kanë ndarë premtime në mes vete, duke mos u frikësuar fare se ato “premtime” dhe hesape mund t’ua prishë i Plotëfuqishmi!

Vazhdon Shaqir Fetai në “diçiturën” e vet numër 16: “Keni kujdes, shoku është mbikqyrja dhe shërbimi ndaj tij. Andaj, ta hudhish në kurthe dhe humnerë është tradhtia më madhe.” A ka tradhëti më të madhe nga ana e Shaqir Fetait se sa momenti kur ai doli publikisht dhe e tradhëtoishokun e vet të jetës, efendi Rexhepin! A ka tradhëti më të madhe se sa momenti kur ata që e përkrahën instalimin e tij në krye të BFI-së, tash, i zhgënjyer prej tyre, i hedh në humner duke i tradhëtuar rrast! Ata i kanë besuar për një çast, e kanë ndihmuar, e kanë përkrahur, ndërsa tani janë kthjellur dhe e kanë kuptuar që Shaqir Fetai është katastrofa e kombit dhe e fesë prandaj, të zhgënjyer, ia tërheqin besimin. Ky nuk i respekton duke u tërhequr por, merr masa kundër tyre dhe i shpallë armik, meqë po ia shpalosin të gjitha gjynahet Shaqir Fetait!

Dhe, fare në fund, Shaqir Fetai e përmbyllë me këtë fjali “diçiturën” e vet: “Mbros shokun nga humnera. Ky është dinjiteti yt.”

Cili është dinjiteti i Shaqir Fetait të padinjitetshëm?! Shaqir Fetain duhet ta mbrojnë të gjithë, të gjithë duhet t’i servilosin, të gjithë duhet ta përkrahin në mëkat, sepse e përkrahën njëherë kur ky ia nguli thikën shokut të vet më të ngushtë, i cili u bë sebeb që Shaqir Fetai të ketë një karrierë të gjymtë. Ai nuk paska qenë shok! Shok paska qenë vetëm Shaqir Fetai dhe, nëse ju nuk e përkrahni, do të ngelni pa dinjitet dhe pa vende të punës! Ky po që po na del një satrap i përkrahur nga forcat e errëta. Tek do të dalin mbi ujë pislleqet e tij! Kur do të notojë si m... mbi ujë, atëher do të pështyhet prej të gjithëve, madje edhe prej vetë përkrahësve dhe instaluesve të tij. Diçka po kundërmon fliqetë në horizont!

***/Bota/06.06.2023/***

## ***Sjellja dhe përmbajtja protokolare e hipokritit***

***Shaqir Fetai ka humbur pusullën, atij i duhet  
urgjentisht pushimi pensional! Ai u instalua  
politikisht në krye të një institucioni pa pasur  
përgatitje elementare për një karrierë të tillë.  
Shaqir Fetai është “humoristi” më i shpifur në çdo  
paraqitje të tij. Ai është skuth dhe, njëherit edhe  
hipokrit, i cili, mundohet që vjedhjet, tradhëtitë  
dhe dështimet institucionale, t’i kamuflojë me  
“përkrahje ndërkombëtare”! Sjelljeve prej dylberi  
të Shaqir Fetait do t’ia kishte lakmi edhe Narcisi***

***Nga Mahir Rexhepi***

Kohë më parë, Shaqir Fetai, ky instalacion i dhunshëm i strukturave të dyshimta politike, përjetoi një tronditje të thellë! Ata që u futën në skemat përkrahëse të tij kur u instalua në krye të BFI-së, tashmë ia kanë tërhequr besueshmërinë dhe kanë hedhur një lum akuzash dhe dyshimesh në punët e tij prej hajni dhe hipokriti. Dymbëdhjetë organe dhe anëtarë të “rrijasetit” të tij ia tërhoqën besueshmërinë, pas çka, Shaqir Fetai, për ta shpëtuar b... e vet, nisi t’i shkarkojë po ata që dikur ishin të flaktë në përkrahjen e tij në të gjitha shkeljet kushtetutare dhe në rrënim të imazhit fetar e kombëtar të BFI-së që e kishte ndërtuar decenie me radhë.

Shaqir Fetai nuk e pranon publikisht se ka pasur tronditje deri në themel të BFI-së së tij! Por ama, sjelljet e tij, hakmarria e tij dëshmon për të kundërtën. Ai po përgatitet që këto ditë t’i ndëshkojë e t’i largojë edhe dy myftinj të e pa përkulur, atë të Tetovës dhe atë të Kumanovës! Myftiu i Strugës, si butak që është, vetëm sa ka filluar t’i futet nën bolet Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai tashmë ka ngelur me “myftinj” që janë dëshmi e gjallë për atë se çfarë do të thotë analfabet funksional! Zatën, më të mirë e më të fortë nuk i duhen, sepse edhe vetë Shaqir Fetai është i tillë, analfabet gjysëm funksional.

Shaqir Fetai, i ngelur në grahmën e vet të fundit, nis dhe i thërret të gjithë ambasadat, një nga një, duke u thënë që mos ta takojnë dhe mos të komunikojnë me Mustafa Dautin, sepse qenka shumë i rrezikshëm dhe se, për shkak të rrezikshmërisë së lartë tashmë ai është shkarkuar nga posti i “ministrit të jashtëm” të BFI-së! Për informacion më të hollësishme, Shaqir Fetai i lutë që ta vizitojnë BFI-në dhe t’u shpjegojë se pse nuk duhet të kontaktohet me Mustafa Dautin. Pra, Shaqir Fetai Mustafa Dautin e përdor si krimb në grepin e hedhur për ta gjuajtur peshkun!

Dy ambasadorë, nga të gjithë të kontaktuarit dhe të ftuarit, tashmë i kanë ardhur Shaqir Fetait. Do t’i vijnë edhe shumë të tjerë, të cilët deri më sot nuk kanë dashur ta legjitimojnë njeriun i cili kap një pozitë duke shkelur çdo akt ligjor e kushtetues. Tani do t’i vijnë, edhe atë me të vetmin qëllim: që të binden se sa i rrezikshëm është Shaqir Fetai, dhe jo se i vinë për ta përkrahur, siç ua interpreton “të dashmëve” të vet vizitat e ndërkombëtarëve.

Të gjithë nga kori diplomatik që do t’i vinë, do të dëshirojnë të dëgjojnë për problemet e brendshme të BFI-së: për korrupsionin, për nepotizmin, për krimin e organizuar, për pakënaqësitë, rrebelimet, dështimet, sektarizimet. Ata nuk vinë për të dëgjuar “letërnjohtime të BFI-së”, sepse nuk kanë nevojë, siç nuk kanë nevojë të dëgjojnë as për organizimin e jetës fetare, sepse i dinë shumëfish më mirë seç mund t’i dijë Shaqir Fetai!

Shaqir Fetai e falënderon ambasadorin hungarez për kontributin e tij dhe të shtetit hungarez për ndihmën që po ia jep Maqedonisë së Veriut për euro-integrime. Përmbajtja protokolare e Shaqir Fetait është ose e vjedhur, ose e kopjuar, ose e huazuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të RMV-së! Shaqir Fetai sillet dhe përdor vokabular të institucioneve qeveritare. Shaqir Fetai nuk di të shpreh qëndrime opozitare karshi institucioneve shtetërore për padrejtësinë që i bëjnë mbi këtë institucion. Shaqir Fetai ka durimin e pelës dhe, është në gjendje të durojë gjithçka që i vjen nga shteti vetëm që të lavdërohet si përkrahës dhe kontribues në bashkëjetesë multikonfesionale! Dhe, për të dalur sa më skandaloz në protokol, ai kërkon nga ambasadori hungarez që të ndihmojë në akreditimin e Medresesë Isa Beu! Me këtë kërkesë, avdalli, nuk llogarit se po i nënçmon ministrat e BDI-së, ministrat që i kanë dhenë fjalë se do të ndihmojnë, ministrat që natë e ditë përpiqen për ta akredituar Medresenë por që ky akreditim hasë edhe në shumë pengesa juridike, të clat, nuk kalohen aq lehtë. Shaqir Fetai dëshmon se nuk u beson më ministrave shqiptarë ndaj dhe tashmë ndihmën e kërkon te kori diplomatik.

Edhe ambasadori francez në BFI qëndroi për t’u njohtuar nga

dora e parë me atë që tronditshëm ndodhi në BFI. Ndërsa Shaqir Fetai, për ta fshehur këtë fakt, ashtu siç po mundohet që ta fshehë gjatë tërë kohës, flet gjepura, fle për organizimin e jetës fetare në Maqedoninë e Veriut, flet gjëra të përsëritura e stërpërsëritura. E porositi gazetarin e paguar që të shtrijë pyetje të tipit “zoti ambasador, si po ju duket drejtimi i BFI-së nën udhëheqjen e Shaqir Fetait”! Natyrisht që ambasadori do t’i thotë fjalët më të mira, këtë ia kërkon bon-toni, kodi i mirësjelljes kur je mysafir! Se si po e drejton Shaqir Fetai BFI-në flet tërheqja e besueshmërisë nga 12 organe dhe anëtarë të “rijsetit” dhe ngelja e “rijasetit” të tij në mjeranë!

Shaqir Fetai tani më është në pritje të “ofensivës” së nëpunësve të tij si dhe të ambasadorëve që do të vijnë “për ta vizituar dhe për t’i dhënë përkrahje”. Por, në çka ta pëkrahin Shaqir Fetain? Në vjedhje të mëtejme? Në shkelje të mëtejme të akteve normative? Në degradim të mëtejme të BFI-së? Në shkatërrim të turpshëm të jetës fetare islame në RMV? Në sektarizim dhe në defaktorizim të xhematit myslimanë të vendit vetëm e vetëm për ta relativizuar peshën e tij si një trup i unifikuar? Shaqir Fetai po harron se kori diplomatik në vend tashmë është i njohtuar në hollësi me çdo gjë që po ndodhë në BFI dhe se tani do të shprehin dëshirë që të njohtohen edhe nga pala e “pushtetit” të Shaqir Fetait. Natyrisht që do të zhgënjehen dhe se sjellja e tij prej hipokriti veçsa do ta shtojë edhe më shumë simpatinë e ndërkombëtarëve karshi mospajtuesve me sjelljet dhe veprimet e Shaqir Fetait.

Të kota do të jenë edhe përpjekjet e Shaqir Fetait për ta puçur barkun e vet me barkun e diplomatëve gjatë përsëritjeve të tij. Kjo sjellje protokolare është tejet ofendese për secilin diplomat. Distanca prej gjysëm decimetri e këmbëve të veta me ato të diplomatëve gjatë qëndrimit në përsëritje flet për sjelljet prej dylberi të Shaqir Fetait. Shaqir Fetai ka nevojë për dashuri (mund ta ketë edhe dëshirë shpirtërore, epsh!) por, kjo dashuri e diplomatëve dhe vizituesve nuk arrihet duke u përsëndeur me manire prej dylberi. Kjo dashuri duhet të jetë respekt për punën që e bën nikoqiri. Në rastin konkret – çfarë pune po bën Shaqir Fetai përveçse që po vjedh dhe po shkatërron gjithçka të ndërtuar me mund e me gjakë? E gjithë puna e tij, që nga instalimi e deri te “masat disiplinore” kundër “rrebeluesve” është një dosje voluminoze e denjë për prokurorinë e shtetit, e cila, pa dyshim që një ditë do të aktivizohet. Është pikërisht heshtja para veprimeve të Shaqir Fetahajve që ka bërë të bie besueshmëria e ndërkombëtarëve dhe vendorëve në dy për qind ndaj organeve të drejtësisë.

Ky problem do të jetë i papërballueshëm për gjatë kohë për organet e drejtësisë, ndaj dhe, shumë shpejt do t'i gllabërojnë pikërisht “peshqët e mëdhnj”, ndërsa çifti i Shaqir Fetahajve për këta organe nuk perceptohet peshk më i madh se sa belvica!  
***/IKlikLarg/10.06.2023/***

## ***Manipulimet e BFI-së me çmimet e kurbanave***

***Kush e caktoi çmimin e kurbanit të sivjemë? Cili komision! Cili organ e miratoi këtë çmim? A pati tender për thertoret? A pati tender për frigoriferët për maganizimin e mishit? Tender për shitjen e lëkurave të kurbanëve, apo, sivjet ky kontribut i myslimanëve të vendit do të refuzohet? Me ligjet e vendit, gjithçka që shkon mbi vlerën prej 5000 eurove i nënshtrohet procedurës së tenderimit, nuk guxon të ketë marrëveshje në katër sy***

***Nga Jasir Jashari***

Në facebook-un e të ashtuquajturit reis, Shaqir Fetait, na është postuar një reklamë e BFI-së që ka të bëjë me kurbanët e sivjemë. Mbi trupin e lopës (pra, jo të deles-dashit) na është vendosur çmimi prej 160 euro, me qëllim që të krijohet një përshtypje e gabueshme se kaq kushton “ky kurban”! Manipulim i radhës!

Askush në BFI nuk di të na thotë se si u arrit deri te ky çmim! Askush nuk di të na thotë as përgjigjen tjetër që ka të bëjë rreth donimit të kurbanit! Në fakt, a do të ketë sivjet fare dhurim të kurbanit, sepse, pllakati zyrtar na thotë: “Pagesa bëhet në:... dhe numërohen vendet se ku mund të bëhet pagesa! Po ata që dëshirojnë të dhurojnë kurban të gjallë! Do të refuzohen? Nuk ka pikë grumbullimit të gjësë së gjallë që do të dhurohet për kurban?! Do me thënë që, sivjet BFI-ja merr vetëm pagesa për kurbanë dhe jo edhe kurban të gjallë!

Manipulimi i radhës, më flagrant, është ai që thekson: “Dhuro Kurbanin tënd për Medresenë”! Për cilën Medrese? Për atë që sivjet i pati 20 maturantë dhe 18 profesorë? Megjithatë, kërkesa është “korrekte”, sepse, kërkohet për Medrese e jo për medresantët, sepse, me Medrese përfshihen edhe profesorët, edhe edukatorët, edhe personeli teknik i Medresesë, edhe rojtarët, edhe guzhinjerët dhe, marur në përgjithësi, ky staf është dyfish më i madh se i nxënësve, të cilët, vit për vit janë në numër më të vogël!



Por, shtrohet pyetja se cila është ajo sasi e mishit e cila do të ishte e mjaftueshme për një vit për Medresenë. Sa ton mish duhet që brenda një viti të ushqehen mirë nxënësit si dhe ky staf që dyfish tejkalon numrin e nxënësve, të cilët, fundja, e paguajnë ushqimin e vet përmes participimit për t'u regjistruar në Medrese!

Nga sasia e përgjithshme e mishit të kurbanit që mblidhet çdo vit, nuk shkon më shumë se një e treta për nevojat e Medresesë, sepse mjafton kjo sasi! Pjesa tjetër, thuhet se shpërndahet ndër të varfërit, fukarenjtë, të ngratët dhe ata që janë në nevojë, ne vendin tonë!

Prandaj, nuk është mirë që BFI-ja edhe më tej të manipulojë dhe, në emër të Medresesë të tubojë kotribute të cilat në sasi shumë të vogla përfundojnë për nevojat e kësaj vatre mësimore fetare. BFI-ja duhet të kërkojë, të propagojë dhe të sensibilizojë opinionin mysliman të vendit që të dhurojnë kurbanë për ta zhvilluar humanitetit institucional në vendin tonë, që në mënyrë institucionale të shpërndahet kurbanit atje ku e do nevoja. Institucioni më i lartë fetar islam të vë dorë në çdo sofër të myslimanit skamnorë të vendit.

Po pse të bëhet pagesa e kurbanëve nëpër organet e caktuara të BFI-së dhe jo të dhurohet kurbanit si gjë e gjallë? Sepse, shpenzimet do të jenë më të mëdha dhe fitimi do të jetë më i vogël. Pra, nuk bëhet fjalë që të sigurohet mishi për Medresenë, porse të fitohet sa më shumë nga kurbanit! Nuk ka pagesë për therrje, për rjepje, për magazina-frigoriferë, për ushqyerje deri sa të theren.

Edhe diçka, po flitet se sivjet, pagesa për kurbanë do të jetë i madh! Mbi 2000 kurbanë të haxhilerëve mund të paguhen që të theren nëpër vise myslimane të Afrikës ku fukarallëku është i tmerrshëm. BFI-ja me këta kurbanë edhe do të bëjë sevap me fukarenjtë, edhe “do ta çojë në vend” amanetin po edhe do të fitojë rrastë, sepse, nëpër viset afrikane kurbanit nuk kushton më shumë se 80 euro! Pra, BFI-ja ka llogaritur që vetem nga kurbanet e haxhilerëve t'ua rëndojë xhepat myslimanëve të vendit për të përfutur vlerën prej 160 mij euro! Nëse do të paguheshin edhe rreth 5000 kurbanë siç paguhet mesatarisht çdo vit, dhe, kur dihet se një e katërta e tyre ndalet për nevoja të Medresesë, një e katërta e tyre mezi shpërndahet nëpër myftinë për të përfunduar kryesisht nëpër shtëpitë e operativës dhe të familjarëve të tyre, atëherë, është më se e qartë se, edhe dy të katërtat do të përfundojnë në viset afrikane ku kurbanit nuk kushton më shumë se 80 euro! Është krejt çështje tjetër se sa pritët kurbanit? Dyshimet gjithnjë e më të mëdha po bijnë mbi institucionin e BFI-së, mbi sinqeritetin e saj në raport me therrjen e kurbanëve. BFI-ja ka vendosur që për çdo farz islam të vë taksa të papërbalueshme për myslimanët e vendit! Taksat e dhunshme kanë të vetmin funksion – t'i

detyrojnë njerëzit të heqin dorë nga identiteti kombëtar dhe ai fetar!

Dikush duhet ta vëzhgojë dhe ta parandalojë, madje edhe ta sanksionojë tërë këtë manipulim në emër të fesë. Në emër të fesë po fitohet jashtëzakonisht shumë, në emër të fesë “të devotshmit” po ecin me makina lluksoze, kanë bërë shtëpia lluksoze me oborre të paimagjinueshme, në emër të fesë po shtrohen darka e dreka të majme, ndërkohë që fenë na e kanë lënë në duart e matrapazëve

***/Nistori/12.06.2023/***

## ***Ta shpëtojmë BFI-në sa s'u bëmë gaz i botës***

***Bashkësia Fetare Islame sa më parë duhet të vihet në binare të shëndosha, duhet t'i kthehet vetëvetes dhe t'ju shërbejë ekskluzivisht myslimanëve të vendit. BFI ka traditën e vet, ka historinë e vet dhe, për t'i ruajtur këto, i duhet një reformë e thellë dhe gjithëpërfshirëse! Kështu siç po zhvillohen punët, në mënyrë krejt amatore dhe krejt nonshalante, ky Institucion po ngelë pa perspektivë, ndërsa për këtë do të bartin përgjegjësi morale edhe ata që BFI-në e lanë në dorë të injorantëve që po drejtohen nga i gjori Shaqir Fetai***

***Nga Mr. Eset Shaqiri***

Tre vite më parë, njohës të hollë të akteve normative të Bashkësisë Fetare Islame, sidomos të Kushtetutës së saj, por dhe njerëz mjaft me përvojë në organizimin e jetës fetare institucionale, themeluan Këshillin për mbrojtjen e kushtetutshmërisë së BFI-së! Ky Këshill përkon me post-situatat e krijuara pas realizimit të një puçi klasik mbi ish-reisul ulemanë H. Sulejman ef. Rexhepin! Që nga kjo situatë, çdo gjë tutje po rridhte jasht kornizës kushtetutare si dhe të akteve të tjera normative të BFI-së. Të vetëdëshëm se disa qarqe jodashamirëse të këtij Institucioni po këmbëgulnin në instalim të një praktike shumë të shëmtuar dhe të rrezikshme në BFI (marrja e pushtetit me puç, ndihmuar nga qarqet politike të pushtetit), si dhe plotësisht të bindur se BFI-ja kurrë më nuk do të jetë në formatin e më parshëm, ngritëm iniciativën që vëllazërisht të kontaktojmë e të zhvillojmë debat konstruktiv me sa më shumë nëpunës të BFI-së, përfshirë këtu edhe “reisin” e instaluar, Shaqir Fetain, me qëllim të sensibilizimit të të gjithëve që çdo veprim përtej Kushtetutës së BFI-së do të ishte gabim fatal për perspektivën e këtij Institucioni. Dhe, ja ku jemi tani – gati sa s’jemi bërë gaz i botës!

Përpekjet tona, pra të Këshillit për mbrojtjen e kushtetutshmërisë së BFI-së, për të biseduar edhe me Shaqir Fetain, hasën në kundërshtimin e tij kategorik, në refuzimin brutal të tij me fjalë nga më banalet dhe duke na “qortuar” se pse ne kishim kontaktuar me ish-reisul ulemanë, H. Sulejman ef. Rexhepin!

Insistimi ynë në këtë debat vëllazëror ishte që të stopohen veprimet që binin ndesh me akteve normative të BFI-së, jo nga synimet për shkelje të qëllimshme të akteve normative, por, për shkak të mosnjohjes së tyre me materiet juridike të BFI-së. Ky Institucion ishte vënë nën llupën e organeve të drejtësisë si dhe të përfaqësuesve të shumtë diplomatikë të cilët e kishin Kushtetutën e BFI-së dhe po vërenin qartë se Institucioni ishte shndërruar në një fushëmëjdan bashibuzukësh!

Hapeshin “institute” me një qasje nonshalante mbi konceptin “Institut”, hapeshin sektore askund të parapara me Kushtetutën e BFI-së, ngriteshin në organe subjekte e drejtuar nga koordinatorë, harxhohej vakëfi (bonot në vlerë janë vakëf) në mënyrë të padhimbshme, krejt kjo që të krijohet mundësitë dhe “trupa votuese” e cila do t’ia siguronte zgjedhjen “reis” Shaqir Fetait deri në pensionimin e tij (në prill të këtij viti ai duhej të ecte)!

Periodha e pensionimit të Shaqir Fetait përkoi me një “puç” të ngjashëm, tashmë kundër tij, madje nga po të njëjtit që e zhvilluan më parë kundër H. Sulejman ef. Rexhepit! Shaqir Fetai, në vend se të jepte dorëheqje, sepse kundër tij ishin shprehur e nënshkruar 12 anëtarë të Rijasetit, Shaqir Fetai konvokoi mbledhje të jashtëzakonshme që zgjati prej orës 01 e deri në pra 04 të mëngjesit, duke u munduar që t’i bindë (po thonë edhe me polici) nënshkruesit se kishin bërë gabim, apo edhe duke informuar se kishte sjellë vendime për shkarkim apo edhe sistematizimin e tyre nëpër vende të tjera pune!

Shaqir Fetai erdhi dhe po e përfundon karrierën duke shkelur Kushtetutën dhe çdo akt tjetër normativ të këtij Institucioni! Meqë nuk kishte kuorum, meqë nuk kishte anëtarë të mjaftueshëm të Rijasetit, Shaqir Fetai ia merr kompetencat Rijasetit dhe silltet tamam si me qenë vetë ai “organ kolektiv” duke sjellë vendime jashtë kompetencave të veta të grabitura! Me këtë rast, i njollosoi, i devalvoi dhe i zhgënjeu të gjithë mbështetësit e tij nga segmentet politike të pushtetit, ndërsa, nuk e besojmë që nuk do t’i vë në lëvizje edhe organet e drejtësisë për t’ia tërhequr vërejtjen për keqpërdorim të pozitës, të detyrës zyrtare dhe për tejkallim të kompetencave!

Bashkësia Fetare Islame sa më parë duhet të vihet në binare të shëndosha, duhet t’i kthehet vetëvetes dhe t’ju shërbejë ekskluzivisht myslimanëve të vendit. Bashkësia Fetare Islame ka traditën e vet, ka

historinë e vet dhe, për t'i ruajtur këto, i duhet një reformë e thellë dhe gjithëpërfshirëse, në të kundërtën, druajmë se do të përfundojë keq! Kështu siç po zhvillohen punët, në mënyrë krejt amatore dhe krejt nonshalante, ky Institucion po ngelë pa perspektivë, ndërsa për këtë do të bartin përgjegjësi morale të gjithë ata që u bënë shkaktar që BFI-në ta lënë në dorë të injorantëve që po drejtohen nga i gjori Shaqir Fetaj! BFI-ja është shtëpi e hoxhallarëve dhe jo stacion policësh që pengojnë hoxhallarë për t'u futur në Shtëpinë e vet!

***/TetovaSot/18.06.2023***

## ***Dekompozimi politik i instalacionit fetar***

***Shaqir Fetai paska shkuar në Medrese për ta vizituar dhe për t'ia uruar postin dejtorit të ri të kësaj vatre të mesme profesionale! Drejtori është anëtar i “rijasetit” të Shaqir Fetait, si organ-institucion i BFI-së! Për ta thjeshtësuar për opinioninin e gjërë, po themi se, “rijaseti” është si një qeveri dhe, paramendoni të publikohet lajmi se si kryeministri vizitoi një ministri! Idiotizëm i skajshëm***

***Nga Mahir Rexhepi***

Instalacioni i segmenteve politike antikombëtare e antifetare në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, paska kryer një “vizitë urimi”!!! Në situata të caktuara qëllimi justifikon mjetet! Sepse qëllimi është i sinqertë, i domosdoshëm, jetik dhe, në këtë rast, mund të justifikohet edhe tradhëtia, edhe shkatërrimi, edhe përmbysja totale! Ky justifikim mund të pranohet nga këndvështrimi i debilit, faqeziut, të shiturit, fuksit!

Shaqir Fetai tradhëtoi, Shaqir Fetai u fut në skema të rrënimit dhe shkatërrimit të BFI-së; u fut në defaktorizimin dhe në sektarizimin e komunitetit mysliman të vendit. Për herë të parë në historinë moderne të vendit kemi të regjistruar “bashkësi fetare islame” të tjera, ndonëse kjo është rreptësisht e sanskionuar me ligj! Për herë të parë kemi xhami private, kemi xhami që drejtohen nga sektashë të cilët nxorën kokë duke e shfrytëzuar dobësinë dhe ligësinë e Shaqir Fetait. Për këto lëshime, për mbylljen e syve para këtyre situatave faktike, Shaqir Fetai paguhet, merr rrogë, merr hurma humanitare, merr bileta për t'u shëtitur herë pas here dhe për t'u befasuar me ndonjë peshqesh “vëllazëror”, me ndonjë aparat telefoni etj.

Shaqir Fetai e ka shumë të qartë se ai, prej 99 për qind të myslimanëve të vendit llogaritet element i huaj, i pa dëshiruar dhe shumë i rrezikshëm për perspektivën e fesë islame në vend.

Shaqir Fetai thellë në ndërdijen e vet e ka shumë të qartë se është i huaj edhe për Bashkësin Fetare Islame, ndaj dhe, si i huaj që është, pret e përcjell njerëz nga organet dhe institucionet e BFI-së, takime këto që në kushte normale do të llogariteshin si shumë jetike në funksion të punëve ditore dhe të mbarëvajtjes së punëve. Shaqir Fetai pret profesor nga Fakulteti i Shkencave Islame!!! Një lajm ky që mund të plasohet vetëm nga një zyre shumë e largët, nga një person që nuk ka të bëjë fare me Institucionin e vizituar!

Shaqir Fetai paska shkuar në Medrese për ta vizituar dhe për t'ia uruar postin dejtorit të ri të kësaj vatre të mesme profesionale! Drejtori është anëtar i “rijasetit” të Shaqir Fetait, si organ-institucion i BFI-së! Për ta thjeshtësuar për opinionin po themi se “rijaseti” është si një qeveri dhe, paramendoni të publikohet lajmi se si kryeministri vizitoi një ministri! Po pse e bën këtë Shaqir Fetai! Sepse, e din shumë mirë që emërimin që e bëri ai ishte i jashtëligjshëm, ndaj dhe mendon se “organet” e tilla janë jashtë orbitës së BFI-së dhe, vizitimet aty mund të sjellin ndonjë “përfitim”! Mund të urohet dikush që është i zgjedhur nga pala tjetër, është zgjedhur me konkurs në mesin e më shumë kandidatëve, apo që është emërtuar nga subjekte të huaja për BFI-në! Shaqir Fetai e uron drejtorin të cilin e emëroi vetë! A ka gjë më naive se kjo! Shaqir Fetai e paska vizituar Medresenë!!! A ka informacion më banal se ky! Është njëjtë sikur të thuhet se drejtori i fabrikës për prodhimin e aeroplanëve vizitoi repartin që prodhon krahë të aeroplanëve, apo bishtin e aeroplanit, ose edhe gomat e aeroplanit! Një lajm i këtillë do të ishte skandaloz dhe burlesk njëkohësisht.

Shaqir Fetai ia lejon vetes edhe të informojë për vizitën e organeve të veta që ua bën, edhe pritjen e dejtuesve të organeve të veta. Një organ kolektiv (si një qeveri), në kushte normale, do të duhej të ishte në një godinë, në takime të përditshme, në çdo orë, në çdo minut, të sillen vendime të përbashkëta dhe në kohë reale, dhe jo të vizitohen një herë në vit.

Sot, kur BFI-ja e Shaqir Fetait vizitohet prej qoftexhinjëve, prej guzhinierëve të suksesshëm, prej do nallbanëve e prej samarxhinjëve, dikur ky Institucion vizitohet nga burrshtetas të huaj e të kombit, nga komesarë ndërkombëtarë e nga faktorë me relevancë të konsiderueshme. Dikur ky institucion merrej me projekte jetike kombëtare, ndërsa sot merret me vizita të ambasadorëve maqedonasë si dhe për lavdëratat për faktin se si Maqedonia e Veriut i plotëson të gjitha kushtet për euro-integrime, thuase kjo propagandë është detyrë ekskluzive e “reisit”!

A mund të ndodhin gafa dhe informata të tilla nga taborri i komuniteteve të tjera fetare në vend siç i ndodhin Shaqir Fetait? A

mund të lexohet ndonjë lajm për z. Stefanin që ka vizituar ndonjë ipeshkëvi të vendit apo nonjë ambasador të Maqedonisë së Veriut. Kurrë! Sepse, ata liderë veprojnë ekskluzivisht në brendi të vijave të kuqe të jetës fetare. Askujt, asnjë force politike, asnjë subjekti shtetëror nuk i kanë borxh siç u ka Shaqir Fetai. Shaqir Fetai nuk po e kupton se tashmë është lexuar nga a-ja deri te zh-ja dhe se ai mbahet nën vëzhgim (qoftë edhe përmes “vizitave”) vetëm si element ruso-serb. Ai edhe në çastet kur është në “bashkëpunim” me botën arabe, është i angazhuar kryekëput për kazanin e politikave ruso-serbe. Këtë e ka dëshmuar jo një herë! Këtë tashmë e kanë kuptuar edhe qarqet politike që e instaluan, prandaj dhe po shprehen angazhime serioze për ta deinstaluar sa më parë! ***Fakte/19.06.2023/***



## ***Kuazi-lideri fetar***

***A ka Shaqir Fetai në “stafin” e vet gazetarë, redaktorë, a ka njohës të gjuhës shqipe. Po vetë ai, pse shtiret se e njej zejen e shkrimit, pse shtiret se e njej gjuhën shqipe, pse shtiret se është “redaksi” më vete, ndërkohë që “diciturat” e tij, “informacionet” në FB-un e tij janë dëshmi e një diletantizmi dhe të një analfabetizmi funksional të paparë në asnjë organizatë apo institucion tjetër. Medet, në çfarë niveli ka degraduar BFI-ja e kapur nga segmentet sharlatane***

***Nga Semiha Shaqiri***

Nëse në FB-un personal publikohet një link ku është i botuar ndonjë informacion që flet për kryetarin e shtetit, kryeministrin, dejtorin, liderin, kjo do të ishte e kuptueshme dhe do të trajtohej si përkujdesje e personit zyrtar për t'i grumbulluar shkrimet e ndryshme që shkruhen për të, por, kur vetë zyrtari publikon informacion të shkruar prej tij ndërsa vetes i drejtohet me titullin që e ushtron, kjo flet për narcisoizëm, flet për shqetësimin e vetë “funksionarit” të cilin nuk e pranon askush për të tillë! Për shembull, nëse futeni në FB-un personal të Shaqir Fetait, do të vëreni shkrime të shkruara prej tij e për vetëveten ku vetes i drejtohet me “reisul ulema”! Nuk thotë, për shembull, “sot isha”, apo, “sot pranova”, apo, “sot u takova” etj. por, gjithkund do të hasni në fjali idiotike të tipit “sot reisul ulema ishte”, apo” sot reisul ulema u takua” etj. etj.! Në facebook-un personal vetes i drejtohet me titull! Këtë e bën vetëm narcisi, Shaqir Fetai.

### **Shaqir Fetai duhet të ndëshkoht për bastardimin e sintaksës së gjuhës shqipe**

Duke qenë i bindur Shaqir Fetai se e njej mirë zejen e shkrimit, apo se është intelektual dhe autor i “plotë” librave (që të gjitha të paredaktuara, ose me redakturë nga bilmezët anonimë), duke qenë se

thellësisht e ndjenë bojkotin e “profesionistëve” që i ka të angazhuar në “stafin” e vet, apo edhe duke dyshuar në aftësitë e tyre profesionale, i rreket shkrimit të “lajmeve” dhe publikimit të tyre në fb -un e vet, ndonëse tërësisht janë jashtë standardit të shkrimit të gatshëm për publikim.

Le t’ia analizojmë lajmin e fundit të tij me titull

**“REISUL ULEMA PËRSHËNDET UDHËTIMIN DHE ARRITJEN E REHATSHME TË HAXHILERËVE NË MEKË.”**

Pra, titull me shenjë pikësimi në fund! Nuk ka njeri normal në botë që do të përshëndeste udhëtimin dhe mbërritjen e rehatshme. Ka njerëz që e lusin Zotin për udhëtim të mbarë, për arritje të rehatshme por ama, që të përshëndesë udhëtimin, kjo i ndodhë vetëm avdallit, Shaqir Fetai! Tutje, në informacionin e vet me plotë “mëlmesa” idiotike, Shaqir Fetai thotë: “Ishte një organizim i nivelit të lartë...”, “akomodimi i shpejtë në hotelin e Mekkes...”, “Reisul Ulema shprehi kënaqësinë e tij për udhëtim të rehatshëm dhe preciz...” dhe debilizma të ngjashme! Udhëtim i rehatshëm dhe precizi!!! Flet avdalli për teknikalitete, ndërsa nuk është në gjendje të thotë një fjalë se sa haxhilerët iu qasën këtij kushti në përputhje me normat islame të haxhit! Nëse i hy kësaj teme, do të dalë pastaj tërësisht në fushë të Allahut ku do të shihen të gjitha të metat që mund t’i ndodhin vetëm atij që nuk ka lidhje me parimet islame! A mund të jetë informacion “kryesia qendrore u takua në Mekke”, “Apo kryesia qendrore realizoi takim me stafin mjekësor të haxhilerëve tanë”. Apo, “kryesia qendrore takoi haxhilerët e Tetovës, apo të Shkupit, apo të Kumanovës”, në prag të Arafatit” etj. Qenka mbledhur kryesia për të raportuar se “të gjithë haxhilerët u akomoduan në hotel”! Qenkan tubuar për nevojën e kohëzgjatjes së ushqimit në hotel (apo në restorant), gjë që mund të realizohet me një urdhër apo kërkesë zyrtare! Qenkan prezantuar edhe programet fetare që do të zhvillohen në mesxhidin e hotelit! A nuk flet kjo për një angazhim spontan, pa kurrfarë planifikimi paraprak dhe pa kurrfarë vizioni paraprak mbi atë se si do të kryhet haxhi i sivjemë! Tani, na ka ngelur vetëm edhe informacioni se “me kërkesë të kryetarit të haxhit, mjeku ia mati temperaturën filan haxhi babës”! Secili mjek e di detyrën e vet, e di ilaçin, e di mjekimin, çka ka nevojë që t’i mbedhë kryetari i haxhit, vetëm sa për të bërë “lajm” ë?! Po kjo kryesi, këta hoxhallarë, ky farë “reisi” i hamamit, a u ka folur haxhilerëve se çka do të thotë veshja që në nisje e ihramit dhe çka do të thotë pastaj, me të vendosur në hotel, zhveshja e ihramit, bërja e dushit si dhe veshja dhe qëndrimi në rrobe të përditshme! Haxhilerët duhet të jenë nën këshilla të vazhdueshme se si ta plotësojnë haxhin në përputhje të plotë me normat e haxhit, sepse ky ibadet nuk kryhet

përditë, për dikë mund të jetë hera e parë dhe e fundit në jetën e vet. Ka paguar aq shumë sa i ka therur shpirti ndërsa nuk janë nën përkujdesin e “stafit profesional” të Shaqir Fetait, të cilit, më shumë se çdo gjë tjetër i interesojnë teknikalitetet, paratë e fituara nga haxhi dhe të arrijnë në mënyrë precize në Meke, sepse, ruana Zot, dyshimet e tij janë që mund të përfundojnë disa kilometra tutje, diku kah Jerusalemi, apo Jemeni! I ka këto dyshime i mjeri, i ka, sepse, siç e ka këtu të fraksionuar situatën, ashtu të fraksionuar i ka edhe anëtarët e “stafit të haxhit” të sivjemë! Detyrat, obligimet, rolet, angazhimet, përcaktohen para nisjes, e jo pasi të arrihet në vendin e caktuar, sepse kjo pastaj flet për dilema, për dyshime, për frikëra nga sabotazhi, nga shantazhi, nga rrebelimi! Shaqir Fetait nuk i intereson se a do të kryejnë haxhin në përputhje me normat e haxhit, e as a do të humbë ndonjë haxhi si pasojë e sabotimeve të ekipit të tij, dhe as nëse e njeh kryetari i haxhit arabishten si dhe të tjerët, apo jo. Me rëndësi të arrihet fondi ku do të mund të vjedhin të gjithë organizatorët e haxhit. Apo, hajde të mos themi të vjedhin por, me çmimin e lartë të haxhit të krijojnë fond për t’i dërguar në haxh lajkatarë e servilë (madje me gratë e tyre), të atillët që deri para nisjes në haxh janë larë në raki! Shaqir Fetait i intereson fondi i zi përmes të cilit do ta sigurojë rehatinë precize në kolltukun e fituar me haram!

## **Shaqir Fetai e pret dhe e dekoron ish-kordinatorin e Velesit**

Avnia Dervishovski dikur ishte koordinatorë i Velesit, atëherë kur në skenë vepronte edhe rahmetliu Jakup Selimovski! Shsqir Fetai atëherë ishte në kabinetin e Sulejman ef. Rexhepit, i cili po zhvillonte një luftë të ashpër me disa institucione shtetërore që ia kishin mundësuar Selimovskit regjistrimin e Bashkësisë Islame Ballkanike. Shaqir Fetai ishte një ndër “mentorët” e efendi Rexhepit, i cili, jo se kishte besim të madh tek të gjithë ata që i përkisnin komunitetit torbesh! Të gjithë i trajtonte me dyshime të theksuara si bashkëpunëtorë të Selimovskit. Shaqir Fetai kishte detyrë për ta përcjellë aktivitetin “kolaboracionist” të Avnia Defvishovskit, i cili, jo njëherë ka qarë si fëmijë nga presionet që ia bënin e që i vinin pikërisht nga Shaqir Fetai! Këtë pisllek më së miri e shpjegon Sulejman ef. Rexhepi! Kurse, Shaqir Fetai, i ndërë deri në vdekje në faj, e pranon këto ditë në zyre Avni Dervishovsin dhe, pa i kërkuar me asnjë fjalë falje, e dekoron me mirënjohje për kontributin që ka dhënë në BFI! Ky gjest mund të jetë vetëm i hipokritit jo analfabet, por, i hipokritit të djallëzuar!

## Lajkat foshnjëake të Shaqir Fetait

Shaqir Fetai për momentin është në atë situatë siç është edhe bebja e uritur që i bën mijëra lajka mamit të vet vetëm për pak tamël gju! Paska pritur një imam turk i cili paska shërbyer diku në katundet e Shtipit dhe që tani, pas pesë viteve paska vendosur që të kthehet në Turqi. Dhe Shaqir Fetai për kontributin e tij i ndanë mrënjohje imamit turk. Po pse a nuk ka imamë në Myftininë e Shtipit që iu desht Shaqir Fetait të huazojë nga Turqia?! Po cili paska qenë ai kontribut i imamit turk që dallon nga kontributet e imamëve të tjerë që u shërbejnë xhematlinjëve të Myftinisë së Shtipit! Kush i raportoi Shaqir Fetait për kontributin e këtij imami kur e vërteta është se Shaqir Fetai kurrë nuk ka qenë në territorin e kësaj Myftinie, madje as që ka ditur gjë për angazhimet fetare të këtij imami turk, kurrë nuk e ka takuar imamin dhe as xhematin e këtij imami dhe, për më tepër, prezent nuk e pati as Myftiu e Shtipit i cili do të duhej të raportonte mbi aktivitetin islam të imamit në fjalë! Mysafiri duhet të nderohet dhe të respektohet, pa dyshim. Por ama, jo me kaq servilizëm, sepse na paske qenë mik i mikut të kushëririt të djalit të tezës së dajës pi kah halla e babës së atasheut për çështje fetare në ambasadën turke!

## Misioni i suksesshëm i katër medresantëve protestues

Ditë më parë, në protesta dolën hiç më shumë se katër medresantë të cilët shprehën angazhimin e tyre për ruajtjen e vlerave të familjes sipas parimeve islame por edhe sipas parimeve të feve të tjera qiellore. Një kundërvënie publike kërkesave gjithnjë e më absurde të komunitetit të LGBT-së. Këta katër të rinjë u tallën, u përçmuan, u ofenduan, duke u akuzuar si naivë, që kanë organizuar diçka madhore vetëm në mes vete! Në fakt, këta heronjë të ditës së sotme na e dëshmuar vetëm një të vërtetë, na dëshmuar se në angazhimin e tyre për një familje dhe shoqëri të shëndoshë janë vetë, se pas tyre nuk qëndron as Medreseja, as Fakulteti, as stafi i tyre, as BFI-ja, as hoxhallarët dhe as kërkush! Mesazhi nga kjo protestë e sinqertë ishte se, LGBT-ja përkrahës më të mëdhenjë mund të gjejë në mesin e “nëpunësve” dhe “institucioneve” të Shaqir Fetait. Ligjertata eventuale si dhe “komunikatat” shtërpe nuk e kanë peshën e protestës fizike!

## **Shaqir Fetai si “dekor”, si shishe e zbrazët coca-cole në vitrinë**

Në kohën e “xhaxhit”, shishet e zbrazëta, që kishin formë intersante, ruheshin, me to dekoroheshin vitrinat e dhomave të ndejës! Po këtë pamje ta jep edhe prezenca e Shaqir Fetait nëpër përcjellje të të diplomuarve nëpër universitete shtetërore që nuk i pranojnë medresantët tanë! Shaqir Fetai në rolin e “dekoracionit”! Shaqir Fetai nuk është në gjendje, madje dhe nuk guxon që si “lider shpirtëror” të ketë të drejtën t’u drejtohet të rinjëve me ndonjë porosi, sepse, ai është i bindur se sapo të ngjitet në podium të gjithë do t’i fëshkëllenin, do ta gjuanin me domate, me specat, me patate...

Lideri fetar nëpër evente të tilla, madje edhe më të mëdha e më të rëndësishme, është personi i rehatuar në krye të vendit. Është e paimagjinueshme që lideri fetar të mos e thotë një fjalë para të pranshmëve, para gjeneratës së re! A munda t’i ndodhë kjo, për shembull, Sulejman ef. Rexhepit, i cili, në Konferencën e Parë të liderëve fetarë botërorë, iu kërcënua haptazi Nikolla Gruevskit se do t’ia bojkotojë Konferencën nëse nuk do t’i jepet fjala për t’iu drejtuar mysafirëve nga mbarë bota! Asgjë nuk është fjala e dekanit apo e rektorit sa është fjala dhe porosia e liderit fetar! Fjala kurrë nuk mund t’i jepet një kuazi-lideri fetar, siç është Shaqir Fetai! Këtë e di edhe vetë ai, prandaj rri si macja nën sofër!

***/Fol/26.06.2023/***

## ***Singeriteti i haxhilerëve dhe idiotizmi i BFI-së***

***Një ditë më parë, BFI e RMV-së doli me komunikatë duke njohtuar se haxhilerët e Maqedonisë së Veriut me sukses e kryen haxhin e sivjemë. Ndërsa, pa kaluar akoma 24 orë, opinioni i vendit shokohet nga një video prej haxhit ku shihen se si haxhilerët e Kumanovës janë lënë në mëshirën e fatit!***

***Nga Jasir Jashari***

Një video shokuese po qarkullon nëpër rrjetet sociale dhe mediat e vendit që po flet për një numër të konsiderueshëm haxhilerësh nga Kumanova që, pasi kanë kryer ritualin e gjuajtjes së shejtanit, janë lënë në rrugë, shihen duke pritur që të vie t'i marrë dikush. Pas tërë asaj dite të mundimshme, pas tërë asaj dite të rënduar nga turma të mëdha të haxhilerëve nga tërë bota, nga vapa e papërballueshme dhe nga lodhja e ditëve të më parshme, ata ngelin në rrugë dhe presin që të vie t'i marrë dikush. Asnjë nga "kryesia e haxhit" nuk vërenë se po mungojnë jo një e dy haxhilerë, apo tre haxhilerë, që rëndom ndodhë përgjatë haxhit, por, po mungojnë mbi 50 haxhilerë!

Ky detal hapi shumë muhabete në opinionin e vendit. U tha: kështu kur në kryesi të haxhit gjenden persona që nuk e dinë arabishten; kështu kur në kryesi të haxhit shkojnë persona të sektarizuar dhe që mbrojnë interesa të huaja; kështu kur paraprkisht kryesia e haxhit nuk u mblodh asnjë ditë për t'u përgatitur me qëllim që skena të tilla të mos u ndodhin haxhilerëve tanë; kështu kur ua ngulin haxhilerëve çmimin e papërballueshëm dhe këta pranojnë që t'ua mbushin gushën Shaqir Fetait dhe honxhobonxhove të tij; pasi i kanë marrur paratë dhe pasi e kanë ndarë përfitimin haram, natyrisht që për kryesinë ka përfunduar haxhi, ndërsa haxhilerët është mirë që mos të lëvizin poshtë-lartë sepse askush nuk ka obligim që t'iu rrijë mbi kokë...

Vetëm BFI-ja e Shaqir Fetait e gjeti fajtorin! Sipas një "njohtimi"

që e lëshuan si fletërrufe, fajet nuk i paskan kryesia e haxhit, nuk e paskan ata që kanë qenë të obliguar dhe të paguar që të përkujdesen për çdo një haxhi, por, fajet i paska pasur “dikush” i cili incizimin e paska bërë në mënyrë tendencioze “për tu njollosur organizimi i mirëfilltë i haxhit 2023” dhe se na qenka shumë normale shkëputja e grupeve të haxhilerëve dhe humbja e tyre! Kjo na qenka shumë normale!

Në atë incizim shiheshin dhe flisnin haxhilerët e Kumanovës, që të gjithë të zhgënjyer, që të gjithë të lënë pas dore, ata ishin prindër të dikuj, ishin motra dhe vëllezër të dikujt! Çka mendon Shaqir Fetai, si janë ndjerë pjesëtarët e familjeve që janë në Kumanovë, si ndjehet djali kur e sheh nënën ulur në trotuar, të harruar e të braktisur, të mllefosur e të zhgënjyer. Kjo, sipas Shaqir Fetait mund të përkthehet edhe si sabotazhë e njerëzve të organizuar për pamje të tilla me qëllim që të “njolloset organizimi i mirëfilltë i haxhit 2023”!

Po në cilin haxh ka ndodhur që opinioni të njohtohet për humbjen e grupit të madh të haxhilerëve! Në cilin vit është njohtuar për dukuri të tilla? Kurrë! Sepse kryesia ka qenë kompakte, sepse kryesia ka qenë e organizuar mirë dhe e përkushtar për çdo haxhi që e ka pasur si amanet. Sivjet, me gjasë haxhilerët i konsideruan vetëm si valutë, si dollar e si euro, ndaj dhe humbja e tyre nuk paraqet kurrfarë problemi, sepse ka plotë haxhilerë të tjerë (siç ka edhe shumë para nëpër xhepa)!

Është jo islamike, është jonjerëzore, është përtej çdo parimi human që një Institucion për një problem të tillë të dalë me një njohtim idiotik. Në vend se Shaqir Fetai të kërkojë falje publike, në vend se të solidarizohet me trishtimin dhe dhembjen e familjarëve të haxhilerëve, në vend se të premtojë se do të marrë masa kundër kryesisë, ai, i shkreti, shikon “organizim sabotues” si dhe akt tendencioz për ta “njollosur organizimin e mirëfilltë të haxhit”! Do me thënë, haxhilerët e Kumanovës, në sinkronizim me dikë që është tendencioz kundër BFI-së, e paskan përgatitur këtë “material propagandistik” sa për ta nxirë fytyrën e faqeziut, Shaqir Fetai!

Cilitdo lider fetar që do t’i ndodhte ky problem, pa kurrfarë hezitimi do të ofronte dorëheqje të parevokueshme dhe nuk do të përpiqen që fajin ta kërkonte pesëmij kilometra larg ngjarjes. Po, këtë përpëlajtje “morale” do ta bënte vetëm një hipokrit që është i pashoq në vend e në botë ***TetovaSot/02.07.2023/***

## Shaqir Fetai po zhytet bashkë me kungullin e vet

Përpëlitjet e kohëve të fundit të Shaqir Fetait ngjasojnë si në përpëlitjet e bishtit të këputur të xhapinit! I shpërthyen plotë skandale gjatë këtyre ditëve. Në vazhdim do të ketë edhe më shumë, sepse, skandalet e tij tashmë janë të radhitur në sistemin domino: skandali shkaktonte skandalin tjetër!

Përkundër këtij fakti i gjori po mundohet që këto skandale t'i mbulojë me do "intervista të porositura" të haxhilerëve prej të cilëve kërkohet që të flasin fjalë sa më të mira sidomos për "mirë-organizimin" e haxhit me një çmim nga më të shtrenjtët në rajon!

Si mund të relativizohen me aq naivizëm faktet e pamohueshme, madje të dekomentuar! 2030 haxhilerë në një guzhinë hoteli i cili nuk është në gjendje për ta shtruar me orë të tëra një vakt ushqimor. Kolona kilometrike të haxhilerëve për vaktin e mëngjesit, të drekës, të darkës, duke i kaluar dhe lënë shumë kohën të namazeve!

Si mund të relativizohet humbja e haxhilerëve, lënia e tyre nëpër rrugë, pa udhëheqës të caktuar. Si mund që imami-udhëheqës të mos e vëreje se grupin e vet të haxhilerëve nuk e ka me vete dhe, përkundër kësaj, t'ia fusë pushimit nën fladën e kondicionerëve. Këtë idiotizëm Shaqir Fetai mundohet ta mbulojë me "Haxhilerët nga Ohri e Resnja sot me sukses e kryen haxhin", ndërkohë që sot, me sukses e kanë kryer haxhin të gjithë haxhilerët e botës! Apo, Shaqir Fetait i duhen "lajme" që do ta mburrin!

Nuk ka më mburrje falco për Shaqir Fetain, tatjpete e tij nuk ka të ndalur, urrejtja kundër tij gjithnjë po vjen duke u shtuar. Ai po braktiset prej të gjithëve, ai po përceptohet si person shumë i rrezikshëm i transplantuar në trungun kombtar e fetar nga "dora e zezë" që deri vonë e përgëdheli si "ORAO"!

Se sa përkrahet Shaqir Fetai ta sjellim këtu vetëm një kuriozitet! Ky është ai që ia hapi varrin dhe që e shtyu në varr ish-reisul Ulemanë H. Sulejman ef. Rexhepi! Bashkëpunëtorët e tij që si të magjepsur nisën ta përkrahin hajnin e postit të reisit, tashmë kanë reflektuar dhe e kanë braktisur. Do ta braktisin gjithnjë e më shumë, siç po e braktis edhe xhemati i rëndomtë. H. Sulejman ef. Rexhepi tash e një kohë të gjatë nuk është në opinion, është i izoluar e i marginalizuar, nuk është në asnjë post, nuk është në asnjë forum, nuk është prezent në asnjë event fetar, sepse e pengon Shaqir Fetai nga frika se mund të ulet pranë tij. Megjithatë, çdo paraqitje eventuale e tij, paraqet fakt dhe bëhet lajm i vërtetë: atë e duan shumë më tepër se Shaqir Fetain. E fundit: Shaqir Fetai na doli me një Mesazh për Kurban Bajram që



nuk ishte asgjë tjetër përveçse një hartim shkollor nga medresantët nismëtarë. Me mesazh doli edhe H. Sulejman ef. Rexhepi dhe, që të dy i publikuan në FB-un personal. Rezltati është ky: për mesazhin e Shaqir Fetait janë 291 like, 18 mesazhe-reagime dhe 7 shpërndarje, kurse për mesazhin e Sulejman ef. Rexhepit rezultati ishte tamam siç i ka hije një lideri: 543 like, 61 mesazhe-reagime dhe 19 shpërndarje!

Shaqir Fetai nuk po kupton se kungulli ka nisur t'i fundoset në ujë. Kjo fundosje ka inercionin e vet dhe, tatëpjeta po e zhytë edhe mjeranin, Shaqir Fetai!

***/LMR në BFI/Lajme7/03.07.2023/***

## ***Injoranti me potencë fizike***

**Këto ditë, një anëtar i Rijasetit (Jusuf Zimeri) i nis letër publike Shaqir Fetait, këtij instalacioni të shëmtuar në krye të BFI-së nga qarqe të shërbimeve antifetare e antikombëtare të vendit. Letra shpalos një mori defektesh dhe problemesh të turpshme në BFI që lindën me ngritjen e këtij farë instalacioni të haramshëm**

***Nga Mahir Rexhepi***

Një prej bashkëpunëtorëve më të ngushtë të Shaqir Fetait dhe, për nga klerarkia fetare njeriu i dytë i vendit (drejtor i Sektorit për çështje fetaro-arsimore) i shkruan letër publike Shaqir Fetait. Veç tjerash ia përkujton edhe një problem, i cili nuk guxon të shkojë aq lehtë, pa u analizuar mirë e hollë! Shaqir Fetai shpesh u paska thënë bashkëpunëtorëve të vetë “Jam shumë i fortë! Hiç nuk e keni idenë se sa i fortë jam bërë”! Dhe tani, të jetë ky kërcënim i Shaqir Fetait hiç nuk e duron toka, sepse, të gjithë e dinë, ama të gjithë ata që e njohin, e dinë se çfarë bithpambuku që është Shaqir Fetai, çfarë frikacaku e çfarë lëpiskaxhie ka qenë dhe mbeti! Me këtë shprehje prej avdalli Shaqir Fetai, në fakt, është munduar të demonstrojë pak forcë karshi atyre që, ose kanë qenë të shantazhueshëm, ose i ka pasur në grusht duke i lejuar që të vetësajojnë “dosje”, sepse, sipas letrës publike Shaqir Fetai jo një herë qenka mburrur se i ka në grusht do “hajna” të cilët i ka pasur në pozita të larta dhe me të cilët ka bashkëpunuar ngushtë! Edhe hajna edhe bashkëpunëtorë?!

Le të supozojmë se Shaqir Fetai na qenka bërë i fortë, madje aq i fortë sa “nuk e paskan pasur idenë për forcatën e tij”! Po prej nga këtë forcë Shaqir Fetai?! Kush ia dhuroi? Pse iu desht forca Shaqir Fetait? Forca, fuqia, (ushtria, policia) të duhet ose për të sulmuar dikë, ose për t’u mbrojtur nga ndonjë sulm! Shaqir Fetai e sulmoi një Instiucion, me traditë dhe me histori të papërsëritshme, e sulmoi, e shkatërroi, e rrënoi deri në themel! Shaqir Fetait i duhet një forcë e tillë jo se ka nevojë të mbrohet, sepse, askush nuk është duke e

sulmuar, madje të gjithëve po iu duhet që të kënaqen tek e shikojnë se si ngulet prej skandali në skandal, prej problemi në problem sepse të gjithë e përceptojnë si të huaj, si mish i egër, si masë tumorale! Shaqir Fetait mund t'i duhet kjo fuqi, forcë, për t'u mbrojtur nga opinioni i gjërë, nga populli, i cili po ndjenë se po i mbushet kupa me idiotizmat e Shaqir Fetait. Shaqir Fetai e pret konfrontimin me popull, është i bindur se populli do t'ia tëkërlisë shallin e hoxhës, ndaj dhe demonstroi fuqi dhe jo respekt! Sepse, po të demonstrome nder e respekt, të vetmin nder që do të mund ta shprehte karshi popullit, do të duhej të ishte vetëvarja publike e tij! Shaqir Fetait nuk i ka ngelur asgjë tjetër përveçse këtij akti si të Judë Iskariotit, sepse kur teneqja i futet aventurës për ta imituar çelikut, këputet në kurriz!

Nga e mori Shaqir Fetai tërë atë fuqi me të cilën u kërcënohet të punësuarve? Nga e mori atë guxim për të manifestuar forcë, ndërkohë që nuk guxon të ulet e të debatojë publikisht me oponencën e vet? Kush ia dha, kush ia garantoi, pse duhej t'i jepte "x-factor"-i fuqi Shaqir Fetait? Fundja, pse i duhet Shaqir Fetait të jetë më i forti?! Forca duhet vetëm në rast të nevojës për shkatërrim! Dikush po thotë se këtë fuqi e ka nga UDB-ja të cilës i shërbeu me aq zell Shaqir Fetait! Dikush tjetër po thotë se këtë forcë ia ka garantur Spasovski, Ministri i Punëve të Brendshme. Porse, ajo që hap dilema është çështja: pse këtë forcë t'ia japë UDB-ja apo policia maqedonase e vendit!

Në fakt, Shaqir Fetai ka momente kur të tjerëve u lavdërohet me fuqinë e BDI-së që i qëndron mbrapa Shaqir Fetait! Kështu thotë Shaqir Fetai, duke u munduar ta njollosë këtë Parti kombëtare si bastion të udbashëve! BDI gjithnjë ka qenë alergjike ndaj udbashëve, ndaj kurrë nuk i ka mbrojtur! Por, nëse është marionetë e policisë maqedonase që drejtohet nga LSDM-ja, duhet të analizohet nëse është alet që një ditë do të përdoret për ta shantazhuar dhe dëmtuar BDI-në, nëse kjo parti eventualisht do të futej në marrëveshje koalicionimi me VMRO-në!

Rasti i Kërçovës, i rrënimit të minares së xhamisë të fundshekullit XVIII, dëshmon se Shaqir Fetai ka nevojë për fuqi Samsoni! T'i lidhë me zinxhirë minaret që janë të kategorisë së objekteve të rëndësië të veçantë historike. Rrënohet minarja e Xhamisë në Tuhin, një vit më parë rrënohet Eski Xhamia në Tetovë, po atë vitë rrënohet edhe minarja e xhamisë në fshatin Tatesh! Shaqir Fetai e përdorë këtë fuqi për t'i rrënuar të gjitha xhamitë e vjetra të ngritura nga popullata myslimane autoktone. Në vendin tonë duhet të jenë xhamitë e periudhës osmane, të ndërtuar nga turqët, ndërsa ato që tashmë llogariten shekullore e të vjetra, të ndërtuara nga popullata myslimane e vendit, duhet të rrënohen, xhami të reja të kemi vetëm nga koha e Shaqir Fetait e këndeji!

Një gjë është e qartë, në viset shqiptare do të ngelin në kujtesë dy periudha si më të rëndat kur janë prishur xhamitë vendore: ajo e luftës së Slllobodan Millosheviqit dhe periudha e avdallit Shaqir Fetai. Xhamitë e vjetra, gjithnjë meremetohen, ose konservohen dhe ruhen pavarësisht përshtypjeve të para se mund të paraqesin rrezik për qytetarët vendorë! Vetëm, në kohën e Shaqir Fetait prishen minare e xhami të vjetra e shekullore dhe në vend të tyre të ngriten xhami të reja, “bashkëkohore e moderne”! Nuk ka kuptim që Eski Xhamia në Tetovë edhe më tej të mbajë këtë emër kur tashmë është “Jeni”! Dikur, në kohën e reisit të më parshëm, në një Myftini të vendit u prish një xhami e vjetër por, brenda pak ditësh u ndërmorën masat dhe u shkarkua Myftiu, një prej teologëve më të respektueshëm të vendit! Sepse ai nuk e pati “takatin” e Shaqir Fetait! Shaqir Fetai shkatërron Institucion, e vjedh Vakëfin, e shet Vakëfin, e fal Vakëfin, regjistron bashkësi të tjera “islame”, lejon ndërtimin e xhamive private, nuk ka kontroll mbi 80 për qind të xhamive, prish xhami të vjetra, rrenë, premtion, ofendon, përçmon pa iu futur therrë në këmbë. Sepse është shumë i fuqishëm! Vetëmse akoma nuk dihet se prej nga e gjithë ajo fuqi, kush po ia jep dhe për çfarë po i duhet. Fundja, a i ka hije potencia fizike injorantit?!

*/IKlikLarg/08.07.2023/*

## Fuqia e të xhindosurit

*Kur dikush ndjenë se po e kaplon një fuqi e paimagjinueshme dhe e pa përceptuar nga mendja e shëndoshë, kjo do të thotë se kemi të bëjmë me të xhindosur, me të djallëzuar, me një person që është gërshtë në duart e aparateve të rrezikshme antikombëtare e antifetare. Bëhet fjalë për shpirtshiturin i cili mungesën e shpirtit e përmbushë me fuqi e forcë të dhuruar nga blerësi i shpirtit. Dhe kjo dhuratë nuk është asgjë tjetër përveçse frymë në tullumbacen që mund të pëlcasë në çdo sekond*

*Nga Merita Veseli*

Këto ditë lexova një shkrim në portalin kombëtar, tetovasot.com, i cili kishte të bëjë me një dukuri shumë të rrezikshme dhe antinjerëzore. “Lideri” ynë fetar, Shaqir Fetai, kolegëve të vet i rrëfhet se sa i fortë na qenka bërë, se si as me mend nuk mund ta imagjinojnë se sa qenka bërë i fuqishëm! Kjo flet se ky farë Shaqir Fetai dikur paska qenë i dobët, madje tepër i dobët, aq i dobët sa as që mund të paramendohet se një ditë do të bëhet “i fuqishëm”! Po si i edhi forca këtij farë biçim “lideri”? Forca e papritur gjithnjë manifestohet vetëm te të djallëzuarit, te ata që satanizohen, te ata që shpirtin ia shesin djallit dhe xhindosen fare! Këta tipa, përjetësisht ngelin të rrezikshëm, madje aq të rrezikshëm sa, qetësimi i tyre ndodhë vetëm nëse lidhen në zinxhirë, përtej formës së lidhjes së një gomari apo të një kali!

Në fakt, Shaqir Fetait i erdhi fuqia që në momentin kur pranoi që ta tradhëtojë më të fuqishmin (ish-reisin, Sulejman Rexhepin), që në momentin kur pranoi që t’ia ngulë thikën njeriut që nuk i bënte hesap institucionet shtetërore që talleshin me ndjenjat kombëtare e fetare të shqiptarit, të myslimanit! Shaqir Fetai u xhindos, pranoi që dikush t’i fryjë në vrimë... dhe ta bëjë të fortë, aq të fortë sa t’ia ngulë thikën pas shine njeriut që na pat lodhur duke folur fjalë miradie për Shaqir Fetain.

Fillimisht, Shaqir Fetai ndjeu se po bëhet i fortë dhe i fuqishëm madje që nga momenti kur vendosi t'ia kthejë shpinën UDB-së serbe e cila e kishte pas pagëzuar dhe rritur me nofkën “ORAO”, sepse, tashmë kishte dalur dikush që do ta marrë nën ombrellën e “patriotizmin kombëtar e fetar”! Ai nuk i dha pesë pare as për vendimin e UDB-së që ta shantazhojnë duke ia botuar një faqe nga dosja e Shaqir Fetait në rolin e spiunimit të teologut të mirënjohur, të kombëtarit, Nexhat Ibrahimit, si dhe të teologut tjetër, që ia shkatërroi karrierën, Ramiz Alisë, nga Tetova! Nuk i bëri përshtypje botimi i këtij dokumenti kompromitues, apo, thjesht, trimi Shaqir Fetai vendosi të heshtë, sepse, po të reagoonte e kishte të qartë se portalet do të mbusheshin me faqe të tjera nga dosja e tij si bashkëpunëtor i UDB-së! UDB-ja e dekonspiroi dhe e kompromitoi deri në rruzat e gjakut të qelbosur, ndërsa ky u xhindos dhe u pajis me një fuqi të re, me një forcë e cila iu “dhurua” për ta zbatuar projektin: për ta njolllosur BFI-në, për ta devaluuar, për ta shkatërruar hap pas hapi, për ta përçarë, për ta vjedhur, për ta plaçkitur, për ta defaktorizuar, për ta zhbërë tërë atë histori kombëtare e fetare që e kishte ky institucion dhe për ta sjellë në derexhen ku e ka sjellë, në institucion humoristik që drejtohet nga dofarë kurajbera që i thonë vetes myfti e që nuk janë të zotët as për çobanë dhenësh.

Do me thenë, “fuqia” e Shaqir Fetait është fund e krye shkatërrimtare, nuk është mbrojtëse, nuk është avancuese, nuk është progresive, nuk është zhvillimore. Deri më sot është dëshmuar se fuqia e Shaqir Fetait është ajo e avdallit, e të xhindosurit por edhe e të shejtanosurit, që ushqehet me djersën e popullit mysliman të cilën, Shaqir Fetai dikur e pinte me pambuk ndërsa sot e pi me shishe pijanecësh. Shaqir Fetai është gënjeshtar, është gjakëshprishur, ai nuk ka asnjë gram nga nuri i të devotshmit, nuk ka asnjë gram të njeriut karizmatik, nuk ka asnjë gram hije të njeriut të rëndë, nuk ka asnjë gram sinqeritet të njeriut të hallallshëm. Paramendoni se si është shprehur Shaqir Fetai ditë më parë, kur ndjeu se po ngulfatet nëpër skandale që po i ndodhin me haxhinjtë në vendet e shenjta. Ata i paskan dërguar selame se sapo të kthehen në Shkup, do t'ia rrethojnë BFI-në dhe do t'ia marrin paratë e vjedhur të haxhit! Shaqir Fetai ka thënë: “e kanë të kotë përpjekjen për të më detronizuar. Unë jam i fortë. Sa ta kem BFI-në do ta kem edhe BDI-në, sepse këtë parti dikush duhet ta ushqejë me para, siç më ushqen ajo mua me forcë”! Një nga misionet e Shaqir Fetait është që ta njolllosë edhe BDI-në, partinë e kombit, duke e shpërfaqur si përkrahëse të udbashit dhe të të xhindosurit. Shaqir Fetai, madje sikur ta ndjejë edhe fuqinë e NATO-s brenda vetes! Shaqir Fetain nuk e do as Zoti, e jo më krijesa e Zotit.

Shaqir Fetai është anti-Zot, djalli i veshur nën petkun e teologut që ka dalur në gjueti të teologëve gjysëm naivë e gjysëm teologë! Shaqir Fetai është aq i dobët sa që frikësohet e trembet edhe nga hija e vet. Sepse, imantin e ka të dobët, sepse është vegël për një përdorim, sepse, e ndjenë se në çdo moment mund të hidhet në pleh!

***/1KlikLarg/10.07.2023/***

## **Instalacioni i shpifur po bojkotohet masovikisht**

**Gati dyzet vite më parë, atëherë kur filloi me punë Medresja “Isa Beu” në Shkup, kjo vatër atrsimore u shndërrua në simbol të krenarisë të çdo familje myslimane, në çerdhe të kalitjes së familjes myslimane, në vatër të përgatitjes së kuadrít fetar të nevojshëm për myslimanët e vendit. **Sot, pas 38 viteve, fatkeqësisht, sot po braktisen me të madhe. Po pse?****

*Nga Mahir Rexhepi*

Ditë më parë përfundoi pranimi i nxënësve të Medresenë “Isa Beu”, në atë qendroren, në paralelen e femrave në Shkup, në Tetovë, në Gostivar si dhe në paralelen për djem në Shtip! Rezultati – katastrofë! Turp! Shumë dekurajuese për perspektivën islame në këtë nënqiell! Ishte kjo një strategji e mirëplanifikuar nga të tjerët dhe e zbatuar prej të tanëve apo ishte një zhgënjim total i tanëve nga ata që i llogarisim për “të tanët”!

Në Medresenë e Kondovës u pranuan gjithësej 20 nxënës, paralelja për vajza në Tetovë regjistroi gjithësej 14 nxënëse, ajo e Shkupit 26 nxënëse, ajo e Gostivarit vetëm 5 nxënëse dhe paralelja për djem e Shtipit regjisroi gjithësej 12 nxënës!

Në Medresenë e Kondovës për këta nxënës të regjistruar në vitin shkollor 2023/2024 do të ligjërojnë mbi 10 profesor, do të jenë të angazhuar 4-5 edukatorë, 3-4 roje, 2-3 magazinierë, 7-8 guzhinierë si dhe 7-8 personelë tjetër teknik (shofer, punëtorë kafiterie etj.) Shkurt, për 20 nxënës të pranuar do të angazhohen rreth 40 persona, qoftë si mësimdhënës qoftë si personel teknik!

Në Paralelen e vajzave në Tetovë për 14 nxënëse do të angazhohen mbi 20 personelë arsimor e teknik. Për paralelen e vajzave në Shkup do të jenë të angazhuara mbi 20 personelë arsimor e teknik, për ata pesë



nxënëse në paralelen e Gostivarit do të angazhohen rreth 25 persona, arsimtarë si dhe personelë teknik, si dhe për paralelen në Shtip do të angazhohen rreth 30 të punësuar (profesorë dhe personeli ndihmës, ai teknik etj.). Shkurt e shqip, sivjet në pesë paralele të Medresesë “Isa Beu” janë regjistruar gjithësej 72 medresantë, për të cilët do të angazhohet personeli arsimo e teknik në numër prej mbi 135 persona!

Ja ku demantohet propaganda e Shaqir Fetat “jepni “fitra, zeqat, kurbanë si dhe kontribute të tjera) për medresantët tanë! Ndërsa në kurriz të çdo medresanti të saporegjistruar hanë të paktën nga dy-tre persona të tjerë, të cilët Shaqir Fetat i mbanë si përkrahës të vetin si dhe si propagandues të politikave destruktive e shkatërrimtare të vetin!

Pse në mënyrë kaq drastike po bojkotohet Medresja “Isa Beu” prej myslimanëve të vendit? Dikur Medresja ishte shkolla më e preferuar e të rinjëve tanë. Në çdo regjistrim vlonin fëmijë të interesuar për t’u regjistruar, konkurrenca për dy paralele të vitit të parë (mbi 70 sish) ishte e hatashme, kishte me qindra intervenues, madje kishte prindër të pasur që ishin në gjendje të finansojnë e të kontribuojnë pa hesap vetëm e vetëm që fëmija t’i regjistrohet në Medrese.

Që kur u instalua turpshëm Shaqir Fetat në krye të BFI-së gjithçka ka marrur tatëpjetën nëpër institucionet e BFI-së! Myslimanët e vendit nuk hanë barë! Po e shikojnë se degradimi i këtij Institucioni ka arritur kulmin. Po e shikojnë shumë mirë se institucioni “hoxhë” është devaluuar deri në të interesuar për të shërbyer nëpër shërbime sekrete policore. Asnjë nxënës i Medresesë nuk mund ta fillojë vitin shkollor pa u përcaktuar, pa u pozicionuar dhe pa u spiunuar nëse është me Shaqir Fetat apo me dikë tjetër; nuk ka nxënës e nxënëse që nuk porositen që ta përcjellin e spiunojnë njëri tjetrin, shoqja shoqen! Që në fazën e parë të shkollimit fetar u mbjellat dëshira për spiunim! Sepse, Shaqir Fetat i intereson kjo: të dijë saktësisht se kush është me të e kush është me “shejtanin”! Shaqir Fetat Medresenë e ka shndërruar në filiale të shërbimeve sekrete, sepse, të qenurit spiun si nxënës i ka ngelur lezet!

Shaqir Fetat jo që nuk ia doli ta vazhdojë traditën e më hershme që medresantët, edhe pse nga një vatrë asimore e pa akridituar, megjithatë të kenë të drejtën e regjistrimit të fakulteteve ku t’ua dojë e bardha zemër, por, për më keq, me heshtjen e vet si dhe me servilizmin e tij në shenjë falënderimi që e bënë “reis”, ua ka ndaluar të gjithë medresantëve regjistrimin nëpër fakultete shtetërore, madje edhe në vetë Fakultetin e Shkencave Islame.

Janë një mori deformimesh e katandisjesh të vrazhdta të shfaqura e të ndodhura që nga instalimi i Shaqir Fetat, që kanë ndikuar në

bojkotimin masiv të kësaj vatre mësimore që dikur ishte bastion i islamizmit burimor e autokton!

A nuk flet paralelja e vajzave në Gostivar, e cila do të startojë vitin shkollor 2023/2024 me vetëm pesë vajza, se, vetë gostivarasit, vetë myslimanët e devotshëm të territorit të kësaj Myftinie, masovikisht e bojkotojnë “birin” e tyre, Shaqir Fetain! Kjo nuk do të thotë se vajzat e familjeve myslimane nuk dëshirojnë që të vazhdojnë shkollimin e tyre në Medrese, kjo nuk do të thotë (siç pohon revoltueshëm Shaqir Fetai) se myslimanët e këtij rajoni nuk janë të interesuar që ta përgatisin femrën shqiptare, shtyllën e familjes, që të jetë e kalitur me moral dhe të jetë e gatshme të ruajë e të rrisë familje sipas mësimave dhe parimeve të fesë islame. Prej mbi 150 mij myslimanëve të Gostivarit me rrethinë, të dalin vetëm pesë vajza që dëshirojnë të mësojnë në Medrese? Jo, ky nuk është fakt shqetësues, ky fakt është një mesazh për Shaqir Fetain, një porosi se ai bojkotohet masovikisht, se prindërit e kësaj ane nuk dëshirojnë që fëmijët e vet t’i lënë në duart e një rrenci, të një hajni, të një faqeziu siç është “biri i tyre”, Shaqir Fetai! Me Shaqir Fetain Medresja po shkon drejt mbylljes! Kjo po i konvenon edhe vetë këtij mahluku, sepse, masovikisht po bojkotohet edhe në burime financiare që janë jetike për të funksionuar guximshëm organet dhe institucionet e BFI-së! Myslimanët nuk kanë pra që ta trashë qafën Shaqir Fetai, Isral Jakupi, Qenan Ismaili dhe buljashët e tjerë.

### **P.s.**

Ditë më parë, Shaqir Fetai na informoi se ishte në Medrese për t’ia uruar postin drejtor personit, të cilin vetë e kishte emëruar drejtor, ndërsa tani prej tij kërkon që të nënshkruhet si “ushtrues detyre drejtor”! Me ligjet e vendit, ushtruesi i detyrës drejtor, apo kryetar, e ka për detyrë që këtë post ta ushtrojë derisa të zgjidhet drejtori i ri. Do me thënë, vetë nuk ka të drejtë të konkurrojë, sepse e përgatit konkursin për drejtor të ri. Ky proces e përjashton nga e drejta për t’u kandiduar personi i cili e përgatit konkursin! Ligjet e vendit, drejtësia jonë e kritikuar prej institucioneve me më relevancë në botë, ka bërë përjashtim vetëm për Shaqir Fetain, të cilin, nga u.d. e ngritën në “reis”, sepse, ky u duhej strukturave të pushtetit dhe jo se e deshtën myslimanët e vendit. Këtë praktikë do të mundohet ta vazhdojë edhe i mjeri, diletanti, Shaqir Fetai, gjithnjë derisa organet e drejtësisë të vendit të ngrisin padi kundër tij për shkelje brutale të ligjeve të vendit./  
Kombetare  
**/12.07.2023/**

# **Kurbani u vodh e u keqpërdor me të madhe**

**Sipas Shaqir Fetait, sivjet myslimanët e vendit paskan paguar gjithësej 4459 kurbanë si dhe diaspora jonë 1905 kurbanë, gjithësej, 6364, prej të cilëve qenkan shpërndarë, përveç për nevoja të medresesë, edhe 12.000 pako me mish, apo 160 tonelata mish! Çka thotë matematika e çka thonë dispozitat islame të kurbanit**

*Nga Mr. Eset Shaqiri*

Që në fillim duhet nënvizuar se këto të dhëna janë sa tepër subjektive po aq edhe diletanteske, sepse, konvertimi i këtyre shifrave në euro, apo edhe në sasi mishi, apo edhe në numër kurbanë, nuk përputhen askund! Kjo përputhje nuk mund të arrihet duke u raportuar shifrat nga Shaqir Fetai apo nga komisioni i tij. Një komision apo një audit i pavarur do të ishte më i besueshëm dhe më transparent se sa secili prej BFI-së së Shaqir Fetait.

Nuk dihet nëse në këtë numër kurbanësh janë futur edhe numri i kurbanëve të haxhilerëve (2030) apo, fati i tyre nuk dihet. Paratë janë marrur por nuk dihet se çka ka ndodhur me kurbanët! Nëse edhe numri i kurbanëve të haxhilerëve pëfshihet në këtë shifër që e ofron Shaqir Fetai, atëherë, na del pun se sivjet, situatën e kemi katastrofale.

Shaqir Fetai thotë se “për dallim nga vitet e kaluara këtë vit numri i dhuruesve ka tejkaluar vitet e mëparshme”! Rrenë e kulluar që del nga goja e Shaqir Fetait! Prandaj nuk duhet besuar këtyre shifrave e raportimeve subjektive, të cilat fshehin vjedhje galopante si të parave ashtu edhe të mishit, keqpërdorim flagrant të mishit të kurbanit, i cili i është besuar “BFI”-së së Shaqir Fetait.

Le ta shohim se si është sillur numri i kurbanëve ndër vite që jan paguar në BFI dhe le të dalë në sipërfaqe rrena e kulluar dhe e pakrip e “komisionit” të Shaqir Fetait.

Viti 2023, 6364 kurbanë (nëse nuk raportohen dhe ato të haxhinjëve, kjo do të thotë se ato vidhen, manipulohen!)

Viti 2022, 6346 kurbanë (dmth se sivjet ka vetëm 20 kurbanë më shumë se vjet)

Viti 2021, 6873 kurbanë (dmth 509 kurbanë më shumë se sivjet)

Për vitin 2019 dhe 2020 nuk u raportua fare, sepse, ishte “kohë e mjegullnajave” ndërsa ujku gjithnjë do mjegull!

Por, vitet e më heshme kanë regjistruar 7000, 8000 madje edhe 9145 kurbanë! Këto fakte e paralizojnë Shaqir Fetain përballë dëshirës së tij të sëmurë për t’u vetëlavdëruar gjithnjë, ndonëse vazhdimisht punët i ka helaç!

Nga ana tjetër, 6364 kurbanë nuk bëjnë 160 tonelata mish, porse më shumë edhe për nja 40-50 tonelata mish!

Qenkan shpërndarë 12 000 pako me mish! Për të varfër, skamnorë dhe, gati po aq edhe për institucionet dhe entet shtetërore, për spitale, për burgje, për “Komunalecin” etj! Po vetë shteti i Maqedonisë së Veriut, me sa kurbanë kontribuoi në BFI për t’i therrur dhe për t’ua shpërndarë të varfërve! Apo, shtetin e kemi aq të varfër sa, Shaqir Fetai e llogaritë si detyrë të shenjtë për t’i mirëmbajtur entet dhe institucionet, sidomos burgjet dhe spitalet! Cili Mysliman i Maqedonisë së Veriut e bëri nijet therrjen e kurbanit duke sugjeruar që një sasi e mishit të tij të shkojë nëpër burgje, për lloj-lloj të burgosurish! Shaqir Fetai ia ka dhuruar “Komunalecit” mijëra pako me mish dhe u ka lënë në dorën e tyre, vetë ata t’i shpërndajë si të duan. E, dihet se si shpërndahen pakot humanitare nëpër institucione: për shefa e nënshefa, skamnorit as që ia prek dhëmbi!

Në fakt, po flitet se Shaqir Fetai, për t’iu futur nën sjetull BDI-së, ka dhënë urdhër që pako me mish të shpërndahen nëpër disa ente e institucione shtetërore që drejtohen nga kuadrot e kësaj partie! Ky fakt do të sjell dëm të madh, pa dyshim, sepse, do t’i iritojë myslimanët e varfër, skamnorët, jetimët, por edhe ata që kanë dhuruar kurbanë për këtë kategori që kanë nevojë për shtrirjen e dorës humane dhe jo që disa menaxherë me mishin e huaj të shesin mëshirë! Këtë mëkat e bën vetëm Shaqir Fetai!

Fare në fund, Shaqir Fetai është mirë që tash e tutje të kërkojë kurbanë jo për medresenë Isa Beu, por për burgjet dhe spitalet e shtetit të Maqedonisë së Veriut. Shaqir Fetai duhet të ndërjegjësohet dhe të kuptojë se për hirë të bijës së vet që e ka “zvezda” në paralelen e vajzave në Gostivar, nuk mund ta bajë këtë paralele ku janë të paraqitur sivjet vetëm 5 femra. Porse, atë paralele duhet ta shkrijë dhe ta bart në Tetovë! Për pesë medresante të angazhojë personel arsimor e teknik që do t’i kushtojë BFI-së mijëra e mijëra euro, prej të cilave do të pëfitojë më së shumti e bija e Shaqir Fetait!

Tani, sipas kësaj llogarie, secili Myfti ka të drejtë të hapë paralele vajzash dhe aty t'i punësojë bijat, gratë, rejat, nuset, kusherirat nga hallat, nga dajot, nga xhaxhallarët etj. Turp! Kështu e do Zoti Shaqir Fetain?!

***/Kombetare/13.07.2023/***

## **A shpëlahet shpirti me ujë të vjedhur**

*“Ka nga ata (hipokritë) që kanë bërë besëlidhjen me Allahun, duke thënë: “Nëse Ai na jep nga dhuntitë e Tij, sigurisht që do të japim lëmoshë dhe sigurisht që do të bëhemi njerëz të mirë”! Por kur Ai u dha atyre nga dhuntitë e Veta, ata u bënë koprracë dhe kthyen shpinën, duke u larguar. Prandaj, Ai ua lidhi hipokrizinë në zemrat e tyre, deri në ditën kur do të dalin para Tij, sepse e shkelën premtimin dhënë Allahut. Ata e kishin zakon gënjeshtren.” (Et-Teube, 75-77)*

**Nga Mahir Rexhepi**

Tash dy-tre vite, në pikun e turizmit si dhe të ardhjes së mërgimtarëve tanë, Shaqir Fetai po mundohet ta bëjë “traditë” fjalën e tij të kotë drejtuar mërgimtarëve tanë: “Mirësevini bashkatdhetarë tanë në vendlindjen tuaj”! Shaqir Fetai nuk përcakton se cilëve bashkatdhetarë u drejtohet! Nëse flet në përgjithësi, ka mjaft maqedonasë që kthehen nga Skandinavet, nga Kanadaja, Çikago, nga Australia, kthehen vëllehët, kthehen turqët, romët, serbët etj. Nuk ka asgjë të keqe t’ju urojë mirëseardhje edhe këtyre mileteve, por, a e keni dëgjuar ndonjëherë zotëri zotëri priftin ortodoks maqedonas që t’u urojë mirëseardhje mërgimtarëve shqiptarë?!

Këto ditë Shaqir Fetai ka shkuar edhe më larg! Ka anashkaluar Organizatën Humanitare të BFI-së, Bashkësinë Fetare Islame e ka shndërruar në organizatë humanitare dhe, nën siglën e BFI-së ka dalur (respektivisht, ka nxjerrë nxënës medresantë) në pikën kalimtare të Tabanocit të cilët po u japin nga një shishe ujë shoferëve që po futen në Maqedoni! Shaqir Fetai, nga kabineti i ftohtë, nën kondicionerët e vjetër që shpenzojnë energji pa hesap, po sheh në filxhan të kafesë se po na vijnë mërgimtarët dhe se po i freskon me nga një shishe ujë!

Po pse vetëm këtë pikë kufitare? Pse ka nevojë për këtë “humanizëm” Shaqir Fetai kur tërë bota e di shpirtin e tij të zi e të

shprishur, krejt bota e di që është mjeshtër i hajnisë së të mirave materiale të BFI-së. Në çastin kur iu zbrërthye vjedhja e haxhit si dhe vjedhja e kurbanëve, ai shprehi “interesim” që të dëftohet edhe si “humanist”!

Tjetër! Pse në këtë pikë kalimi nëse jo për propagandë dhe për vetëreklamë, apo edhe për nostalgji ndaj gjithçkaje serbishte! Shaqir Fetai e ka shumë të qartë që brenda myslimanëve të vendit urrehet, nuk duhet, nuk honepset, nuk durohet. Këtë reagim të popullatës nuk e ka pritur asnjëherë, ka menduar se populli është bagëti dhe se do t’i grahë si ta ketë qejfin Shaqir Fetai. Por, ja që nuk i doli kështu! Prandaj, mundohet që ta bëj një “mirësi” me ata që nuk dinë fort për Shaqir Fetain, me mërgimtarët, të cilët, para kamerës dhe para mikrofonit, do ta thonë një fjalë të mirë për Shaqir Fetain që shpërndan shishe të volga me ujë valë, të ngrohur nga dielli që përcëllon dhe shkrinë asfaltin. I mjeri, faqeziu, me një shishe ujë, mundohet ta mashtrroj Allahun xh.sh. dhe të blejë një fjalë të mirë, “një urim e një bekim” mërgimtarësh!

Po sa turistë dhe sa mërgimtarë kalojnë nëpër atë pikë kalimi? A janë vetëm shqiptarë apo edhe millet tjetër! Si po ia del Shaqir Fetai t’i dallojë se kush janë shqiptarë e kush të tjerë? Si po ia del që shishen mos t’u japë të tjerëve por vetëm mërgimtarëve shqiptarë, bashkatdhetarëve tanë? Nëpër atë pikë kalimi më tepër kalojnë serbë dhe të huaj se sa shqiptarë! Serbët shkojnë për në Ohër, për Greqi e Bullgari dhe gjetkë, siç kalojnë edhe perëndimorët! Në ditë kalojnë deri në 10-20 mij pasagjerë dhe, sa shishe i shpërndan Shaqir Fetai! Ku e mori ai këtë buxhet për t’u shpërndarë ujë turistëve dhe mërgimtarëve! Apo, u ndanë sa të zgjasë reklama dhe propaganda e porositur dhe e kryer naivisht!

A e di Shaqir Fetai se sa mërgimtarë shqiptarë kthehen në vendlindjen e tyre përmes pikës kalimtare në Aeroportin e Shkupit! Sa mërgimtarë kthehen përmes tragetit që ankoron në Durrës dhe, përmes Rugës së Kombit dhe asaj të Ibrahim Rugovës dhe të Arbër Xhaferit futen nga pika kalimtare të Bllacës! Po sa nga ajo e Dibrës, po sa nga ajo e Qafës së Thanës! Po shumë mërgimtarë që vijnë përmes Aeroportit të Strugës-Ohrit?

Shaqir Fetai është munafik, madje kallëpi i munafikut. Shaqir Fetai ka nevojë për reklamë pozitive në çastin kur është shpërfytyruar i tëri në masë katrani! Pse këto sjellje të çakoduara nuk i kishte kur ushtronte detyrën e organit të BFI-së, si Myfti i Gostivarit? Apo, atëherë ishte i ndërgjegjshëm se nuk ka nevojë ta mashtrroj Zotin e Madh, sepse edhe vjedhjen e ka pasur më të ngushtuar, ngase kontrolli ka qenë i rreptë, vjedhja ka qenë e pamundshme, sidomos

në kohën kur Sekretar Gjeneral ishte Hfz. Afrim ef. Tahiri dhe, si rrjedhojë, edhe mundësia për mëkatim i Shaqir Fetait ka qenë më i vogël, ndaj nuk ka pasur nevojë për humanitet që të shpresojë në ndonjë mirësi nga i Madhi Zot. Patjetër që Zoti Fuqiplotë një ditë do t'ia bëjë të mundshme Hfz. Afrim ef. Tahirit që të kryej revizion mbi punët tradhëtuese disajeçare të Shaqir Fetait dhe gjithçka ta bëjë trasnaprente, ta dijë mbarë popullata dhe diaspora jonë se kush në të vërtetë ishte Shaqir Fetai “humanisti”!

Sot, kur është zhytur në haram, në pislleqe, kur po e ndjenë urrejtjen e tmerrshme të popullatës së vendit, ka nevojë për “tjetër xhemat” dhe për kamuflim të shpirtit të zi eventualisht me ndonjë shishe uji prej 20 denarësh!

Allahu xh.sh. në Suren El Bekare, në ajetin 9, thotë: “Ata përpiqen të mashtrojnë Allahun dhe besimtarët, por në të vërtetë mashtrojnë vetëm vetveten, megjithëse nuk e ndiejnë”! Të bësh përpjekje me nga një shishe ujë që ta pastrosësh shpirtin e haramtë, këtë mund ta bëjë vetëm Shaqir Fetai, i cili, në pikën kufitare ku vlojnë serbët, të cilëve u shërbeu me lezet nën nofkën “ORAO”, pret mërgimtarë për të cilët nuk ka bërë asgjë, qoftë një lutje insitucionale e publike drejtuar Allahut Mëshirëplotë që t’i ruaj mërgimtarët tanë dhe t’ua lehtësojë sa më shumë ardhjen shëndosh e mirë në gjirin e familjes së tyre. Asnjëri prej tyre nuk vjen as për Shaqir Fetain dhe as për shishet me ujë të Shaqir Fetait. Ata vijnë për familjen e tyre, në mesin e të cilëve, natyrisht që do të dëgjojnë, veç tjerash, edhe informacion burimor e të dorës së parë edhe për të bëmat e zeza të Shaqir Fetait

***/TS/16.07.2023/***



## **Përpjekjet e hipokritit për t'u viktimizuar**

*Në një ga ato diciturat e bajatshme e sharlatanteske të Shaqir Fetait, i shtrënguar nga nevoja e flaktë për pak lavdërim, nis e vetëlavdërohet duke u munduar që ta shurdhojë zërin kritik që po kumbon furishëm ditë e më shumë kundër tij. Shaqir Fetai, veç të tjerash, shkruan: “Kjo kohë nuk lejon të humbësh mend e të merrshet me ata që mbjellin shpifje, ofendime, sharje, shantazhime, sepse të sjell veten në situatë pasiviteti...”*

*Nga Valbon Osmani*

Kush po e shantazhuaka Shaqir Fetain? Për këtë nuk di gjë as opinioni por as organet gjegjëse të drejtësisë! Të shantazhohet Shaqir Fetai ndërsa ky mos ta paraqesë shantazhin, kjo është pjesëmarrje në vetëshantazhim! Nuk është e çuditshme të dëgjohej një ditë se si Shaqir Fetai e shantazhon vetëveten, sepse, është nëna e shantazheve!

Kush po shpifë për Shaqir Fetain kur mbarë bota e di se si erdhi në krye të BFI-së? Si e zhvilloi puçin klasik i ndihmuar nga strukturat e caktuara antifetare e antikombëtare të strukturuar në pushtetin maqedonas.

Si mund t'i thotë shpifje Shaqir Fetai faktit që ai e tradhëtoi liderin historik të BFI-së, ia nguli thikën pas shpine, pasi e ndihmoi dhe këshilloi të futet llugave për të cilat Shaqir Fetai ka pasur njohuri të hollësishme!

Janë me dhjetra portale, me dhjetra media kombëtare, me dhjetra personalitete kombëtare që kanë dëshmuar publikisht se si kanë qenë të spiunuar nga Shaqir Fetai dhe nga familjari i vet ambasador deri sa kanë shërbyer në UDB e në KOS! Pra, nuk është një apo dy që të llogariten si tendencë për shpifje, porse janë me dhjetra e dhjetra që

kanë dëshmuar ndërsa spiunët kanë heshtur dhe nuk kanë reaguar nga frika se mund të vërshohen nga të tjera fakte, argumenta e dokumenta!

Si mund të thuhet se “po shpifin rrugaçë” kur dhjetra media kanë shkruar për puç që i kanë bërë Shaqir Fetait, edhe atë jo një por, që kur u instalua dhunshëm në krye të BFI-së, i përjetoi tri puçe! Do me thënë, bashkëpunëtorët e tij, për brenda dy-tri viteve tri herë i shprehin mosbesim, shprehin pakënaqësinë dhe kërkesën që sa më parë të ikë nga posti i uzurpuar pa kurrfarë merite!

A është shpifje konstatimi se Shaqir Fetai qëllimisht paraqitet si “gllup” dhe natë e ditë shkelë Kushtetutën e BFI-së, vetëm e vetëm që t’i realizojë kërkesat e huaja për ta degraduar e rrënuar BFI-në. Këtë mision e ka Shaqir Fetai dhe, madje është mirë që ta pranojë këtë mision, ndryshe, do të llogaritet si fare i pamend dhe marrëzish i verbuar për karrierë për ç’gjë është në gjendje të bëjë gjithçka të keqe.

Si mund t’i thotë shpifje kur mbarë bota e di se si ka shpikur poste, organe, institucione, vetëm e vetëm që t’i emërojë njerëzit që me lezet ia fërkojnë bolet derisa ky pjerdh për shtatë palë qejfe duke shkatërruar gjithçka që është ndërtuar me mund e me gjak në këtë Institucion. Ka emëruar myftinj kordinatorët që nuk janë të denjë as për imamë të katundeve të thella malore!

Si mund të thotë se dikush për të po shpifë se rreth vetes ka spiunë e hajna të tmerrshëm ndërsa tashmë i ka larguar e “sistemuar” si njerëz të rrezikshëm që paskan vjedhur e spiunuar! Madje për këtë i ka informuar edhe ambasadorët në vendin tonë! Tani, kush po rrenë: opinionioni apo Shaqir Fetai?

Kush po e shanë Shaqir Fetain kur dihet se 12 anëtarë të Rijasetit nënshkruan që ai të shporret nga posti që e uzurpoi paturpësisht, ndërsa ky duke i kërcënuar me polici dhe pas mesnatës, disa i ktheu, disa i largoi e disa do t’i largojë këto ditë!

Po pse kush është Shaqir Fetai që të duhet me patjetër! Meqë paska kaq shumë që nuk e duan, pse ky nuk e provon të kundërtën, pse nuk i bindë që është i mirë por i largon nga puna dhe të tjerëve u kërcënohet se do t’i çmend me atë çfarë do t’ju bëjë! Kush është ky farë beshareti që të duhet me dhunë! Mos është gjë BFI-ja ojq e tij personale që ky të largojë e të afrojë me ligje e nene inegzistente! T’i largojë dhe t’i etiketojë me nofka nga më pezhorativet: hajna, spiunë, bashkëpunëtorë të elementeve të huaja, njerëz që kishin vjedhë në BFI... Të gjithë këta sot flasin se çfarë kriminaliteti në të vërtetë ka bërë dhe po bën Shaqir Fetai për këtë kohë për ç’gjë ata janë detyruar që të ngrisin iniciativë që ta largojnë nga BFI! Thonë që për momentin bashkëpunëtorë më të ngushtë e ka hajnin e mbi 40 mij eurove qe ia dhanë amanet për BFI-në! Sipas Shaqir Fetait këta paskan bërë mëkat

dhe prandaj duhet të lagohen, sepse janë ngritur kundër “të parit”! Po Shaqir Fetai kundër kujt u ngrit? Kujt ia nguli thikën? Kë e trdhëtoi? Pse e mori mbi vete këtë mision kaq antishqiptar e antiislam?

Se sa i suksesshëm na qenka treguar Shaqir Fetai për këtë po dëshmuaka situata ekonomike si asnjëherë më e fortë, organizimi i mrekullueshëm i haxhit dhe kurbanët, por dhe hyrje daljet “kombëtare” e ndërkombëtare në BFI!

Ky konsntatim flet se Shaqir Fetai kurrë nuk ka qenë i preokupuar me BFI-në, kurrë nuk i ka interesuar se çfarë po bëhet aty, kurrë nuk i kanë interesuar sukseset epokale, të arriturat epike, sukseset e paimagjinueshme! BFI-ja u mëvetësua më 1991 dhe, për brenda dy dekadave arriti të bëhet institucion me reputacion gjithandej botës. U vizitua nga burrshtetas, nga ministra të vendit e të huaj, nga personalitete, emisarë e diplomatë ndërkombëtarë; u bë anëtare e shumë organizatave botërore, mori pjesë në shumë kongrese, seminare e evente botërore, ngriti lart zërin për padrejtësitë që ushtrohen kundër shqiptarëve si popullatë shumicë në numërin e përgjithshëm të myslimanëve të vendit. Organizoi shumë evente me karakter kombëtar e ndërkombëtar!

Shaqir Fetai as që mund t’i ëndërrojë këto suksese, ndërsa po i palos sukseset një mbi një në rrënim dhe shkatërrim të BFI-së!

Nuk paska probleme financiare? Po ku të ketë probleme kur ia kthyen ata që e sollën në krye të BFI-së bonat me vlerë, si shpagim të vakëfit të nacionalizur dhe “të pakthyeshëm”. Shaqir Fetai një ditë do të përgjigjet penalisht për shpenzime të këtyre bonove, sepse, po i bie që ka shitur vakëfin për t’i kënaqur me rroga bashkëpunëtorët e vet dhe për të pasur mundësinë për të vjedhur sa t’i dojë e zeza zemër.

Qenka mbyllur numri i paraparë për haxhilerët e vitit të ardhshëm si dhe për ata të vitit 2025 dhe, këtë Shaqir Fetai e llogarit si sukses të vetin! Shaqir Fetai ka ngritur strategji për të pasur mundësinë për të vjedhur gjithnjë e më shumë! Tani janë nja 500-1000 vende të zbrazea që do të nxirren në lecitacion e që do t’i fitojnë ata që do të japin më shumë nga çmimi i caktuar për në haxh. Këtë strategji do ta zhvillojë duke u prononcuar që tani se për dy vitet e ardhshme janë mbushur të gjitha vendet e caktuar për haxh. Dhe, edhe nëse është e vërtetë kjo – kjo nuk mund të llogaritet sukses i Shaqir Fetait, porse përmirësim i kushteve ekonomike të njerëzve që kanë dëshirë dhe mundësi të shkojnë në Haxh.

Janë makina, janë troje, janë prona për të cilat ekzistojnë fakte që Shaqir Fetai “ka paguar” qindfishin e çmimit fillestar, duke u thënë se do t’u japë kaq lekë që ata t’ia kthejnë kaq lekë!

A mund të jetë shpifje se në Gostivar, në paralelen e vajzave

sivjet janë praqitur vetëm pesë vajza që kanë shprehur dëshirë për të mësuar në Medresenë Isa Beu! Paralele me pesë nxënësë?! Po pra, do të funksionojë, sepse e bija e Shaqir Fetait mund të ngelë pa punë! Ja pra, ja që Shaqir Fetai nuk i vjel myslimanët e vendit për medresantët e për të mirën e islamit por për bijën e vet dhe për të mirën e bashkëpunëtorëve që duhet t’ua mbushë gushën me qëllim që t’ua blejë lojalitetin!

Ku ngeli Hoteli i BFI-së? Si u bë që në pallatet e ngritura në (ish-komunaleci) vakëf të Myftinisë së Shkupit plotë funksionarë të Shaqir Fetait kanë përfituar nga një hyrje! Si u bë që Medreseja nuk akreditohet dhe nuk do të akreditohet pa një dëmshpërblim nga ana e Shaqir Fetait për ata që do ta “akreditojnë”? Çka po bëhet me vakëfin qindra mijëra euro ku ishte përpara zyryja e Myftinisë së Shkupit e sot po degradon në kotec pulash e qenësh endacakë! Njerëzit po shohin tek hynë e dalin nga aty konsumues të drogës, çifte prostitutësh, ngase është lënë si objekt publik!

I thotë shpifje Shaqir Fetai edhe faktit që Ibn Pajko u shit për 350 mij euro!

I thotë shpifje Shaqir Fetai edhe faktit që studentët e arkitekturës nuk dinë asgjë për ndërtimin dhe dimensionet e objekteve të vjetra fetare islame ndërsa janë të obliguar gati të dinë për çdo kishë që është ndërtuar!

A është shpifje edhe fakti që xhamitë e vjetra edhe më tej, si në kohën e ateizmit jugosllav, vlerësohen si “monumente historike” apo si “objekte të rëndësisë së veçantë, me vlerë historike” dhe nuk trajtohen si trashëgimi kulturore! A e di Shaqir Fetai se pse nuk trajtohet trashëgimi kulturore?

Shaqir Fetai është rrenci më i pashembullt në fytyrë të tokës, është mynafiku dhe hipokriti më i rrezikshëm, është hajni më i pashpirt si dhe është dhe do të ngelë në histori si rrënuesi dhe shkatërruesi më i vullnetshëm i gjithçkaje të arritur në emër të fesë islame dhe të kombit. Si të tillë, Shaqir Fetain nuk e do Zoti, ndaj dhe nuk e duan as njerëzit.

***/1KlikLarg/18.07.2023/***

## **Rezultatet e një ankete shkurajuese dhe ofenduese**

*Në opinion po qarkullon një informacion lidhur me një anketë mbi besueshmërinë e myslimanëve të vendit ndaj BFI-së dhe “reisit”, të realizuar nga po ato struktura maqedonase-ortodokse që e sollën Shaqir Fetain në krye të BFI-së! Tani, kur njeriu nuk po ia del me kohë që t’i numërojë skandalet e njëpasnjëshme të BFI-së së Shaqir Fetait, “religija.mk”, si dhe “IPIS” marrin detyrë që t’ia rregullojnë sadopak piarin këtij Institucioni që tashmë është në grahmën e vet të fundit*

*Nga Mahir Rexhepi*

Kur të huajt merren me analizimin e problemeve të tjetrit, gjithnjë ia huqin! Kjo huqje nuk paraqet kurrfarë problemi për “analistin e huaj”, sepse synimi i tij është t’i fusë lekët në xhep, por edhe ta kryej një “amanet” që ia ka dhënë dikush!

Shaqir Fetai, meqë po heshtë si e përdala dhe nuk bëri asnjë reagim kundër një ankete e cila si synim paska pasur t’ia rregullojë piarin Shaqir Fetait ndërsa si qëllim paska pasur të tallet e t’i poshtrojë si myslimanët e vendit ashtu edhe Institucionin e vetëm fetar islam në RMV!

### **E vërteta sipas “religija.mk”**

Religija.mk është një portal alternativ vullnetar i KOM-it (Kishës Ortodokse Maqedonase), i cili, në emër të promovimit të bashkëjetesës fetare shukë donacione të majme nga vendorët e nga të huajt. Një promovus këmbëngulës i kësaj vlere pa dyshim që është edhe Fondacioni gjerman “Konrad Adenauer”! Ndërsa, kryesisht mbulon aktivitetet e kishës, promovon vlerat fetare e kulturore të kishës, propagon politikat e mirëqenies ndërfitare të Kishës si dhe, herë pas here, publikon ndonjë skandal apo ndonjë problem të brendshëm të BFI-së!

Tani, ky portal, së bashku me sivëllain tjetër “IPIS”, sipas të gjitha gjasave angazhohen nga strukturat maqedonase që e instaluan Shaqir Fetait në krye të BFI-së si dhe nga vetë ky farë instalacioni që, sado pak t’ia rregullojnë imazhin! Por, në këtë “përprjekje”, megjithatë sheshit del një tendenciozitet i cili duhet të kritikohet prej të gjithëve dhe, jo të heshtet, sepse, kjo heshtje e kësaj radhe, më vonë do të na kushtojë shumë!

Si mos të reagohet kundër rezultateve që dalin nga përgjigjet e “të anketuarve”, të cilat nuk përkojnë aspak me të vërtetën! Thua vetëm 28 % e myslimanëve të vendit paskan besim të plotë në BFI-në, dhe 43 % “deri diku”! Do me thënë 72 % e myslimanëve të vendit nuk i beojnë apo kanë dyshime në BFI-në! Dhe ky “fakt” nuk e brengos fare “parinë” e këtij Institucioni?! E heshtin këtë “fakt” sepse, qëllimi është i përbashkët: ta relativizojnë dhe ta defaktorizojnë deri në minimum peshën e BFI-së!

BFI-ja është vetëm një objekt-institucion që pa organet dhe institucionet e veta nuk ka kurrfarë peshe dhe asnjë kuptimi! Prandaj, projektuesi i kësaj “ankete” është dashur të shtrojë pyetje se sa i besojnë organeve kolektive, organit më të lartë, institucioneve të BFI-së! Apo, e dinë këtë fakt por, meqë organi kolektiv “Rijaseti”, nga dita e tradhëtisë së madhe të Shaqir Fetait e deri më sot, tri herë radhazi i shprehi mosbesim dhe kërkoi që ky “mish i egër” të largohet nga trunghi i BFI-së.

## **Kundërgargumentet ndaj një piari të fallcifikuar**

Kurrë në historinë e e Bashkësisë Fetare Islame në RMV-së (pavarësisht se si është quajtur ky Institucion fetar islam) nuk ka pasur tradhëti aq fatale si ajo që e zhvilloi Shaqir Fetai! Shaqir Fetai në BFI i hapi të gjitha portat e rebelimit, të tradhëtisë si dhe të ardhjes në pushtet përmes puçeve klasike.

Kurrë në historinë e BFI-së nuk ka pasur kaq shumë vjedhje, zhdukje dhe tjetërsime të vakëfit. Komunizmi për 50 vite i nacionalizoi por nuk i zhduku, i konservo i dhe u kujdes për to. Me instaimin e Shaqir Fetait, të gjithë myslimanët e vendit e dinë se ai e shkatërroi vakëfin, e vodhi, e tjetërsoi, e harxhoi. Bonot në vlerë të cilat qeveria ia pagoi BFI-së për ato vakëfe që nuk mund të kthehen kurrë (!!!), Shaqir Fetai nuk i shndërroi sërish në vakëf por i shpenzoi, i shpërnda duke blerë rehatinë në kolltukun e uzurpuar. Nuk ka mysliman në vend që nuk e di se Shaqir Fetai është karrieristi më i tmerrshëm i shoqërisë sonë dhe, si i tillë, turpi më i madh i myslimanëve të vendit. Shaqir Fetai është po ai person që i dëboi

arabët të cilët ishin të gatshëm (dhe i nënshkruan të gjitha dokumentat) për të ngritur një qendër tregtare në qendër të Gostivarit e që do të ngelte vakëf gjigant për Myftininë e Gostivarit. Ai i dëboi dhe kurrë nuk e tregoi arsyen, ndërsa arabët thanë se po ikin për shkak të korrupsionit të tmerrshëm që egziston në Myftininë e Gostivarit (atëbotë myfti ishte Shaqir Fetai).

Kurrë në historinë e BFI-së nuk ka ndodhur që ky Institucion të drejtohet nga udbashët, madje brenda të ketë më shumë udbashë e hajna se sa teologë të devotshëm.

Kurrë në historinë e BFI-së nuk ka ndodhur që i pari i saj (nga pozita e udbashit) të dekorojë udbashë e spiunë me dekoratën zyrtare më të latë të Institucionit! Këtë e bëri Shaqir Fetai, njërin e dekoroi se e kishte bashkëveprimtarë në axhendën e UDB-së, ndërsa tjetrin (diplomatit) e dekoroi sepse ia mundësoi të jetë në listën e rrogave mujore të një institucioni në EBA! Me këtë gjest ia hapi rrugën që nesër ta dekorojë edhe (diplomatit) familjarin e vet që ishte udbash me tapi!

Kurrë në historinë e BFI-së nuk ka ndodhur që të vidhet aq shumë prej haxhilerëve! Të tradhëtohen myslimanët e vendit! T'i regjistrojnë për të udhëtuar dhe një javë para nisjes t'ua kumtojnë çmimin stratosferik të haxhit, më të lartin në rajon!

Kurrë në historinë e BFI-së nuk ka ndodhur që haxhilerët e një rajoni të Maqedonisë së Veriut të braktisen, të ngelin si dhenë në rrugë dhe të mos të dinë kah të skojnë!

Kurrë në historinë e BFI-së nuk ka ndodhur që haxhilerët, pleqtë, nënat, motrat tona të detyrohen e të presin në radhë kilometrike për të hëngë bukë dhe, gjat këtyre pritjeve t'u ikin namazet!

Kurrë në historinë e BFI-së nuk ka ndodhur që të rrihen mu në Qabe anëtarët e kryesisë së haxhit!

Kurrë në historinë e BFI-së nuk ka ndodhur që pozita e imamlereve të nëpërkëmbet deri në nënvlerësim të tyre siç ndodhë sot nga mbetjet e UDB-së së dikurshme.

Dhe, këto fakte të mbulohen me një anketë të portalit kishtar, religija.mk?!

Dy "rezultate" që nuk i bëjnë nder askujt Myslimanët e vendit qenkan në aut fare sipas kësaj ankete! Ata më shumë po i besuakan imamëve se sa institucioneve të shtetit! Më lehtë po kërkuakan ndihmë nga imami se sa nga institucionet shtetërore? Do me thënë, nëse, mos dhëntë Zoti, bie ndonjë epidemi, ata ndihmë do të kërkojnë nga imamët, sepse kanë besueshmëri të madhe ndaj këtij komuniteti, dhe jo nga institucionet shëndetësore shtetërore. Nëse bëhet një krim, nëse vidhet, një shtëpi, nëse vritet një person, nëse rrihet një grua,

nëse shkilet një plakë, myslimanët e vendit nihmë më përpara do të kërkonin nga imamët se sa nga institucionet shtetërore? Një anketë e tillë kurrë nuk është bërë më përpara, por bëhet tani kur pjesa dërmuese e institucioneve shtetërore drejtohen edhe nga shqiptarët! Pra, shqiptarët janë fajtor për zvoglimin e besueshmërisë ndaj institucioneve shtetërore dhe mbështetjen e tyre tek imamët!

Si guxon të heshtë BFI-ja para rezultatit shumë tendencioz, tipik rankoviqian, sipas të cilit, te mbi 70 % e besimtarëve të vendit në punët e përditshme feja paska ndikim! Pse nuk specifikohet ky ndikim?

A i duket Shaqir Fetait punë e madhe që në BFI ndikimi i BDI-së qenka aq i madh? Por ja që nga brenda BFI-së dëgjohej zëra që pikërisht këtë rezultat e ka porositur vetë Shaqir Fetai, sepse, ka nevojë që kjo parti, përmes “qortimeve maqedonase” të heq dorë pak nga BFI-ja. Nga ana tjetër, Shaqir Fetai e di fare mir që ky rezultat është shumë alarmant, është alarm i madh sidomos për faktorin nërkombëtar me relevancë që funksionon në vend. Ky rezultat do të nxisë shumë diplomatë të shkojnë në BFI dhe të marrin informacion nga dora e parë lidhur me ndikimin e Bashkimit Demokratik për Integritim që e paska në BFI. Ky shqetësim do ta kënaq Shaqir Fetain që do të vizitohet nga diplomatët ndërsa e ka bërë me një njollë shumë të madhe BDI-në e cila, tash e tutje, për çdo probem të brendshëm të BFI-së do të shikohet me dyshime!

## **Hoxha i devotshëm dhe karrierizmi i Shaqir Fetait**

Tri-katër dekada më parë, një Hoxhe të madh në vend i vdes gruaja. Në jaci del në xhami dhe, pasi ua falë xhematit këtë vakt, kërkon prej tyre që të përshëndeten dhe t’ia bëjnë hallall!

Xhemati preket shumë nga kjo kërkesë e hoxhës, por, hoxha nuk tërhiqet nga vendimi i vet, me arsyetimin: “Xhemat i dashur, deri më sot e kemi çuar shumë mirë, më keni dashur e ju kam dashur, më keni nderuar e ju kam nderuar. Kurrë nuk kam dëgjuar ndonjë fjalë të rëndë prej jush.

Sot më vdiq gruaja, unë po plakem, problemet nga sot do të jenë edhe më të rënda për mua.

Mund të ndodhë që të shpërqëndrohem nga devotshmëria ime e të më dalë ndonjë fjalë jo e mirë nga goja ime. Do të thoni pastaj: ja ky, i vdiq gruaja e la mendja”! Prandaj, po largohem, që ta ruajmë konsideratën ndaj njëri tjetrit!

Nga ana tjetër, Shaqir Fetai e tradhëtoi pikërisht atë që pati respekt e konsideratë më të lartë ndaj tij! I bëri puç dhe ia mori



karrigen. Tani ky sikur edhe në prush ta ulë b... myslimanët nuk i besojnë, myslimanët e vendit nuk e duan, myslimanët e vendit në heshtje do ta vuajnë shumë instalimin e tij. Ndaj Instiucioneve dhe organeve të BFI-së do t'i kryejnë të gjitha obligimet fetare, kjo për shkak të traditës por edhe vetëdijes së lartë fetare islame, dhe jo sepse po i bëjnë ndonjëfarë nderi Shaqir Fetait. Këtë ia paskan shprehur edhe në anketë: vetëm 17.4 % e të anketuarve janë përgjigjur se “po, tërësisht” kanë besim te “Kryetari i BFI-së”! Kurse 82.6 % e myslimanëve të anketuar kanë shprehur dyshime, besueshmëri të luhatur dhe mosbesueshmëri të plotë!

Thua ky rezultat të jetë problematik që e ka stepur Shaqir Fetain për ta botuar këtë anketë në FB- un e vet, sepse, si t'ia linte titullin: “Nga të enketuarit vetëm 17.4 % kanë besueshmëri të plotë ndaj Reisul ulemasë, hfz. Shaqir ef. Fetait”! Po shihet puna: m...!/  
***Kombetare/25.07.2023/***

## **Tradhëtari**

*Vetëm tradhëtia e parë është e trishtë! Gjatë aktit të tradhëtisë djersët shkojnë kokrra-kokrra dhe, me të pëlçitur të kokrrës së parë të djersës, pëlçet edhe turpi. Tevona, tradhëtia të bëhet ushqim shpirtëror, të bëhet ves, të bëhet bindje, të bëhet fe! Tradhëtari është i bindur se vetëm këtë zanat e di më së miri dhe, këtij zanati i jepet me shpirt, deri në frymën e fundit. Njëherë tradhëtar, përjetë tradhëtar*

*Nga Valbon Osmani*

Tradhëtia është rrjedhojë e ushtrimit të spiunimit. Gjatë çdo spiunimi kryhen një sërë tradhëtishë. Tradhëtohet miku, tradhëtohet familja, tradhëtohet ideali, tradhëtohet atdheu. Tradhëtia “amnistohe” vetëm përmes spiunimit, ndërsa spiunimin nuk ka veprim që mund ta amnistojë!

Njeriu pasi të vdesë, për në botën tjetër e përcjellin, deri në varr, të afërmit dhe miqtë, nga varri e tutje e përcjellin veprat! Tradhëtia dhe spiunimi nuk pranohen për vepra por për veprime të cilat janë të pafalshme si nga njeriu ashtu edhe nga Krijuesi dhe, si të tilla, vepruesit ia sigurojnë vetëmse ferrin!

Spiuni dhe tradhëtari gjithmonë kërkojnë mbrojtje, gjithmonë marrin masa që të mbrohen duke i kamufluar këto veprime. Ose jepen formalisht pas lutjeve e devotshmërisë, ose aftësohen profesionalisht për të ligjëruar fe, madje ose edhe e mësojnë përmendësh Librin e Shenjtë! Tradhëtari dhe spiuni kur e mashtrojnë dhe e marrin më qafë krijesën më të përsosur, nuk e kanë për frikë Krijuesin, sepse, përmes veprimeve të poshtira, tradhëtari dhe spiuni në fakt i përçojnë mesazh Krijuesit se nuk i frikësohen, se kanë aftësinë e mashtruesit që mund ta mashtrojnë edhe Vetë Atë!

Te jeshë ruajtës i Librit të Shenjtë, ta keshë të regjistruar në tru Fjalën e Krijuesit të Gjithëdihëm, ndërsa këtë virtyt ta përdorësh për spiunim e për tradhëti, është goxha guxim prej satani. Tradhëtarët

dhe spiunët jepen pas këtyre veprimtarive vetëm pasi të joshen për ndonjë interes meskin, për ndonjë post a pozitë të cilën nuk mund as ta ëndërrojnë! Kur të mbushet kupa me spiunazhë e me tradhëti, atëherë kërkon shpërblim të bëhesh i madh, për shembull si Shaqir Fetai reis!

Posti reis i arritur falë angazhimit të devotshëm në spiunim e tradhëti, është pozitë prej nga pastaj këto veprimtari kryhen edhe më denjësisht dhe më lehtë, sepse si person publik tashmë gëzon mbrojtje dhe siguri nga punëdhënësi “i pushtetshëm”. Çdo spiun e tradhëtar në ndërdije e ka të sigurtë që nuk mund ta gëzojë mbrojtjen e Krijuesit prandaj i duhet mbrojtja nga “i pushtetshmi”! Spiuni dhe tradhëtari nën petkun e reisit kërkon që të vizitohet sa më shumë, kërkon që të vizitohet sa më shumë, kërkon që asnjë aktivitet politik, shkencor e fetar të mos kryhet pa prezencën e tij dhe, mundësisht, aktivitetet t’i përshkruhen si meritë e “reisit”! Spiuni dhe tradhëtari nuk e ka dert se prezncja e tij e njollosë ndejën, i njollosë njerëzit, i devalvon ata, sepse, ky është qëllimi i tij: meqë është vetë i njollosur, dëshiron të njollosë sa më shumë dhe të shtohet fara e tij! A nuk është ky synimi edhe i Satanit?!

Sepse, spiuni dhe tradhëtari e di fare mirë se “fara” e tij do të jetë e lumtur dhe me kënaqësinë më të madhe do ta nderojë “pemën” e vet duke folur ëmbël për të dhe duke e marrur nën mbrojtje! Fara ta mbrojë pemën!? Ndërsa Krijuesi ynë porositi: “Dhe mos u bëj mbrojtës i tradhëtarëve” (En Nisa, 105).

Për të gjithë hoxhallarët, për të gjithë myftinjët, për të gjithë profesorët, drejtorët, për të gjithë politikanët, shkencëtarët, i Madhi Zot ka porositur: “Dhe mos i mbro ata që mashtrojnë vetveten! Se Allahu nuk i do tradhtarët dhe gjynahqarët.” (En Nisa, 107). Kurse në ajetin 109 të po të njëjtës sure, duke iu drejtuar mbrojtësve të spiunit e tradhëtarit Krijuesi në fakt ia bën me dije vetë tradhëtarit se “Ja, ju i mbrojtët ata (tradhëtarët, spiunët) në këtë botë, por kush do t’i mbrojë tek Allahu në Ditën e Kiametit ose kush do të bëhet përfaqësues i tyre?”

A do ta mbrojnë, a do t’i bëhen “përfaqësus” për shembull do imamë e do “pari fetare” manipulantë e të manipuluar – a do ta mbrojnë këta Shaqir Fetain tek Ai para të cilit përkulen natë e ditë?! Shaqir Fetai i thërret ata dhe iu premton bashkëpunim, sepse, ideologjia komuniste më së shumeti ka qenë e frikësuar nga diaspora. Mijëra bashkëpunëtorë të UDB-së kanë përcjellë aktivitetet e diasporës. Natyrisht, shtetet e dala nga ai sistem edhe më tej i friksohen diasporës dhe, edhe më tej kanë njerëz, ekip, institucione e mënyra për ta përcjellë “veprimtarinë armiqësore” të diasporës. Shaqir Fetai mendon se detyra parësore e tij është që të ketë kontrollë

absolute mbi çdo gjë nga diaspora dhe, këtë angazhim policor vullnetar e interpreton si “bashkëpunim”! Çka i duhet diaspora Shaqir Fetait, çka i duhet Shaqir Fetait diasporës? Diasporës nuk i duhet as për presh në bahçe, kurse Fetait i duhet diaspora për ta mbrojtur, për ta përkrahur, për t’i dhënë shpirt e jetë.

***/BotaSot/30.07.2023/***

## ***Hipokriti përveç hipokrizisë s'ka ç'të ofrojë***

***Është e turpshme të lexoshë një hartim shkollor nga një "reis" i cili ka konceptuar që të publikojë një seri hartimesh qesharake e në fund t'i përmbledhë në një libërth si "filozofema" të një "alimi të madh". Kurse ato do të dëshmojnë vetëm për një injorant dhe hipokrit si specie e veçantë***

***Nga Mahir Rexhepi***

I lodhur dhe i mërzitur nga të kuptuarit prej të gjithë se çfarë udbashi me tapi ka qenë një jetë të tërë, ja që Shaqir Fetai ka nevojë të tregohet edhe si patriot, pa çka që kurrë deri më sot nuk ka bërë asgjë as për fe e as për atdhe, as për shqiptari e as për islam. Asgjë, kurrë!

Shaqir Fetai qenka mahnitur se si shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, të djegur nga malli për atdhe (kodoshi i thotë vatan!) qenkan kthyer sivjet, duke mos u shqetësuar për pritjet e gjata në kufi. Me këtë paskan dëshmuar patriotizmin dhe atdhedashurinë e tyre! Jo vetëm këta, por edhe tek fëmijët e tyre Shaqir Fetai paska vërejtur lumturinë e tyre gjë që dëshmon se edhe ata kan mall për atdheun e prindërve të tyre. I plasi atyre për "atdheun" e prindërve!

Shaqir Fetai na shkruan si një egzaminues i hatashem i cili di se si është mbjellë atdhedashuria te çdo mërgimtar. Ai ua sheh këtë fakt të qëndisur thellë në shpirtat e tyre! Si një i mbinatyrshëm, si një qenie misterioze, me shpejtesi drite, fluturon nga njëri e te tjetri dhe shpalos kënaqësitë e mërgatës sonë që janë kthy e po kënaqen në atdheun e tyre.

A e di ky injorant për ta bërë dallimin në mes të atdheut dhe vendlindjes? Nëse Shaqir Fetai niset nga logjika se vendlindja është atdheu, atëherë, të paktën duhet të kuptojë se vendlindje dhe atdhe i fëmijëve të mërgimtarëve tanë do të jenë po ato vende ku ata lindin, kështu që me aludime prej spiuni Shaqir Fetai nuk guxon t'ua imponojë Maqedoninë e Veriut si atdhe të tyre.

Mërgimtarët tanë nuk marrin udhë të gjata mijëra kilometra që

të çmallen me vendlindjen apo “atdheun” e tyre, sepse ata nuk kane plasur aq fort për atdheun i cili në mënyre të planifikur i dëboi apo i nxiti që të ikin. Ata vijnë për t’u çmallur me prindërit e tyre, ata vijnë për ta përqaftuar nënën, babain, për t’u shkrehur në vaj nga malli në përqaftimin e vëllait, motrës, nipërve, mbesave, farefisit! Ky është motivi që i detyron ata që të vijnë në vendlindje, e jo malli për atdheun, i cili kurrë nuk bëri gjënë më të vogël për kthimin e tyre. Prandaj mos të rrejë Shaqir Fetai dhe mos të sjellë aludime të tilla sikur Maqedonia na qenka si Mekke ndërsa mërgata jonë si Muhamedi a.s. i cili lotoi kur u kthy në Mekke.

Një numër i madh nga këta mërgimtarë kanë ikur nga familjarët e tyre edhe për pasojë të spiunimeve nga soji i Fetahajve. Pse nuk e shkruan edhe për këtë dukuri Shaqir Fetai një hartim shkollor, psh me temë: roli i spiunëve, si puna jonë, në dëbimin e shqiptarëve nga vatrata e tyre!

***/Kombetare/09.08.2023/***

## **Rezili që njollos konferencat islamike**

*Konferencat ndërkombëtare janë evente, të cilët, të ftuarit dhe pjesëmarrësit e drejtëpërdrejtë, i shfrytëzojnë sa për ta trajtuar temën e caktuar aq edhe për t'i shpalosur problematikat e vendeve dhe shoqërive gjegjëse prej nga vinë pjesëmarrësit. Por ka edhe nga ata mysafirë që ftohen si spektatorë të eventit sa për t'i dhënë numër pjesëmarrësve, si puna e Shaqir Fetait*

*Nga Mahir Rexhepi*

Bashkësia Fetare Islame jo vetëm në planin e brendshëm por edhe në atë ndërkombëtar ka degraduar deri në mospërfillje. Më herët, nuk bënte vaki që nëpër konferenca e tubime ndërkombëtare të mos dëgjohej edhe zëri i Bashkësisë Fetare Islame përmes përfaqësuesit të saj. Konferenca dhe, përmes saj, e tërë bota myslimane dhe më gjërë, dëgjonin edhe për problemet e shoqërisë myslimane të Maqedonisë së Veriut si dhe të vetë BFI-së! Kësisoj, BFI-ja dashur e padashur shndërrohej në një “qendër vëmendjeje” nëpër konferenca! Opinioni botëror mysliman informohej për problematikat me të cilat përballëshin myslimanët e vendit por edhe dëgjonin konkretisht mbi organizimin brilant dhe angazhimin vetëmohues të myslimanëve të Maqedonisë së Veriut në avancimin e jetës fetare islame në vend. Mediat e ftuara përveç konferencave hapësirë të konsiderueshëm i krijonin edhe përfaqësuesve të myslimanëve nga Maqedonia e Veriut, respektivisht, ish-kryetarit H. Sulejman ef. Rexhepit, i cili me përgjegjësi më të lartë fetare e kombëtare i shfrytëzonte këto evente për ta plasuar të vërtetën e shqiptarëve dhe myslimanëve të Maqedonisë gjithandej botës myslimane. Për këtë dëshmojnë edhe intervistat, fjalimet, referatet, debatet, shkrimet e përfshira në kompletin e tij “Për Fe dhe Atdhe”!

Po sot? Sot BFI-ja nëpër eventet e ngjashme merr pjesë sa për t'i deshifruar përfaqësuesit e saj si dhe për t'i lakuriqësuar e për të dalur

në pah interesi i tyre personal, dëshira e tyre për të udhëtuar, për të këputur ndonjë dorë mëditjesh si dhe për t'i heshtur të gjitha çështjet që i tangojnë myslimanët e vendit. Shaqir Fetai e ka të rëndësishme prezencën e vet nëpër evente të tilla arabe, ndonëse nuk di as të flasë, as të shkruaj as të komunikojë me isharete me pjesëmarrësit nga bota islame turko-arabe, dhe nuk e ka në plan të parë që të prezantojë problemet aktuale, avansimet eventuale të çështjeve që janë shpalosur nëpër konferenca të tilla apo edhe të lidhë miqësi të reja në mes të këtyre shteteve dhe ekskluzivisht BFI-së! Ekzistojnë dëshmi të shumta që flasin se si Shaqir Fetai nëpër konferenca të tilla mundohet si skuth që të takojë personalitete të larta dhe t'i ftojë ata që të jenë mysafirë të shtetit të Maqedonisë së Veriut dhe jo të BFI-së!

Këto ditë Shaqir Fetai prezantoi si publik i verbër dhe i shurdhër në një konferencë vjetore që organizohet në Meke dhe prej nga na informoi se e kreu “Umren e Parë”! Po kush e ka penguar deri më sot që mos të shkojë e të kryej Umren?! Apo nuk ka shprehur asnjëherë interesim derisa nuk iu mundësua kjo qelipur!

Shaqir Fetai thotë se dha kontributin në organizimin e kësaj Konferencë. Po si rrenë në ditë me diell, madje prej vendit të shenjtë! Shaqir rrencakut duhet t'i ndalohet rreptësisht hyrja në atë vend të shenjtë, për shkak të profilin e tij prej udbashi, karakterit të tij të pakarakter dhe mentalitetit të tij provincial.

Rrenën e dytë të cilën Shaqir Fetai e liferon prej Mekes është kur shkruan se kinse atë e paska takuar Ministrin për çështje fetare, Abdul-latif ibën Abdulaziz Al Shejhin. E vërteta është se Ministri në fjalë organizoi një pritje kolektive dhe i takoi së bashku kryetart e bashkësive islame të disa viseve euro-aziatike. Pra, për asnjë sekond nuk u bë takimi tet a tet i Ministrit dhe Shaqir Fetait. Sikur të ndodhte kjo, atëherë, po, titulli do të ishte i saktë se Shaqir Fetai takoi Ministrin. Shaqir Fetai e deformon këtë informacion me qëllim të arsytimit të pjesëmarrjes së tij në këtë event.

Rrena e tretë e Shaqir Fetai, të cilin ky mundohet të na e imponojë si “shkencë” është fundi i informacin: “Reisul Ulema i shoqëruar nga H. Ismet ef. Ademi gjatë dy ditëve të plota arritën të takohen me personalitete dhe krerë të ndryshëm të botës ne çka ndruan përvoja të llojeve të ndryshme”!

Si e para, në konferencë përpos nikoqirit nuk pati asnjë nga “krerët e ndryshëm të botës”! Shaqir Fetai këtë “llapsuz” e bën qëllimisht, sepse do të tregojë se, njëherë e një kohë, ai takoi krerë të ndryshëm të botës! Ky edhe rrenat i ka të planifikuara!

E dyta, Shaqir Fetai me “krerët e ndryshëm të botës” paska ndërruar përvoja! Pse a këta “krerë të botës” paskan pasur nevojë për



përvojën e Shaqir Fetait prej spiuni, prej tradhëtari, prej devalvusi të islamit institucional, prej shitësi të vakëfit, prej vjedhësi të pronës së BFI-së, prej degraduesi të jetës së organizuar fetare islame... Nëse ka paaaak përvojë fetare Shaqir Fetai, atë e ka vetëm sa për t'i maskuar të gjitha përvojat e shumta imorale të cilat e karakterizojnë këtë bzhyt!

Eu medet sa posht i ka rënë pazari Bashkësisë Fetare Islame, ku e ka degjeneruar famën e dikurshme ky farë Shaqir Fetai që kur u instalua në krye të BFI-së, e cila, dikur, gjatë viteve '90 në qarqet e ndryshme të botës islame, konsiderohej ndër pesë faktorët më me relevancë në botë, pas Arabisë, Turqisë, Egjiptit dhe Palestinës! Dikur çështja shqiptare zinte vend edhe nëpër konkluzionet e konferencave të ndryshme islamike. Sot këtë e pengojnë misionarët e strukturave antishqiptare të pasuar nga serbomadhi Vuçiq!

***/BotaPress/15.08.2023/***

## **Vetëzbërthimi i despotit**

*Shërbimet sekrete janë të parët që e nuhasin gjakimin e një personi për t'u shndërruar në despot, në tiran, në autoritar, në diktator! Personi me një gjakim të tillë, gjënë e parë që do ta bëjë është që t'i bindë shërbimet sekrete se vetëm informacioni i vet është i saktë ndërsa i shërbimeve ka nuanca të manipulimit. Prandaj, e ngrit në kult e në institucion të vërtetën e vet. Dhe krejt kjo metamorfozë shpirtërore bëhet ngase personi me synime despotike fillimisht është frikacaku më i madh që mund të ekzistojë në fytyrë të tokës*

*Nga Mr. Eset Shaqiri*

Po e lexoja “diçiturën” e fundit të Shaqir Fetait, intalacionit në krye të BFI-së nga shërbimet që nuk kanë lidhje me këtë Organizatë dhe me islamin në përgjithësi dhe, sakaq para syve, sikur nisën, si në shiritin filmik, të më shfaqen personazhe të historisë që në mbamendjen e njerëzimit kanë ngelur vetëm si despotë, tiranë, diktatorë, autoritarë. Asnjëri prej tyre pushtetin nuk e ka kapur për shkak të aftësisë, shkathtësisë, zgjuarësisë apo karizmës prej lideri të mirëfilltë. Intriga, gënjeshtra, sjelljet prej anormali dhe psikopati (sepse vuajnë nga një paranojë e pashërueshme) ngelin vegla përmes të cilëve do të ngjiten majave të “liderizmit”!

### **“Engjëlli” brenda lëkurës së satanait**

Despotët, autoritarët, imponohen si njerëz më të ditur, më të aftë në raport me autoritetet e mëparshme, me liderët e mendimit ndryshe. Për bashkëpunëtorë më të ngushtë despotët gjithmonë i afrojnë ata idividë që janë në gjendje që ta luajnë në mënyrë transparente anën e zezë të despotit, që janë në gjendje të vrasin, të burgosin, të shkatërrojnë gjithçka në emër të despotit i cili ka “personlitet engjëlli”

brenda lëkurës së satanait! Ky despot i frikëson deri në bindje të gjithë bashkëpunëtorët e vet duke u thënë se është shumë i fortë, se nuk ka më të fortë se ai, se është në gjendje ta përmbys botën, aq i fortë që është! Natyrisht, këtë forcatë do ta gjejë pasi t'i dobësojë shërbimet sekrete që dikur e mbushnin me informacione të sakta dhe, pasi do të krijojë përshtypjen se e vërteta e vet është absolute, ndaj nuk do të ketë nevojë për shërbime sekrete sepse informacionet e tyre mund të jenë “fake”! Edhe nëse nxjerrin ndonjë dosje me nofkën “ORAO”, ju mos i besoni këtij shërbimi, sepse ata gënjejnë! Vetëm unë e them të vërtetën, thotë despoti!

## **“E vërteta” e diktatorit**

Pra, diktatori, ose despoti, ose tirani, ose autoritari, sapo të ngjiten në pushtet, në hapin e vet të parë, sakaq, nisin ta krijojnë këndvështrimin prej nga duhet të vëzhgohet e vërteta, sepse ky sukses do ta bëjë shumë të fuqishëm dhe të rëndësishëm, ndërsa nga ana tjetër, edhe bashkëpunëtorët e vet do të jenë në gjendje që të mësohen shumë shpejt se e saktë është vetëm ajo që e thotë prijësi i tyre diktator!

Hapi i dytë i diktatorit është që ta forcojë bindjen tek të tjerët, sidomos te bashkëpunëtorët e vet të ngushtë se, ai kurrë nuk mund të jetë në gabim. Të gjithë gabojnë dhe, ata nuk mund të gabojnë nëse nuk do të jenë gjallë dhe, jan gjallë si rrjedhojë e “shpirtmiresisë” së diktatorit! Despotët gjithmonë e kanë monopolin mbi të vërtetën!

Kësisoj, ata që janë të ndershëm e të devotshëm, do të fillojnë të ndalojnë së thënuri të vërtetën, mercenarët e diktatorit do të hidhen në sulm për ta përhapur gënjeshtërën. Rritet servilizmi dhe gatishmëria për t'u shkrirë për diktatorin! Ata që rrugës do të gabojnë dhe do ta thonë eventualisht ndonjë të vërtetë, ata do të shantazhohen, sepse diktatori e ka të vërtetën e vet edhe mbi “rrebeluesi” të cilët, ose do të vetëpërfshihen ose do t'i nënshtrohen diktatorit për t'u shndërruar në kavje për labororet eksperimentale të diktatorit, despotit, tiranit. Dhe, sa më i fuqishëm në ngulfatjen e së vërtetës, aq më i madh do të duket peshonaliteti i diktatorit!

## **Mizori i thyen edhe veglat përmes të cilave vjen në pushtet**

Miqtë personal të liderit diktator do të shëbejnë si bedena prej nga do të fluturojnë vetëm shigjetat e së vërtetës së diktatorit. Këta miq janë po ata vegla (qofshin këto edhe organizata, shërbime sekrete

e parti) që e kanë ndihmuar diktatorin që të kapë pushtetin. Këta miq nuk do të mund t'ia mbajnë zhagun diktatorit prandaj edhe, sakaq, mund të shndërrohen në armiq të tij. Por, lideri i tyre tashmë i aftësuar për të zgjidhur probleme që shfaqen shtigjeve të egra të diktaturës, pa dyshim, do t'i eliminojë këta armiq dhe, për më afër vetes do të afrojë individë të rinj, të cilët nuk jepen pas idesë, traditës, sepse më fort parapëlqejnë që të thyejnë kurrizin e të përkulen para liderit të tyre diktator, i cili do t'u hap perspektiva të sigurta të rinjëve! Këta nuk vërejnë se tashmë diktatori është futur në rrethin vicioz të shkatërrimit dhe se perspektivën do ta kenë terr e skëterr!

## **E vërteta absolute e diktatorit**

Tërë ky përshkrim mbi instalacionin diktatorial në krye të BFI-së a nuk e zbërthen më së miri dhe në mënyrë plastike Shaqir Fetain, i cili gjithkund mundohet ta shesë të vërtetën e vet se ai është reisul ulema, ndonëse edhe zogjtë e malit e dinë se si u ngjit majave të pushtetit! Është identik si personazhët historik me biografi prej diktatorësh! Shaqir Fetai gjithnjë mundohet ta shesë të vërtetën e vet si absolute! Për këtë të vërtetë ai është në gjendje të përbmys një botë të krijuar nga i Madhi Zot! Të vërtetën e vet nuk e provon në debate, në diskutime, nëpër forume, nëpër ndeja, sepse nuk ka nevojë, sepse ai është i bindur se e vërteta e tij është “absolute”. Nisur nga kjo logjikë ai edhe rrenë, sajon gënjeshtër, iluzionet dhe halucinacionet personale i paraqet si saktësi dhe, sukseset eventuale i paraqet si të tijat personale, ose si të arritura që evidentohen që nga instalimi i tij në krye të BFI-së!

## **Parrulla që deshifron synimin e autoritarit**

Kjo u pa edhe në “diçiturën” e tij nr. 27, të publikuar në fb-un e vet. Aty Shaqir Fetai mundohet ta bindë botën se, që kur u bë që ky të prezantojë nëpër konerenga ndërkombëtare, islami ka nisur të kuptohet më mirë, jeta islame anekënd botës ka marrur hov, kontributi i tij në këtë progres është i pakontestueshëm! A nuk është kjo ëndërr e çdo diktatori, tirani, hipokriti ose, a nuk duket kjo si një lakmi e “ushtarit të djallit”?

“Vet fakti që ishin ftuar krerët e Bashkësive dhe Meshihateve islame në botë dëshmoi në ngritjen e vetëdijes organizative dhe shpjeguese të Islamit konform burimeve të tij me qëllim që të mos lihet hapsirë qëllimeve destruktive, shpjegimeve fracioniste, mendimeve radikale e ekstremiste, përçarjes, dhe ndikimeve të

dëmshe për Islamin, muslimanët dhe njerëzimin në përgjithësi”, thotë Shaqir Fetai në paçavurën e vet numër 27! Pra, nëse nuk do të ftohej Shaqir Fetai në këtë Konferencë, islami burimor nuk do të ishte i mundshëm të perceptohet dhe të kuptohet në botë dhe, meqë e kanë thirrur atëherë këtu mbyllen të gjitha thashethemet mbi mendimin radikal, mbi ekstremizmin, përçarjen, fraksionizmin etj. dukuri këto shumë të fuqishme dhe shumë prezente në përditshmërinë tonë që kur në krye të BFI-së u instalua Shaqir Fetai! Kur kemi pasur “fetfa” personale nëpër tik-toka e fb-ka më shumë se sot, nga hoxhallarë të diskutueshëm, ndërsa para tyre hesht Shaqir Fetai dhe “institucioni” i tij! Kur kemi pasur “bashkësi islame” më shumë se sot që kur Shaqir Fetai u hodh në ngulfatjen e kësaj të vërtete duke u munduar që atë ta paraqesë si “të vërtet fake”! Xhemat më të fraksionuar kurrë nuk kemi pasur siç e kemi sot. Këto dukuri nuk i durojnë bashkëpunëtorët e tij, prandaj edhe tri herë radhazi janë munduar që ta shkarkojnë. Por, përhapjen e së vërtetës personale Shaqir Fetai e ka mision, edhe pse ajo e vërtetë mund ta ngulfasë islamin dhe jetën islame institucionale në vend!

## **Diktatori ka vetëm një temë**

Shaqir Fetai vazhdon me cinizmin e vet të djallëzuar: “Për këtë e gjithë Konferenca kaloi në shpjegimin e parimeve islame si dhe prezentimi i tij i mesatares (el vesatijeh vel i’tidal) që është edhe drejtim i pastër dhe i vërtet i Islamit. Koncepti i pastër monoteist, ndërtimi i morales tek besimtari, forcimi i familjes së shëndoshë, harmonia e jetës me njerëzit në përgjithësi pa dallim kombi e race, paqja, toleranca, solidariteti dhe bashkjetesa, zhvillimi në sfera të ndryshme të jetës, unitetit i besimtarëve kudo që jetojnë dhe veprojnë ishin temat kyçe për të cilat u debatua dhe u bisedua.” E vërteta është se Shaqir Fetai as që di se çka është biseduar dhe çka është debatuar, sepse ai nuk e njeh gjuhën arabe! Ai nuk u beson këtyre temave, sepse tema e tij është më e rëndësishme dhe unike! Tema e tij është si ta zgjasë sa më shumë pushtetin e vet diktatorial, jo në demonstrim të fuqisë, sa të hipokrizisë dhe të vërtetës së vet. Flet për një Konferencë, në të cilën ka qenë i ftuar edhe vetë ai, prandaj për herë të parë në këtë Konferencë shpalosen parimet islame! Po në konferencat e tjera tradicionale, çfarë është biseduar, apo është përhapur mendimi radikal e ekstremist! Për herë të parë paskemi “koncept të pastër monoteist”! A nuk është ky ekstrati i hipokrizisë së Shaqir Fetait?

## **Autokrati: Mos u besoni të vertetave që flasin mbi vjedhjet, mbi spiunimet, mbi tradhëtinë si mision brenda BFI-së**

Tutje, Shaqir Fetai thotë: “Në të gjitha Konferencat botërore të vendeve muslimane tashmë islamit i qasen me një maturi dhe thellësi të mendimit duke synuar që Islami të jap ate kryesoren si fe e mesatares...!” Pra, që kur nisi të marrë pjesë nëpër konferenca botërore edhe Shaqir Fetai, tashmë islamit i qasen me një maturi! Po si ka qenë më herët nëpër Konferenca të ngjashme botërore? A nuk flet kjo përpjekje dhe ky këndvështrim i Shaqir Fetait, gjakimin e tij për kapjen e majave botërore, synim diktatorial për ta përhapur të vërtetën e vet, edhe pse nuk e ka të qartë dhe nuk e ka aftësinë për ta kuptuar dhe për ta zbërthyer profesionalisht “islamit si fe e mesatares”? E vërteta e Shaqir Fetait duhet të jetë absolute edhe për sa u përket fenomeneve dhe parimeve islame!

Shaqir Fetai vazhdon tutje me cinizmin e vet plot helëm gjarpëri duke e përhapur të vërtetën e vet absolute: bashkësia e tij fetare na qenka përfaqësuese e denjë e myslimanëve të Ballkanit dhe përfaqësuese-ambasadore e islamit në Ballkan dhe Evropë! Pra, mos u besoni të vertetave që flasin mbi vjedhjet, mbi spiunimet, mbi tradhëtinë si mision brenda BFI-së; mos i besoni të vërtetës për sektarizim të xhematit dhe frakcionim të BFI-së; mos i besoni vjedhjes, tëhuajësimit dhe shkatërrimit të vakëfit, mos i besoni fjalëve që flitet për kontrabandues të refugjatëve, mos e përhapni të vërtetën për atë se si bashkëpunëtorët e ngushtë të Shaqir Fetait brenda natës na dalin boss-a, biznesmenë, pasanikë me prona të paimagjinueshme, ndonëse me një rrogë mesatare, por, besoni të vërtetës së Shaqir Fetait i cili thotë: “Bashkësia fetare e Islame me pjesmarrjen e saj në këto Konferenca dhe ftesat e rregullta si dhe dhënia e pozitës së lartë në protokolet e tyre paraqet përfaqësues të denjë të muslimanëve të Ballkanit”, duke e përfunduar të vërtetën e vet: “bashkësive islame për muslimanët e Ballkanit si ambasador – prezentues të Islamit në Ballkan dhe Evropë”, edhe pse nuk ka BFI në Evropë për të cilën është e përhapur e vërteta absolute për një Institucion ku kultivohet tradhëtia, spiunimi kontrabanda e ndihmave humanitare, vjedhja e fitrit, zeqatit, kurbanëve, haxhit, vjedhja e vakëfit, dhe heshtja apo mbulimi i të gjitha këtyre dukurive antiislame e antihumane!

Duke qenë e vërtetë e pamohueshme fakti që në këtë “diçiturë” të Shaqir Fetait ka plotë rrena, hipkrizi, “të vërteta diktatoriale”, cinizëm e tallje me islamit, për herë të parë Shaqir Fetai, që kur nisi t’i publikojë diçiturat e veta paçavra si “aforizma” të një mendimtari

të pashoq, ai për herë të parë nuk e përmyll diçturën me frazën e tij refren “kështu na do Zoti”! Shaqir Fetaj është i vetëdijshëm se cinikët dhe hipokritët nuk i do Zoti, ndaj dhe nuk shkon më tej nëpër shkallët e mëkatit!

***/TetovaSot/21.08.2023/***

## ***Kujt i duhet një BFI kaq e defaktorizuar***

***Ndonëse në BFI-në e Shaqir Fetait vlojnë skandalet, ndonëse nepotizmi, korrupsioni, vjedhja, devaluimi, deinstitutionalizimi, amoraliteti kanë arritur kulmin e lulëzimit, asnjë nga mediat shtetërore, asnjë nga organet shtetërore të drejtësisë, asnjë nga komisionet gjegjëse nuk merren me këtë institucion dhe me të degjeneruarit brenda tij! Madje edhe e favorizojnë, e ushqejnë këtë krim, vetëm e vetëm të funksionojë një BFI e degraduar në nivel të një ojq-je me rol periferik***

***Nga Jasir Jashari***

A ju kujtohet BFI-ja e dikurshme? Një Institucion shumë relevant, shumë i respektueshëm, shumë kushtetues, shumë i vendosur në realizimin e programit dhe strategjisë të bazuar në platformën e Institucionit që kishte për qëllim avancimin e jetës fetare por dhe zgjidhjen e çështjeve kombëtare të pjesëtarëve të vet, që me shumicë absolute ishin dhe janë shqiptarë! Dikur BFI-ja kishte edhe peshën e Institucionit fjala e të cilit respektohej gjithandaj qarqeve ndërkombëtare! Kishte staf profesional, personalitete nga më të mirët në rajon e më gjërë.

Sot, BFI-në e kemi në nivel të një çajtores provinciale ku hyn e del mileti sa për të pirë një çaj e për të bërë një sesion fotosh me “reisin” e instaluar në krye nga qarqet që nuk kan asgjë të përbashkët me islamin!

Dikur institucionet e caktuara shtetërore i përkrahnin lëvizjet e dyshimta vetëm e vetëm që të dëmtohet BFI-ja, e cila natë e ditë i luftonte ato lëvizje në emër të ruajtjes së unitetit dhe të islamit burimor e autokton, ndërsa sot, institucionet e caktuara shtetërore e përkrahin BFI-në e Shaqir Fetait vetëm pse është shumë tolerante në realizimin e synimit të tyre: defaktorizimin e BFI-së, fracionimin e xhamatit si



dhe përkrahjen e sa më shumë “bfi”-ve që do të jenë turpi më fatal i myslimanëve të vendit.

Sot, brenda BFI-së vlon nepotizmi, vlon shantazhi, krimi, hajnia, vjedhja e vakëfit. BFI-ja është shndërruar në qendër e intrigave nga më të poshtrat! Iks myftiu e fal Shaqir Fetain nëse ia punëson në Medrese një kushëri, tjetri myfti e fal Shaqir Fetain nëse do t'i shkarkojë nga myftillëku myftiun e Kumanovës, të Tetovës si dhe të Strugës, tjetri myfti, e përkrah opcionin politik të “liderit” nga fisi i të cilit mbanë sekret një femër që e trajton si grua të dytë, myftiu tjetër nuk i bëzan Shaqir Fetait sepse ky akoma nuk ia ka hapë dosjen e vjedhjes duke ndërtuar magazina e objekte gjigante me paratë e fitrit e të zeqatit, të tjerët myftilerë i rrinë sus Shaqir Fetait, sepse ky i ka ngritur në institucion, edhe pse ata nuk e meritojnë as të drejtojnë dy copa dhenësh!

Për të gjitha këto dukuri të tmerrshme kanë njohuri institucionet e shtetit, organet e drejtësisë, subjektet e caktuara politike, të cilat, “pa vetëdije” janë bërë mburojë e interesave mesquine të honxho-bonxhove të Shaqir Fetait!

Sot BFI-ja, aty-këtu, herë pas here vizitohet edhe nga ndonjë diplomat i huaj, i cili jo se nuk është i njohtuar nga shërbimet e veta me krimet dhe maskrallëqet që vlojnë brenda BFI-së, por, ja që kanë instruksione që ta legjitimojnë defaktorizimin dhe degradimin e BFI-së, ngjashëm siç po e legjitimojnë edhe institucionet shtetërore, madje, fatkeqësisht, edhe disa “parti politike kombëtare”, sepse, ia kanë dalur disa ta partizojnë dhe ta militarizojnë institucionin duke shpresuar në gjenerim te votave partiake!

Një gjë është e qartë! Një BFI në këtë nivel ku e ka sjellë Shaqir Fetai me politikat e veta nonshalante, nuk i duhet askujt, aq më pak myslimanëve të vendit! Një BFI që sjell vendime punësimi nëpër çajtores, madje emëron drejtor të medresesë në kundërshtim me Statutin e Medresesë, që sjell vendime denacionalizimi të vakëfit përmes bonove në vlerë edhe atë nëpër oda katundesh dhe jo në Rijaset; një BFI e defaktorizuar dhe e depersonalizuar është një kokëdhembje fatale për vetë perspektivën e shtetit dhe të shoqërisë.

Sot fjala e BFI-së nuk dëgjohet askund, nuk ka peshë, rrjedhimisht nuk është vendimtare! Sot BFI-ja nuk është në gjendje të zgjidhë qoftë një problem më të vogël me të cilën përballet! Sot BFI-ja konsiderohet si turpi më i madh i myslimanëve të vendit, të cilët, për hirë të devotshmërisë së tyre, kanë frikë të ngrisin zërin protestues kundër kësaj dukurie shkatërrimtare që po ndodhë brenda BFI-së! “Lideri” i BFI-së sot është njeriu më i përfolur në Ballkan e më gjërë, emri i tij përflitet herë me nofkë e herë si tradhëtar, herë si hajn e

herë si bashkëpunëtorë i strukturave të caktuara, aq më tepër kur të gjitha këto u thanë edhe nga anëtarë të Rijasetit! (Shkarkimi i të cilëve ndodhi dy-tre muaj më parë!)

Tërë ky degradim nuk i bën përshtypje as institucioneve shtetërore, as subjektit politik të bllokut mysliman dhe as faktorit ndërkombëtar! Heshtja e rrënimt po u konvenon të gjithëve! Porse, nuk duhet harruar, nuk ka rrënim pa zhurmë dhe, nga ana tjetër, nuk ka ngritje pa zhurmë! Zhurma e rrënimt mund të zgjasë disa sekonda, por ama zhurma e ngritjes mund të zgjasë përjetësisht dhe, në këtë përjetësi të detyrohen pastaj të gjithë që të mëshirohen me atë zhurmë, madje edhe të sakrifikojnë më sublimen vetëm e vetëm që ngritja të përfundojë sa më shpejt dhe, me të, të përfundojë edhe zhurma sado e lezetshme që mund të jetë për palën ngritëse!/*TetovaSot/29.08.2023/*

## **Shaqir Fetai ka nevojë për shkollim fillor të plotë**

Shaqir Fetai është mësuar në jetën e vet kontraverse që asnjëherë mos të mendojë dy herë para se ta hedhë hapin! Populli thotë: mendoje dy herë, pastaj thuaje! Mos bëj hop pa e hedhur hapin! Lexoje nja 100 herë para se të publikoshë atë që e mendon! Mos e vepro atë që nuk dëshiron të veprohet mbi ty! E Shaqir Fetai të gjitha i bën, siç i duket atj mirë, madje edhe budallallëkun më të shtrenjtë e vepron, e thotë, e bën! Prandaj del kaq palaço, kaq qesharak i shpifur! Prandaj është alet kaq i përshtatshëm në duart e pista të turlifrë projektuesi!

Paska dalur me një urim për ditën e parë të vitit të ri shkollor! Mezi pret të dalë në publik rast e pa raste, ndonëse ajo që e publikon e demaskon si injorant flagrant! Qenka shumë e madhe kjo ditë, sepse në këtë ditë (shih abdallin!) po u realizuaka “dija, nëpërmes të cilit formohen gjeneratat e ardhshme në dy segmente: segmenti moral, mbjellja e tipareve të sjelljes ndaj vetvetes, të tjerëve dhe, segmenti i dytë ngritja e dijes përmes të cilës njih sferat e ndryshme të jetës së njeriut, që çon drejt zhvillimit, përparimit dhe ngrit nivelin e vetëdijes mbi gjithçka që e rrethon: mbi besimin, kombin, familjen, njeriun dhe shoqërinë.”

Në bazë të këtij “definicioni” të Shaqir Fetait del puna që ky farë “alimi” duhet të rikthehet në bankën fillore dhe, që në start t’i caktohen mësuesit që do ta anjin derisa t’ia mbjellin diturinë! Shaqir Fetait i mungojnë ato të dy segmentet që ngriteshkan në shkollë: ka dëshmuar se është i pamoralshëm, se është jobesnik, se është tradhëtar, se është hajn e shkatërrimtar. Gjithashtu, ka dëshmuar se, gjithçka që e rrethon, besimi, kombi, familja, shoqëria, nuk kanë kurrfarë peshe e rëndësie në krahasim me interesat e tij personale mesquine e shumë të ulëta!

Apo, Shaqir Fetai mendon se këto dy segmente arrihet që në ditën kur ulesh për herë të parë në bankën shkollore. Prandaj avdalli thotë: “Është ditë e madhe sepse realizohet dija”! Ndërsa dija është një proces që të shoqëron tërë jetën. Vetëm te Shaqir Fetai realizohet që ditën kur nis viti shkollor! Për Shaqir Fetain e rëndësishme është që të nisë viti shkollor e ku do të dalë e si do të shkojë, kjo nuk ka fare rëndësi për të. Prandaj, e ka sjellë Medresenë, “shkollën e vet” në këtë derexhe, në situatë kur asnjë mysliman nuk dëshiron të nisë ditën e parë shkollore aty. Le të tregojë Shaqir Fetai se në paralelen e vet në Gostivar, sa vajza u regjistruan që të vijojnë vitin shkollor 2023-2024 në Medrese! Vetëm pesë vajza, ë! Ky fakt nuk duhet ta bëjë Shaqir Fetain që t’i gëzohet ditës së parë shkollore, por, duhet ta trishtojë, ta çmendë, shpirtërisht ta degjenerojë. E jo në mjerimin më të madh shkollor të shitet si njeriu më i lumtur në botë. Shpirtshituriedhe kjo vaki i ka hije!

***/LMR ne BFI/01.09.2023/***

## **Çka po ndodhë me BFI-në e Shaqir Fetait: para e madhe e BFI-së u kap në “Tabanoc”?!**

*Shaqir Fetai tashmë po flet me të madhe: “jam shumë i fortë, nuk kanë çfarë të më bëjnë. Pas më rri Ali Ahmeti dhe e gjithë BDI-ja”! Nën këtë logjikë të tij të mbrastë, në BFI po ndodhin skandale të tmershme, skandale këto që po i përsbkruben edhe BDI-së*

*Nga Mahir Rexhepi*

Vetëreklamimi i Shaqir Fetait si njeri shumë i afërt i Bashkimit Demokratik për Integrim, e cila, sipas “reisi” po i ofruaka përkrahje pa rezervë meqë na qenka kuadër i klerarkisë së ngushtë të Partisë së Ali Ahmetit, i ka hapur shteg veprimtarisë kriminele që po lulëzon me të madhe që kur nga qarqet e shërbimeve të dyshimta u instalua në krye të BFI-së! Shaqir Fetai thotë se, BDI-ja e përkrah meqë kjo parti, edhe kësaj radhe, shumë shpejtë do të ketë nevojë për “financa të zeza” për zgjedhje të parakohëshme, të cilat do t’ia sigurojë BFI-ja, ndërsa “reisi” ka nevojë për këtë Parti, sepse kësosoj ndjehet më i fortë jo në organizim të BFI-së por në zhvatje të këtij Institucioni si dhe në dezorganizim total. Fundja (sipas një incizimi) vetë Shaqir Fetai pranon se para e madhe nga Haxhi i sivjemë është derdhur në xhepat e një funksionari të lartë të BDI-së (nga goja e tij lakohet edhe emri i këtij funksionari)!

Ka kohë që flitet se në BFI janë nja dy kolegë (miq të ngushtë të Shaqir Fetait) të cilët merren me kontrabandimin e refugjatëve avganë, sirianë etj. Madje ky shqetësim është ngritur edhe në qarqet diplomatike! Personi i fundit të cilit i është ofruar detyra e shoferit të kamionit për kontrabanim të refugjatëve ka qenë i infiltruar nga shërbimet gjegjëse shtetërore, ndërsa marrëveshja është arritur jo më larg se një metër nga kabineti i Shaqir Fetait.

Shaqir Fetait ia bëjnë tri herë puçin e njëjtë siç ia bëri ky tre

vite më parë H. Sulejman ef. Rexhepit. Ndërsa nuk i largon, nuk i ndëshkon për mosrespektim të normave kushtetutare të BFI-së. Në insistimin e Myftiut të Shtipit, Nasir Rexhepi, për largimin e të gjithë myftive si dhe të drejtorëve dhe dekanit të FSHI-së, Shaqir Fetai i përgjigjet (dhe kjo bisedë është e incizuar): “E kam më lehtë që t’i mbaj dhe të vazhdoj me të njëjtin, sepse, për të gjithë kam dosje. Të rinjtë që do të vinë nuk do të jenë kaq shumë të shantazhueshëm!”

Këtë përgjigje ia ka dhënë (edhe kjo e incizuar!) edhe myftiu të Shkupit, Qenan Ismaili, i cili që nga organizimi i puçit nga ana e anëtarëve të Rijasetit, vazhdimisht i kërkon Shaqir Fetait që t’i largojë tre myftinjte: atë të Kumanovës, Abedin Imerin, myftiun e Strugës, Salim Sulejmanin, si dhe myftiun e Tetovës, dr. Qani Nesimin!

Shaqir Fetai është bërë model dhe motiv i të tjerëve për vjedhjen e vakëfit, për vjedhjen e fitrit dhe zeqatit! Ditë më parë, Shaqir Fetai ia kurdisi një skandal myftiut rrebel të Tetovës, dr. Qani Nesimi, në lokalitë e të cilit policia gjeti sasi të drogës. Natyrisht, lokali i dhënur me qera nuk mund të jetë nën “juridiksionin” e pronarit të vërtetë. Çdo gjë që do të ndodhë përgjegjësi do të japë qeraxhiu dhe, këtë fakt e ka ditur edhe Shaqir Fetai. Por, për “reisin” e rëndësishme është që t’i bëhet fjala myftiut rrebel se, ja, ky paska një objekt gjigant, që e ka mbajtur sekret, sepse e paska ndërtuar me pratë e fitrit dhe të zeqatit të cilat nuk i ka dorëzuar Shaqir Fetait por i paska “vjedhur!” “Do t’i dorëzojë”, thotë Shaqir Fetai, “siç do t’i kthejë edhe të gjitha rrogat që i ka marrur në UT, si profesor, sepse na qenka i vetmi person në Maqedoninë e Veriut që i merr dy rroga, edhe si profesor edhe si myfti! Antikorrupsioni shumë shpejt do ta krehë dhe kjo do të jetë kërkesë e imja zyrtare”, përfundon Shaqir Fetai në bisedë me myftiun e Shtipit!

Shaqir Fetai i thotë zotëri avokatit (biseda mëse një orëshe e incizuar!) veç të tjerash: Pse nuk heq dorë nga Qani “pederi” (myftiu i Tetovës), pse rri me të kur e di fare mirë se Qani Nesimi tashmë është i falimentuar, e kam në grusht dhe e teri kur të dua...”

Shaqir Fetai bashkë me Qenan Ismailin dhe me nja dy myhybë të tjerë, natë e ditë po punuakan për të realizuar fshehurazi ndërrime kushtetutare, të cilat do ta zënë në befasi edhe BDI-në, e cila, sipas Shaqir Fetait, ka filluar të japë shenja se do të heq dorë nga Shaqir Fetai. Ndërrimet Kushtetutare do të jenë të egra, të panjohura për anëtarët e Rijasetit, kurse Qenan Ismaili me të madhe po i fërkon duart, duke i thënë “organit” të vetë bazë se, ja, shumë shpejt, me këto ndërrime BFI-ja do të jepet në tepsi në duart e FRI-së, organizatë këtë, të cilën, dikur Shaqir Fetai dhe reisi i tij, Sulejman ef.

Rexhepi, e quanin “filiale të UDB-së”! Po pse Shaqir Fetai BFI-në t’ia dorëzojë “UDB”-së? I ka gjë borxh?

Skandali i fundit më i pabesueshmi, i cili, implikon edhe persona të lartë nga Ministria e Punëve të Brendshme! Nga BFI-ja po qarkullojnë biseda (mund të jenë edhe tendencioze) se, ditë më parë, një ditë pas takimit të Shaqir Fetait me “reisin” e BFI-së së Preshevës, në kufirin e Tabanocit është ndalur vetura zyrtare e BFI-së ku janë gjetur 750 mij euro dhe një armë pa leje! Me intervenimin nga “lartë”, brenda pesëmbëdhjetë minutave procedura ka përfunduar dhe, ky krim madje as që është shënuar në aktivitetet doganore dhe as që është raportuar mbi këtë përpjekje që me makinën zyrtare të BFI-së të nxirren jashtë 750 mij euro! Ky informacion mund të jetë shpekulim, madje as që do të besonte dikush se një gjë e tillë mund të ndodhë në BFI, por ama, kjo bisedë që del nga BFI-ja shkakton dyshime të mëdha!

***/Fol.mk/05.09.2023/***

## ***Mospërfillësi i kriminalizuar***

***Mospërfillja e praktikave normative shpie në autoritarizëm! Autoritarizmi shpie në shkatërrim, krim dhe në vorbullën e veprave të ndryshme penale! Dhe, tërë kjo shpie në degjenerim të dinjitetit të bashkëpunëtorëve të sinqertë të autokratit. E ç'afërsi kanë këto veprime me fenë islame?***

***Nga Mahir Rexhepi***

Shaqir Fetai i paska thirrur ata të administratës së Myftinisë së Gostivarit dhe, paka kërkuar prej tyre që t'ia urojnë drejtorët e rinj që i ka gjetur dhe i ka emëruar vetë, pa përfilluar asnjë organ të BFI-së. Kjo nuk është “për inatë të resë më vdektë djali”, porse, kjo është përtej budallallëkut! Me qenë normal Shaqir Fetai, do t'ju hyte dru atyre që vinë në këtë formë për t'u tallur me “reisin” e tyre! Po a mund të ndodhë që një ministri, me komplet administratën, t'i shkojnë kryeministrit në zyre, për ta uruar për drejtorët e eshalonit të dytë e të tretë që i ka emërtuar vetë! Po pse e bën këtë gafë Shaqir Fetai! Natyrisht, për faktin që gati janë shterur ata që po i përgjigjen për t'i shkuar e për t'ia bërë lajmin se ja, “reisi u vizitua nga hamami i hyrës”, por edhe më shumë për faktin që ka mbetur vetë, si karapidi!

Mbi të gjitha, Shaqir Fetait do t'ia ketë tërhequr vërejtjen dikush për gabimet fatale që është duke i bërë. Ai po sillet sikur BFI-ja të jetë kotec i babës së vet, apo ahur i babgjyshit të vet! Shaqir Fetai po mundohet që me këtë akt të Myftinisë së Gostivarit t'i bëjë karshillëk edhe organeve të drejtësisë, ku një ditë do të përgjigjet me patjetër!

Nga Myftinia e Gostivarit Shaqir Fetai, tamam si klysh i skuthit, po kërkon që të përkahet në shkelje kushtetuese dhe në krim. A ka përgjegjësi penale? Pa dyshim që po!

Shaqir Fetai, duke anashkaluar aktet normative të BFI-së, meqë ka nisur të ndjehet i forë saqë i është mbushur mendja se arrat mund t'i thyejë me b..., largon e punëson persona, pa kurrfarë baze juridike. Për këtë punë është Rijaseti dhe jo reisi, por, meqë nuk ka Rijaset,

Shaqir Fetai vetë qepë e vetë pret! I largoi kokë më vete pesë anëtarë të Rijasetit, natyrisht që kokë më vete do t'i duhet edhe t'i pjellë pesë anëtarë të rinjë të Rijasetit!

Por, në këtë akt të bilmezit Shaqir Fetai, ka një skandal edhe më flagrant se sa kjo shkëlqej kushtetutare! Shaqir Fetai po i varrosë praktikat normative të BFI-së, një rregull të pashkruar mbase por shumë humane!

Në të kaluarën ka qenë rregull që në administratën e BFI-së të ketë përfaqësues të paktën nga Myftinitë më të mëdha të vendit dhe, ata përfaqësues janë pranuar me sugjerim të myftive. Kështu është krijuar ai balans i domosdoshëm i përfaqësimit rajonal nëpër organet e BFI-së! Konkretisht, ish-reisul ulema H. Sulejman ef. Rexhepi ka punësuar persona nga myftinitë vetëm ata që kanë qenë të propozuar nga ana e myftiut përkatës e që vendimet për punësim kanë dalur nga Rijaseti! Kështu edhe, eventualisht, janë larguar!

Sot Shaqir Fetai nuk pyet asnjë myfti, sepse po e ndjenë veten "shumë të fortë"! Ai, sot, është në gjendje t'i bëjë karshillëk edhe vetë Zotit! Pse jo, kur tashmë ka dhënë edhe prova konkrete se di ta gënjejë e ta mashtrrojë Zotin, di mos t'i frikësohet madje edhe të veprojë kundër urdhërave të Tij! Shaqir Feta nuk flet, sepse është dibidus, por ama ai vepron, sepse është intrigant!

Me këto largime e punësime që i bën, në fakt Shaqir Fetai dëshiron t'ju përcjellë mesazhe vetë myftive, të cilët, assesi të reagojnë për këtë mospërfillje nonshalante të Shaqir Fetait! Shaqir Fetai me urdhër personal largoi nga puna pa kurrfarë baze tre nëpunës kumanovarë, për të cilët dikur një Myfti i Kumanovës kishte dhënë pëlqimin se këta persona janë ata që përfaqësojnë Myftininë e Kumanovës dhe që e bëjnë balansin e të punësuarve nga territoret e myftinive të tjerë. I largoi nga puna ndërsa komplet Myftinia e Kumanovës hesht! Ata nuk u zëvendësuan me kumanovarë por me lakej të Shaqir Fetait! Shaqir Fetai punësoi në vend të një kumanovari një tetovar, të cilin vetë Myftinia e Tetovës nuk e honepste dot për shkak të amatorizmit dhe paaftësive në punë administrative! A e përfaqëson ky person Myftininë e Tetovës në organet dhe institucionet e BFI-së! Me këtë heshtje të tyre, në fakt, Shaqir Fetai po krijon terren që, një ditë, kur t'i largojë edhe myftitë (e kjo do të ndodhë shumë shpejt), mos të reagojnë askush, sepse, ata nuk kanë reaguar edhe kur ua kanë larguar përfaqësuesit e myftinive të tyre. Shaqir Fetai nuk ka nevojë për përfaqësues me personalitet e me adresë, atij i duhen përfaqësues ekskluzivisht të interesave mesquine të Shaqir Fetait. Për momentin, Shaqir Fetai po përfshinë njerëz rrebelë të cilët nuk pjerdhin fort për organet e myftinive dhe, me këtë, ai stimulon



krijimin e organeve paralele të myftinive aktuale. Fundja, Shaqir Fetai ka lejuar dhe ka stimuluar themelime të bashkësive islame paralele e nuk po stimuluaka myftini paralele!

Aktualisht, nuk është problem Shaqir Fetai dhe as akti i tij mospërfillës, problem është mosreagimi publik i organeve si dhe i anëtarëve të “rijasetit” të cilët, shumë shpejt do ta provojnë edhe vetë ata, mbi kurriz të tyre, mospërfilljen e Shaqir Fetait, vetëm sa të gjejë përkrahje edhe te do “myftilerë” siç e paska gjetur te myftiu pa personalitet e padinjitet i Gostivarit! Tani me radhë do t’i vijnë për ta uruar për drejtorët që i ka emëruar (çfarë suksesi e çfarë aktiviteti jetik për islamin në vend!!!) edhe “myftitë” e tjerë të cilët që të gjithë i ka të shantazhueshëm. Qetësinë e Myftiut të Shkupit po e siguron duke ia premtuar atij mospërfilljen absolute në përcaktimin e tij për punësim të fëriestave nëpër organet dhe institucionet e BFI-së. Ja ku po e degradon BFI-në intriganti Shaqir Fetai me njerëzit e vet të nëntokës “fetare”!

***/BotaSot/08.09.2023/***

## ***Dekori i politikave maqedonase***

***Kur një institucion ka probleme me politikat e pushtetit, atëherë, në ceremoni të ndryshme të organizuar nga pushteti nuk shkon i pari i institucionit por e dërgon dikë nga “eshaloni” i tretë, sa për t’ia bërë me dije që, të respektoj por nuk pajtohem me politikat e egra antihumane! Ai që është dekor i pushtetit, ai nuk do të mungojë në asnjë event politik, ndryshe, dekori hidhet në pleh, si limoni i shtrydhur***

***Nga Sihana Shabani***

Lajm sensacional: “Reisul ulema, Shaqir Fetai, merr pjesë në ceremoninë e Parlamentit kushtuar pavarësisë së Maqedonisë”! Dhe ky lajm shkruhet me tonet e kënaqësisë më të madhe, sepse, ja se “sa i fortë që është” Shaqir Fetai! Pa të, shteti nuk bën asnjë hap! Kurse Shaqir Fetai bën hapa gjigant sa herë që shteti diskriminon shqiptarët, si pjesë dërmuese e komunitetit mysliman të vendit!

Shaqir Fetai, ky surrogat i politikave të qarqeve antiislame dhe antishqiptare të vendit e të rajonit, ky farë nxënësi i “UDB-së me nofkën “ORAO”, gjenë kohë dhe mundësi madje për të udhëtuar edhe në konferencë ndërkombëtare në Egjipt, lajm këtë që e ilustron me një fotografi që paraqet “Shaqir Fetai para foltores”! Deri më sot, në asnjë konferencë Shaqir Fetai nuk ka arritur ta përfaqësoj BFI-në ashtu si duhet! Në fakt, askush nuk e thërret për mend, sepse e kanë të qartë nivelin e analfabetizmit të tij, por e ftojnë si dekor, si shumë perfaqësues të tjerë të institucioneve minore nëpër botë! Një jetë e tërë i kaloi si dekor avdallit! Dekor i UDB-së, dekor i Sulejman Rexhepit, pastaj dekor i Bahri Aliut, dekor i Arif Eminit, dekor i qarqeve antishqiptare e antiislame në vend dhe, ja, për bukurinë që ma ka, ka nisur të përfshihet si dekor edhe nëpër konferenca ndërkombëtare!

Shaqir Fetai ditë më parë e bekoj dhe ditën e parë të fillimit të shkollave në RMV, madje edhe atë ditë kur nxënësit shqiptarë të Velesit me polici u dëbuan nga shkolla e tyre. Këtë urim, Shaqir Fetai

e nisë me: “Sot është dita e parë e vitit shkollor në gjith vendin. Të gjith të gëzuar arsimtarë, nxënës, prindër dhe çdo njëri që e do dijen. Është ditë e madhe sepse realizohet dija, imperativ i shenjtë i Zotit...” Po kur mohohet dhe kur nxirren pengesa subjektive për ta realizuar këtë imperativ të Zotit, çfarë duhet të bëjnë myslimanët? Çfarë duhet të bëjë Institucioni më i lartë islam? Shalën nën bisht dhe të heshtë, ë! Të heshtë si Shaqir Fetai? Të bëhet dekor i Parlamentit dhe t’i përgjigjet institucioneve shtetërore që nuk reagojnë kundër atyreve që i pengojnë nxënësit shqiptarë për t’u shkolluar, që nxirren me polici nga shkolla?!

Shaqir Fetai “nuk di” se çfarë po ndodhë në Veles! Shaqir Fetai nuk e shprehu as më të voglin shqetësim, qoftë përmes ndonjë komunikate institucionale, prej atyre komunikatave “as mish, as peshk” që i shkruan ai dhe shërbimi i tij diletantesk!

Shaqir Fetai u desht që të reagojë në mënyrë ultimative, sepse, dikush po pengon realizimin e imperativit të Zotit – nuk po i lë shqiptarët që të shkollohen! A nuk e shqetëson ky fakt Shaqir Fetain apo, ja që nuk guxon të reagojë sepse dikush pastaj ia shkundë kolltukun që e ka uzurpuar pa kurrfarë merite, vetëm sepse b... i ka për kolltuk!

Shaqir Fetai, me “myftiun” kukëll prej druri, të Velesit, si dhe me tërë “rijasetin” anemik të vetin, si dhe me shërbimet e kota që i ka, është dashur të jetë në Veles dhe, të futen në atë shkollë të mesme që ua mbyllë dyert nxënësve shqiptarë dhe, le të vinin pastaj policia dhe le t’i nxjerrnin nga shkolla këta farë “përfqësues të ulemave”!

Çka do të thotë politika diskriminuese arsimore? Çka do të thotë akti i dëbimit institucional nga shkolla të nxënësve shqiptarë? Asgjë tjetër përveçse politikë diskriminuese dhe dëbuese, mesazh për shpërngulje kolektive dhe, strategji për zbrasjen e Velesit prej shqiptarëve dhe, përgjithësisht prej myslimanëve një spastrim etnik “i paqtë”!

Shaqir Fetai e ka gjithë të drejtën morale për të reaguuar, sepse, ky me mish e me shpirtë angazhohet për shkollimin e maqedonfolësve në Medrese. Kjo është politika e BFI-së, e cila, duhet të kujdest po kaq për politika të mira ndaj myslimanve të vendit, sidomos ndaj shqiptarëve!

Mosreagimi i Shaqir Fetait flet ekskluzivisht për solidarizimin e tij me politikat diskriminuese në rrafshin arsimor e kulturor kundër shqiptarëve. Shaqir Fetai nuk ka kohë për të qëndruar qoftë vetëm një orë në Veles, ndërsa fluturon për Kajro ku “do të prezantohen vlerat islame në botë”!

Po myslimanët e Velesit, nxënësit shqiptarë që nuk lejohen të

vazhdojnë shkollimin e mesëm, a nuk janë një vlerë islame në botë? A nuk do të duhej ta alarmonte botën myslimane me këtë diskriminim që u bëhet shqiptarëve në Veles! Eee, do ta bënte sikur të dinte arabisht dhe, të mos ishte i ftuar në cilësinë e dekorit tretësor në Konferencë! Ia kanë fragmentarizuar e ia kanë parcializuar xhematin-ummetin, ia kanë bërë copë-copë jetën institucionale fetare, i kanë themeluar bashkësi fetare islame alternative, ndërsa ky vetëm e fërkon barkun duke e mbushur me copa të vjedhura nga Vakëfi!

***/BotaPress/09.09.2023/***

## ***Pse u tremb Shaqir Fetai në Kajro***

***Nëse Shaqir Fetai është analfabet në gjuhën arabe, ja që ka dikush që e di mirë këtë gjuhë! Shaqir Fetai lavdërohet se shumë portale paskan shkruar për vizitën e tij në Egjipt, gjegjësisht, për pranimin e tij nga ana e rektorit të Universitetit të Az'harit! U shkrua për Shaqir Fetain i cili për shtypin egjiptas paraqet një anonimus absolut, apo shtypi vendor përcolli aktivitetet e nikoqërive të një eventi ndërkombëtar? Shaqir Fetai edhe në përpjekje për manipulime na del të jetë injorant i pashoq***

***Nga Mahir Rexhepi***

Është kjo një përpjekje dëshpëruese e Shaqir Fetait për të mjegulluar sado pak të gjitha ato shkrime që e degradojnë deri në qenie të fëlliqtë e që u botuan nëpër portale të shumta kombëtare. Këto shkrime ia shpalsën një sërë skandalesh avdallit, e zbërthyen hipokrizinë e tij, ia zbardhën koordinimin me strukturat antishqiptare e antiislame që po i zhvillon gjithnjë e më pashpirtë, sepse, ka ardhur në atomin e fundit të të bërit keq mbi Institucionin dhe jetën fetare islame institucionale.

Shaqir Fetai mendon se si vetë edhe të tjerët nuk e dinë arabishten dhe ofron shkime në gjuhën arabe duke i titulluar

**“SHUMË PORTALE EGJIPTIANE SHËNUAN VIZITËN E REISUL ULEMASË H. HFZ. SHAQIR EF FETAJ NË EZ’HER”!**

Injoranti mendon se në këtë formë rregullohet piari, mendon se kësisoj do të zbutet sado pak urrejtja gjithëpopullore kundër këtij avanturieri që ka marrur përsipër shkatërrimin e të kaluarës së begatë të BFI-së dhe perspektivën e ummetit mysliman të vendit!

Po kush e njeh Shaqir Fetain në Egjipt? Çka paraqet Shaqir Fetai

për Egjiptin? Çfarë personaliteti i rëndësishëm i botës myslimane na qenka Shaqir Fetai që shtypi arab të merret me të! Në Egjipt ka pasur një event të rëndësishëm që ka mbledhur personalitete fetare nga mbarë bota. Gazetarët kanë shkruar për këtë event. Gazetarët kanë shkruar dhe kanë përcjellë aktivitetet e Kryemyftiut të Kajros, i cili, në kallaballëk qenka takuar edhe me Shaqir Fetain, gjest ky protokolar i domosdoshëm! Gazetat kanë shkruar dhe kanë përcjellë aktivitetin e Rektorit të El- Ah'zarit, i cili, në një takim kurtuazie ka takuar në kallaballëk edhe Shaqir Fetain! Pra, është shënuar aktiviteti i personliteteve vendore, i nikoqirëve, e jo i mysafirëve që kanë qenë me qindra të tillë. Aktivitetet e mysafirëve i përcjell shtypi i vendit të tyre. Po kush nga shtypi vendor ia tëjti Shaqir Fetait për aktivitetet e tij në Kajro!

Të vetmin aktivitet personal që e ka zhvilluar me këtë rast Shaqir Fetai është vizita që ia ka bërë ambasadës maqedonase në Kajro e që nuk shkroi asnjë media e vendit, madje as faqja zyrtare e MPJ-së! Shaqir Fetai vazhdon edhe më tej t'i vizitojë ambasadoret. Jo që e ka në tagrin e vet, por, thjesht, e ka nga incercioni i aktivitetit të spiunazhit që e ka në gjak! Dihet se kush më herët i vizitonte ambasadat dhe pse vizitoheshin ambasadat prej atyreve që nuk kanë kurrfarë lidhje e pune me ambasadat! Vetëm spiunët, gjegjësisht ata që kishin obligim që të paraqiten nëpër ambasada për t'i marrur urdhërat dhe detyrat që duhet t'i kryejnë aty ku do të gjenden!

Shaqir Fetai nga këto takime na informon se ia paska dalur që t'i bindë që të dy subjektet për sa i përket studentëve shqiptarë që do të dëshirojnë të studiojnë në Ez'her! Ambasadorja do të jetë në shërbim të studentëve eventualë ndërsa Universiteti do t'i panojë të gjithë ata që do të shprehin interesim për të studiuar në këtë Universitet!

Sa bursa i siguroi Shaqir Fetai? Sa u mbush me premtime se studentët shqiptarë do të ndihmohen financiarisht për të studiuar në këtë Universitet! Nga ish-reisi i tradhëtuar dhe "i ekzekutuar" nga Shaqir Fetai, për studentët shqiptarë që dëshironin të studiojnë në këtë Universitet për çdo vit siguroheshin bursa studentore! Dhe jo vetëm për në këtë universitet por edhe për qendra të ndryshme universitare në botën islame. Derisa e ndërtoi Fakultetin e Shkencave Islame! Që kur startoi kjo vatër e jona, politikë e ish-reisit ishte që, kuadri ynë i lartë të dalë e të përgatitet vetëm në këtë Fakultet dhe se të mos na degdiseshin studentët nëpër vise të huaja për gjuhën dhe kulturën tonë.

Çka mëton të arrijë Shaqir Fetai me këtë truk? Ta amortizojë të vërtetën e tmerrshme se, për vitin shkollor 2023/2024 ia ka dalur të regjistrojë vetëm 5 (pesë) medresante në paralelen e femrave në Gostivar? Ky avdall e kënaqi në Maqedoninë e Veriut, e "luloi" me

Meresenë e Isa Beut e i ka mbetur që ta “pasurojë” edhe Az’harin me studentë shqiptarë! As një hap nuk e ka bërë në drejtim të pranimit të medresantëve nëpër fakultete të vendit, madje, të paktën, në Fakultetin e Shkencave Islame, ndërsa e llogaritë si sukses personal premtimin e autoriteteve të Universitetit El Az’har për t’i pranuar dy-tre studentë nga Maqedonia e Veriut që dëshirojnë të studiojnë atje! Shaqir Fetai të paktën për një gjë do të duhej të ishte korrekt me opinionin e vendit! Meqë ka vendosur të informojë nga Egjipti, pse nuk tregon se si autoritetet e institucioneve të ndryshme egjiptase e pyesnin me mall për ish-reisul ulemanë H. Sulejman ef. Rexhepin dhe, cilin nga këta personalitete e rrejti duke i thënë se e ka bashkëpunëtorë të ngushtë dhe krah të djathtë! Pse e gënjeu dhe pse pati nevojë për këtë rrenë! Apo, u tremb nga gjithë ai interesim i autoriteteve egjiptase për H. Sulejman ef. Rexhepin

*/IKlikLarg/12.09.2023/*

## ***Loja me dinjitetin e femrës si loja me zjarr***

***Nëse një pushtet mendon se reformat duhet të jenë në të mirë të tij dhe jo në të mirë të shoqërisë dhe institucioneve nacionale, atëherë kemi të bëjmë me një pushtet i cili përgatitet për një sistem me një diktaturë klasike! Pushtetet e këtilla jo se nuk përfundojnë një ditë, por, deri tek ai përfundim dhe rikuperim të pasojave, kostoja do të jetë shumë e madhe, madje fatale për shoqërinë***

***Nga Rabije Ramadani***

Pas përfundimit të sistemit diktatorial të Enver Hoxhës, një malsor, i gjendur para një kamere televizive e cila po rejstronte prononcime të qytetarëve të rëndomtë, do të deklarohet: këtij diktatori nuk i falet asgjë, sepse ma paska degjeneruar malsorin, të cilin nga 2 metra, fiks për gjysëm shekulli ma paska sjellë në 1.80 cm! Kjo shprehje u mor si konstatim absolut: diktatori synon edhe degjenerimin e kombit dhe, për më shumë, të racës njerëzore!

Këtë synim, fatkeqësisht, e ka edhe Shaqir Fetai, ky instalacion në krye të BFI-së nga do qarqe antishqiptare e antiislame në RMV, i cili, ndërrimet kadrovike i koncepton si reforma! Në fakt, politikat kadrovike sa për instalim të lojalistëve janë hyrje në diktaturë!

Shaqir Fetai, në emër të kësaj “reformë” politikat e tij kadrovike që kundërmojnë në diktaturë ka filluar që t’i zbatojë pa asnjë frikë! Kur të pëlçet marrja, turpi, humbet edhe frika!

Së fundmi, Shaqir Fetai paska bërë edhe “një reformë” me të cilën e ka degjeneruar një traditë mëse tri dekadëshe! Shaqir Fetai, thjesht, tallet me Medresenë, me shkollimin e të rinjëve tanë, me edukimin e tyre në frymën e pastër islame! I përfshirë në një aferë amorale, me nuanca të pedofilisë, bashkë me një kolegë të vetin, për ç’gjë sot e gjithë BFI-ja ia bëjnë llafin, me gjasë i ka shkaktuar shije të ëmbël, ndaj dhe shkon e prekë aty ku shoqëria jonë është jashtëzakonisht e ndjeshme!



Shaqir Fetai i paska nxjerrur nja gjashtë profesoresha nga paralelja e vajzave të Shkupit dhe të njëjtat i ka angazhuar në Medresenë e meshkujve në Shkup, ndërsa prej aty ka nxjerrur tre profesorë dhe i ka dërguar në paralelen e femrave në Shkup! Pse iu desht kjo aventurë? Madje, puleni i Shaqir Fetait, drejtori rishtakë i Medresesë “Isa Beu”, me rastin e reagimit të profesoreshave të revoltuara, ka thënë: “kujt nuk i pëlqen ky ndërrim kadrovik, le të ikë, ka plotë kandidatë që presin të punësohen”!

Po pse “reisi” luan me bijat, me gratë, me nënat e huaja dhe nuk e sjell vajzën e vet nga paralelja e vajzave në Gostivar në Medresenë e meshkujve në Shkup?! Këto profesoresha do të angazhohen në lëndë profesionale! Janë disa njësi mësimore të cilat profesoreshat do ta kenë shumë të vështirë t’i ligjërojnë para nxënësve pubertetlinjë! A nuk është kjo një tallje idiotike e Shaqir Fetait me dinjitetin e profesoreshave tona shumë të nderuara! Ky gjest prej psikopati i Shaqir Fetait praktikisht e vërteton atë konstatim dhe ata fakte të publikuar më herët që flasin për këtë mahluk si për një rrënues të BFI-së dhe të jetës fetare institucionale!

Muslimanët e vendit, personeli arsimor si dhe administrata e BFI-së duhet që sa më parë të ngriten dhe të reagojnë kundër këtyre “politikave” të pista të Shaqir Fetait i cili talljen me dinjitetin e motrës myslimane e quan “reformë”!

Në fakt, Shaqir Fetai këtë këmbim të kuadrit profesional nëpër paralele jo adekuate, nuk e bën për reforma, por, thjesht, për “vetëlargim” të kuadrit dhe për zëvendësim të tyre me “posllushnikë”, ose e bën edhe për spiunim nga paralelet e ndryshme! Gjithësesi, vështirë që do të pajtohen bashkëshortët e profesoreshave që ato të jenë të rregullta në Medresenë e meshkujve, ndaj dhe, Shaqir Fetai që tani i ka “në llager” “profesorët” e ardhshëm të Medresesë Isa Beu të cilët do të jenë “kuadër i Shaqir Fetait”!

Luajtja me dinjitetin e femrës myslimane, luajtja me personalitetin e motrës shqiptare, është, thjesht, lojë me gurac prej gacash. Dikush, shumë shpejt do të digjet...

***/BotaSot/14.09.2023\*/***

## ***Pacipshmëria***

***Aktiviteti i Institucionit tonë fetar islam jo që është bërë një refren monoton, qesharak e i denjë për fillet e një shoqate joqeveritare e themeluar prej amatorëve dhe entuziastëve, por, ditë e më shumë po i ngjanë një “institucioni” jofetare e shkombëtarizuese***

***Nga Florim Huseini***

Tërë aktiviteti i një Institucioni reprezentativ është rudhur në pritje e përcjellje si në “odë të mixhës”, në përcjellje të ngushëllimeve e në dua të synetimeve! Natyrisht, organet profesionale të BFI-së nuk mund ta durojnë këtë mision sarkastik e të padenjë për parinë fetare me integritet. Si pasojë e kësaj si dhe një sërë aferash e skandalesh, këta organe drejtuesit e të cilëve janë dhe anëtarë të Rijastit të BFI-së (që tashmë po quhet “BFI-ja e Shaqir Fetait) kanë ngritur iniciativë për shkarkimin e Shaqir Fetait. Tri herë radhazi janë organizuar por, ja që Shaqir Fetai po ua mbanë bishtin nën rrotë dhe, sa herë po lëvizin ky me gjasë po ua shtyp bishtin! Do me thënë, skandalet dhe korrupsioni, aferat dhe punët e pista janë “shpirti” i kësaj BFI-je që akoma është duke e mbajtur të gjallë!

Tri vjet më parë ndodhi “i njëjti” organizim, ndonëse me të gjitha nuancat e një tradhëtie të madhe! Të njëjtët organe dhe persona u organizuan dhe ia morën “pushtetin” ish-reisul ulemasë Sulejman ef. Rexhepit! Nëse atëherë i mblodhën subjektet e dyshimita nëntoksore (që nuk ua donë të mirën as islamit e as myslimanëve, gjegjësisht, shqiptarëve), kësaj radhe u mblodhën kryekëput nga pakënaqësia e drejtimit dhe aktivitetëve skandaloze të Shaqir Fetait, i cili, me intriga nga më të ultat para tri viteve ia doli që t’i bindë ta përkrahin atë në instalimin në fronin e BFI-së!

Në fakt, një javë para se të ndodhë tradhëtia e madhe, të gjithë ata që ishin prononcuar për një dokumentar kushtuar H. Sulejman ef. Rexhepit, kishin thurur elozhe për reisin e tyre, gatise e kishin ngritur në nivele “pejgamberike”, madje kishte nga ata që para Sulejman ef.

Rexhepit kishin vënë dorën në Kuran duke u betuar se kurrë nuk do ta tradhëtojnë, sakaq, iu përgjigjigjën urdhërit, gati policor, që të tubohen të gjithë dhe t'ia shprehin mosbesimin, duke ia marrur edhe titullin reis. Të vetmin argumentim që e patën ishte: “e shkeli Nenin 58 si dhe u krijua opinioni për ta shkarkuar”!!!

Po sot, pse po të njëjtit po i shprehin mosbesim Shaqir Fetait të instaluar në krye të BFI-së? A dinë diçka më tepër këta mosbesues të Fetait, pse nuk e tregojnë mënyrën e puçit, kush i organizoi, pse u organizuan, cilët ishin premtimet, cilët janë zhgënjimet, apo, nuk guxojnë të flasin sepse do të vetëdekonspirohen! Në fakt, ka prej atyreve që edhe po flasin, po thonë që dhënia përkrahje më tej për Shaqir Fetain është punë e mëkatshme, sepse, për këto tri vite sa e përkrahëm kemi dështuar në reforma aq shumë të nevojshme, kemi humbur përkrahjen e xhematit, e kemi segmentarizuar dhe frakcionuar xhematin, kemi heshtur para “dorës së zezë” që po merret me regjistrimin e “bashkësive të reja islame”, kemi heshtur para shpenzimit nonshalant të vakëfit (letrave me vlerë), para degradimit dhe keqmenaxhimit me vakëfin, kemi heshtur para tentativave për jetësimin e filozofisë “përçaj e sundo”, jemi trullësuar nga shumë afera e skandale dhe nuk kemi ditur të kërkojmë përgjegjësi, sepse nuk ka pasur reagime dhe sqarime institucionale dhe, për pasojë, jemi damkosur që të gjithë! Në BFI natë e ditë punohet në shkelje të Kushtetutës së BFI-së, formohen lloj-lloj shërbimesh e sektoresh të pa parapara me Kushtetutë, është defetarizuar dhe dekombëtarizuar tërësisht misioni i BFI-së; në krahasim me BFI-në e viteve të para të demokratizimit të sistemit politik, sot jemi karikaturë e shëmtuar e një institucioni anti-fetar, pa koncept, pa program, pa synime e paqëllime; niveli kadrovik e organizativ ka zbritur në nivel të amatorizmit të rëndë e qesharak.

Nëse Sulejman ef. Rexhepi u turpërua nga organizimi për shkarkimin e tij dhe, nuk pranoi që edhe më tej t'ju prijë “tradhëtarëve të mëdhenj”, Shaqir Fetai ia doli që të jetë më “erbpap” se ai dhe, i shkarkoi dhe po i shkarkon të gjithë të pakënaqurit. Disa i ka futur në vrimë të miut duke ua tundur para hunde dosjet e këqia (pra, ai akoma drejton BFI-në me kuadër që janë me dosje të këqia) disa i ka shantazhuar e disa i ka blerë me paratë e fitrit dhe të zeqatit! Kështu po thonë të dëbuarit e fundit, të cilët, deri dje ishin bashkëpunëtorë më të ngushtë e më të dashur të Shaqir Fetait, dhe kjo e bën të paqartë konstatimin nëse ishin të këqinjë atëherë apo tash, kur e përkahën Shaqir Fetait apo tash kur po e mohojnë! Për përkrahje nuk ka kurrfarë arsytimi nga ana e tyre, ndërsa për mohim kanë listuar një mori argumentash tashmë të publikuar.

Shaqir Fetai nuk e ka atë turp e atë shqetësim të Sulejman Rexhepit që të reagojë ngjashëm si ai pas “ngritjes së iniciativës” për shkarkimin e tij! Shaqir Fetai i shkarkon të gjithë ata që nuk e duan, që ia numërojnë të gjitha arsyet se pse duhet të ikë një orë e më parë! Shaqir Fetai ka mision, ai duhet ta kryej misionin të cilin e mori që në ditën kur vendosi ta tradhëtojë reisin e vet dhe t’ia ngulë thikën pas shpine! Populli thotë: çka do të mbjellësh atë do të korrësh!  
***/Kombetare/23.09.2023/***

## ***Për situatën e nderë në BFI të gjithë jemi fajtor***

***Feja islame nuk mundet në asnjë mënyrë të përkufizohet vetëm si një lëndë e një doktrine metafizike, e as si një grumbull për kryerjen e ritualeve fetare. Islami është mënyra më e përsosur e jetës njerzore***

***Nga Naser Sabiti***

Feja Islame është sistem vlerash, organizim ekonomik, social, kulturor, arsimor etj., themelet e së cilës mbështeten në Shpalljen Hyjnore.

Politika ekonomike islame angazhohet për ruajtjen dhe zhvillimin shoqëror e individual, për plotësimin e nevojave materiale dhe shpirtërore të Muslimaneve në rradhë të parë.

Ne sot jetojmë në një situatë të dyndjeve të mëdha ekonomike, arsimore e sociale. Është më se e nevojshme që në shtetin tonë në veçanti të shprehet një përkujdesje maksimale për popullin shqiptar, meqë përbën shumicën e pjesëtarëve të fesë islame si dhe për të gjithë muslimanët në RMV. Ky përkujdes i takon sidomos BFI-së, Institucion ky i cili kohëve të fundit po fundoset nga skandalet dhe aferat e papara më herët. Që kur “një dorë e huaj” e solli në krye të këtij Institucioni Shaqir Fetain, gjithçka ka marrur tatëpjetën!

Letargjia e Bashkësisë Fetare Islame në RMV ka ndikuar në mënyrë të drejtë për drejtë në mungesën e vullnetit të strukturat brenda BFI-së për ta luajtur atë rol sipas përgatitjeve profesionale, ndërsa krejt kjo i ka krijuar hapësirë “reisit” të instaluar në pasjen e një monopoli në lindjen e një duzinë “bashkësisë fetare islame” si dhe “shoqata humanitare” e që nuk dihet se cila është “kibla” e tyre, nga vinë dhe as që dihen mjetet e tyre financiare me të cilat operojnë në popullatë.

Situata në aspekt të ngritjes edukativo-arsimore të kuadrit teologjik është mjaft brengosëse. Këta do të jenë ata që do të

udhëheqin Rijasetin si dhe BFI-në në të ardhmen. “Reisi” aktual me qëndrimet e veta nonshalante, me paaftësinë e vet, me intrigat dhe interesat e veta meskine, qartë po na e bën me dije se, në këtë nënqiell islami do ta ketë një perspektivë të mjegullt dhe jo gjithaq të qartë. Krijohet përshtypja se Shaqir Fetai po punon në drejtim të rrënimt të Institucionit me qëllim që pas tij të mos ketë BFI! Duke qenë top-temë dhe lajtmotiv i shumë shkrimeve, duke qenë bazë e shumë skandaleve dhe dështimeve të njëpasnjëshme, nuk mundet që ai të na shitet si “pararoje” e islamit! Të gjitha faktet po dëshmojnë për momentin se ai angazhohet vetëm për degradim dhe eliminim të çfarëdo roli e peshe të BFI-së në shoqërinë tonë në të ardhshmen!

A guxon që BFI-ja dhe kreu i saj të mos e dinë numrin e xhamive në vend si dhe emrat e tyre?!

BFI-ja jo vetëm që duhet të ketë numrin e saktë të xhamive në RMV, por është e obliguar edhe të emërojë, të mbikëqyrë dhe të përcjell vazhdimisht mbarvajtjen punëve brenda tyre.

Për habi (e nga habia ka lindur edhe filozofia!) paria e BFI-së as që e di numrin e saktë të xhamive. Reisi i mëparshëm pohonte se janë mbi 1000, ndërsa ky aktuali thotë se janë herë 700 e herë 800 xhami. Kjo flet për një mosnjohje elementare të situatës së Institucionit që e drejtojnë, me që dallimi është në mbi 300 xhami. Ndërsa as që e dinë edhe sa imamë, hatibë, mualimë, vaizë e myezinë ka BFI-ja, edhe pse thonë se aktivë (pra, të punësuar) janë mbi 1300. As ky numër nuk mund të thuhet se është i saktë, sepse as dhjetë për qind prej tyre paguhen nëpërmjet transaksioneve bankare. Nëse këtu i shtojmë edhe numrin e medresantëve, të studentëve të FSHI-së si dhe të atyreve që studiojnë nëpër vendet turko-arabe, atëherë lirisht mund të themi se kemi të bëjmë me një Institucion që për filozofi të veten e ka prodhimin e hiper kuadrit i cili, për t’u punësuar diku do të nis të hapë “tezga fetare” ku do të na shiten turlifarë “islami” e turlifarë fetvae që do të na bëjnë pikë e pesë dhe gaz i botës. Natyrisht, për fajtor historik dhe i vetëm do të njihet ekskluzivisht Shaqir Fetai, sepse ky tashmë po dëshmon se i interesin vetëm tymi i vet!

Nëse kjo që u tha këtu është kështu, atëherë Feja Islame do të bëhet bastion i antagonizmave, i sektarizmit të shoqërisë sonë që veçmë ka marrur hov.

Numri jashtëzakonisht i madh i të diplomuarve në shkencat fetare bën që të ndërtohen e të hapen xhami në çdo lagje, kurse BFI-ja as që do të mund të ushtrojë “pushtet”-kontroll mbi to.

Aktualisht, janë me qindra xhami në RMV që po ushtrojnë aktivitet tërësisht autonom e nën vëzhgim të qendrave të ndryshme që po derdhin pa hesap para!

Nëse i vështrojm rrjedhat aktuale të BFI-së, ne si pjesëtar të fesë islame, nuk na jep asnjë shkëndi shprese për përmirësimin e jetës fetare e aq më pak të asaj kombëtare. Sektet dhe rrymat e ndryshme që po veprojnë në emër të islamit janë ulur këmbëkryq në mesin tonë dhe, e gjithë kjo nuk është shenjë e mirë as për fenë dhe as për kombin tonë. Kjo po ndodhë para syve të faktorit tonë politik i cili duhet ta ketë mbi kurriz çështjen kombëtare të cilën ngjarjet aktuale në BFI po e rëndojnë së tepërmi. Faktori politik duhet të jetë i brengosur po kaq sa edhe analistët, opinionistëtsi dhe mbarë popullata përkatëse e vendit.

Sipas mendimit tim kjo duhet të shërbejë si një alarm drithërues duke filluar për popullatën, subjektet tona politike si dhe për të gjithë faktorët relevant kombëtar në Botën Shqiptare.

Të gjitha faktet por dhe shumë zëra që vijnë nga brenda Institucionit, flasin qartë se, brenda institucionit të ashtuquajtru BFI nuk ka aspak konsolidim të udhëheqësisë, nuk ka program as plan veprimi kah e mbara por vetëm kah shkatërrimi total! A do ta lënë faktorët relevantë kombëtar që të shkatërrohet edhe më tej ky Institucion me rëndësi të veçantë historike e kombëtare, kjo varet para së gjithash nga komuniteti teologjik i vendit, nga organet dhe institucionet që janë shtylla të BFI-së! Një gjë është e qartë: të gjithë po heshtim dhe sikur pokënaqemi tek po e shikojmë se si “reisi” aktual, me paaftësinë e vet si dhe me do përkrahës pa integritet, si i trembur po e vështron tek po fundoset BFI-ja. Ndihmë racionale do të ishte vetëm kontributi në largimin e tij një orë e më parë.

***/Kombetare/24.09.2023/***

## ***Dikush t'i lidhë këlyshët***

***E zbuluan! Ai që paska kritikuar “reisin”, Naser Sahiti, qenka profesor i Universitetit të Tetovës! Sakaq u organizuan dhe nisën me rrebesh sulmesh e shqetësimesh. Ia thyen edhe pass-in dhe iu futën në facebook prej nga ia nisën fotografite e pjesëtarëve të familjes! Me demek, të kapëm, ta dimë adresën, shtrëngohu...***

***Nga Jasir Jashari***

Një mik-vëlla i imi, një mysliman i devotshëm e me taban kombëtar, zotëri Naser Sahiti, kishte publikuar një shkrim që kishte të bëjë me numrin e xhamive të vendit, të cilin kurrë nuk e thanë të saktë. “Reisi” Shaqir Fetai, gjithnjë manipulon me shifrën 700-800 xhami! Ish-reisi i Shaqir Fetait thoshte se janë mbi 1000 xhami. Pra, për 300 xhami nuk ia qëllon Shaqir Fetai, për të cilin artikullshkruesi thotë se një “dorë e zezë” e instaloi në krye të BFI-së. Ky konstatim metaforik e paska prekur fort Shaqir Fetain dhe, sakaq, ia paska lëshuar dofarë Keci e Meci të hamamit, të cilët e kanë shqetësuar deri pas mesnate. Në fakt, është tmerruar nga publikimi i këtij realiteti mbi huqjen galopante të numrit të xhamive. Edhe “reis” edhe mos me e ditë gjënë më elementare? Skandaloze!

I kanë kërkuar mikut dhe vëllait tim të dinë se kush e ka detyruar të shkruaje dhe cila është ajo “dorë e zezë” që e paska instaluar Shaqir Fetain në krye të BFI-së!

Ua tregoj unë, sepse këta farë Keca e Meca, mbase nuk e dinë që Shaqir Fetai ka qenë servili më i gërditshëm i Sulejman Rexhepit. Aq ka qenë servil sa, bashkë me honxhobonxhët e vetë, i kanë kërcyer edhe “belidenc” për ditëlindje dhe në ahengun me rastin e dekorimit nga ana e presidentit shqiptar, Ilir Meta. Madje i kanë kërcyer të eksituar deri në pikën e ekstazës.

Aq servil dhe, sakaq, na u trimërua Shaqir Fetai?! Kurrë në jetë nuk lejoi që t'i bie një pikë pluhuri mbi autoritetin e Sulejman Rexhepit, ndërkaq, brenda natës rebelohet dhe udhëheq puçin kundër



Mulla Sulës! Një dorë e zezë, pa dyshim, ia turbulloi shpirtin dhe mendjen Shaqir Fetait dhe, mos të na bëhet tash francuz por le të na e thotë se cila dorë e përgedheli duke e inkurajuar në këtë aventurë shumë të rrezikshme për Institucionin e BFI-së. Për këtë “dorë të zezë” për islamin dhe për myslimanët e vendit e dinë edhe zogjtë e malit, të gjithë faktorët relevant të vendit, të cilët tash do ta kenë edhe një informacion plus: përveç blerjes së heshejes të mediave të vendit, tash metodë për ta heshtur të vërtetën po e përdorin edhe kërcenimin! Mbrëmë Naserit, ia kanë kërkuar edhe adresën e shtëpise dhe i kanë thënë të shtrëngohet mirë se për dy minuta do i ketë te dyert e oborrit. Le të nisen, po i pres aty, për bujrum! Metodë terroriste serbe, a!

Kecit e Mecit dhe të gjithë këlyshve të Shaqir Fetait i themi që për atë “dorë të zezë” e cila e instaloi Shaqir Fetain në krye të BFI-së, ta pyesin vetë Shaqir Fetain, sepse ai e njih dhe, edhe më tej fërkohet dhe kruhet nga e njëjta “dorë”! Nëse nuk ua thotë ai, le ta pyesin H. Sulejman ef. Rexhepin, sepse ua thotë pa përtesë e pa ngurrim. Shaqir Fetai bën mirë t’i lidhë këlyshët dhe mos t’i ndërsejë se po u del ndonje “sharan” e po t’i kullufitë si llokumat!/*IKlikLarg/25.09.2023/*

## ***I tepërti***

***Janë shumë mexhlise që e kanë një të tepërt,  
një të panevojshëm, një të padurueshëm e të  
pahonepsur! Gjithmonë i tepërti ndjehet si mish i  
egër në trup të shëndetshëm: nuk e ka vendin aty  
por i pëlqen të rrijë aty, gjithnjë i bindur dhe i  
lumtur se avash-avash do të rritet e bëhet kancer!***

***Nga Dr. Zeqie Veseli***

Nuk ka gjë më të keqe se mos t'ia dishë hallin vetëvetit, thotë gjakovari! Për të gjithë ata që u pëlqen vetja para pasqyrës dhe që janë të vetëbindur se janë “vlerë”, gjakovari u percjell selam: “hajt bac t'u rritë mendja”!

### **I.**

Një fondacion turk me renome ndërkombëtare, keto ditë në Gjakovë nxori plotë 17 hafëzlerë të rinj, në mesin e të cilëve 3 të rinjë qenkan nga Maqedonia e Veriut. Për këtë shkak, në këtë ceremoni fetare paska qenë i ftuar, veç Naim Tërnavës, edhe hipokriti Shaqir Fetai i cili si i pamerituar injorohet nga organizatorët dhe të pranishmit! Shaqir Fetai ngarkohet me përshëndetje të ngrohta për H. Sulejman ef. Rexhepin! Në momentin e shprehjes së falënderimeve dhe përshëndetjeve, personat që marrin fjalën, e shikojnë në sy Shaqir Fetain por, e përshëndesin efendi Rexhepin (H. Sulejman ef. Rexhepin)! Nuk kanë faj, atë person e njohin, për atë person kanë mall, akoma janë të bindur se vetëm atij i takon të jetë reisu lulema i BFI-së, apo, përmes këtyre përshëndetjeve ia shprehin hapur përcmimin Shaqir Fetait, këtij farë instalacioni në krye të BFI nga “dora e zezë”!

### **II.**

Kryemyftiu i Kosovës, hala pa përfunduar ceremonia e shpalljes së 17 të rinjëve për hafiza, nënvizoi se i duhet të ikë, meqe duhet

të marrë pjesë në ceremoninë e varrimit të heroit të kombit, oficerit të policisë shqiptare, të vrarë në pritë nga terroristët serbë, Afrim Bunjaku. Kur iku efendi Tërnavë, nuk e mori me vete edhe Shaqir Fetain. Po mirë, po pse ky i mendermethëshëm nuk iu ngjiti Naim Tërnavës? Pse Shaqir Fetai nuk guxoi të shkojë në varrimin e heroit të kombit? Cila ishte ajo frikë që e stepi në atë çast? I çoi selam dikush Naim Tërnavës që mos të vinte me udbashë në varrim të heroit të kombit, apo, vetë Naim Tërnavë u frikësua që të merrte pjesë në atë ceremoni mortore i shoqëruar nga i padëshiruari? Logjika na thotë se, kësaj radhe, Shaqir Fetai u tregua i kujdesshëm: nuk deshti që ta acarojë askend (mbase as oficerët e UDB-së të Serbisë)!

### III.

Këto ditë vdiq edhe një qytetar i Maqedonisë së Veriut, një shqiptar i Shkupit, një prej patriotëve që u rreshtua në krah të UÇK-së që nga krisma e parë e pushkës së lirisë. Visar Reka, është emër i njohur i drejtorisë së UÇK-së, i celulave të para të kësaj Shtylle të Lirisë. Visar Reka ishte alfa dhe omega e kabinetit të Shatrit në qeverinë e parë të Kosovës, ishte krah i djathtë i strukturave të UÇK-së nëpër konferenca ndërkombëtare, ishte ndër miqtë më të besuar të Presidentit Hashim Thaçi! Shkurt, aty ku jehonte krisma e kushtrimit, aty ku zvarritej urtësia kombëtare për ujdi ndërkombëtare, aty ishte Visar Reka.

Dhe, për Visar Rekën, i cili dha kontribut të pamohueshëm edhe për imazhin ndërkombëtar të BFI-së sonë, Shaqir Fetai nuk e shprehu më të voglin ngushëllim?!

Një navigim nëpër statutet e Shaqir Fetait e të paçavurës së tij zyrtare, do të vërehen turlifarë ngushëllimi dhe jo, asnjë fjalë të vetme për Visar Rekën! Visar Reka, pa dyshim, ka gene arkiv më vete, ka pasur miliona dokumente dhe, a mos i ka rrjedhur ndonjë informacion që e ka shqetësuar Shaqir Fetain deri në këtë masë sa ky sot mos ta ketë në konsideratë emrin e të ndjerit?

Diku kishte thënë: nuk guxoj të shpreh ngushëllime sepse Visari na paska gene djali i hallës së Ermira Mehmetit! Si Visari ashtu edhe Ermira kanë aq shumë kontribute kombëtare të pamohueshme sa, po ta ëndërronte vetëm një nga ato kontribute Shaqir Fetai do të ngritej somnabul e do të përfundonte rrugës për në Beograd!

Pas kësaj kritike, Shaqir Fetait nuk i bëhet vonë që familjes së Visarit edhe t'i shpreh ngushëllime por, pa dyshim, ai këtë nuk do ta bënte për njerzillëk por për "lagështi kombëtare"! Është i pacipë, ndaj dhe, gjithkund i tepërt ***Fakte/27.09.2024/***

## **Kushtetuta themel juridik i një subjekti: sa më shumë të shkilet aq më i lehtë rrënimi**

Këshilli për mbrojtjen e kushtetutshmërisë së BFI-së, herë pas here e publikon Kushtetutën e BFI-së, i cili është akti më i lartë juridik i këtij Institucioni. Pse? Sepse, myslimanët e vendit, të gjithë ata që dinë të navigojnë në faqen zyrtare të BFI-së, aty mund të gjejnë lloj-lloj informate të padenjë për t'u publikuar, nërsa nuk mund të gjejnë asnjë rubrikë për të gjitha normat dhe aktet juridike të Institucionit fetar. Nuk gjendet as Kushtetuta, asnjë rregullore, asnjë statut i organeve dhe institucioneve të BFI-së! Natyrisht, mungesa e këtyre akteve juridike krijon mundësinë e veprimit në kundërshtim të plotë me të njëjtat, ndërsa askush “të mos marrë vesh” se çfarë bëhet. Shkeljet e akteve juridike janë të “pahetueshme” meqë askund nuk mund të provohen shkeljet! Kështu mendojnë Shaqir Fetai me myhybët e vet!

Janë një sërë vendimesh të nënshkruara nga Shaqir Fetai e që thirren në nene jo adekuate të Kushtetutës së BFI-së, të asaj Kushtetute e cila gjendet e deponuar në orgnet e drejtësisë të vendit, me ndryshimet e fundit të miratuara në Rijaset që në vitin 2013! Që nga ky vit nuk ka pasur kurrfarë debati për ndryshime kushtetuese, rrjdhimisht, nuk ka pasur kurrfarë debati publik e as në Rijaset për ndryshime eventuale, ndaj dhe, habit fakti se si për sjellje të vendimeve të ndryshme thirren në nene jopërkates! Mbase dikush, ndonjë “administrator” debill edhe i është futur “redaktimit” të Kushtetutës me qëllim që ta amnistojë “reisin” e vet nga përgjegjësia eventuale. Një ndërhyrje e tillë nonshalante natyrisht që është e dënueshme dhe e sanksionueshme kurdoherë!

Veç kësaj, e publikojmë Kushtetutën e BFI-së me qëllim që myslimanët e vendit të kenë mundësinë ku ta gjejnë dhe përmes saj t'i lexojnë të gjitha shkeljet flagrante të Shaqir Fetait dhe të honxhobonxhove të tij që i kryejnë për çdo ditë të lume. Sepse, nuk ka ditë që uzurpuesit e BFI-së që u instaluan në krye të institucionit falë “dorës së zezë” që nuk ka kurrfarë lidhje me islamin, që nuk nisin punën në emër të shkeljeve kushtetutare si dhe të akteve të ndryshme juridike të BFI-së. Në fakt, aktualisht BFI-ja punon nën diktatin e asaj “dore të zezë” dhe jo bazuar në Kushtetutën apo në statutet dhe rregulloret për punë, sepse ato nuk i kanë, sepse as që u duhen t'i kenë! Megjithatë, myslimanët e vendit duhet t'i kenë të qasshme dhe të vërtetohen vetë se si shkatërrohet çdo ditë të Zotit jeta fetare institucionale!

Mbi të gjitha, le ta shohin se si Neni 37 i Kushtetutës së BFI-së (të asaj Kushtetute të deponuar në organet gjegjëse shtetërore më vitin 2013), pika 2 thotë: “Rijaseti i BFI-së mban mbledhje së paku njëherë në muaj”! Ndërsa “Rijaseti” i Shaqir Fetait, i kontestuar edhe ligjërisht, nuk mblidhet më shumë se një apo dy herë në vit, varësisht nga rastet emergjente (djegia e ndonjë autobusi, e ndonjë spitali, ndonjë fatkeqësi natrore etj.) Po ashtu, le të shohin myslimanët e vendit se mbi ç’baza juridike i kryejnë punët e përditshme Myftinitë e vendit! Rreth kësaj, Neni 32, pika 1 thotë: “Myftinia zbaton vendimet e Rijasetit dhe të organeve më të larta të BFI-së”! Pra, nuk zbaton vendimet e reisit, por të Rijasetit, sepse vendimet e “reisit” mund të jenë të nxitura nga “dora e zezë”! Dhe, kur “Rijaseti” aktual solli vendime mbi të cilat do të duhej të punonin Myftinitë e vendit?! Një “veprimtari” totalisht e çakorduar, amatore dhe aspak e bazuar në aktet normative të BFI-së dhe, për rrjedhojë, kemi konstatimin e pamohueshëm: Në BFI natë e ditë punohet për deinstitutionalizimin e jetës fetare si dhe për rrënim sa më të shpejtë të Institucionit fetar islam, BFI-së!

***Këshilli për mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI në RMV/01.10.2023/***

## **Pse u bojkotua sot FSHI?**

Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI, i uron stafit akademik si dhe studentëve të FSHI-së mbarësi në punë dhe suksese përgjatë vitit akademik 2023-24

Sot në Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup u shënuua fillimi i vitit akademik. Dekani i Fakultetit, dr. Shaban Sulejmani, me këtë rast mbajti një fjalim para stafit akademik si dhe studentëve të cilëve u uroi fillim të mbarë e suksese duke e lutur të Madhin Zot që ta kalojnë këtë vit me sa më shumë të arritura shkencore.

Ajo që ra në sy që në fillim ishte mungesa e Shaqir Fetait, kryetarit ilegjitim të BFI-së. Zakonisht, madje edhe me rregullore kërkohet që në mbledhje të stafit akademik apo edhe në rastet studentore të marrë pjesë edhe reisi i BFI, dhe me fjalë rasti t’ju drejtohet të pranishmëve, kësaj radhe nuk ndodhi kështu, pikërisht sepse Shaqir Fetai tash e disa kohë e bojkoton punën e FSHI-së. Në rastet si sot, ka qenë traditë që fillimvitin akademik ta hapë reisi madje

në prezencë të ministrit të arsimit si dhe funksionarë të ndryshëm të pushtetit.

Pse mungoi Shaqir Fetai në këtë event të FSHI-së? Që kur edhe dekani i kësaj vatre arsimore u përfshi në grupin e të pakënaqurve të BFI-së me punën dhe me sjelljen e Shaqir Fetait të cilit i shprehën mosbesim, ky është hidhëruar me gjithë këtë grup, ndaj disave ka marrur masa me largimin e tyre, ndaj disa të tjerëve është në konsultim me avokatë për masa adekuate e disa të tjerë i bojkoton në formën siç e shprehu sot ndaj dekanit të FSHI-së. Pra, bëhet fjalë për punë inati. Shaqir Fetai po dëshmon fuqishëm se, për inatet e veta të sëmura, për hidhërim personal, është i gatshëm të bojkotojë e të shkatërrojë edhe vetë BFI-në! Inatet e tij janë të pakontrolluar dhe me pasoja shumë të rënda! Ai për inat të dekanit, nuk pranon që t’ju drejtohet dhe t’i nderojë studentët, ardhmërinë e islamit në vend. Shaqir Fetai me këtë rast dëshmoi se ai shpreh urrejtje kundër të gjithëve që respektojnë “armikun” e tij, në rastin konkret, kundër studentëve të FSHI-së që janë institucionalisht nën urdhërin e dekanit i cili na qenka “armik” i Shaqir Fetait.

Ja edhe një dëshmi se Shaqir Fetai nuk respekton kurrfarë akti normativ të BFI-së që e obligojnë reisin të marrë pjesë nëpër mbledhje edhe të Fakultetit. Shaqir Fetai nuk respekton organe e institucione të BFI-së që drejtohen nga “armiqtë” e tij. Ndërsa këta “armiqtë” që e rrethojnë Shaqir Fetain janë të shumtë kurse ky farë “reisi” i tyre nuk do të qetësohet përderisa nuk do t’i largojë të gjithë e t’i ndërrojë me “posllushnikë” të vet, vetëm sa ta sigurojë ndihmën dhe përkrahjen e “dorës së zezë”!

Një sugjerim në vend të vërejtjes: evente të këtilla FSHI nuk guxon të mbajë pa prezencën e themeluesit si dhe dekanit të parë të FSHI-së (pse jo, edhe të dekanëve të tjerë) të cilët kanë arritje të larta akademike! Pa Shaqir Fetain mund të rrjedhin organizimet e këtilla, sepse, e arritura më e madhe e tij, në sferën arsimore, ka qenë mësues i rëndomtë në Medrese!

***/LMR në BFI/02.10.2023/***

## ***Demaskimi i hipokritit të mallkuar***

***Shaqir Fetai, i vetëshpalluri “reis” pasi në këtë post u instalua nga “dora e zezë” (“crna ruka”), e bojkotoi ceremoninë e fillimvitit akademik të studentëve të FSHI-së që u mbajt më 2 tetor 2023! Për këtë gjest të ulët ai u kritikua rëndë dhe, anekënd vendit po i bëhet llafi! I lemeritur nga ky gjest Shaqir Fetai u turr që t’u drejtohet studentëve me një “letër” prej filloristi***

***Nga Mahir Rexhepi***

Duhet të jenë jashtëzakonisht të lumtur studentët e sivjemë, sidomos brucoshët e Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, që patën fatin të shijojnë një hapje të orës së studimeve në këtë vit akademik në një ambient tërësisht të dekontaminuar! Natyrisht, kjo atmosferë e dekontaminuar dhe ekologjiksht në nivel, do të kompromitohej me pranimin e Shaqir Fetait në këtë event. Janë fatlumë kjo gjeneratë e cila po starton vitin pa u indroktinuar dhe infektuar me ndonjë nga ato “paraqitjet pompoze” të Shaqir Fetait që u jep sharm sidomos kur gjenë mundësinë e krekosjes si gjeldet.

Të gjithë e morën vesh se ai këtë event e bojkotoi për shkak se nuk qëndron mirë me dekanin, për shkak se nuk ia doli që ta dëbojë dekanin pasi që ky iu bashkua shumicës së anëtarëve të Rijasetit që i shprehën mosbesim Shaqir Fetait e që u dakorduan që ta shkarkojnë këtë farë fatkeqësie të BFI-së! (Kujdes, dinakëria e Shaqir Fetait është e po asaj shkollë vuçeviçiane që e bën zararën dhe që krrokatë sikur kur ta bëjë pula vezën! Shaqir Fetai tashmë paska vendosur që t’i organizojë bashkëvendësit e vet ligjërues e këta të ndikojnë te studentët dhe, sa më parë duhet të organizohet në FSHI një protestë, një revoltë kundër dekanit, dr. Shaban Sulejmanit, dhe, kësisoj, Shaqir Fetai të gjejë pretekstin për ta larguar dekanin nga timoni i kësaj vatre arsimore).

Këtë të vërtetë në ditë me diell, po mundohet që ta kamuflojë

Shaqir Fetai me një letër përmes së cilës ai u drejtohet studentëve për t'i uruar. Letra ishte tejet amatore, me një sintaksë joshqipe, me shumë gabime, e shkruar shkel e shko, dhe që i revoltoi edhe më shumë studentët, ngase ata e morën si ofendim.

Shaqir Fetai u drejtohet studentëve edhe me këtë fjali: “Për të arritur këtë vlerë para jush qëndrojnë mësimdhënësit e juaj të cilët tashmë janë personalitete të larta shkencore.” Këtu bëhet demaskimi i hipokritit të mallkuar!

Nëse i pyet studentët më të vjetër se cili nga profesorët e FSHI-së është më i mirë dhe më i dashur për ju, pa dyshim që, unanimisht do të thonë se ai është profesor Shaban Sulejmani, madje që nga themelimi i këtij Fakulteti edhe një si ky nuk ka pasur! Ndaj dhe, nuk është zgjedhur rastësisht dekan, dhe as nuk është shtyer me bërryla, dhe as nuk e ka sjellë ndonjë “crna ruka” siç e ka sjellë në krye të BFI-së Shaqir Fetain.

Të gjithë këta studentë që e admirojnë profesorin e tyre, Shaqir Fetai i urrenë po aq sa e urrenë edhe profesorin e tyre! Shaqir Fetai sikur të kishte mundësi tani do ta largonte nga ai post, madje do ta largonte fare edhe nga Fakulteti, sepse, ai i largon nga puna të gjithë ata që Shaqir Fetain e shohin si masë tumurale në trungun e BFI-së. Studentët e idealizojnë profesor Shabanin, sepse ai ka një ligjërim të përkryer, ka një afërsi gjaku me studentët, ka një metodologji shpjegimi të paarritshme. Dhe, Shaqir Fetai planifikon që këta studentë t'i privojë nga mundësia për t'u respektur nga profesori i tyre i dashur, dr. Shaban Sulejmanin dhe, në vend të tij, t'ua sjellë, (pse jo!!!) Ali Pajazitin, të cilin, gjithmonë, në kohën e Sulejman Rexhepit, e ka konsideruar si një “therrë në sy”!

Shaqir Fetai, do të mundohet që ta korrigjojë këtë gabim skandaloz të tij, do të mundohet të gjejë një mënyrë se si t'u drejtohet studentëve “në një ambient të ngrohtë” në FSHI, porse, ai duhet ta ketë shumë të qartë se po atë ditë, kur Shaqir Fetai do të futet në FSHI, ai do të bojkotohet nga studentët, nga ardhmëria e islamit në vendin tonë, sepse ata nuk do të mund të durojnë që të detyrohen t'i buzëqeshin hipokritit të mallkuar!

***/1KlikLarg/04.10.2023/***



## **Mesazhet qesharake të një palaçoje**

***Shaqir Fetai, i vetëshpalluri “reis” pasi në këtë post u instalua nga “dora e zezë” (“crna ruka”), e bojkotoi ceremoninë e fillimvitit akademik të studentëve të FSHI-së që u mbajt më 2 tetor 2023! Për këtë gjest të ulët ai u kritikua rëndë dhe, anekënd vendit po i bëhet llafi! I lemeritur nga ky gjest Shaqir Fetai u turr që t’u drejtohet studentëve me një “letër” prej filloristi***

***Nga Mahir Rexhepi***

Duhet të jenë jashtëzakonisht të lumtur studentët e sivjemë, sidomos brucoshët e Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, që patën fatin të shijojnë një hapje të orës së studimeve në këtë vit akademik në një ambient tërësisht të dekontaminuar! Natyrisht, kjo atmosferë e dekontaminuar dhe ekologjiksht në nivel, do të kompromitohej me pranimin e Shaqir Fetait në këtë event. Janë fatlumë kjo gjeneratë e cila po starton vitin pa u indroktinuar dhe infektuar me ndonjë nga ato “paraqitjet pompoze” të Shaqir Fetait që u jep sharm sidomos kur gjenë mundësinë e krekosjes si gjeldet.

Të gjithë e morën vesh se ai këtë event e bojkotoi për shkak se nuk qëndron mirë me dekanin, për shkak se nuk ia doli që ta dëbojë dekanin pasi që ky iu bashkua shumicës së anëtarëve të Rijasetit që i shprehën mosbesim Shaqir Fetait e që u dakorduan që ta shkarkojnë këtë farë fatkeqësie të BFI-së! (Kujdes, dinakëria e Shaqir Fetait është e po asaj shkollë vuçeviçiane që e bën zararën dhe që krrokatë sikur kur ta bëjë pula vezën! Shaqir Fetai tashmë paska vendosur që t’i organizojë bashkëvendasit e vet ligjërues e këta të ndikojnë te studentët dhe, sa më parë duhet të organizohet në FSHI një protestë, një revoltë kundër dekanit, dr. Shaban Sulejmanit, dhe, kësisoj, Shaqir Fetai të gjejë pretekstin për ta larguar dekanin nga timoni i kësaj vatre arsimore).

Këtë të vërtetë në ditë me diell, po mundohet që ta kamuflojë

Shaqir Fetai me një letër përmes së cilës ai u drejtohet studentëve për t'i uruar. Letra ishte tejet amatore, me një sintaksë joshqipe, me shumë gabime, e shkruar shkel e shko, dhe që i revoltoi edhe më shumë studentët, ngase ata e morën si ofendim.

Shaqir Fetai u drejtohet studentëve edhe me këtë fjali: “Për të arritur këtë vlerë para jush qëndrojnë mësimdhënësit e juaj të cilët tashmë janë personalitete të larta shkencore.” Këtu bëhet demaskimi i hipokritit të mallkuar!

Nëse i pyet studentët më të vjetër se cili nga profesorët e FSHI-së është më i mirë dhe më i dashur për ju, pa dyshim që, unanimisht do të thonë se ai është profesor Shaban Sulejmani, madje që nga themelimi i këtij Fakulteti edhe një si ky nuk ka pasur! Ndaj dhe, nuk është zgjedhur rastësisht dekan, dhe as nuk është shtyer me bërryla, dhe as nuk e ka sjellë ndonjë “crna ruka” siç e ka sjellë në krye të BFI-së Shaqir Fetain.

Të gjithë këta studentë që e admirojnë profesorin e tyre, Shaqir Fetai i urrenë po aq sa e urrenë edhe profesorin e tyre! Shaqir Fetai sikur të kishte mundësi tani do ta largonte nga ai post, madje do ta largonte fare edhe nga Fakulteti, sepse, ai i largon nga puna të gjithë ata që Shaqir Fetain e shohin si masë tumurale në trungun e BFI-së. Studentët e idealizojnë profesor Shabanin, sepse ai ka një ligjërim të përkryer, ka një afërsi gjaku me studentët, ka një metodologji shpjegimi të paarritshme. Dhe, Shaqir Fetai planifikon që këta studentë t'i privojë nga mundësia për t'u respektur nga profesori i tyre i dashur, dr. Shaban Sulejmanin dhe, në vend të tij, t'ua sjellë, (pse jo!!!) Ali Pajazitin, të cilin, gjithmonë, në kohën e Sulejman Rexhepit, e ka konsideruar si një “therrë në sy”!

Shaqir Fetai, do të mundohet që ta korrigojë këtë gabim skandaloz të tij, do të mundohet të gjejë një mënyrë se si t'u drejtohet studentëve “në një ambient të ngrohtë” në FSHI, porse, ai duhet ta ketë shumë të qartë se po atë ditë, kur Shaqir Fetai do të futet në FSHI, ai do të bojkotohet nga studentët, nga ardhmëria e islamit në vendin tonë, sepse ata nuk do të mund të durojnë që të detyrohen t'i buzëqeshin hipokritit të mallkuar!

***/Top24/07.10.2023/***

## **Shaqir Fetai “bën” politikë**

*Bota është në zgripç të një kataklizme të paimagjinueshme. Botën po e nxisin drejt polarizimit më të rrezikshëm që kur ekziston si planet dhe, ky polarizim natyrisht që bëhet për ta reduktuar deri në maksimum numrin e myslimanëve si praktikues të fesë islame! Natyrisht, myslimanët nuk do ta hanë këtë karrem! Zoti e di më së miri*

*Nga Dr. Zeqie Veseli*

Është një botë e tërë myslimanësh që solidarizohen me popullin palestinez për ta rikthyer territorin shtetëror ku ka qenë deri para luftërave botërore. Për ta arritur këtë, duhet që të tkurret territori i shtetit izraelit! Bota nuk pajtohet as për shtrirjen e as për tkurrjen e këtyre territoreve. Bota është për status quo-në që ishte deri para luftës së tmerrshme që po zhvillohet në të dyja territoret, nga të dy popujt! Të tjerët po bëjnë “sehir” e po apelojnë në përmbatje dhe në ndëshkim të atyreve që të parët bënë “bum”!

Përkrahësit luftarakë të palestinezëve me mburrje e deklarojnë ngadhnjimin e tyre që u demonstrua me hedhjen e rreth 10 mij raketave në tokën izaelite, ndersa ushtria izraelite thotë se deri më sot ia doli që mbi Gaza të hedhë rreth 10 ton bomba e predha artilerike! Si raketat e Hamasit ashtu edhe predhat dhe bombat izraelite nuk janë patate por, mjete vrastare që po marrin mijëra jetë të pafajshme! Marrja e jetëve të njerëzve të pafajshëm me gjasë do të vazhdojë edhe më tej. Të dy palët në këtë luftë janë të ndërgjegjshëm se kthim prapa nuk ka: pala palestineze është e bindur se, nëse zbrapsen, kurrë më nuk do ta kenë këtë shansë, ndërsa pala izraelite mendon se, nëse zbrapsen, kurrë më nuk do të mund ta çrënjosin Hamasin dhe, së fundmi, edhe Hezbullahun në tokat palestineze!

Shtete e popuj, gjithandej botës, po apelojnë që të ndalen, sepse veç sa nuk ka shpërthyer kriza humanitare, të ndalen se po vdesin shumë të pafajshëm, shumë fëmijë, gra, pleq e të ngratë!

Shpirti human do të reagonte publikisht, nuk do ta zinte gjumi i natës, asnjë sekond nuk do të ishte i qetë duke u lutur me përlulësi që të ndalohet kjo çmenduri, sepse po vdesin njerëz! Vetëm Shaqir Fetai hala nuk ka reagu! Po vdesin myslimanë, po vdesin dhe hebrenj dhe të krishterë. Mbi të gjitha, po vdesin njerëz të pafajshëm!

Shaqir Fetai deri më tani është dashur të jetë në krah të atyreve që po apelojnë e po luten që të ndërpriten kjo luftë! Shaqir Fetai, nëse është mysliman duhet të reagojë, jo duke u pozicionuar por, të paktën duke e përkujtuar ajetin kuranor që thotë: “e kush vret ndokënd, që s’ka vlarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vlarë të gjithë njerëzit” (El Maide, 32) Ky është urdhëri kuranor që nxit për apel dhe për lutje të përsëritshme që të ndalen luftimet se po vriten njerëz të pafajshëm, po vriten fëmijë.

Më herët ka qenë traditë e BFI-së që të reagojë menjëherë kundër çfarëdo lufte dhe vrasje të njerëzve për interesa politike! Tani, Shaqir Fetai “bën” politikë! Paska thënë që nuk guxon të reagojë meqë hala nuk kanë dalur me kurrfarë reagimi BDI-ja dhe as Ali Ahmeti! Do me thënë, Shaqir Fetai ngjashëm si Ali Ahmeti, “janë shumë të afërt” në logjikë e botëkuptime!

Shaqir Fetai nuk e ndjenë, nuk e ka brenda shpirtit, nuk e ka bindje dhe as fe, porosinë e shenjtë kuranore të cituar më sipër! Ali Ahmeti për hirë të njerzillëkut edhe mund të reagojë, por ama, Shaqir Fetai e ka obligim fetar (nëse e llogarit veten pjesëtar i fesë islame) që të reagojë në emër të atyreve që i përfaqëson dhe çfarë përfaqëson! Shaqir Fetai duhet të thërrasë në lutje gjithëpopullore e gjithëmyslimane që të ndërpriten luftimet që po hanë ditë e më shumë koka njerëzish të pafajshëm, mbase edhe besimtarë të devotshëm, në të dy taborret! Por, Shaqir Fetai nuk ka kohë të lutet e të apelojë, sepse, Shaqir Fetai po “bën” politikë! Kurse “politika” e Shaqir Fetait është si gjella e kavërditur me helëm biologjik!

***/IKlikLarg/13.10.2023/***

## Shaqir Fetai si e Përhitura

E gjithë bota, tërë sy e zemër janë drejtuar kah Rripi i Gazës ku situata luftarake po degjeneron në varr kolektiv për dy milion palestinezë! Bota po lutet përshpirtshëm që të ulen armët e të mbisundojë paqë e perjetshme në atë Tokë të Shenjtë ku u lind Hazreti Isai, nga ku Pejgamberi ynë, Muhamedi a.s., bëri mitaxhin ku udhëhoqi në falje të namazit të gjithë pejgamberët e njerëzimit.

Sot, shqiptarët e besimit katolik i bashkangjiten lutjeve të mbarë botës që ia dedikojnë paqes në Rripin e Gazës.

Shaqir Fetai është përhumbur fare, po gjason në të Përhiturën e përrallave. Ka ngelur pa personalitet, pa asnjë gram autoriteti dhe pa asnjë pikë force për të drejtuar qoftë edhe një lutje për paqë! Shaqir Fetai nuk mundet të veprojë asgjë pa leje dhe pa urdhër të atyreve që e kontrollojnë. Është i shitur kokë e këmbë.

Shaqir Fetai nesër do të shkojë në Egjipt, në një Kongres, i cili, sipas Shaqir Fetait, paska për të debatuar mbi sfidat e islamit dhe mbi zhvillimin e tij në rrjedhat e kohës. SHAQIR FETAI PO RRENË! Sepse, sot, ne mbarë botë myslimane kërkohet një qëndrim i përbashkët mbi luftën izraelito palestineze në Rripin e Gazës! Nesër në Kajro do të shpalosen qëndrimet e botës muslimane mbi këtë luftë të pakuptimtë. Nesër do të shpalosen të gjitha veprimet e ndërmarra nga secili komunitet e shtet i myslimanëve për paqë, për rindërtim dhe për ndihmë të popullit palestines në situatën postkonfliktuoze.

Dhe, çka do të thotë Shaqir Fetai se ka ndërmarrë në vendin e vet? Mos organizoi ndonje lutje të përbashkët në ndonjë prej namazeve! A mos iu drejtua xhemateve të vendit me një lutje drejtuar Zotit të Gjithëfuqishëm për të vendosur paqen në Rripin e Gazës dhe për të shpëtuar miliona njerëz të pafajshëm! A mos ia kërkoi hafëzlerëve të vendit grumbullimin në një xhami për të kenduar hatme dedikuar atyre fëmijëve, nënave, motrave, pleqve të pafajshëm të rënë në pragun e shtëpive të veta? A mos inicoi ndonjë aktivitet humanitar për grumbullimin e ndihmave humanitare që do të depërtonin në destinacion sapo të hapej ndonjë korridor humanitar? Jo! Sepse Shaqir Fetai nuk ka guxim të organizojë aktivitet kolektiv, sepse, do të qortohet nga instaluesit e vet dhe do të bojkotohet masovikisht nga xhemati i vendit. Shaqir Fetai në Kajro do të rrejë: po, edhe ne i kemi dënuar sulmet izraelite mbi Rripin e Gazës! Shaqir Fetai nuk e ka për dert edhe këtë rrenë si një mori rrenash të tjera që i ka shprehur me cinizëm dhe me nonshalancë prej katili.

***/Kombetare/17.10.2024/***

# ***Shaqir Fetai më mirë të mos ndjehej i gjallë***

***Reagim mbi një “reagim” personal të Shaqir Fetait që mundohet t’ia shesë opinionit si “reagim institucional” të BFI-së***

***Nga Mahir Rexhepi***

Pas një mori reagimesh kundër heshtjes mospërfillëse të BFI-së së Shaqir Fetait në raport me luftën izraelito-palestineze, më në fund ky Institucion i uzurpuar mu si tokat palestineze nga kolonët hebrej, doli në opinion me një “reagim” as mish e as peshk, me një “reagim” i cili më tepër ishte “këshillë” palestinezëve që mos të zihen me hebrejntë se sa që ishte protestë kundër planeve hebraike për t’i bërë pluhur dy milionë myslimanët e Rripit të Gazës!

Po pse “reagim” dhe jo komunikatë për opinion? Kundër kujt reagon BFI e Shaqir Fetait? Kundër kritikuesve? Kundër myslimanëve të vendit që nuk lanë gjë pa thënë e hedhur mallkime kundër Shaqir Fetait dhe mahlukëve të tij që po heshtin kundër planeve dhe krizave antinjerëzore që po hartohen dhe shkaktohen kundër myslimanëve të Gazës!

Mbrëmë u rrafshua një spital dhe u mbytën 500 pacientë palestinezë të sëmure e të plagosur. Kjo ngjarje tronditi tërë botën, madje reagan edhe vetë hebrejntë e njerëzishëm. Vetëm Shaqir Fetai hala po hesht! Nuk e shprehu të paktën një dhembje subjektive në ato paçavurat e veta që i shkruan në seri!

Kujt i shpreh reagim Shaqir Fetait? I reagon Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI që e ftoi të reagojë duke ia ofruar edhe disa opzione të njerëzishme se si të reagohet, apo me reagimin e vet të kotë tenton të radhitet në krah të atyre që e dënojnë tërë atë masakër që po ndodhë në Rripin e Gazës!

BFI e Shaqir Fetait reagoi mbrëmë dikur rreth orës 23! Ky “reagim” nuk ishte produkt i ndonjë debati apo propozimeve të dalura nga mbledhja e Rijasetit, e cila nuk mund të mbahet në mesnatë, e cila madje as që është thirrur, por, ishte produkt i revoltës së Shaqir Fetait

kundër mijëra myslimanëve të vendit që mbi të po hidhnin breshëri sharjesh dhe mallkimesh. Honxho-bonxhove të vet u kishte dhënë urdhër që të jenë vigjilent dhe të fshijnë mbrëmë tërë natën dhe sot tërë ditën reagimet e myslimanëve të vendit nëpër rrjetet sociale mbi “reagimin” as mish e as peshk të Shaqir Fetait!

Ja si e fillon “reagimin” BFI-ja e Shaqir Fetait: “Ajo që kemi parë deri më tani, përshkallzimi i situatës së sigurisë në një konflikt të rëndë ka marrë shumë jetra njerëzore në të dyja palët.” Çfarë konstatimi “brilant” e fare i pandjeshëm i Shaqir Fetait! Turp!

Për të qenë turpi edhe më i madh, turpi që sot e ka irituar dhe pezmatuar aq shume myslimanin e këtij nënqielli, Shaqir Fetai, duke u maskuar si skuth prapa Institucionit të degraduar deri në pakuptimësi, BFI-së, vazhdon tutje: “BFI është e përcaktuar të zbatoj normat fetare islame, norma të cilat ka përqafuar e gjithë bota muslimane, këta norma kuranore kanë përcaktuar paqën, tolerancën dhe mirkuptimin si vlera sublimë të popujve musliman.” Po ndëshkimi i agresorit, po ndëshkimi i kriminelëve, po luftimi i përfituesve të luftës, po liria, po të drejtat njerëzore dhe kolektive, po e drejta për përcaktim etnik, po e drejta për ta ruajtur dhe për të pasur xhami për lutje drejtuar Allahut xh.sh., a nuk janë këto norma islame? Krejt bota islame janë ngritur për ta stopuar planin gjenocidal dhe shfarosës që do të zhvillohet në Gaza, veç Shaqir Fetai qenka i përcaktuar për paqen dhe bashkëjetesën si normë islame! Po kur të vritet kjo paqe dhe kjo bashkëjetesë, ç’ka duhet bërë sipas Shaqir Fetait?

Dhe, Shaqir Fetai, ky farë hipokriti që mendon se duhet ta gëzojë epitetin “diplomat” pasi ka vizituar shumë ambasada maqedonase nëpër botë, na flet me “diplomacinë” prej avdalli kur thotë: “Ne si BFI jemi të bindur se bisedimet dhe dialogu janë e vetmja zgjidhje, madje ne besojmë fort se nga dialogu konstruktiv do të arrihet edhe zgjidhje e drejtë.”

Shaqir Fetai sikur flet jerëm, sikur të mos jetë në këtë dynja, flet sikur të jetë i kapur peng, apo sikur të jetë ithtar i më të fortit në konflikt! Shaqir Fetai si duket nuk ka dëgjuar dhe nuk ka parë se çfarë po ndodhë në Gaza; sikur nuk e di se aty nisi spastrimi etnik, nisi gjenocidi me spitalin palestinez për ta përcjellë mesazhin hebre se “as të gjallë e as të sëmurë nuk do t’ju lëmë në tokë të Gazës”! Deri te dialogu që e parapëlqen Shaqir Fetai dikush duhet të japë llogari për këto projekte shfarosëse, dikush duhet të ngelet gjallë për dialog e marrëveshje politike! A bën të lutemi që Zoti ta hedhë mllefën e Vet mbi të gjithë ata që planifikojnë realizimin e “tokës së djegur” duke e “çliruar” Gazën nga palestinezët? Pasi të pastrohet Rripi i

Gazës nga dy milionë myslimanë palestinezë, të instalojmë paqen dhe mirëqenien, thotë Shaqir Fetai! Mjerim!  
*/Fakte/18.10.2023/*

## **I ligu për mend e për famë**

Shaqir Fetai ndodhet në Kajro, në një konferencë ndërkombëtare ku është thirrur për ta përfaqësuar BFI-në si Institucion që dikur, nëpër konferenca të tilla, ishte ndër Institucionet më të rëndësishëm dhe më me peshë. Sot, as për së afërmi nuk e ka atë peshë institucionale. Kjo dëshmohet edhe nga protokollit i Konferencës, i cili, përfaqësuesit më pak të rëndësishëm i ulë në rreshtin e dytë, të tretë, të katërt... Shaqir Fetain e kishin ulur mbrapa reisit të Bosnjës.

Por, organizatori ka vërejtur një dukuri shumë të shëmtuar lidhur me Shaqir Fetain, i cili është bërë lëndë shakaje për të gjithë të ftuarit e Konferencës ku gjuha zyrtare është gjuha arabe. Ata që nuk dinë, nuk e kuptojnë dhe nuk mundën të kontribuojnë në këtë gjuhë ulen sa më mbrapa!

Ka shpërthyer tallja dhe e qeshura e madhe sapo e kane parë tek pozon Shaqir Fetai gjatë pauzave në Konferencë! Qejfi i tij i madh që të fotografohet ulur në rreshtin e parë, duke shitur poza se po dëgjon moderatorin apo ligjëruesin ndërkohë që është kafe-pauza.

Dhe, pastaj, Shaqir Fetai i boton ato fotografi për të treguar se sa “i madh” që është kur del jasht vendit. Harron i gjori se organizatorët i publikojnë dhe i arkivojnë ato fotografi që shënojnë hapjen e Konferencës dhe që e tregojnë Shaqir Fetain të zhytur në kolltukun e rreshtit të dytë, apo fotografi gjatë paneleve duke zhvilluar të pranishmit diskutime e debate dhe jo duke pozuar si i ligu për mend e për famë!

Shaqir Fetai edhe një herë i turpëroi myslimanët e Maqedonisë së Veriut, ndërsa, përkundur Protokollit të Konferencës që nuk e njeh për ndonjë personalitet të rëndësishëm, do të përpiqet ta rrisë veten me vizitën që do t’ia bëjë si zakonisht ambasadorit maqedonas në Kajro. Shaqir Fetai di shumë mirë që ta shtyj turpin me bukë. Prandaj na është bërë nga harami si “doktor rrumbullaki”!  
*/Lajme/19.10.2023/*



## ***Manipulatori i deshifruar***

***Nnga Kajro e Egjiptit Shaqir Fetai na lajmëron për “reisin” i cili na paska konstatuar se Konferenca ndërkombëtare e Kajros paska përfunduar me sukses dhe, kjo i paska dhënë shtytje që të takohet me studentët shqiptarë nga Maqedonia e Veriut që studiojnë në Kajro***

***Nga Mahir Rexhepi***

Manipulatorët janë persona që ia dalin të mashtrojnë në situata të caktuara, që ta mashtrojnë opinionin dhe, të mos hetohen për asnjë moment se janë duke manipuluar. Pra, janë persona me “aftësi të mbinatyrshme” për të krijuar situata iluzioniste dhe, sapunin ta shesin për djathë! Por, ja që ka nga ata “trukaxhinjë” që, sapo ta hapin gojën zbulohen se po gënjejnë, apo, zbulohen se po bëjnë përpjekje për manipulim. Menjëherë goditen me purtekë veshëve dhe heshtin si qeni zgjebarak!

Një manipulator përherë i deshifruar është dhe mbetet Shaqir Fetai! Që kur ka shprehur dëshirë që të bëjë karrierë, këtu e 20-30 vite më parë, ai çdo lëvizje milimetrike që e ka bërë e ka manipulim! Ai frymon mbi manipulimin, ai është ngritur i ndërkryer me manipulim, ai jeton për manipulim, sepse e di që ndryshe vetëmsa do të vendumrojë! Ai është i bindur naivisht se kurrë nuk do të përfundojë i katandisur në theqafje!

Shaqir Fetai ka marrur pjesë në një Konferencë ndërkombëtare në Kajro dhe, me të mbaruar kjo Konferencë ai vetë konstaton se Konferenca paska përfunduar me shumë sukses, ndërkohë që nuk e njih as gjuhën arabe, as gjuhën angleze, as gjuhën turke dhe, rrjedhimisht, as që ka kuptuar se çfarë është folur e diskutuar në Konferencë për të ardhur deri te konstatimi “i suksesshëm”! Ky ishte manipulimi i parë, i cili, përmes fjalës “i suksesshëm” mëton t’ia atribuojë të gjitha të arriturat e Konferencës pjesëmarrjes së Shaqir Fetait! Meqë na mori pjesë ky lanet, ja që vetëvetiu Konferenca na ka dalur “e suksesshme”!

Manipulimi i dytë është darka e tij me studentët shqiptarë nga vendi të cilët studiojnë në Kajro!

Kjo darkë hap dy çështje: Pse mori pjesë Shaqir Fetai në Kajro, kush e delegoi atë, kush ia dha vizën për të marrë pjesë në Konferencë dhe, meqë ka marrur pjesë, çka ka ndryshuar diç në të mirë të myslimanëve të vendit; çka kanë përfituar myslimanët e vendit nga kjo shëtitje ekskursioniste e Shaqir Fetait dhe tajfës së tij me paratë e myslimanëve të vendit! Reisi nuk e hedh as hapin më të vogël pa lejen dhe miratimin e Rijasetit! Rijaseti mblidhet, informohet se ka një ftesë ndërkombëtare, jepen propozimet se kush ta shoqërojë atë (e jo turlifarë spiuni i trefishtë!) dhe, caktohet se nga cili zë i buxhetit të mbulohet ai udhëtim, gjithnjë pasi të konstatohet se ia vlenë apo jo të përfaqësohet BFI-ja nëpër takime të tilla!

Natyrisht, çështja e dytë është fakti që, nëpër mbledhje të Rijasetit, në të tilla raste, merret autorizimi për t'i takuar studentët e vendit që studiojnë në atë vend ku do të prezantojë përfaqësuesi i myslimanëve të vendit. Ky autorizim merret sepse, në mbledhje sillet edhe vendimi që, studentët të shpërblehen me ndonjë ndihmë simbolike në para, të cilat aq shumë janë të rëndësishme për studentët! Kështu ka qenë më përpara, reisi i ka takuar studentët, tek të cilët ka kryer porosinë e Rijasetit që ata të daroviten me ndonjë para nga arka e BFI-së!

Shaqir Fetai i tubon studentët dhe para tyre del me duar në xhepa, duke i fërkuar...! Studentët kanë nevojë për ndonjë metalik dhe jo për kopalla kundërmuese të Shaqir Fetait! Ata kanë nevojë për ndonjë lek e jo për darkën e Shaqir Fetait, e cila, vetëm e tij nuk mund të jetë, sepse ai kurrë nuk pranon të qarosë me paratë e veta, porse, atë fakturë të darkës e dorëzon në arkën e BFI-së.

Natyrisht, kështu do të duhej të vepronte Shaqir Fetai nëse do ta kishte Rijasetin pas vete! Ai nuk e tubon, nuk merr leje dhe nuk sjell vendime në Rijaset, nuk raporton në Rijaset mbi efektet nga pjesëmarrja nëpër Konferenca, sepse ai nuk ka Rijaset, sepse ai nuk është i sigurtë se çka mund të pjellë tash e tutje nëpër mbledhjet e Rijasetit, prandaj ai nuk e mbledh këtë Organ më të lartë kolektiv të BFI-së! Së këndejmi, a nuk është ilegjitim Shaqir Fetai qoftë kjo edhe si pjesëmarrës në një kuvend ku ai në mënyrë manipulative mundohet të shitet për përfaqësues (të kujt?)? Shaqir Fetai, përderisa nuk autorizohet nga Rijaseti, përderisa nuk vepron sipas vendimeve të Rijasetit të miratuara nëpër mbledhje të këtij organi i cili duhet të mblidhet të paktën një herë në muaj, përderisa nuk ka leje të veprojë dhe të prezantojë myslimanët e vendit – pra, përderisa nuk e ka izën e

Rijasetit, ai është ilegjitim, ai është joinstitucional, thjesht, ai është një manipulator porse shumë i lexueshëm, i deshifruar dhe hajgarexhi i shpifur, për ç'gjë ai gjithësesi që një ditë do të japë llogari, një për një!  
***/Opinione/20.10.2023/***

## **Vizë kombëtare për udbashët**

*Në paçavurën e vet të radhës, instalacioni nga “dora e zezë” në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, nis “filozofemat” e veta me lajmin e stërpërsëritur se paska marrur pjesë në përrurimin e një xhamie në Grac të Austrisë, për të vazhduar pastaj mu si udbashët e vjetër, ata të periudhës së Rankoviqit, me disa “konstatime” që i qëndis si “plaf” për ta hedhur sipër kornizës ku shtrihet “çertifikata” e tij prej bashkëpunëtori të UDB-së nën pseudonimin ORAO*

*Nga Mahir Rexhepi*

Sërisht Shaqir Fetai do të na dalë me një shkrim që nuk e kalon nivelin e hartimeve shkollore të filloristëve, të atyreve të cilët përtej entuziazmit fëmijëror nuk dinë të shprehin asgjë më shumë.

Me vendimet e kujt, të cilit organ, Shaqir Fetai u nis me hajnat e tij për në Austri? Kush ia dha lejen! Sa ishte e nevojshme të shkojë Shaqir Fetai në Austri! Sa harxhoi nga arka e BFI-së për këtë ekskurzion privat? Ai më shumë del nëpër dynjallëk se sa që, bie fjala, ka vizituar Myftininë e Kumanovës, apo të Tetovës, apo të Strugës, të Dibrës etj! Nëpër këto myftini po ndërtohen shumë xhami, cilat i vizitoi deri më sot për të parë se si po vejnë punët! Nëpër këto Myftini po hapen xhami, ndërsa Shaqir Fetai brend nëpër qytete të huaja, e fundit herë që ka marur pjesë në inagurim të një xhamie në vend ka qenë 13 shkurt 2023 kur u hodh gurthemeli i Xhamisë së re në fshatin Banjicë të Komunës së Çashkës! Shaqir Fetai nuk shkon nëpër qytet e myftinive tona, sepse xhemati i këtushëm e njohin, ia dinë kapacitetet prej spiuni, nuk e bëjnë hesap të mendermethënsmin, nuk i shtrajnë drekë e darkë të pasur dhe, fare në fund, nuk ka mëditje sa kur të dalë nëpër shtete perëndimore! Pse merr pjesë? Për ta kompensuar refuzimin absolut të xhematit vendor? Për të shitur kopallat të cilat nuk ia del t’i sheshë në terrenin e vet! Dhe, meqë nuk ia del t’i sheshë këtu, para xhematit të cilët kan filluar ashiqare të pëshpërisin “ja, na

erdhi ORAO ud bashi”, Shaqir Fetai nis e të njëjtëve u drejtohet me hartime shkollore. Kësaj radhe na drejtohet si i dehur nën ndikimin e marijuhanës së atyreve që e sollën në “pushtet”! Vetëm një i përhumur si Shaqir Fetai, vetëm një qenie me frena kali në sy, mund të flasë përhanë e të thothë:

“Thellë e ndienin se kjo xhami është qëndra e tyre dhe e vetmja shpresë për të mbrojtur qenien e tyre.”

Një konstatim i tillë mund të shpërthejë vetëm atëherë kur autori është në mesin e të dëshpëruarve, në mesin e të pashpresëve, në mesin e të humburve, të dështuarve në jetë, në mesin e pesimistëve dhe atyreve që tashmë kanë ngelur pa asnjë mjet për mbrojtjen e qenies së tyre. Shaqir Fetai konstaton se, këta të humbur e të dalur jashtë rrugës, paskan ndjerë se kjo xhami na qenka e vetmja shpresë për mbrojtjen e qenies së tyre. Sepse këta paskan ngelur pa familje, pa shkolla, pa fakultete, pa aftësi akademike, pa plan për jetën, pa vizion, pa ideal dhe, ja tani, e “vetmja shpresë për të mbrojtur qenien e tyre”! Po deri në çastin që nuk e patën këtë qendër, po ata shqiptarë që nuk kanë qendra të tilla – ata janë tërësisht në dalalet, “pa shpresë për ta mbrojtur qenien e tyre”!

Shaqir Fetai nuk flet budallallëqe, por, tash e sa herë është konstatuar se ai në gjak e ka cinizmin, e ka ofendimin, e ka përçmimin, e ka talljen me tërë qenien kombëtare, sepse, ai është i krijuar, i gatuar dhe i ndërtuar nëpër guzhina ku përgatiten lloj-lloj reçetash devalvuese për qenien tonë!

“Këtu do tubohemi”, thotë Shaqir Fetai, “për të qenë sa më unik, të edukohemi dhe të mësojmë gjuhën e kombit tonë, të forcojmë lidhjet me trojet tona, të forcojmë bazat e moralit të pastër...”

Shaqir Fetai me këto “perla” prej të sëmuri për mend, na dëfton se tashmë e ka “krijuar” një qendër ku do të mblidhet për ta dëshmuar “unitetin e vet”, sepse vend tjetër nuk i ka ngelur, nuk ka lënë vend pa e bërë turli-kompot! Në atë qendër Shaqir Fetai na thotë se do të mësohet gjuha e kombit tonë! Ajo qendër ishte kopsh-çerdhe apo xhami!

Shaqir Fetai e paska gjetur një vend ku do të forcohen “lidhjet me trojet tona”! Sintagma “trojet tona” e dalur nga një gojë ud bashi, mund të aludojë edhe për trojet serbe, prandaj, ai që është shqiptar nuk lë vend për hutesa por, i bie shkurt e shqip “trojet tona shqiptare”! Shaqir Fetai mendon se akoma jemi në periudhën e analfabetizmit total, në kohën kur shqiptari perceptohej si “qenie me bisht”; Shaqir Fetai akoma mendon se vlejné konstatimet rankoviçiane se shqiptarët nuk dinë asgjë për trojet e veta dhe, shyqyr që u hap një xhami në Grac dhe kanë ku të shkojnë e t’i mësojnë dhe forcojnë “lidhjet me trojet tona”!

Shaqir Fetai thotë se tani më kemi një qendër ku do t'i mësojmë “bazat e një morali të pastër”, sepse, shqiptarët e Austrisë (sipas këtij konstatimi të avdallit) deri më sot, në familjet e veta, në shkolla, në punë, në shoqëri, gjithkund ku gjenden, mësojnë vetëm “bazat e moralit të papastër” dhe, falë kësaj xhamie, tash e tutje do të jetë më ndryshe për ta. A ka ofendim më të madh se kjo?

A ka tallje e përçmim me një urrejtje e cinizëm të skasjshëm më shumë se ky “zbulim epokal” i Shaqir Fetait? Këtij avdalli duhet t'i bëhet rreptësisht e ndaluar prezenca nëpër shqiptarët e Perëndimit, sepse ky nëse tashmë nuk e ka atë rol të spiunit, tashmë e ka rolin e përçmuesit dhe të ofenduesit të ndyrë.

“Ata xhaminë e kuptonin si një qendër e zhvillimit dhe ngritjes së tyre në të gjitha sferat, në ate shkencor, fetar, moral, profesional, ekonomik dhe njerëzor”, konstaton Shaqir Fetai në paçavurën e vet numër 32! Ja se në çfarë niveli i sheh shqiptarët në Perëndim Shaqir Fetai! Ja se me çfarë mentaliteti dhe me çfarë logjike i portretizon shqiptarët e mirë! Ata paskan qenë të përhumbar fare, paskan qenë pa pusullë jetësore, pa orientim e pa kahe, pa shpresë e pa synime. Në këtë xhami tash e tutje ata do të ngriten në të gjitha sferat, tash e tutje shqiptarët e Austrisë në këtë xhami do të ngriten shkencërisht, moralisht, profesionalisht, ekonomikisht... Po, Shaqir Fetai mendon se shqiptarët jetojnë në periudhën e paraqitjes së islamit, atëherë kur xhamia detyrimisht e luante edhe rolin e universitetit, të institucioneve shkencore, morale, politike, shoqërore etj. Sot, shqiptarët nëpër xhami shkojnë si doktor shkence, si deputetë, si mjekë, si shkrimtarë, si liderë politik, biznesmenë e inovatorë, si sportistë e profile të ndryshme profesionale! Aq shumë janë të përgatitur edhe moralisht sa, xhamitë i vizitojnë vetëm si vende ku dëshirojnë me shpirt t'i luten dhe t'i falënderohen Krijuesit të tyre për të gjitha këto të mira që ua ka dhuruar dhe të dëshmojnë me vetëdije të plotë se janë shumë të lumtur që i takojnë fesë islame si dhe të luten që gjithnjë të jenë të mbrojtur nga planet dhe intrigat e njerëzve si puna e Shaqir Fetait, që janë në anën e “ushtrisë së djallit”!

Dhe, Shaqir Fetai gjithnjë këto paçavura i “parfumosë” me nga një “perlë” që ta shëmton ditën dhe momentin, sepse këtë synim jetësor ka avdalli! Shaqir Fetai konstaton se ky popull shqiptar i Austrisë paska dëshmuar se është në ngritje e sipër për vetë faktin që paska ditur ta organizojë një pritje të nivelit të lartë për Shaqir Fetain! Avdalli përfundon: “Organizimi i nivelit të lartë vërtetoi se ata janë në ngritje e sipër, sepse një popull vlenë aq sa dinë të organizohet.” Pra, në këtë rast ka dëshmuar se vlenë, sepse ia ka dalur që të organizojë një pritje të nivelit të lartë! Në fakt, të gjithë ata që janë

munduar ta presin dhe ta nderojnë Shaqir Fetain, janë ose udbashë ose të manipuluar nga UDB-a me të vetmin qëllim që të njolloset kombëtaria e tyre! Shaqir Fetai duhet të na tregojë se si na do Zoti: si udbashë apo si kombëtarë! Nëse na do si kombëtarë atëherë në mesin e kombëtarëve duhet të ketë sa më pak udbashë, të atillë që janë bashkëpunëtorë në listën e ORAO-s!

***/Kombetare/24.10.2023/***

## ***Veza apo pula***

***Shtatë vjet më parë, Bashkësia Fetare Islame organizoi tribunë shkencore “80 vjet kushtetutshmëri të BFI-së”! Asnjë institucion shtetëror nuk shprehu as interesim dhe as urime për tetë dekadat e funksionimit të Bashkësisë Fetare Islame bazuar në Kushtetutën e vet! Tani vjen dilema: në fillim ishte veza apo pula***

***Nga Mr. Eset Shaqiri***

Këto ditë, Komisioni për marrëdhënie me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze na paska organizuar një akademi solemne “80 vjet nga themelimi i Komisionit Fetar në Shtabin e Ushtrisë Çlirimtare Popullore dhe Detashmenteve Partizane të Maqedonisë. (1943-2023)”. Në këtë event ku ishin të ftuar dhjetra priftërinj e funksionarë të Kishës ortodokse maqedonase dhe të kishave të tjera, prezantoi edhe Shaqir Fetai! Në faqen zyrtare të “bashkësisë” së tij, shërbimet e tij skajshmërisht amatore për informim, publikojnë lajmin që thotë, “reisi mori pjesë në shënimin e jubileut të 80 vjeçarit të formimit të kryesisë fetare në Maqedoninë e Veriut.”! Ky lajm, kjo fjalë si e tillë, e dalur nga gazetarë, lektorë, redaktorë, drejtorë sektoresh inegzisten, jokushtetuese, jo që të shkulë së qeshuri, porse krijon përshtypjen se Shaqir Fetai as që e ka ditur se për ku është i ftuar! I përgjigjet një institucioni i cili para shtatë viteve as që e ka uruar BFI-në për 80 vjetorin e funksionimit të saj si kategori kushtetutare – Institucion! Me gjasë, pasi kthehet në zyrën e vet Shqair Fetai, tek atëherë ndërgjegjësohet se ka bërë një gabim flagrant dhe urdhëron që lajmi të maskohet dhe të mjeçullohet sa më shumë!

Shërbimet e Shaqir Fetait duhet ta thonë të vërtetën, të shkruajnë saktësisht për lëvizjet e tij korridoreve të institucioneve shtetërore dhe të jenë sa më objektiv. Sepse, Shaqir Fetai, prezantoi në Akademinë solemne kushtuar themelimit të Komisionit Fetar në Shtabin e Ushtrisë Çlirimtare Popullore dhe Detashmenteve Partizane të Maqedonisë, Komision ky i krijuar me urdhër të komandantit të



shtabit kryesor, gjeneral Mihajlo Apostolski. (1943-2023)”. Çka është kjo nostalgji për “vlerat partizane” në themel të ngritjes së komunizmit dhe të shtetit socialist?

Po në këtë ushtri a nuk pat asnjë shqiptar, asnjë mysliman që paska dhënë kontributin e vet! Po në këtë Komision të parin fetar a nuk paska pasur të përfshirë asnjë hoxhë që nuk u përmendën në asnjë fjalim që u mbajtën në këtë Akademi! Atëher, çka kërkon Shaqir Fetai aty ku madhërohet deri në shenjtëri Referenti i parë fetar i këtij komisioni, Veljo T. Maņevski, si dhe kryetari i parë i komisionit, Epaminonda Pop Andonov!

Shaqir Fetai është dashur qysh para dy jave që të kërkojë nga Komisioni për marrëdhënie me bashkësishtë fetare dhe me grupet religjioze që t’i mbledhë liderët e bashkësive fetare dhe të grupeve religjioze dhe bashkarisht të nënshkruajnë ndonjë memorandum drejtuar Kombëve të Bashkuara që sa më parë të ndalohen luftimet në Rripin e Gazës, të vihet paqe dhe të dënohen sulmet izraelite mbi popullatën civile palestineze! Ky është misioni i një Komisioni fetar dhe jo të impenjohet në “shtabe” ku shtrembërohen faktet përmes censurimit të të vërtetës së përfshirjes së shqiptarëve dhe myslimanëve të vendit në të gjitha proceset e themelimit të këtij shteti! Prezantimi i Shaqir Fetait nëpër “evente” të tilla vetëm sa i legjitimon angazhimet e “komisioneve” në retushimin e fakteve që përjashtojnë shqiptarë e myslimanë nga rrugëtimi i shtetëbërjes së kësaj “dërzhave”!  
*/IKlikLarg/27.10.2023/*

## ***Kush po tallet me Shaqir Fetain***

***Shpesh lexojmë “aforizma” idiotike të përgatitur nga stafi amator i Shaqir Fetait, me ç’rast shkaktohet një “huti” totale; nuk dihet kush me kë po tallet: po tallet Shaqir Fetai me vetëveten, po tallen shërbimet e tij me Shaqir Fetain, apo, të gjithë po tallet me avdallin! Emërues i përbashkët i kësaj talljeje është, thjesht, Shaqir Fetai***

***Nga Mahir Rexhepi***

Shaqir Feti edhe më tej vazhdon me “reformat” e tij: me pritje-përcjelljet e njerëzve që i kap etja për një çaj rusi pasi të kenë bërë ndonjë Pazar në pazarin e fruta-perimeve në Bit Pzar! Ndërkaq vizitat e parapara nga ana e faktorit ndërkombëtar, që realizohen sipas protokoleve të tyre, Shaqir Fetai vazhdon që t’i paraqesë si kërshtëri të këtyre faktorëve për ta takuar “një njeri jasht normales”, një njeri “me karakteristikë të profetëve”, siç është ky farë “reisi” i rremë, i instaluar në krye të BFI-së nga një “dorë e zezë” (sintagmë kjo e përkthyer nga serbishtja “crna ruka”)! Në informacionet e Shaqir Fetait mbi këto vizita të Institucionit Fetar Islam ku është i instaluar njeriu (Shaqir Fetai) më antiinstitucionalist dhe njeriu më i kurdisur për rrënimin e autoritetit dhe të dinjitetit të këtij Institucioni, ka përplot humor naiv, ka përplot “mëlmesa” të pëlqyera vetëm nga avdalli i uritur, ka naivizma që dëshmojnë për një sjellje tërësisht nonshalante, amatore, karakteristikë e njerëzve jo të esullt!

### **Shpirti i madh i një ambasadoreje me kulturë të lashtë**

BFI-në e paska vizituar edhe zonja ambasadore e Suedisë, Ami Larsson Jain, e cila, veç tjerash paska shprehur trishtimin nga djegia e Kuranit prej elementëve të huaj për kulturën suedeze, të cilët në strategjinë e tyre e kanë destabilizimin e Suedisë dhe pengimin e saj për t’u inkuadruar në NATO. Për këtë gjest të ulët, ambasadorja

suedeze gjenë forcë shpirtërore për të kërkuar falje në emër të shtetit dhe popullit suedes para secilit mysliman në botë! Këtë gjest të saj, shërbimet e Shaqir Fetait (me kërkesë të tij prej avdalli) e kanë interpretuar si kërkim faljesh para Shaqir Fetait! Po kush është Shaqir Fetai që t'i kërkohet atij të falur! A mos është ky farë megallomani përfaqësues i myslimanëve të botës? A mos është shutraku "autor" i Kuranit, ndaj, së këndejmi, prej nga guximin që ta personalizojë këtë gjest të ekselencës së saj, zonjës ambasadore!

Çka flet kjo! Kjo do të thotë se, Shaqir Fetai, sa herë që ka nevojë për ta "madhëruar" vetëveten, nuk mbanë llogari për personalitetin e të tjerëve, për sjelljet kulturore dhe elementet civilizuese të të tjerëve! A e llogaritë Shaqir Fetai se në çfarë pozite e ka sjellë ambasadoren dhe, a e ka ndërmend që publikisht t'i kërkojë falje dhe, për ta dëshmuar hidhërimin e vet për këtë tallje që ia bëjnë ambasadores, a e ka ndërmend që ta ndëshkojë dikë, të paktën me masa disiplinore?

A mund të jetë, përveçse tallje, kjo fjali e informacionit për "aktivitetin" e të gjorit: "Reisul Ulema e pranoi kërkimin e faljes dhe e qetësoi Ekselencën e saj, duke i treguar se BFI posedonin formacione burimore në lidhje me atë se çfarë ka ndodhur nga bashkatdhetarët tanë që jetojnë dhe punojnë në Suedi"! Shaqir Fetai e qetësoi Ekselencën e saj!!! Një sjellje "profetike", kjo e Shaqir Fetait, ë?! Tani, në këtë fjali Shaqir Fetai e pranon aktin e ndodhur nga bashkatdhetarët tanë? A është normal ky njeri! Pse gjithmonë e ka qejf që t'i tradhëtojë e t'i spiunojë bashkatdhetarët e vet? Ves i hershëm komunist, apo, tashmë "kulturë familjare"!

## **A i kupton talljet Shaqir Fetai**

BFI-në e paska vizituar edhe shefi i zyres politike në Ambasadën e SHBA-së në Shkup, z. David Myeres dhe, i cili, kinse e paska vlerësuar lartë "reisin" për tolerancën ndërftetare! Në cilin rast e shprehu këtë tolerancë? Kur Shaqir Fetai u dëshmuar se me të vërtetë është tolerant! A ka pasur ngacmime dhe padrejtësia që ky të shprehë tolerancë? Deri më sot, që kur është instaluar në krye të BFI-së nga ajo "dorë e zezë" Shaqir Fetai veçse çka ka heshtur para sërë padrejtësive politike që i janë bërë BFI-së, duke filluar që nga instalimi i tij në krye të Institucionit. Përzierja e kësaj "dore të zezë" në BFI jo që ishte skandaloze, e patolerueshme, por ishte padrejtësia më e madhe që iu bë këtij Institucioni dhe që sinjalizoi se, deri në shkatërrim të tij, nuk ka të ndalur, ndërsa karshi kësaj politike Shaqir Fetai duhet të shprehë tolerancë maksimale, për të cilën edhe do të lavdërohet! Për Shaqir Fetain e rëndësishme është që ai të lavdërohet, sepse një jetë të

tërë është përballur nga talljet dhe ofendimet e ndryshme, të gjitha të merituar! Ndaj këtyre padrejtësive Shaqir Fetai është dhe deri në fund do të jetë tolerant, porse, shtrohet pyetja cila është toleranca e tij kur personalisht atij i bëhet “ndonjë padrejtësi”? Ai është i paprekshëm, këtë ia ka garantuar politika e “dorës së zezë”? Dhe kjo është esenca e çdo “lavdërimi” që ia shprehin të huajt dhe vendorët për atë se sa “tolerant” që është! Shaqir Fetai as që di se çka është toleranca! Nuk është tolerancë zbatimi i urdhërave për degradim dhe rrënim të plotë të BFI-së!

Tutje, Shaqir Fetai ia paska kujtuar mysafirrit amerikan se sa është e rëndësishme miqësia BFI-SHBA (!!!), sidomos në mes të ngjarjeve që ndodhën dhe po ndodhin në Veriun e Kosovës, në Ukrainë dhe në Gaza! Shaqir Fetai edhe me këtë rast nuk ka guxuar që ta emërtojë fajtorin (Serbinë, Rusinë dhe Izraelin) e rrënimin të paqes dhe sigurisë në rajon e në botë! Kur Shaqir Fetai e mblodhi “rijasetin” e vet dhe, kur solli përfundime institucionale lidhur me këto ngjarje që po trondisin themelet e paqes së rajonit dhe të mbarë botës? Shaqir Fetai ngjanë në pulën e lagur sipër plehut dhe, në tërë këtë situatë, meritat e tij (të pulës) konsistojnë në heshtje, në mos kakuritje të besdishme, të cilat Shaqir Fetai i përkthen si “kontribut në tolerancë” si dhe në dialog ndërftuar për çgjë e paskësh lavdëruar diplomati amerikan! Megjithatë, deri më sot nuk u gjet njeri të dëshmojë se për cilin dialog, për çfarë dialogu bëhet fjalë, ku u zhvillua ai dialog, kur, me çfarë rasti dhe cilat ishin përfundimet e atij dialogu! Kush e inicioi, kush e organizoi dhe me çfarë motivi? Sepse, kështu siç e paraqet Shaqir Fetai, krijohet përshtypja se ky avdall është një prej diplomatëve që mund t’i afrohet Kisinxherit dhe se politikat e tij janë aq të larta për t’u kuptuar sa, mjafton, vetëm të lavdërohet dhe kaq! Toleranca dhe dialogu ndërftuar janë filozofi jetike e kombit shqiptar, janë elemente të identitetit kulturor shqiptar dhe, nuk është afinitet i mjeranit Shaqir Fetai.

Edhe në këtë lajm ka një “margaritar” shumë të poshtër që rri mbyllur vetëm në guacën e mentalitetit provincial të Shaqir Fetait! Ai thotë: “Kreu i BFI, ritheksoi qëndrimin e Bashkësisë Fetare Islame se institucioni të cilin ai e drejton është i vendosur dhe i përkushtuar maksimalisht që të ndikojë në ngritjen e vetëdijes së besimtarëve se rruga të cilën duhet ta ndjekim si shoqëri, është ajo drejt Bashkimit Evropian”. Me u pas pyetë Shaqir Fetain, a kurrë nuk do të dilte nga zyret e UDB-së por, orientimi i shqiptarëve properëndimit është përcaktim i betonuar që nga rilindasit e kombit me të cilët, Shaqir Fetai si “ORAO” nuk mund të ketë asgjë të përbashkët! Sa i përket politikave të brendshme, kjo është strategji e mbarë subjekteve

politike të vendit, të cilët kanë tagrin për ta udhëhequr shtetin dhe shoqërinë, e cila, në përqindje të konsiderueshme është e orientuar kah vlerat pro-perëndimore. Pra, është politikë shtetërore, nga e cila nuk guxon të luajë asjë milimetër Shaqir Fetai, sepse sakaq ia curravin veshët.

## **U realizua premtimi i artistit**

Ditë më parë, në një lokal në Gostivar, rastësisht takohen Shaqir Fetai me artistin mjaft të dashur e të respektuar, prof. Nevzat Kicën, nga Gostivari. Sakaq, pas përshëndetjes, Shaqir Fetai i ka thënë se është e pakuptueshme që një artist i Gostivarit mos ta vizitojë numrin një të BFI-së i cili po ashtu vjen nga Gostivari. “Të vishë për një çaj”, i ka propozuar Shaqir Fetai. Artisti, piktoi i dashur, ia ka kthyer “po, do të vij dhe do ta realizoj këtë premtim”!

Artisti e mbajti premtimin, e vizitoi Shaqir Fetain me shpresë se prej tij do të dëgjojë ndonjë respekt e vlerësim për artin e tij, për kontributin e tij si pedagog dhe për vlerat e pakontestueshme që ngërthehen nëpër veprat e tij pikturale! Shaqir Fetai thotë se, e falënderoi për vizitën dhe biseduan gjërë e gjatë për rrjedhat në shoqëri në veçanti në sferën shkencore dhe informative! Ja pra si e manipulon artistin Shaqir p... Për të me rëndësi ka qenë vizita prej nga do ta nxjerrë një foto e një informatë se dikush e vizitoi të gjorin!

Piktorët i vizitojnë zyrat dhe intitucionet e rëndësishme gjithnjë me shpresë se do t’ia dalë që të shesë ndonjë punim artistik. Nevzat Kica e di fort mirë se ekziston një BFI me shumë zyre, se ekziston një Medrese, një Fakultet të cilat mund të stolisen me vepra artistike që do t’i bleheshin artistit të popullit. Kjo i intereson Kicës dhe jo kopallat diletanteske të Shaqir Fetait, i pa denjë për të pasur ndonjë titull shkencor dhe për të pasur ndonjë bashkëbisedim të niveleve të duhur e të lartë, me askend!

***/ShqipPress/03.11.2023/***

# ***Shaqë mos harro ti ke qenë spiun i UDB-së në Jugosllavi***

*Nga Nexhat Ibrahimimi*

*(Profesor Ibrahimimi është Ish i burgosur politik nga Kosova, ku 8 vite e 1 ditë, ka vuajtur dënim në burgjet e Millosheviqit. Ka qenë ish koleg dhe cimer i Shaqir Fetahut gjatë studimeve në Sarajevë)*

I dashur Efendi Shaqa!

Vitet e fundit më ke befasuar, madje më ke shtangur me akrobacionet politike, me nëpërskëmbëzat tinzare ndaj miqve e shokëve, me marifetllëqë të mbitokës e nëntokës, edhe pse unë prisja të befasohem me punë konstruktive e sistematike brenda Bashkësisë Islame të Maqedonisë.

Nuk të përshëndeta me selam, sepse mu dukë hipokrizi nga ana ime. Nuk të pyeta si je, sepse më duket e tepërt, sepse jehona e disponimit tënd dëgjohet edhe jashtë Maqedonisë, që jep të kuptoj që ke kondicion për shumë lojëra futbollit.

Nuk të quajta as Reis, sepse nuk e kam kuptuar që në atë vend ke ardhur me rrugë të mirëfillta, as nuk je duke ia bërë hizmetin “islamçe” punës, por hizmetin e bënë sipas direktivave që të vijnë nga “kufjet” në vesh, që mos ta dëgjojë veshi i majtë ç’ dëgjon veshi i djathtë.

Shaqë i dashur! Kemi ngrënë e pirë në një sofër për shumë vite, kemi kaluar vitet më të mira të rinisë së bashku, kemi lozur futboll dhjetëra herë, por nuk e dija se gjatë kësaj kohe t’i përveç shkollës ke kryer edhe një mision tjetër, atë të puthadorit të regjimit, të zëdhënësit tonë pa autorizim për dobi të tyre. Çuditë, sa i fortë paske qenë e nuk e kam ditur. Por më dhe pak kurajo, që edhe unë paskam vlejtur dikur që “madhëria jote” të merret. Ti ke pasur të gjitha autorizimet, si i gjithëpushtetshëm që je, atëherë e sot, ndaj edhe i ke dhënë të drejtë vetes të flasësh në emrin tim për mua para autoriteteve të UBDA-s,

përkatësisht të flasësh për idetë, veprimet dhe jetën time para organeve të spiunazhit.

Ç'të ndodhi? Përse më spiunove? Të duhej pozita! Të duhej pasuri! Përse më solle aq telashe mua dhe familjes time?! Edhe pse ndonjëherë kam dyshuar, megjithatë i kam thënë vetes, nuk ke të drejtë, hafëz Shaqa nuk e bënë këtë. Një hafiz, një teolog, një cimer, një bashkëshort, një baba, nuk e bën, ose së paku më jep ndonjë shenjë se ç'po ndodh rreth meje, që jam i ndjekur. Ke pasur kohë, ke pasur mundësi, ke pasur rast!

Përse nuk e bërë këtë më vonë, pasi jemi rritur e martuar, kemi krijuar familje e kemi bërë karrierë? Përse nuk the: o njeri, kam qenë i ri dhe kam gabuar!, ose kam qenë i shtrenguar nga policia dhe kam gabuar!, ose kam pasur oferta por e shoh që kam gabuar! Nuk të dhembesha unë? Nuk të dhimbsej familja ime (por edhe e jotja)? Nuk të dhimbsej titulli i hoxhës e hafizit? Apo, ke kryer detyrën tënde patriotike prej jugosllavi dhe ke spiunuar fëlliqtë mbi shokët e dhomës! Aman, sa e rëndë që edhe sot i them këto fjalë, hera e parë që flas publikisht për këtë temë, edhe pse e di tashmë shumë vite më herët, qysh kur shteti yt Jugosllavia të ka shpallur për spiun.

I dashur Shaqë, ia hodhe paçe Molla Sylës. I dhe pleksus dhe nokaut. U bërë më i fortë se ai. Por, më kujtohen edhe servilizmat tua ndaj tij. Por, ke duruar me durim 'bilalian' deri në çastin e duhur për ta goditur.

Në vend që ta përmirësosh gjendjen juridike, financiare, kulturore, fetare, njerëzore në organizatë, ti po e gjunjëzon organizatën, po përjashton kuadrot, po ofendon kolegët. Shumë e rëndë. Kush të dha këtë të drejtë?! UDBA?! O Shaqë, nëse gabove si i ri, si pranon të gabosh si i vjetër! A nuk e sheh varrin disa hapa më tej! Apo reisët si ti nuk japin llogari, si të ishe njeri 'Komiteti'!

Para disa muajve bërë allishverishe jo të matura, duke shkarkuar njerëz nga puna, sepse nuk i ke pëlqyer fjalët dhe veprat e tyre! Po, por nëse ti ke të drejtë të flasësh e veprosh përse edhe ata nuk e kanë këtë të drejtë? Vallë, të erdhi shpallje ty për saktësinë e fjalëve dhe veprime tua. Në vend të përjashtimit, përse nuk i ke ftuar të bisedosh konstruktivisht, me sinqeritet, të shohësh gabimet tua dhe natyrisht të tyret.

Sërisht këto ditë me allishverishe! Më ngjan në lugatin, të cilit kur i konsumohet forca, pinë gjakun e ndonjë njeriu, për të vazhduar jetën prej lugati. Ty, të kënaq kjo që përjashton njerëz! Mos je bërë, vallë, më i madh tanimë kur ke shkarkuar kolegë tuajit nga detyra pa gjykim! Mbaje mend, as Nemrudi, as Faraonët, as Hitleri, as Tito, as Stalini në fillim nuk kanë pirë gjakun e shokëve. Kjo filloi kur filluan

të mbesin pa prova, pa argumente, kur kishin frikë nga vetja dhe hija e tyre!

A nuk ishte më me vend të jepje dorëheqje, e të shkoje në shtëpi si njeri, që të të përshëndesin njerëzit njerëzisht. Kështu, ca kalamaj rreth teje të duartrokasin dhe ti merr forcë nga tifozaletu i tyre. Abuzon me Bashkësinë Islame, abuzon me ligjin, abuzon me të drejtat e njeriut për nevojën e të mbeturit spiun deri në frymën e fundit. Habitem me ty. Kështu nuk të kanë mësuar mësuesit tuaj, as në medrese, as në fakultet. Mbase kjo është ndonjë vijë gjenetike që ti dhe familja do t'i turpëroheni me vite e vite. Edhe Çegrani do të turpërohet nga vesvesja e të qenit spiun.

Habitem se si gjen guxim të dalësh para njerëzve e t'u flasësh për të mirën e kundër të keqes, për hallallin e haramin, për miqësinë e dashamirësinë, kur ti ke thyer të gjitha parimet e njerëzores. Sa ajete e hadithe ke shkel duke vepruar në mënyrën tënde.

I dashur Shaqë! Edhe ne të tjerët gabojmë. Bëjmë gabime, por për dallim prej teje, përmirësohemi. Bëjmë edhe mirë, sepse e dimë se do të gabojmë edhe në të ardhmen. Lutemi dhe pendohemi, sepse kjo është rruga jonë.

Nuk do ta zgjas më shumë. Të sugjeroj: shkel në tokë, merre shtuar, shko në shtëpi. Kjo është më mirë se të vazhdosh të gabosh. Vazhdimi në gabime të çon më tej, në ambis, nga ku nuk ka kthim!

Shprehi keqardhje për këto fjalë që u detyrova t'i them pas shumë vitesh. Më dhimbseth si e bënë gjumin. Më dhimbseth si do të përgjigjesh në Berzah.

Mos e harro, ti ke qenë spiuni im. Më ke bërë dëme fizike dhe psikike. Më ke prishur jetën. Shkaku i ambicieve tua të liga, unë jam rrahur, jam uritur, kam pritur disa vite për punë, sepse isha i padëshiruar për ata si ti, që udhëhiqnin Bashkësinë Islame. Hallall nuk e ke sepse as nuk e ke kërkuar hallallëkun. Dhe nuk do ta kesh hallall, nëse kjo gjë për ty vlen diçka.

Ish-miku yt, Nexhat Ibrahim

**09.11.2023, Prizren**  
**/Almakos/**



## ***Si vepron shërbimi i Shaqir Fetait***

***Po ata njerëz të cilët, me urdhër të “pronarëve të tyre”, ia dhanë përkrahjen Shaqir Fetait, po këta njerëz hodhën firmën për puç kundër tij! Shërbimet inteligjente këtij akti i thonë “goditje për shkundje”, pra, jo për të bërë ndryshim por për t’i ngjallur e për t’i bërë më aktive bashkëpunëtorët që i kanë në terren (në BFI)***

***Nga Miradije Demiri***

Shih habinë, të gjithë ata që e përkrahën instalimin e Shaqir Fetait në krye të BFI-së, po ata tashti kërkojnë largimin e tij, të cilin dëshirojnë t’ia bëjnë po në të njëjtën formë siç ia bëri ky “babait të vet shpirtëror”, H. Sulejman ef. Rexhepit!

Është kjo lojë apo rrebelim i bashkëpunëtorëve të UDB-së?! Natyrisht që është lojë, sepse, po ata të cilët dikur morën urdhërin që ta hedhnin firmën për përkrahje të Shaqir Fetait, nuk mundet që të njëjtit tash të rrebelohen kundër Shaqir Fetait. Një rrebelim i tillë eventual do të thoshte kundërshtim i bashkëpunimit të mëtejme me UDB-në! Prandaj, thjesht, është lojë e inskenuar po nga ato struktura nëntokësore që e sollën Shaqir Fetin në krye të BFI-së! Do me thënë, Shaqir Fetai largon nga rrethi i vet vetëm ata njerëz të cilët shërbimi inteligjent vendos që t’i zëvendësojë me të rinjë, dhe jo se i largoi sepse këtij iu kërcënua pozita! Pozita e caktuar prej UDB-së nuk mund të çenohet aq lehtë, aq më pak nga bashkëpunëtorët dhe strukturat operative, sepse, janë një! Ky puç në fakt ishte vetëm një taktizim i shërbimit inteligjent për t’ua bërë me dije të gjithëve se kushdo që do të përpiqet për ta larguar Shaqir Fetain, do të jenë pikërisht shërbimet sekrete ato që do ta mbrojnë dhe shpëtojnë, siç e mbrojtën dhe shpëtuan edhe me rastin e puçit të tretë, kur, pas mesnate, shërbimi maqedonas dha urdhër që të shpëtohet operativci i tyre, Shaqir Fetai!

Shaqir Fetai në maj të këtij viti (2023) largoi nga “rijaseti” i tij pesë anëtarë, të cilët i zëvendësoi me pesë të rinjë emrat e të cilëve

i erdhën në listë! Ndonëse ky ndërrim kuadrosh ishte i dakorduar dhe i urdhëruar, tërë kjo u bë kinse me nervozizëm e me hidhërimi, sepse, dikush dikë po e kërcënonte me puç! “Puçi” i kryer nga ata që si bashkëpunëtorë u urdhëruan të kryejnë puç paraprak, nuk llogaritet goditje, por, ndërrim kuadrosh nga ata që hartojnë lista bodrumeve sekrete. Këta ndërrime mund të bëhen pa dijeni, mund të bëhen me qëllim shumë të mirë, porse, duhet kuptuar që ata mund të jenë edhe target i rekrutimit nga ana e shërbimeve inteligjente. Sepse, operativcit gjithnjë i duhen bashkëpunëtorë të rinj, të cilët, në momentin e dekonspirimit dhe të zbulimit të tyre, zëvendësohen me të rinj dhe në interes të synimit dhe objektivave të shërbimit inteligjent.

Pra, edhe pse me “nervozizëm” Shaqir Fetai i shkarkoi pesë anëtarë të Rijasetit, në fakt ai bëri vetëm zëvendësimin e tyre, me marrveshje paraprake të kamufluar.

Kurse, tani, në nëntor, Shaqir Fetai i largoi edhe dy myftinj (Qani Nesimin e Tetovës dhe Salim Sulejmanin e Strugës)! Në plan për ta larguar e kishte edhe myftiun e Kumanovës, Abedin Imerin, por, pas takimit të tij me Oliver Spasovskin, ministër i punëve të brendshme i RMV-së, dhe me urdhër të tij, Abedin Imeri ngeli edhe më tej myfti i Kumanovës. I pari nuk u pajtua të largohet pa zhurmë, ndërsa i dyti u largu gatise i lumtur që i shërbeu “ORAO”-s dhe i stërlumtur që me nënshkrimin e tij u bë shkaktar që të instalohet në krye të BFI-së.

Pas kësaj, Shaqir Fetai “raportoi” se i largoi njerëzit e Sulejman Rexhepit që po e kërcënonin vazhdimisht dhe se në vend të tyre solli “njerëz të çiltër”! Mendon Shaqir Fetai se mund t’ua hedhë myslimanëve të vendit? Mendon ai se mysimanët e vendit nuk e dinë se askush nuk mund t’i prekë njerëzit e shërbimeve inteligjente, nëse vetë ato shërbime nuk ndjejnë nevojë për ndërrime kadrovike?!

BFI-ja për momentin është shumë keq e kapur prej shërbimeve inteligjente serbo-ruso dhe lindore dhe, të gjitha ndryshimet që mund të bëhen brenda dhe nuk vijnë nga strukturat e pastra kombëtare, thjesht, mund të jenë ndryshime si rezultat i kompromitimit të kuadrove të instaluar nga shërbimet e ndryshme jo kombëtare e jo fetare. Shaqir Fetai nuk është rezultat i një vendimi kombëtar, as rezultat i një përkrahje kombëtare, por, thjesht, është rezultat i vendimit për shpërblim që vjen nga strukturat antishqiptare e antiislame ku ka shërbyer ai paraprakisht.

***/IKlikLarg/12.11.2023/***

## **Dikur Bashkësia Fetare Islame qeveriste, sot ajo administrohet**

***Ekzistojnë organizata, të cilat, funksionojnë  
gati në formë shteti, sidomos ato që janë të  
kategorisë kushtetutare! Qeverisen, platformën  
e vet, programet e veta, strategjitë e veta i  
zbatojnë përmes organeve më të larta kolektive,  
ekzekutive, ligjvënëse, ndërsa efektuohen përmes  
administratës. Këto organizata drejtohen nga  
kuadrot që i nënshtrohen meritokracisë dhe  
afiniteteve të natyrshëm, e kundërta e kësaj do të  
thotë falimentim, nënshtrim, poshtrim, vasalitet***

***Nga Mr. Abaz Islami***

Me shpërbërjen e ish-shtetit jugosllav u shpërbënë edhe ish-organizmat kolektivë me kompetenca të padiskutueshme. E kësaj kategorie ishte dhe e ashtuquajtura “Bashkësia Islame e Jugosllavisë”, në të cilën aderonin detyrimisht të gjitha bashkësisë fetare islame të republikave dhe krahinave të atëhershme. Mëvetësimi i RMV-së, si i republikave të tjera, ia hapi shtegun edhe BFI së RMV-së të pavarësohet dhe, nga kategoria statutare të ngritet në atë kushtetuese. U mblodhën ajka e intelgjencies kombëtare e fetare dhe me vullnet të paluhatur i hynë një organizimi krejt të ri si të Institucionit ashtu dhe të jetës fetare islame në vend. U punua natë e ditë, në komisione të ndryshme, të ndihmuar nga shumë debate e propozime, nga shumë ligjërime profesionale e ndihma vëllazërore nga faktorë të ndryshëm në vend e në botë.

U ngrit sistemi i anëtarësisë, u centralizua buxheti, u krijua një sistem i ri financiar, u centralizua vakëfi, u punua në hartëzimin e vakëfit, u grumbulluan dokumenta, quke qenë në harmoni me faktorin politik mysliman u punua pa rreshtur për decentralizimin e vakëfit të nacionalizuar, u ngritën dhjetra iniciativa për rikthimin e vakëfit, u

kompletuan dhe u dorëzuan dokumentat e perefuzueshme, u shpenzua mund e para, u kalua qindra orë nëpër zyrat gjyqësore duke mbrotjtur interesat e Institucionit.

Hartoheshin strategji e projekte, të cilat merrnin formë pas debateve publike, pas konsultimeve me bazën, pas miratimeve nga organi më i lartë i BFI-së (Meshihati, Rijaseti), pas miratimi nga Kuvendi i BFI-së dhe të organizmave të tjerë. Pra, punohej natë e ditë, sepse projektet e miratuara nëpër këta organe duhej të zbatoheshin! Organet mblidheshin gati çdo muaj, e jo si sot, një herë në vit!

Dikur në BFI hartoheshin strategji kombëtare, zhvilloheshin projekte kombëtare; dikur në zyret e BFI-së zhvilloheshin takime të rëndësishme dhe jetike për kombin në çastet kur po trokiste ora shqiptare, ndërsa sot, në ato zyre, zhvillohen takime me delegacionin rus, me përkrahës të Putinin që zhvillonin propagandë putiniane në prag të invazionit rus mbi Ukrainë!

A ishte i lehtë zbatimi i projekteve, a ishte financiarisht i gatshëm Institucioni për t'i hyrë projekteve? Gjithësesi që po, sepse, projektet mbështeteshin në preventiva të sakta e të sigurta financiare, bazoheshin në premtime të shumta vëllazërore për përkrahje të projekteve. Si shembull mund të merret Fakulteti i Shkencave Islame, Konvikti i Medresesë, meremetimi i shumë Xhamive të kategorisë me vlerë të veçantë historike e kulturore. Shtimi dhe dispersimi i paraleleve të Medresesë, profesionalizimi i sektoreve të dikurshëm të BFI-së. Kështu, me plotë kuptimin e fjalës, qeverisëj dikur me BFI-në! Po sot?

Sot, me BFI-në, mjerisht, administrohet! Nuk dihet kush qeverisë, ndërsa perceptimi i lartë është se BFI administrohet, meqë është shndërruar në filiale të organeve shtetërore që patën strategjinë si ta devalvojnë, ta defaktorizojnë dhe ta sjellin në këtë derexhe ku është sot BFI! Me BFI-në nuk lejohet të vetëqeveriset, porse të administrohet, të zbatohen të tjera plane, që thuren jashtë zyrave dhe jashtë organeve të BFI-së, nga ata që në krye të BFI-së instaluan një person si Shaqir Fetai. Ata që e njohin këtë person, ata të cilët kanë punuar me këtë person, të gjithë flasin se Shaqir Fetai asnjëherë nuk ka shprehur interesim për ta kuptuar funksionimin dhe zhvillimin e këtij Institucioni, ai gjithnjë ka pasur qëndrime të ndërkrjera, gjithmonë ka qenë indiferent, flegmatik, asnjëherë nuk është kyçur në debate, në propozime, edhe atëherë kur është përfshirë nëpër komisione kontributi i tij ka qenë zero. Ai u instalua në krye të BFI-së pa kurrfarë programi, ai edhe sot nuk ka një strategji të qartë se si të veprojë, ku të shkohet dhe ku të arrihet me BFI-në! Ai nuk di të veprojë as me Kushtetutë, as me statute të organeve as me rregullore

të patjetërsueshme. BFI sot ka ngelur pa asnjë infrastrukturë juridike, sepse, dhe ato që ishin dikur “i amortizoi” Shaqir Fetai me makinerinë që nuk i bën hajër asnjë institucioni serioz!

Shaqir Fetai nuk është i aftë (sepse e ka hendikep mosnjohjen e arabishtes, turqishtes) të krijojë miqësi të reja! Miqësitë ai i “arrinë” përmes sekserëve të cilët duhet të paguhen, të shpërblehen, apo të dekorohen!

Ky edhe mysafirët i pret kot e kot, pa strategji e pa plan, edhe vizitat i bën pa plan e pa interes të përgjithshëm, mjafton që dikush ta ftojë, qoftë edhe për një vizitë të ndonjë “Qevapçillnice”!

Shaqir Fetai vetëmse duhet t’i “administrojë” dhe t’i zbatojë planet dhe projektet e atyreve që e instalojnë në krye të BFI-së! Ka kush e qeverisë BFI-në, ajo duhet të jetë një “projekt” i administratës dytësore, një eksperiment i zbatueshëm vetëm prej çiftit të Shaqir Fetait!

***/Kombetare/20.11.2023/***

# ***Demaskimi i tradhëtisë***

***Recension  
(Përkitazi me librin “MASKA E TRADHËTISË”,  
i cili sapo u publikua elektronikisht, nën  
përkujdesin e Korporatës për Produksion,  
Informim dhe Botim “1kliklarg”, Tiranë)***

***Nga Halid Sadiku***

Kohë më parë doli në publik edhe edicioni i katërt nga biblioteka elektronike e Korporatës për Produksion, Informim dhe Botim “1kliklarg”, me titull “Maska e tradhëtisë”! Botimi në fjalë është i po të njëjtës linjë që trajton fenomenin e tradhëtisë nga individit konkret (Shaqir Fetai, uzurpatori i BFI në RMV), i cili, u bë subjekt trajtimi që në librin e parë me titull “Tradhëtia dhe komploti i Shaqir Fetait në kohë pandemie”, për të vazhduar në lirbin e dytë me titull “Nusprodukti i një komploti dhe tradhëtie, e për të arritur te vëllimi i tretë “Maska e tradhëtisë”.

Libri i parë trajtonte tradhëtinë e Shaqir Fetait që ia bëri Institucionit të Bashkësisë Fetare Islame në RMV, të cilën, përmes shkeljeve kushtetutare, përmes degradimit deri në një nëndegë partiake të një mëhale të Gostivarit, i ndihmuar nga shërbimet e ndryshme intelektuale ia doli që ta manipulojë një strukturë të tërë institucionale për ta vënë në shërbim të interesave personale. Është kohë kjo kur BFI-ja, si një Institucion me histori e me reputacion kombëtar e ndërkombëtar, si një faktor i patejkalueshëm, u shndërrua në një paçavurë në dorën e Shaqir Fetait, i cili, sa hap e mbyll sytë, fshiu nga faqa e historisë një traditë dhe një faktorizim të Institucionit që e arriti për tri dekada rresht. Natyrisht, një Institucion kaq i fuqishëm nuk i konvenonte vetëm strukturave antiislame, antishqiptare dhe që ishin kundër etablimit të subjekteve me karakter të pathyeshëm kombëtar. Vegla, si Shaqir Fetai, do t’ia dalë që, si një gomarë, të vihet në krye të karavanit të deveve, që kishin marrur një rrugëtim shumë të vështirë por që ishte tepër i rëndësishëm për perspektivën fetare dhe kombëtare të shqiptarëve të RMV-së!

Libri i dytë trajtonte problemet dhe pasojat që do të renditen si varg trespishë e që do të shprehin rezultatin publik që do të vijë si rrjedhojë e e tradhëtisë së Shaqir Fetait. Çdo përpjekje të elementeve antishqiptare e antiislame që do të mundohen që ta paraqesin Shaqir Fetain si zgjedhje e duhur për “reforma në BFI”, në fakt do të zbërthehen si skenare e strategji të huaja për ta degraduar e deformuar peshën dhe rolin e BFI-së në shoqërinë e gjithmbarshme të vendit. Do të jenë mbi 250 shkrime të publikuara brenda një viti, analiza, komente, opinione, intervista e ese, që do t’i zbërthejnë ato “përpjekje” destruktive nën siglën e Shaqir Fetait, dhe, si një brum i ardhur nxjerr produktin “Nusprodukti i një komploti dhe tradhëtie”! Veprimet ditore në kundërshtim të çdo germe të Kushtetutës së BFI-së, veprimet amatore e të papjekurta prej një avdalli, vjedhjet e vakëfit, dezorganizimi dhe defkatorizimi flagrant i Institucionit, lugët e pushtetit të futur në tasin e BFI-së ku përzihet e gatuhet një gjellë e kontaminuar që i dedikohet gjeneratave aktuale dhe atyreve që po vijnë nga shoqëria shqiptare e myslimane e vendit; hapja e terrenit për veprime bashibuzukësh, trasimi i “loteve” të “një autostrade” ku do të bëhen garat kush më shumë do të bëjë shkelje kushtetare në emër të islamit e të kombit nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, aktiviteti i natëeditshëm i aktivistëve të devotshëm të Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI, të cilat u zhvilluan për zbardhjen e çdo tradhëtie, të çdo mashtrimi, të çdo vjedhje, të çdo degradimi dhe dukurie tjetër e shkaktuar në BFI si pasojë e keqmenaxhimit të Shaqir Fetait, si dhe, si pasojë e betimit të tij para strukturave të dyshimta për ta “reformuar” BFI-në deri në degradim dhe defaktorizim total – të gjitha këto janë materie e librit të dytë dedikuar fytyrës me njëqind maska të Shaqir Fetait.

Libri i tretë, është produkt që del në vazhdën e dy librave të parë. Pra, edhe ky libër elektronik është përmbledhje e shkrimeve dhe publikimeve njëvjeçare që, kësaj here, paraqesin aktivitetin ditor të “rrebelëve” kundër tradhëtisë, të cilët as në vitin e katërt të veprimtarisë tradhëtuese të Shaqir Fetait nuk heshtin dhe nuk e kanë ndërmend të ndalen derisa BFI-ja të kthehet në binaret e veta kushtetuese.

Mbi 150 shkrimeve të publikuara gjatë këtij viti që po e lëmë, nëpër portale të ndryshme kombëtare, të përfshira në librin e tretë elektronik me titull “Maska e tradhëtisë”, në fakt trajtojnë pasojat që vijnë nga një shturrje totale e veprimeve antikomtare e antifetare të Shaqir Fetait dhe të klikës së tij. Shkrimet zbardhin edhe përpjekjet e Shaqir Fetait që veprimet e tij antikusshtetuese e tradhëtuese të marrin bekimin e pushtetit, të faktorit “ndërkombëtar”, të korit diplomatik

maqedonas; trajtojnë përpjekjet e Shaqir Fetait për të hapur kanale të ekstremizmit fetar e për të shpërthyer ndonjë “epidemi radikaliste”, me të vetmin qëllim që të tërhiqet vëmendja e opinionit të gjërë që tash e tre vite ka hedhur fokusin mbi aktivitetet fatale për fe e për komb që po i ushtron Shaqir Fetai nën titullin “Reisul ulema i BFI-së”!

Këta tre botime elektronike mund të shërbejnë edhe si doracak i zbërthimit të tradhëtisë por edhe si zbërthyes i pasojave dhe dukurive që pasojnë pas çdo tradhëtie dhe pas çdo dhurimi të shpirtit shejtanit. Ajo që nëpër këtë materie është sinjalizuar se çfarë do të mund të ndodhë me Institucionin dhe me honxho-bonxhot e Shaqir Fetait që e ndihmuan në realizimin e tradhëtisë së madhe si dhe të devalvimit dhe defaktorizimit të një prej Institucioneve më të fuqishme dhe më stabile në vend, Ballkan e më gjërë, siç ishte BFI për tri dekada rresht, më në fund po shpërfaqet edhe praktikisht! Një Institucion i privatizuar dhe i ulur në prehër të strukturave të caktuara pushtetit antiislam e antishqiptar, një Institucion i personalizuar dhe pa organe më të larta kolektive, pa organin gjegjës që do ta pengonte vjedhjen masive që po ndodhë në BFI, pa njerëzit që do ta pengonin defaktorizimin dhe shkatërrimin epik të BFI-së; përçarjen e madhe që mund të përfundojë edhe tragjikisht (rasti “Myftinia e Tetovës”!), vetëm e vetëm se dikush parapëlqen veprimtarinë antikushtetuese që garanton “mirëqenie” personale!

Ja pra, në shoqërinë “fanatike” siç mundohen t’i paraqesin shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, paska edhe të atillë që i luftojnë të gjitha ato dukuri që ushtrohen në emër të fesë e të kombit; që me një gjuhë e stil konician i zbardhin të gjitha tradhëtitë dhe veprimet antikombëtare që luhen mbi kurriz të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut. U ngelë në ndërgegjeje subjekteve kombëtare që t’i verifikojnë këto dukuri, që t’u dalin përpara dhe individëve të shitur t’u tërhiqet veshi deri në largim nga skena e veprimit të pastër fetar e kombëtar.

Çdo gjë që është thënë në këtë publikim, por edhe në dy të parat, tani “të pakënaqurit modern” të Shaqir Fetait, po mundohen që t’i përdorin si veprime dhe reagime “autoriale”! Pakënaqësia e tyre nuk është brengë e sinqertë kundër veprimeve tradhëtuese të Shaqir Fetait, porse, thjesht, pakënaqësi prej bebeje për shkak të dëbimit nga sahani me gjellë të kontaminuar që përzihet nga luga e pushtetit antishqiptar që nëpër pjata serviret me garuzhden në pamje të Shaqir Fetait

***/IKlikLarg/26.12.2023/***



# ***Organet policore të BFI-së***

## ***Editorial i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI***

Pas shpërthimit të aferës skandaloze në mes të BFI-së dhe organit të saj, Myftinisë së Tetovës, Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI, heshti dhe nuk deshti që të ndërhyjë në mes zënkave të turpshme që gjeneruan pas hidhërimit të uzurpatrit të BFI-së, Shaqir Fetait, për puçin e organizuar dhe, të shkarkuarit nga Myftinia e Tetovës, Dr. Qenan Nesimi. Reagimi i fundit i publikuar në faqen zyrtare të Lëvizjes është ai i 14 nëntor i vitit 2023, i huazuar nga arkivi i Këshillit për Mbrojtjen e Kushtetutshmërisë së BFI-së, e që është shkëputur nga një intervistë më e gjatë e ish-sekretarit gjeneral të BFI-së, Afrim Tahirit, ku flet për nevojën imediate të kthimit të organeve të BFI-së në Kushtetutën e saj dhe nevojën për të vepruar ekskluzivisht sipas këtij akti më të lartë të BFI-së. “Të mblidhemi sa më urgjentisht dhe të gjejmë mënyra kushtetuese për të dalur nga kjo krizë e rëndë që e ka kapluar BFI-në”, ka apeluar efendi Tahiri!

Që nga botimi i këtij materiale Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI nuk ka publikuar asgjë! Ka pritur që të reflektojnë degjeneruesit e BFI-së që kanë uzurpuar kolltuqet e organeve të këtij Institucioni dhe të ulen për të gjetur zgjidhje kushtetutare si dhe për të inicuar ndryshime eventuale në Kushtetutë, të pranueshme për të gjitha palët, si për ata që ëndërrojnë veprime duke shkelur mbi Kushtetutë, ashtu edhe për ata (Lëvizjen) që angazhohet për respektimin e patjetërsueshëm të Kushtetutës përgjatë veprimit institucional.

Lëvizja Myslimane për Reforma në BFI nuk ka qenë vëzhguese pasive e kësaj krize nga më të thellat që kur ekziston BFI-ja! Vazhdimisht ka dërguar sinjale për ulje të tensioneve dhe për kthim në Kushtetutë, porse, natyrisht, ky angazhim ka hasur në veshë të shurdhër të atyre që janë përkrahës të anarkisë dhe shkelës të drejtpërdrejtë të Kushtetutës së BFI-së!

Dhe, ja ku jemi sot! Jasht BFI-së funksionon një prej Myftinive më të mëdha dhe më të rëndësishme të BFI-së – Myftinia e

Tetovës! Ajo vepron jashtë normave kushtetutare të Institucionit, ndëra Shaqir Fetai këmbëngulë në kthim të këtij ogani përmes policisë shtetërore. Pra, Shaqir Fetai angazhohet që meritat e kthimit t’ia përshkruaj policisë dhe jo vullnetit të mirë të hoxhallarëve të vendit!

Për çdo moment pritet që të “çlirohet” Myftinia e Tetovës dhe të lidhet në pranga profesori i USHT-së Qani Nesimi e të shoqërohet nga policia në donjë ent ndëshkimor, ndërsa, “myftiu” tjetër, Selver Xhemali, i shoqëruar nga policia e shtetit, të futet triumfalisht në Myftininë e Tetovës! Pastaj, Shaqir Fetai, pas daljes si gjeldet nga Qabja, të futet si gjeldet i shoqëruar me polici në Myftininë e pashkelur të Tetovës për muaj me radhë!

Këtu merr fund kuptimi i funksionimit kolektiv të BFI-së, e cila, pas kësaj “zgjdhje fetare” me polici, do të perceptohet si “organ” i policisë që instalon personalitete të pëlqyeshëm nga bashkëpunëtorët e tyre!

I instaluari i policisë shtetërore në krye të BFI-së aktron se po vepron kushtetutshmërisht duke u thirrur në Kushtetutë si dhe në “obligimin” e policisë shtetërore për t’ia pastruar terrenin! Nëse ndodhë kjo – a do të ketë kuptim të mëtejme Institucioni i BFI-së?! Natyrisht, Shaqir Fetai duhet ta lavdërojë dhe ta shpërblejë me diçka tërë atë angazhim policor në instalimin e myftiut të ri në Myftininë e Tetovës. Dhe, do të nisë pastaj sistemi domino, në të gjitha organet dhe institucionet e BFI-së. Medet!

***/IKlikLarg/25.01.2024/***

## **Mesazhet satanike të Shaqir Fetait**

*Do të shkrubet e do të flitet për Shaqir Fetain derisa të ndërgjegjësohet e të shporret sysh! Meqë ky ndërgjegjësim do të jetë i ngadalsbëm e mbase edhe i pamundshëm, edhe ndalimi i shkrimeve dhe bisedat do të jetë i pamundshëm, sepse ky ndalim do të ishte mëkat dhe hapje shteg për të keqen dhe për të gjitha llojet e dështimeve. Myslimanët nuk janë të interesuar të dështojnë, prandaj do të flasin e do të shkruajnë derisa ta ndërgjegjësojnë “satanin”. Ndryshe, nuk do të na dojë Zoti*

*Nga Myrvete Ibrahim*

Shaqir Fetai edhe një herë na doli me një nga ato “postulatet filozofike” të tij (38 me radhë) që nuk flasin për asgjë tjetër përveç për injorancën e tij si dhe për përpjekjet e djallëzuara për ta kamufluar hipokrizinë e vet. Shaqir Fetai është kallëpi i hipokrizisë, kështu që, ai edhe në lutje apo raste fetare e njerëzore është hipokrit!

Në “postulatin” e tij të fundit Shaqir Fetai flet për atë se sa qenka e mëkatshme të shkrush apo të flasësh kundër tjetrit! E folura dhe shkrimet qenkan punë të djallit, ata që flasin e që shkruajnë kundër tjetrit qenkan persona të satanizuar, persona shumë të rrezikshëm, shumë të këqinj për shoqërinë.

Shaqir Fetai asnjëherë nuk flet kështu për veprimin, si akt, por, vetëm për shkrimet dhe të folmet! Mos janë punë engjëjllore ato veprime që i ka kryer Shaqir Fetai përgjatë jetës së vet e, sidomos, për këto 4-5 vitet e fundit! Ai që folë apo ai që shkruan, qoftë edhe në mënyrë tendencioze, sipas Shaqir Fetait, e turpëron veten! Po veprimet e Shaqir Fetait – cili ishte impakti i tyre? Mos e mori më qafë veten? Mos i bëri diçka keq vetëvetes? Me veprimet e veta Shaqir Fetai ka

marur më qafë shumë persona, ka djegur shumë familje, ka shkatërruar shumë jetëra, ka degjeneruar institucione e parime të shëndosha shoqërore e fetare! Të demaskohet Shaqir Fetai, qoftë përmes shkrimeve apo bisedave, është obligim fetar, është punë e shenjtë kombetare, është punë e njerëzishme.

Të gjithë ata që e kanë vënë në tapet të kritikave Shaqir Fetain e kanë një arsye: ta luftojnë të keqen, gjarpërin që e ka mbështjellë Institucionin fetar, munafikun më të madh që aktualisht ka shoqëria jonë. Kurse Shaqir Fetai shkruan “postulate” pikërisht për këta persona që e kryejnë një obligim fetar e kombëtar në zbrërthimin e karakterit të Shaqir Fetait.

Shaqir Fetai harron se dikur dhe sot është personi që ka folur dhe që flet broçkulla me të cilat pastaj ka djegur e shkatërruar shumë persona e familje. Veprimet e spiunazhit nuk kryhen pa e pasur të shfrenuar metodën e të folurit dhe të shkruarit! Publikisht e pyeti ish kolegu i vet, Nexhat Ibrahim, pse ka folur për të te oficerët e UDB-së dhe ia ka nxirë një jetë të tërë! E Shaqir Fetai hesht dhe, i lutet të gjithëve që ta kopjojnë në heshtje: me kokë nën shalë, të heshtin të gjithë. Pra, meqë hesht Shaqir Fetai, të heshtin edhe të tjerët që flasin e që shkruajnë për Shaqir Fetain!

Veprimet e Shaqir Fetait, të folmet dhe raportimet me shkrim të Shaqir Fetait, janë burime të pashtershme të portretizimit të (pa) personalitetit të tij, qoftë përmes të folmes apo të shkimit. Lapsat do të jenë të pashtershme, si dhe fjalët do ta kenë burimin e vet të bekuar për ta zbrërthyer këtë mahluk, i cili na tregon se sa qenka mëkat të flasësh e shkruash për Shaqir Fetain. Ky farë mahluku duhet të jetë i fundit, absolutisht i fundit, i cili ka të drejtë për të folur për mëkatin, sepse ai është vetë mëkati! Ajo që ka bërë ai, ajo që ka vepruar, që ka folur rrejshëm e spiunuar me lezet – është shtrati ku rritet mëkati. Kësisoj, Shaqir Fetai përveçse i shërben mëkatit, askujt nuk mund t’i shërbejë. Asnjë “kontribut” i tij nuk i hy në xhep askujt, madje as që i duhet dikujt. Do të shkruhet e do të flitet për Shaqir Fetain derisa të ndërgegjësohet e të shporret sysh! Meqë ky ndërgegjësim do të jetë i ngadalshëm e mbase edhe i pamundshëm, edhe ndalimi i shkrimeve dhe bisedat do të jetë i pamundshëm, sepse ky ndalim do të ishte mëkat dhe hapje shteg për të keqen dhe për të gjitha llojet e dështimeve. Myslimanët nuk janë të interesuar të dështojnë, prandaj do të flasin e do të shkruajnë drisa ta ndërgegjësojnë “satanain”.

Ndryshe, nuk do të na dojë Zoti!

***/IKlikLarg/27.01.2024/***

## ***Shaqir Fetai ka qejf të luajë “topa”***

***Shaqir Fetai, me rastin e inagurimit të Talat Xhaferit për Kryeministër Teknik i RMV-së, u iritua shumë nga fjalimi i Ali Ahmetit, sidomos në momentin kur tha se “Me Marrëveshjen e Ohrit” fituan të gjithë, fitoi edhe Kisha Evangjeliste, fitoi edhe Komuniteti Hebraik”! Po BFI-ja e Shaqir Fetai, a fitoi? Po, “trashtë e Sulës”, thonë kah Drenica!***

***Nga Saxhide Osmani***

Ali Ahmeti, publikisht pyeti: “Jeni me Rusinë apo me BE-në”! Ata që për momentin po japin shenja se janë në krahun e Rusisë, ata nuk iu gëzuan zgjidhjeve të Qeverisë Teknike! Nuk ishin as në votimin, as në urimin kolektiv kombëtar dhe as në ndarjen e gëzimit historik në mes të shqiptarëve me rastin e marrjes së detyrës Kryeministër Teknik të Talat Xhaferit! Mungoi edhe Shaqir Fetai!

Shaqir Fetai u iritua shumë nga fjalimi i Ali Ahmetit, sidomos në momentin kur tha se “Me Marrëveshjen e Ohrit” fituan të gjithë, fitoi edhe Kisha Evangjeliste, fitoi edhe Komuniteti Hebraik”! Po BFI-ja e Shaqir Fetai, a fitoi? Po, “trashtë e Sulës”, thonë kah Drenica!

Shaqir Fetai, si puro-filo-rus, mungoi, nuk ndau gëzimin historik me mikun e tij, Talat Xhaferin, të cilin e mori më qafë dhe desh ia nxii karrierën atëherë kur ia aranzhmoi takimin me delegacionin rus të Putinin. Iku nga momenti historik dhe shkoi diku, në një xhemat çergranas të Perëndimit që e paskan thirrë ta inagurojë “futbollin e vogël” që e paska inicuar xhemati i Çegranit.

Ku iku Shaqir Fetai!? Ç’paraqet “futbolli i vogël” për momentin aktual të BFI-së? Shaqir Fetai më me lezet do të merrej me “topa” se sa me problemet jetike që po vlojnë në BFI! Problemet nuk zgjidhen duke ikur prej problemeve! Problemet nuk marrin fund duke i mbuluar me plafin e çenit të zgjebosur dhe duke e argëtuar “njeriun e lumtur”!

Shaqir Fetai dhe “futbolli i vogël”! Me vete merr edhe “organet”

sa për të dëshmuar rrejshëm se “atje poshtë gjithçka është në rregull”; “ja, këtë e dëshmon edhe përkrahja që ma japin organet e mia e që më shoqërojnë gjithkund”!

Cilët “organe” i japin përkrahje Shaqir Fetait! Ata që i shantazhon natë e ditë? Ata që i ka të korruptuar, që i ka hajna profesionistë, që i ka injorantë të klasit të parë! Zatën, vetëm para këtyre kategorive Shaqir Fetai mund të paraqitet si “kapiten” i ekipit futbollistik që rrezikon rënien poshtë ligave lokale e amatore.

Shaqir Fetai ka probleme me Myftininë e Tetovës, me atë të Kumanovës, ka proleme me Myftininë e Shtipit, ka probleme me Myftininë e Strugës, me atë të Shkupit. Shaqir Fetai “nuk ka probleme” vetëm me ato “myftini” që i shpalli vetë ky, madje jasht parimeve kushtetutare të BFI-së! Shaqir Fetai ka probleme me Fakultetin e Shkencave Islame! Ka muaj që nuk ka shkelur në këtë vatër të lartë arsimore, sepse aty është Dekan njeriu që nuk e bën hesap as për kapacitet intelektual dhe as për kapacitet fetar! Megjithatë, Shaqir Fetai e ka obligim kushtetues që nëpër mbledhje të Fakultetit të ketë përfaqësues të Rjasetit. Por, ja që ky Rijasetin e ka privatizuar dhe e ka personalizuar kështu që, kush nuk është me Shaqir Fetain nuk mund të jetë as me Rijasetin!

Fakulteti i Shkencave Islame është ajka e intelegjencies fetare në Maqedoninë e Veriut! Është vatër e diturisë prej nga rrezaton dituri profesionale kjo ajkë e ulemasë! Shaqir Fetai i shantazhon këta profesorë dijetarë islam të Maqedonisë së Veriut! Nuk ka rritje rrogash për të tillët, thotë Shaqir Fetai. Shaqir Fetai i shantazhon madhje edhe i ofendon rëndë të gjithë ata që respektojnë punën e Dekanit aktual e që nuk i binden urdhërave hipokrite të Shaqir Fetait!

Shaqir Fetai vendos në emër të Rijasetit për dijetarët islam kulmor të Maqedonisë së Veriut! Janë një grup injorantësh që përbëjnë Rijasetin e Shaqir Fetait, i cili, vendos për fatin e FSHI-së por edhe për fatin e islamit në vend! Nëse i merr dhe i nxjerr në rresht, do të të bie damllaja nga ajo që do të shohësh: persona pa personalitet, pa qytetari, pa pikë kulture të përgjithshme, persona me servilitetin si të vetmin afinitet të tyre, persona me tru të atrofizuar, të karakterizuar nga injoranca e skajshme, persona të gatshëm që me dhunë ta mbrojnë kolltukun e pamerituar, persona që nuk dinë të të lidhin asnjë fjalë të urtë! E pra, të tillët do të vendosin për fatin e organeve dhe të institucioneve të BFI-së, gjithësesi, edhe për Fakultetin e Shkencave Islame në Shkup?

Shaqir Fetait i konvenon një situatë e tillë, sepse, po të mos ishin këta, para kujt ai do ta shprehte “tërë atë kapacitet intelektual” prej hipokriti që e posedon me bollëk?

Po të mos ishin këta, si do ta formonte ekipin futbollistik për të luajtur “topa” me, përgjithësisht, jetën fetare islame në vend! Shaqir Fetai ka qejf, madje vdes, për të luaj me “topa”!  
***/Politesa/29.01.2024/***

## **Vardisje e shpifur**

*Pse qenka antikushtetuese shkarkimi i Qani Nesimit ndërsa nuk ishte antikushtetuese shkarkimi i ish-sekretarit gjeneral hfz. Afrim ef. Tahirit? Edhe ky nuk u thirr në atë mbledhje famoze të Rijasetit siç nuk u thirr as Qani Nesimi me rastin e shkarkimit të tij! Po pse nuk ishte antikushtetuese dëbimi në mënyrë tinzare i Sulejman Rexhepit, i cili nuk u ftua në atë “rijaset” shkarkues?*

*Nga Shaban Aziri*

Problemet në Bashksinë Fetare Islame në RMV nuk kanë të sosur. Brenda heshtet ndërsa problemet që po e defaktorizojnë ditë e më shumë këtë Institucion, po shtohen. Së fundmi ka shpërthyer, deri në kufijtë e përlëshjes fizike, edhe problemi i Tetovës. Shaqir Fetai dëshiron që me çdo kusht të shkojë në vend ndëshkimi i tij që ia ka parapar Myftiut të Tetovës, Qani Nesimit, ndërsa ky, me çdo kusht përpiqet ta legjitimoj Shaqir Fetain si “reis”, madje edhe në këto ditë më të vështira për të. Si?

Qani Nesimi, po na del të jetë “luftëtarë i denjë” në mbrojtjen e kushtetutshmërisë së BFI-së, gjest ky që është kërkuar tash e katër vite, përmes qindra e qindra paraqitjeve publike të opononçës së shkelësve të Kushtetutës së BFI-së!

Qani Nesimi, është personalisht ai që e përkrahu fuqishëm Shaqir Fetain në tradhëtinë e madhe! Është vetë ai që, me përfshirjen e tij vullnetare në të qenurit kundër kandidatit i Shaqir Fetait, praktikisht ia legjitimoi tërë atë ngjitje antiligjore e antikushtetuese në karrierë!

Është vetë ky Qani Nesimi që, me mbi 100 imamë nga Tetova erdhi për t’ia uruar postin antikushtetues dhe jolegjitim Shaqir Fetait, dhe, për t’ia ligjësuar e legjitimuar tërë ato shkelje antikushtetuese e antiislame që i ndërmorën me instalimin e Shaqir Fetait në krye të BFI-së!

Qani Nesimi toleroi dhe përkrahu sërë veprimesh antikushtetuese,



antiprofesionale e antifetare, që i ndërmori Shaqir Fetai, madje akoma e toleron duke iu vardisur në mënyrë shumë të shpifur derisa i drejtohet “reisul ulema”, “letër reisul ulemasë”, “nuk i pranojmë vendimet e Reisul ulemasë se janë antikushtetuese”...

Kur u bënë këto veprime antikushtetuese? Po pse qenka antikushtetuese shkarkimi i tij ndërsa nuk ishte antikushtetuese shkarkimi i ish-sekretarit gjeneral hfz. Afrim ef. Tahirit? Edhe ky nuk u thirr në atë mbledhje famoze të Rijasetit siç nuk u thirr as Qani Nesimi me rastin e shkarkimit të tij! Po pse nuk ishte antikushtetuese dëbimi në mënyrë tinzare i ish Reisul Ulemasë Sulejman Rexhepi, i cili nuk u ftua në atë “rijaset” shkarkues?

Një organ i cili shkel Kushtetutën e BFI-së, ai organ suspendohet përkohësisht, ndërsa personeli drejtues i organit shkarohet pa më të voglën mëdyshje! Është konstatuar mijëra herë se Shaqir Fetai është subjekt jokushtetues, i instaluar në mënyrë antikushtetuese dhe person që natë e ditë e shkel Kushtetutën e BFI-së? Pse Qani Nesimi asnjëher nuk ia përmendi këto dukuri Shaqir Fetait por, sakaq, e paditi në momentin që këtij ia zuri bishtin me der? Tani, në rastin e Qani Nesimit “reisul ulema” e shkel Kushtetutën, e shkel iks nenin e kushtetutës, i shkel disa nene dhe, për më keq, Qani Nesimi edhe më tej i drejtohet me “reisul ulema”! Do me thënë e njuh për “reis”, por nuk ia njuh veprimet e tij të ndërmarra për shkarkimin e Qani Nesimit! Kjo përveçse që është hiporkizi e madhe, është edhe vardisje.

Të gjitha reagimet, komunikimet e Qani Nesimit bëhen me “reisul ulemanë”, apo me “kryetarin e BFI-së”! Qani Nesimi nuk është në gjendje që t’ia tërheq zyrtarisht përkrahjen e Myftinisë së Tetovës, ta tërheq votën që ia ka dhënë Shaqir Fetait, ta ngrijë përkrahjen ndaj BFI-së përderisa në krye të saj është njeriu antikushtetues, Shaqir Fetai. Ai duhet publikisht që ta ndërpresë bashkëpunimin me Shaqir Fetain, si dhe me të gjithë ata që bashkëpunojnë me Shaqir Fetain, përderisa nuk do të largohet nga posti i “reisit” që e ka uzupuar me ndihmën e subjekteve politike antikombëtare e antifetare dhe që po vazhdon ta zbatojë strategjinë e këtyre “përkrahësve” që më së paku kanë respekt ndaj BFI-së. Qani Nesimi nuk duhet ta njohë njeriun i cili vepron kundër Kushtetutës së BFI-së, dhe jo vetëm në rastin e tij! Qani Nesimi vazhdon ta njohë për “reis” po atë njeri që erdhi në mënyrë antikushtetuese, që vazhdoi në mënyrë antikushtetuese dhe që në mënyrë antikushtetuese po silltet edhe me rastin e Tetovës. Qani Nesimi i çon selame Shaqir Fetait: “hiç dor nga vendimi për të më larguar mua, se ti për mua ke qen dhe vazhdon të jeshë “reis”! Pra, sipas kësaj logjike, Shaqir Fetai qenka antikushtetues vetëm në rastin e Qani Nesimit! Një antikushtetues, mund të silltet në mënyrë

jokushtetuese, pse jo, edhe në rastin e Qani Nesimit, sepse vetë Qani Nesimi është katërcipërisht shkelës i Kushtetutës së BFI-së, që në momentin që Shaqir Fetait i drejtohet me “reis” dhe duke vazhduar me minimizimin e rolit të “rijasetit” dhe duke i dhënë peshë kushtetuese “organeve” formale që, fatkeqësisht, nuk janë të përfshirë në asnjë nen në Kushtetutën aktuale të BFI-së.

***/BotaSot/06.02.2024/***

## ***Pse dibranët e bojkotuan Shaqir Fetain***

***Në Dibër kurrë nuk mund të dëgjoshë të flitet për tradhëtarin, për spiunët, për njerzit e poshtër, për mynafikët dhe hipokritët. Kjo kategori personash nuk honepset prej dibranëve. Kurrë nuk i zënë ngojë por as kurrë nuk ua shprehin respektin, as edhe formalisht, sa për sy e faqe***

***Nga Adelina Pustina***

Shaqir Fetai, në Xhaminë e Sahatit, në qytetin e Dibrës, na paska organizuar një manifestim apo tribunë shkencore kushtuar Israsë dhe Miraxhit! Po pse pikërisht në Dibër? Kur për herë të fundit ishte në Dibër Shaqir Fetai? As vetë ai nuk e mbanë në mend! Nuk është kjo arsyeja se pse e bojkotuan dibranët, por, arsyeja është diku më thellë!

Në Xhaminë e Sahatit, në momentin kur doli të flasë Shaqir Fetai, nuk pati të pranishëm më shumë se 97 veta! Dibra me rrethin ka rreth 30 xhami, edhe atë: Xhamia Hunqar, Xhamia e Sahat Kullës, Teqe (Xhamia e re), Xhamia Bajram Beg, Xhamia Budullec, Xhamia Namazjar, Xhamia Konjare, Xhamia Krifses, Xhamia e fsh. Ame, Xhamia e fsh. Bajnisht, Xhamia e fsh. Spas, Xhamia e fsh. Sokollic, Xhamia e fsh. Konjare, Xhamia e fsh. Bomovë, Xhamia e fsh. Taranik, Xhamia e fsh. Otishan i Poshtëm, Xhamia e fsh. Otishan i Epërm, Xhamia e fsh. Xhepisht, Xhamia Kosovrasti i Epërm, Xhamia Kosovrastit i Poshtëm, Xhamia e Mogorçës, Xhamia e Broshticës, Xhamia e fsh. Gorenc -1, Xhamia e fsh. Gorenc 2, Xhamia e Ballancës, Xhamia në Qendrën e Zhupës, Xhamia Papraniku i madh e Paparnikës, Xhamia Papranik i Vogël, Xhamia e Bajramovcit, Xhamia e Zhitinenës, Xhamia e Breshtanit, Xhamia e fsh. Pralanik, Xhamia e Koxhaxhikut, Xhamia e Novakut, Xhamia e Elevcës, Xhamia e Dollgashës, Xhamia e Broshticës, Xhamia e fsh. Skudrinje Xhamia e fsh. Pristojnica Haxhi Demir, Xhamia e fsh. Vidushe, Xhamia e fsh. Rostushe e Re, Xhamia e fsh. Rostushe e Vjetër, Xhamia e fsh. Velebrod, Xhamia e fsh. Trebisht e Re, Xhamia e fsh. Trebisht e

Vjetër, Xhamia e fsh. Jances, Xhamia e fsh. Axhievs, Xhamia e fsh. Zhirovnic mahalla e Poshtme, Xhamia e fsh. Zhirovnic Qendër, Xhamia e fsh. Zhirovnic e Epërme etj.

Pra, në Dibër dhe rrethin ka një Myftini e cila mbulon një terren ku funksionojnë mbi 30 xhami, në të cilat janë të angazhuar, më së paku nja 30 imamë. Pa dyshim, ka edhe mualimë, ka vaizë, por ka dhe muteveli! Vetëm personeli i Myftinisë si dhe i xhamive të kësaj ane do të duhej ta mbushte përplot Xhaminë e Sahatit ku u turpërua Shaqir Fetai!

Shaqir Fetai u prit nga dhjetra qytetar, pothuajse nga asnjë hoxh Dibre dhe, xhaminë e mbushi kryesisht me shoqërues të vetë dhe me disa hoxhallarë që i kishte porositur me patjetër të vijnë nga qytete të ndryshme, sepse, mbase e ndjente (apo kishte informacin!!!) që do të bojkotohet prej dibranëve!

Po pse u bojkotua?

Tashmë është krjuar opinioni i realtë kritik për Shaqir Fetain, këtë “reis” partiak! Dibra ka nxjerrë burra, ka nxjerrë personalitete feare, ka nxjerrë personalitete kulturore, burrshtetas, shkrimtarë. Dibranët shquhen me mikrpietje që vështirë se e gjene nëpër vendet e tjera. Në Dibër, mysafirrit thonë: “Shtëpia është e Zotit dhe e mikut (mysafirrit)”! Në Dibër kurrë nuk mund të dëgjoshë të flitet për tradhëtarin, për spiunët, për njerzit e poshtër, për mynafikë dhe hipokritët. Kjo kategori personash nuk honepset prej dibranëve. Kurrë nuk i zënë ngojë por as kurrë nuk ua shprehin respektin. Me mospërfillje ua përcjellin mesazhin “nuk të duam”! Kaq! Dibranët nuk pranojnë të futen në debate e diskutime dhe t’ia mundësojnë spiunit e tradhëtarit që të legjitimohet. Thjesht, e injorojnë dhe e përcjellin ashtu edhe siç hy në Dibër “me bisht nën shalë”!

***/Kombetare/07.02.2024/***

## ***Stili komunikues i hipokritit***

***Hipokriti nëse kap një post, ai para masës drejtohet nga pozita e “zotit”, dhe kërkon të trajtohet ashtu siç ndjehet! Hipokriti mendon se i gjithë respekti shprehet për postin dhe jo për dijen! Hipokriti si nga pozita apo funksioni, ashtu edhe nga niveli i cinguar intelektual flet dhe komunikon me të njëjtin stil – flet me gjuhën e engjëllit në të cilin është i shpërfytyrë shejtani: nga goja është i ëmbël, e me zemër të prishur, në buzë ka mjaltin, kurse në zemër helmin***

***Nga Mumin Fazliu***

Asnjë veprim i hipokritit, sado që në dukje të parë mund të krijojë përshtypje se është islamikisht në rregull, nuk bëhet për Allah por, ekskluzivisht, për vetëlavdërim. Asnjë krijesë në botë nuk ka nevojë jetike për vetëlavdërim sa ka një hipokrit. Nuk e pret lavdrimin, sepse, thellë në shpirt e ka të qartë se nuk vlenë për pesë para, prandaj edhe lëshohet në vetëlavdërim. Hipokriti kur e portretizon veten, apo kur flet për vetitë e veta “të mira”, ai në fakt përçon sinjale se po bëhet gati ta “nxijë” tjetrin, apo, ta mohojë tjetrin, sidomos të devotshmin, prej të cilit i vjedh vlerat e padiskutueshme gjatë përshkrimit të vetes apo të “personalitetit” të vet.

pozicionimin e vet në klerari hipokriti e vlerëson si përcaktim nga Zoti, kurse zhveshjen e personalitetit të tij, lakuriqësimin e shpirtit të tij, e vlerëson si tendencë e gojëkëqinjëve. Mynafiku nuk e pranon se, si ngritja ashtu edhe tatëpjeta në karrierë “Të gjithë janë nga Allahu” (En Nisa, 78).

Pa dyshim, tërë kjo që u tha deri këtu para syve ua sjell të ashtuquajturin “reisul ulema” Shaqir Fetain! Ky far mynafiku, edhe urimet personale që i shpreh për “miqtë” e vet për ndonjë fejesë, apo syneti, edhe faljen e namazit të ndonjë xhenaze, edhe pierjen e çajit me ndonjë nga “bashkëpuntorët” e vet, mundohet ta paraqesë e ta shesë si “aktivitet i Rijasetit” dhe si “kontribut islam të reisul

ulemasë"! Dhe, insiston që tërë kohës të flitet dhe popullata të merret me të tilla "kontribute" e me të tilla "aktivitete" idiotike, që nuk mund t'i hynë askujt në punë përveçse hipokritit!

Ky farë prototipi i hipokritit modern, Shaqir Fetai, kohve të fundit me të madhe flet për ish-reisin e vet, H. Sulejman ef. Rexhepin. Flet dhe e "lavdron"! Flet për trimërinë e tij, për paluhatshmërinë e tij në sjellje të vendimeve, për rezistencën burrërore të tij karshi tendencave të partive për ndikime politike, flet për programet dhe projektet e tij dhe, këmbëngulë në atë se për Sulejman Rexhepin gjithnjë do të flasë mirë dhe me pietet!

Po pse Shaqir Fetai e hap këtë temë? Pse e përmend kohëve të fundit kaq shpesh Sulejman Rexhepin! Dikush do të mendojë se ka nevoj për ta folur të vërtetën për të? Jooo, sepse, prapa këtij nijeti të djallëzuar, fshihet e vërteta e cila Shaqir Fetain e lakuriqëson në hipokrit të vërtetë.

Shaqir Fetai me këtë stil të komunikimit që e ka zgjedhur së fundmi, ka nevoj që ta arsyetojë spiunimin, tradhëtinë dhe hipokrizin e vet të pafshehur! Flet mirë për Sulejman Rexhepin sepse sakaq duhet të jap edhe shpjegime se pse e tradhëtoi! Pra, duke dhënë sqarime mbi tradhëtinë, Shaqir Fetai përpiket që ta devalvoj vazhdimisht Sulejman ef. Rexhepin. Sepse, pas lavdërimit që ia bën, nis dhe ia renditë të gjitha "të metat" që i paska pasur ai: vjedhjen, bixhozin, kurvërinë, shkatërrimin e vakëfit, përvetësimin dhe ngritjen e pronave personale nga vakëfi, vjedhjen e fitrit, zeqatit, haxhit, familjarizimi i organizimit të haxhit dhe, të gjitha këto, e paskan nxitur që t'ia organizojë puçin! Dhe, sa herë që e pyesin se pse çdo veprim të Sulejman Rexhepit e kanë miratuar në Rijaset, se asnjëherë nuk ia kan tërhequr vërejtjen në Rijaset, se të gjitha procesverbalet e mbledhjeve të Rjasetit drejtuar prej Sulejman Rexhepit, mbajnë deklarata e vlerësime nga më pozitivet, se të gjitha deklaratat e Shaqir Fetait rreth personalitetit dhe veprimtarisë së Sulejman Rexhepit, janë vlerësime si për një burrshtetas që i ka munguar myslimanëve jo vetëm të Maqedonisë së Veriut por edhe tërë rajonit, Shaqir Fetai do t'ju prgjigjet se: vlersimet i ka dhënë nga frika! Po pse frikësohej Shaqir Fetai? Nga kush frikësohej? Kush e friksonte Shaqir Fetain prveçse frika se dikush do t'ia kuptojë para kohe tërë skenarin e djallëzuar të tij, të përgatitur nëpër laboratore të qarqve antishqiptare e antimyslimane. Shaqir Fetai po harron se, stilin e komunikimit që e ka zgjedhur, në fakt, vetëm sa po vetëzhveshet dhe po e demaskon veten prej hipokriti të panjohur më parë në mesin e myslimanëve të këtij nënqielli.

Është mëkat që nuk funksionon ndonjë komision etik në BFI dhe, me të zbuluar të elementeve të hipokritit në radhët e nëpunësve të

vet, sakaq të zhvishen nga të gjitha titujt fetar, sepse, Shaqir Fetait me këtë bagazh të hipokrizisë nuk guxon edhe më tej ta mbajë titullin as hafëz e as hoxhë. Bota nuk njeh asnjë “hafiz hipokriti” dhe as “mulla hipokriti”!

*/IKlikLarg/08.02.2024/*

## **Cili “myfti” po gënjenë më shumë**

“Myftiu” i emërtuar për qejfi të “reisit” inekzisten, Shaqir Fetait, u.d.-ja Selver Xhemaili i Tetovës, doli me informatën se sapo paska realizuar një takim me fiks “100 imamë” të Tetovës!!! Menjëherë i reagoi Myftiu aktual i Tetovës, Qani Nesimi se, këto ditë paska realizuar një takim me 250 hoxhallarë e drejtues të xhemateve të Muftinisë së Tetovës! Tani, nëse i mbledhim na dalin 350 hoxhallarë e përgjegjës të xhamive të Tetovës. Njëri prej “myftive” po gënjen! Ky numër “imamësh” i të dy “myftive” përbëjnë gati numrin e përgjithshëm të imamëve të punësuar në tërë territorin e Maqedonisë së Veriut!

“Myftiu” i Shaqir Fetait, Selver Xhemaili, paska realizuar takim me “100 hoxhallarë” të Tetovës, në një restorant dhe, të gjithë ishin pa shall, pa simbolikën e imamit të mirëfilltë. Po ashtu, edhe “myftiu” aktual, i shkarkuar sipas Kushtetutës së BFI-së por nga “reisi” a-kushtetues, kishte realizuar takim me imamlerët e Tetovës, në hapësirën e Myftinisë por që, që të gjithë ishin pa kurrfarë shenje imami!

Tani, “restorantet” e Xhemailit dhe “myftinitë” e Nesimit mund të mbushen edhe me plotë qytetarë të rëndomtë sa për një fotografi fallce! Prej nga i gjeti herë njëri e herë tjetri të gjithë ata imamë!? Mbase këta të Selver Xhemailit janë “imamë” të cilët nesër, me të larguar të Qani Nesimit, do të punësohen nëpër ato xhami imamët e të cilëve nuk do t’i jenë lojalë dhe për pasojë do të largohen nga puna? Po çka nëse do të shndërrohen në lojalë të pakompromis të Selver Xhemailit? Do me thënë që, këta “imamë” që ia mbushën restorantin, kanë shërbyer vetëm si prezervativë dhe se do të duhet të presin punësime në ditë më të mira!

Që t’i zbusin këto dilema, si Selver Xhemaili, ashtu edhe Qani Nesimi, do të duhet që takimet e radhës me imamlerë t’i bëjnë me po ata imamë që nuk ngurrojnë ta veshin xhuben dhe ta vënë shallin e të fotografohen, qoftë edhe si numër! Kësisoj do të kuptohej se kush po rrenë më shumë, ndërsa do t’ia mbyllnin të gjitha shtigjet e rrenës

edhe Shaqir Fetait, i cili, një karrierë të tërë e ka ngritur mbi rrenën, mbi tradhëtinë e spiunllëkun dhe, si njëri ashtu edhe tjetri, mos të shëndërrohen në vegël të lirë të rrenave dhe intrigave të Shaqir Fetait. BFI-ja duhet të dalë nga kthetrat e partive politike ku e ka futur Shaqir Fetai dhe, së fundmi, edhe Selver Xhemali! Ka vdekur më periudha e komunizmit i cili sigurinë e vet e shihte vetëm në komunitet fetare të robëruara!

***/LMR në BFI/18.02.24/***



# ***Shaqir Fetai po bën petulla në ujë***

## ***-Editorial i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI***

Në mbledhjen e fundit të gjysëm “Rijasetit” të Shaqir Fetait, të atij “organi kolektiv” që e devalvon tërësisht institucionin RIJASET, Shaqir Fetai na paska paralajmëruar një “boom” të madh aktivitetesh me rastin e muajit Ramazan! Që këtu, Shaqir Fetai mendon se do t’ia dalë që edhe agjërimin që do ta kryejnë myslimanët e vendit, sikundër edhe myslimanët anekënd botës, ta llogarisë si “aktivitet i Shaqir Fetait”!

Po cilat aktivitete do të mund të ishin ato që paralajmërojnë “boom”-in e këtij farë honxhobonxhoje i cili ia doli që pa kurrfarë kontributi politik e kombëtar, madje edhe me zero kontribut fetar, të instalohet si misionar partiak në krye të BFI-së. Po BFI-ja e mëparshme, ajo në të cilën Shaqir Fetai nusëronte si ato nusët që ia dalin të bëjnë petulla në ujë, a nuk zhvilloi aktivitete të ngjeshura fetare me rastin e muajit të agjërimit? Po organizimi i atyre mijëra promovimeve, debateve, ligjeratave fetare, po ato mijëra emisione e mijëra minuta në radio e televizione shtetërore e private, po ato qindra e qindra vizita të xhemateve të ndryshëm, po angazhimi i qindra e qindra medresantëve e studentëve nëpër xhematë të ndryshëm – a nuk ishin këto aktivitete të ngjeshura!

Shaqir Fetai mendon se BFI-ja ka nisur që kur ai u instalua politikisht në krye të këtij Institucioni nga subjektet që janë në perëndim e sipër!

Paska thirrur “rijasetin” e tij dhe aty e paska “diskutuar dhe rumbullakuar Programin e Muajit të Ramazanit” të cilin e paska përgatitur komisioni i posaçëm i Shaqir Fetait, por që nuk tregojnë se mbi cilin program paraprak u bazuan, nuk tregojnë se cilat do të jenë risitë e “programit” të sivjemë, të cilat nuk janë hasur në asnjë program paraprak të aktiviteteve të ndërmarrura përgjatë muajit të Ramazanit!

Në informatën mbi këtë mbledhje të “rijasetit” thuhet se aty “u

diskutuan dhe harmonizuan aktivitetet”! Cilat aktivitete? Si mund të harmonizohen aktivitetet, o avdalla!

Dhe, risia më e madhe na qenka se, në këtë mbledhje na qenkan dakorduar “datat për mbajtjen e manifestimeve qendrore për të shënuar datat më të rëndësishme gjatë muajit ramazan”! U dakorduan datat për të shënuar datat!!! Këtë “dakordim” mund ta bëjnë vetëm diletantët dhe sharlatanët e kryesharlatanit Shaqir Fetai! Boom aktivitetesh na qenkan edhe shënimi i Ditës së Bedrit, Natës së Kadrit dhe Netët Kuranore! Po pse këto ngjarje madhore islame a nuk janë shënuar edhe më herët ë! Duhet që të dakordohen datat për këto data!!! Dhe, krejt ky “dakordim” të llogaritet si “aktivitet i bujshëm”?!

Për çfarë aktiviteti të bujshëm flet përçarësi historik i BFI-së, Shaqir Fetai, ndërkohë që Myftininë e Tetovës e ka jashtë sistemit? Për çfarë aktivitetesh të muajit të Ramazanit mund të flasë Shaqir Fetai kur mungon në “planet e tij” një territor mjaft i rëndësishm i një Myftinie të cilës Shaqir Fetai i bie rrotull me lehtësinë më të përballeshme që mund ta imagjinojë vetëm truri jo i shëndoshë!

Shaqir Fetai përgatit dhe dakordon data e aktivitete pa Myftininë e Tetovës, apo, plani i tij është – bëje Zot sa më llugë! Dëshiron që, mundësisht, të zhvillojë aktivitete paralele dhe të shkaktojnë ndonjë përlëshje, ndonjë zënkë ndërvëllazërore, ndonjë rrahje e, mos dhënë Zoti, edhe vrasje, vetëm e vetëm që të shkojë në vend konstatimi i Shaqir Fetait se “tetovarët nuk e meritojnë më mirë”! Ky është “Programi” i Shaqir Fetait! Turp! Prej të marruarit vetëm marre do të presësh! Ishalla projektet e tij të djallëzuara dështojnë që në ditën e parë të muajit të rahmetit e të bereqetit! Amin!

***/Mileniumi3/21.02.2024/***

# ***A bëjmë humanizëm në emër të Zotit***

***Bashkësia Fetare Islame në RMV, kohëve të fundit, humanitetin e ka shndërruar në mjet manipulimi për ta “rregulluar” imazhin e vet të degjeneruar deri në përmasa të frikshme! Humaniteti a ka datë të caktuar kur duhet të kryhet? Apo, ky aktivitet bëhet vetëm kur duhet të rjepet populli, edhe ashtu, skajshmërisht i varfër***

***Nga Halid Sadiku***

Humaniteti është reflektim që vjen nga ndjenja, nga sensi, nga përkushtimi për të kryer vepra të mira në emër të Zotit Mëshirëplotë, për të ndërmarrë veprime që e zbusin dhembjen, trishtimin dhe vështirësitë që shkaktohen nga skamja, nga varfëria!

Në ajetin 271 të Sures El Bekare thuhet: “T’i jepni lëmoshat haptazi, është gjë e mirë, por t’ua jepni ato të varfërve fshehurazi, është edhe më mirë dhe ju shlyen disa nga gjynahet tuaja. Allahu e njeh mirë çdo vepër që ju bëni.”

BFI-ja e Shaqir Fetait parapëlqen që aktivitetin humanitar ta bëjë “haptazi”! Jo për ta kryer një porosi kuranore sa për ta arritur “mundësinë” e vetëlavdërimit. I duhet pak lavd dhe pak shpirt! Ndërsa aktivitetin e fundit humanitar e ka kryer fill pas muajit të agjërimit të vitit të kaluar (2023) me shpërndarjen e disa ton hurmave të ardhura “dhoratë” nga Arabia Saudite. Hurma pas iftari! Gjëja e fundit për të cilën kanë nevojë të varfërit tanë janë hurmat!

Bashkësia Fetare Islame e ka urdhër kuranor, e ka mision të domosdoshëm, madje edhe të detyrueshëm, aktivitetin human. Duhet që të ketë strategji, program se si ta mbajë gjithnjë të gjallë ndjenjën e humanitetit, të ndihmës, të zgjatjes dorë parreshtur drejt nevojtarit skamnorit; duhet të ketë plan veprimi, të ketë detyrë mbi detyrat ndihmën e përditshme për nevojtarët, për kategoritë më të rrezikuara sociale në shoqërinë tonë.

Shaqir Fetai e ka bërë trend që këtë aktivitet ta ndërmarrë dhe ta

“intensifikojë” vetëm përgjatë muajit Ramazan! Të manipulojë me të varfërit, por dhe ta ngacmojë si hajn ndjenjën e humanitetit të të pasurit! Në këtë muaj mblidhen edhe taksat fetare, si fitri dhe zeqati! Kur të shohin xhemati se sa “humanitet” po bëjnë këta të BFI-së së Shaqir Fetait, pse mos të japin fitër e zeqat! Me shtimin e sasisë së të hyrave nga këto dy taksa fetare, Shaqir Fetait edhe më shumë manipulon! Këtë shtim eventual të të hyrave e paraqet si “dashuri e zjarrtë” që na e paskëshin myslimanët e vendit për Shaqir Fetait, dhe jo si obligim fetar. Pra, ai ndjenjën humanitare të myslimanëve nuk e paraqet si ndërgjegjësim të tyre për të ndihmuar skamnorët por, e paraqet si “lojalitet të myslimanëve ndaj Shaqir Fetait”! Sa më shumë të hyra të mblidhen aq më e madhe përkrahja e myslimanëve për politikën degjeneruese të Shaqir Fetait!!!

Në fakt, nga fitri e zeqati Shaqir Fetait veçsa e siguron mundësinë për ta ngritur rrogën e vet e për ta bërë nja 8-9 mij euro, rrogë nga më të mëdhatë në rajon!

Këta të BFI-së së Shaqir Fetait mendojnë se humaniteti duhet të theksohet vetëm për Muajin Ramazan, mendojnë se njëmbëdhjetë muajt e tjerë nuk ka nevojë për humanitet, mendojnë se humaniteti bëhet vetëm nëse ke për të dhënë, kurse për të pasur gjithësesi që duhet të inicoshë aktivitetet për të tubuar ndihma të përditshme për skamnorët e vendit. Përderisa nuk tubon, nuk fton për të dhuruar ndihma, përderisa nuk merresh me sensibilizimin praktik të qytetarëve për të qenë në shërbim të të varfërve dhe skamnorëve, përderisa gati tërë vitin vetëm mrizon nën kënaqësinë e dreka-darkave që i ha si i babzitur, kjo do të thotë se nuk je i gatshëm dhe i disponueshëm për të kryer porosinë kuranorë dedikuar ndihmesës për të varfërit e skamnorët!

Po çfarë ndihme humanitare mund të zhillojë njeriu që me spiunazhë ka nxirë jetëra e ka varfëruar familje e gjenerata të tëra! Apo, tashmë po e ndjenë nevojën për t’u kthyer në Rrugë të Zotit! Por, ky kthim është i pamundshëm pa pendim publik! Zoti Mëshirëplotë në ajetin 160, të sures El Bekare, thotë: “Mirëpo atyre që pendohen, përmirësohen dhe tregojnë atë që kishin fshehur, Unë ua pranoj pendimin, sepse Unë jam Pranuesi i pendimeve dhe Mëshirëploti”  
***/Kombetare/27.02.2024/***

## **“Bisedat e lira” në BFI si dikur në polici”**

***Shaqir Fetai edhe një herë ka dëshmuar  
katërcipërisht se është gjallë i interesuar të  
shkatërrojë gjithçka që quhet Bashkësi Fetare  
Islame në RMV, e ngritur me shumë mund, me  
shumë djersë e me shumë urtësi nga personalitete  
të ndryshëm që ka pasur ky Institucion***

***Nga Arben Musliu***

Në faqen zyrtare të Shaqir Fetait publikohet një informatë me autorësi të këtij farë avdalli. Sikur të ishte i ndonjë shërbimi, po i ndonjë nga ata bilmesë që i ka, mbase edhe do të përtypej disi kjo informatë, por ama, të publikohet një hakaret i tillë madje me autorësi të njeriut që pretendon se është “ma i madhi në vend”, kjo vërtetë që është një alarm për të gjithë teologët e vendit: HAPNI SYTË SE JU HËNGËR NAMA E ZEZË!

Shaqir Fetai paska mbajtur një mbledhje me “rijasetin” e vet dhe, në një diskutim të lirë qenka konstatuar se “Bashkësia fetare islame edhe në vitin 2023 vazhdoi me suksese të larta duke tejkaluar vitin 2022 me 30%”!!! Natyrisht, ky konstatim del nga një “diskutim i lirë”, siç thotë havdalli, sepse sikur të ishte një diskutim serioz, prej njerëzve kompetentë e me minimum urtësinë e mirëfilltë të hoxhallarëve, konstatimi do të ishte se MJERISHT, KEMI ARDHUR NË NJË DEREXHE KU QË TË GJITHË NËPUNËSIT E BFI-së NDJEJNË TURP TË MADH QË TË DEKLAROHEN SE PUNOJNË NË KËTË INSTITUCION!

A ka nevojë BFI-ja për diskutim të lirë, për shërim të komplekseve të Shaqir Fetait, a ka nevojë BFI-ja për nëpunës që më së miri dinë t’ia fërkojnë Shaqir Fetait, i cili vdes për këtë “aktivitet”?!

Shaqir Fetai (ata që nuk e njohin) gjithnjë ka vuajtur për pak lëvdatë dhe, tashmë e ka me bollëk, tashmë ka krijuar “komunitet”, analfabetë të rënd funksional, të cilët as që dinë se çka është qasja kritike, as që e kutojnë se kritika është gjëja më pozitive që mund të

ndodhë, as që dinë t'i analizojnë dhe t'i zbërthejnë problemet, as që kanë guxim ta tregojnë të vërtetën e hidhur, sepse, pas kësaj dëshmie kritike që të gjithë do të duhet kokëulur e të poshtuar të ikin nga Institucioni.

Asnjë prej tyre, që mrizojnë nën hije e të pasmëve të Shaqir Fetait, nuk guxojnë ta pranojnë të vërtetën se në BFI kurrë nuk kanë qenë punët kaq katastrofë, madje as në kohën e mbretërisë jugosllave, e as në kohën e ideologjisë komuniste.

Kujt i shtet Shaqir Fetai dushk për gogla!? Si mund të jetë një vit shumë i suksesshëm i BFI-së në vitin kur janë shënuar tri rrebelime të anëtarëve të rijasetit të cilët kanë kërkuar që Shaqir Fetai, si dështak i shpifur, të ikë nga BFI-ja dhe, vetëm falë policisë shtetërore, ia doli që të mbetet në BFI?

Si mund të jetë BFI-ja e suksesshme kur dihet se tashmë ajo është një filiale e dobët e policisë shtetërore!

Si mund të jetë e suksesshme BFI përgjatë vitit 2023 kur dihet se Shaqir Fetai i largoi 8 anëtarë të Rijasetit, sepse, që të gjithë kërkuan shkarkimin e tij për dështime e keqdrejtim të Institucionit!

A u diskutua ky problem, a pyeti dikush dhe a u përgjigj dikush se si ndodhi shkarkimi njëherazi i tetë anëtarëve të Rijasetit?

Si na qenka shumëfish më e suksesshme se vitin 2022 kur dihet se më vitin 2023 nisën dhe kulmuan përçarjen fatale të BFI-së së Shaqir Fetait me Myftininë e Tetovës!

Si qenka e suksesshme BFI kur ky Institucion nuk ka qasje në mbi 500 xhami të vendit, nuk ka qasje në Fakultetin e Shkencave Islame; para Medresesë "Isa Beu" ka dalë si një rrence e papërmirësueshme në premtimet se "ose këtë të hënë ose atë të enjte do të akreditohet Medresja"...

Si mund të jetë e suksesshme BFI-ja e Shaqir Fetait në vitin kur kanë shpërthyer xhami private (për herë të parë në historinë e islamit në këtë nënqiell!); si na paska dalë e suksesshme në humanizëm kur përveç të disa hurmave si dhe do paketave që kanë arritur nga Turqia, aktivitet human përgjatë tërë vitit nuk ka pasur! Si mund të thuhet gëzueshëm se Myftinitë paska bashkëpunuar në mes vete! A mos paska pritur Shaqir Fetai që më vitin 2023 Myftinitë të shkëputen, ta ndërpresin bashkëpunimin dhe të shkatërrohet organi kolektiv i BFI-së, Rijaseti! Mbase kjo është strategjia e Shaqir Fetait, një Zot e di!

Sipas Shaqir Fetait, viti 2023 paska shënuar suksese të mëdha edhe në bashkëpunim me diasporën!!! E çka rezultoi në fund nga ky "bashkëpunim"?! Asgjë, me përjashtim të disa shëtitjeve klandestine të Shaqir Fetit, vjeljen e disa mëditjeve dhe paradhënieve gjatë shëtitjeve avantureske të tij nëpër "dynja"!

“Është kënaqësi kur secili vit është më i suksesshëm se viti i mëparshëm. Tashmë Rijaseti i BFI në çdo sferë po shënon aktivitete të nduarnduarta në sfera të ndryshme: fetaro arsimore, kulturore, shkencore, humanitare, bashkpunimit në mes të Muftinive dhe institucioneve relevante, qendrat islame në diasporë”, thotë avdalli, Shaqir Fetai!

Cilat na qenkan ato suksese në sferën e kulturës? A e di Shaqir Fetai se çka do të thotë kulturë dhe se çka përfshihet nën nocionin e kulturës? Po të shkencës? BFI-ja e Shaqir Fetait e suksesshme në shkencë?! Në arsim? Nuk prezantoi në asnjë mbledhje të këshillit arsimor të FSHI-së, ndonëse për një gjë të tillë e obligon Kushtetuta! Nuk debatoi për asnjë problem të kësaj vatre arsimore, nuk shprehu brengën për pozitën e mjerueshme të profesorëve, të stafit akademk. Jo që nuk arriti ta akreditojë Medresenë por nuk ia doli të sigurojë as kuota për regjistrimin e medreantëve nëpër ato fakultete ku kanë dëshirë, siç ishte në kohën e ish-reisul ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepit! Sukses e paskësh quajtur edhe pjesëmarrjen e tij si publik pasiv e i pagojë nëpër konferenca ndërkombëtare! Në asnjë prej tyre nuk foli, në asnjë prej tyre nuk ndikoi qoftë edhe me një rezolutë formale, nga asnjëra prej tyre nuk u kthye me ndonjë sukses për BFI-në! Sukses e quan vetëm daljen përtej Çegranit?! Shaqir Fetai qenka vizituar pandërprerë nga kori diplomatik? Me këtë do me thënë se, jo vetëm që po e duan njerëzit e brendshëm (pa dyshim, të Punëve të Brendshme) por, po na e dashka edhe kori diplomatik! Madje po e vizituakan pa ndërprerë! Kjo është rrenë nga e cila nuk ndjehen mirë përfaqësuesit e korit diplomatik!

“Muftitë, drejtorët, imamët, mutevelitë dhe besimtarët po e vërtetojnë për çdo vit vigjilencën e tyre në shërbim të Islamit dhe organizimit të jetës fetare, në veçanti ndaj Medresesë Isa Beu në Shkup dhe degëve të saja në Shkup, Tetovë dhe Gostivar”, thotë mjerani!

Kjo vigjilencë asnjëherë nuk ka munguar, madje kurrë dhe, nuk ka nevojë që të na shpjegojë Shaqir Fetai se imamët qenkan në shërbim të islamit! Po, nëse ai është mësuar që si “imam” të jetë në shërbim të policisë (sidomos të UDB-së), atëherë, po, i arsyetohet habija që imamët e mualimët qenkan në shërbim të islamit! Por, “të drejtuar” nga Shaqir Fetai sa po ia dalin që të kenë ndikim te xhemi? Zero ndikim! Madje, me rezultate shumë negative, sidomos sa i përket arsimimit në Medrese! Kur ka qenë numri më i vogël i nxënësve dhe i studentëve se sa në kohën e Shaqir Fetat? Në paralelen e femrave në Gostivar për vitin akademik 2023 u regjistruan vetëm pesë medresante! Kjo i duket sukses Shaqir Fetait? Apo, ky sukses

konsiston në atë që edhe sivjet u siguroa “grupi” të cilit do t’i ligjërojë e bija e Shaqir Fetait, si profesoreshë! Tashmë është e njohur se, Shaqir Fetai, të gjitha dështimet dhe katandisjet i llogarit “suksese” që tejkalojnë ato të vitit paraprak!

Krejt në fund, të theksojmë se, thellë në vete Shaqir Feai e ndjenë se punët i ka m..., se punët i ka bërë llugë; intimisht ndjenë se është i paafte për të drejtuar një Institucion jetik për shoqërinë e gjërë; e ndjenë se është i paautoritet, i papersonalitet, se është i parespektushëm, se është i padëshirueshëm, se është marionetë e policisë, e partive politike që kanë ndikim të madh në polici; thellë në vete e ndjenë se po sharron gjithnjë e më thellë në gropën të cilën e hapi vetë dhe nga e cila nuk ka shpëtim, ndaj dhe ka nevojë për “biseda të lira” në të cilat do të idealizohet “si i suksesshëm” dhe “biseda të lira” këto që do të shoqërohen me komente nga komentues të clët porositen që ta thonë një fjalë të mirë. Sepse, Shaqir Fetai vdes për një fjalë të mirë, e cila mund të dëgjohet vetëm në “biseda të lira” (si dikur në policinë serbe) nga njerëz që profesion parësor kanë fërkimin e “boçeve” të kandarit me kurdisje policore!

***/Gazeta/02.03.2024/***



## ***Në cilin mulli po e çon ujin Shaqir Fetai***

***Para do ditësh lexova një shkrim me titull “Shaqir Fetai po bën petulla në ujë”! Le të bëjë! Nuk ka asgjë të keqe, por, megjithatë, një e keqe ekziston: kujt po ia bën këto petulla? Vetes? Apo popullatës muslimane të vendit? Cili “shëf guzhinë”, po e mëson Shaqir Fetain për të na bërë “petulla” që nuk do t’i hante asnjë gjë e gjallë***

***Nga Jasir Jashari***

Po i afrohemi Muajit të shenjtë të Ramazanit me një atmosferë shumë të zymtë, të cilën po na e rëndon edhe më shumë perceptimi i gabueshëm që tashmë e kemi krijuar për fenë dhe për jetën fetare islame në vend!

A është gjithçka në rregull me jetën fetare islame në vendin tonë, në Maqedoninë e Veriut dhe, a është kjo jetë ajo të cilën po mundohet të na e imponojë “imperatorit” qesharak, Shaqir Fetai?

A mundet që me gënjeshtër e me vetëlavdërime të krijohet një imazh që do të pranohej prej të gjithëve?! Natyrisht që jo, sepse, një imazh i tillë do të dilte karikaturë e gjallë e një hipokrizie të cilën masa e gjërë nuk mund ta durojë!

Po del që cilësimi aktual me të cilën po tipizohet Shaqir Fetai është ai i vetëlavdëruesit të shpiftë (të gërditshëm)!

### **Humanizmi nuk bëhet as për inat dhe as me inat**

Dy-tre ditë më parë, në disa portale të vendit, dhe jo vetëm, u botua një shkrim tjetër që fliste për nivelin e turpshëm dhe të mjerueshëm humanitar të Shaqir Fetait dhe të “institucionit” që po e drejton ai! A mund të lavdërohet dhe të theksohet “sensi human” duke iu shpërndarë të varfërve hurma pasi të ketë kaluar Ramazani!

A mund të lavdëroresh se je “institucion human” me faktin që pranon rolin e servisimit të ndihmave humanitare që vijnë nga Turqia! Po, je i përfshirë në humanitet, por tërë ky aktivitet nuk guxon të përvetësohet dhe, ndihmat e huaja, për të cilat është zhvilluar aktivitetet në rang kombëtar të Turqisë, të përvetësohen e të paraqiten si “kontribut i reisul ulemasë”! Si guxon që në “teksturën” e Shaqir Fetait të publikuar në fb-un e vet zyrtar, të thuhet: “Bashkësia Fetare Islame përmes O.H. Hilal ofron për besimtarët tanë që janë në gjendje të rëndë ekonomike”! Po çka ofron? Kur ofron? Si e siguroi atë që e ofron? Cili është angazhimi konkret në terren për grumbullimin e asaj që e ofron? Kjo që e ofron, a është permanente apo aksidentale, “sezonale”, një herë në vit, sa për propagandë për ta ngacmuar pak sensin për fitër e zeqat që i duhet Shaqir Fetait si oskigjeni për të sëmurin nga hasma!

Pastaj, Shaqir Fetait shton fjalinë: “Reisul Ulema falënderoi Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfit të Republikës së Turqisë e cila me vite të tëra në bashkëpunim me BFI-në realizojnë aktivitete humanitare”! A nuk është kjo një gënjeshtëri e terrshme që shprehet sa për t’u ngjitur në podiumin e vetëlavdrimit? Po si Vakëfi i Turqisë në bashkëpunim me BFI-në e Shaqir Fetait po e realizuaka këtë aktivitet human? Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfit të Turqisë i ka mekanizmat e veta, e ka rrjetin e vet, i ka mjetet dhe metodën e grumbullimi të ndihmave që shkojnë me miliona tonelata dhe që pastaj po kjo Drejtori, nën shpenzimet e veta, i distribuon ato ndihma anekënd botës! Tutje, shpërndarja e tyre deri te myslimanët e varfër bëhet përmes “bashkëpunëtorëve servis”! Sa pra, BFI-ja e Shaqir Fetait u angazhua në këtë akcion humanitar të Vakëfit të Turqisë? Hiç fare! Prandaj, nuk është islamikisht në rregull që të grabiten, mudi, përpjekja dhe shpirti islam i të tjerëve! Vetëm një hipokrit dhe një nevojtari i verbër për vetëlavdërim, si Shaqir Fetait, mund të thotë: “z. Juksel Onder, falënderoi dhe uroi Reisul Ulemanë dhe BFI-në për angazhimin dhe kujdesin që tregojnë për familjet e varfra”! Cili është ai kujdes dhe ai angazhim që na e paska treguar Shaqiri bashkë me “BFI”-në e vet për familjet e varfëra? Kur këto familje janë të varfëra dhe kur duhet të shprehej ai kujdes ndaj tyre? A janë të varfëra vetëm një herë në muaj, një herë në sezonë apo një herë në vit? A mund të ndodhë që këto familje zakonisht varfërohen në prag të Ramazanit atëherë edhe kur duhet të ndihmohen! Dhe, në fakt, cilat janë ato familje që ndihmohen? Në Maqedoninë e Veriut numri i familjeve të varfër është me mijëra e mijëra dhe, a ndihmohen të gjithë apo vetëm ato “familje të varfëra” që përzgjidhen prej “aktivistëve humanitar” të Shaqir Fetait?

## **Mysafirët që vijnë për ta lavdëruar Shaqir Fetain**

Shaqir Fetai, në zyren e vet të pamerituar tashmë ka bërë traditë që të presë e të përcjellë njerëz që shprehin dëshirë dhe gatishmëri për ta pirë një çaj me të! Se cila është ajo kënaqësi e pirjes së çajit me Shaqir Fetain këtë mund ta dijnë vetëm ata që kah moti kanë ngelur pa integritet! Në vazhden e kësaj “tradite të sëmurë” po viijnë njerëz të cilët po kontribuojnë në bërjen “traditë” të një vesi të sëmurë: vetëlavdërimin e Shaqir Fetait! Sepse, secili mysafir që hyn në atë zyre të uzurpuar, po hyka me nijet për ta thënë një lëvdatë të panjohur për Shaqir Fetain? Nën drejtimin e tij po na lulëzuaka BFI-ja dhe po na u avancuaka jeta fetare në Maqedoninë e Veriut!!!

Paskan ardhur një grup profesorësh të një Universiteti të Stambollit dhe na qenkan mahnitur me ”mrekullitë” e Shaqir Fetait, ndaj edhe na e paskan ftuar që ta vizitojë Universitetin! Ndërsa ky mjerman ka më shumë se një vit që hala nuk e ka vizituar Fakultetin e Shkencave Islame, sepse ka frikë që profesorët e vet do ta injorojnë, bash ashtu siç e meriton!

Shaqir Fetai në fb-un e vet zyrtar na shkruan: “Në anën tjetër Dekani Yılmaz duke vlerësuar lartë kontributin e Reisul Ulema H. Hafiz Shaqir ef. Fetai, në drejtim të menaxhimit, administrimit dhe avancimit të Bashkësisë Fetare Islame të RMV-së dhe të jetës fetare në përgjithësi, potencoi se rezultatet e këtij menaxhimi tanimë janë temë bisedash edhe në qarqet tona.” Na del puna se dekanit turk që nuk paska kurrfarë angazhimi tjetër përveçse të përcjell menaxhimin dhe administrimin “e Shaqir Fetait qe e paskan avancuar” BFI-në! Paramendoni, Turqia nuk paska se me çfarë përveçse me temë “sukeset e Shaqir Fetait”! Çka është kjo nëse jo vetëkënaqësi, masturbim shpirtëror i një të dështuari, një të shpifuri, një hipokriti të rrezikshëm.

Po atë ditë, kur këta profesorë turkë që nuk kanë të bëjnë asgjë me Bashkësinë Fetare Islame në RMV paskan vizituar Shaqir Fetain, të njëjtin e vizituan edhe një grup i konsiderueshëm i hoxhallarëve nga Tetova, të cilët e demaskuan “konstatimin turk” se, Shaqir Fetai po na e avancuaka jetën fetare në RMV!!!

## **A e merituan hoxhallarët injorimin e Shaqir Fetait**

Në BFI-në e Shaqir Fetait ia mësynë një grup i konsiderueshëm i hoxhallarëve tetovarë, të cilët kishin ardhur për ta dorëzuar një peticion të mbi 200 teologëve dhe këshillave të mbi 60 xhamive të Tetovës, të cilët kishin kërkuar që, në njëfarë forme, të gjendet një

solucion, një zgjidhje alternative, të paktën deri sa të përfundojë Muaji i Ramazanit si dhe zgjedhjet e përgjithshme parlamentare dhe presidenciale në vend! Shaqir Fetai i kishte injoruar tërësisht, madje “i kishte pritur me mospërfillje”! Shaqir Fetai, jo që po e dëmton vetëm BFI-në me këtë sjellje prej misionari, porse, ia ka mësyrë që ta dëmtojë shumë fort edhe vetë BDI-në si dhe pushtetin aktual (LSDM-BDI) të cilët edhe e sollën në krye të BFI-së! Pra, 65 xhami, po kaq imamë, po kaq mualimë, po kaq hatibë, janë po kaq “mediume” që, në prag të zgjedhjeve të 8 majit, mund të luajnë rol jetik në propagandën qoftë fituese qoftë humbëse! Atëherë, në mullirin e kujt po e çon ujin Shaqir Fetai? A mos po angazhohet Shaqir Fetai që mulliri i BDI-së të ngelë shterp, pa pikën e ujit?!

Të të vijnë në zyre një grup i konsiderueshëm i hoxhallarëve, si përfaqësues i pjesës dërmuese të xhimateve të Tetovës, kjo pa dyshim që do të llogarritej ngjarje e ditës, ngjarje e muajit, ngjarje e vitit dhe, si e tillë, gjithësesi që do të duhej të shënohej! Këtë ngjarje kaq të rëndësishme Shaqir Fetai e injoroi, siç i injoroi edhe hoxhallarët që kishin ardhur me një mision shumë fisnik – qetësimin e situatave të pakëndshme në momentin e dhënë! Këtë ngjarje Shaqir Fetai nuk e shënoi, nuk e regjistroi, nuk e publikoi!

Dhe, këta hoxhallarë na qenkan befasuar me sjelljen e Shaqir Fetait! Mbase më në fund u bindën se Shaqir Fetai është kundër të gjithë atyreve që nuk i përuken deri nën shuall të këpucëve të baltosura! Shaqir Fetai do të ishte kundër çdo hoxhe, kundër çdo muderrizi, kundër çdo teologu, kundër çdo subjekti, këshilli, kundër çdo institucioni, kundër çdo personaliteti që do t’ia numëronte dështimet, rrenat dhe pasojat e paaftësisë së tij për të drejtuar një Institucion si BFI-ja! Shaqir Fetai e di shumë mirë se nuk ka BFI të shëndoshë pa ish-sekretarin e përgjithshëm, h. Afrim ef. Tahirin. Vërtet, pse nuk kërkon dhe pse nuk pranon Shaqir Fetai që të ulet me efendi Tahirin për ta nxjerrë BFI-në në binare të shëndosha dhe për ta shpëtuar nga ky degradim e shkatërrim që do ta ketë vetëm një emër – Shaqir Fetai! Nuk ulet Shaqir Fetai, sepse dikush nuk e lë që BFI të stabilizohet, mbase nuk është në planet e tyre një BFI stabile dhe unike! Nuk e lë dikush apo nuk do vetë Shaqir Fetai? Kjo dilemë tashmë është shumë e qartë!

***/TS/06.03.2024/***

## ***Pse Shaqir Fetai i fryen skandaleve***

***Shaqir Fetai kur ngelë pa tema, pa arsye për të publikuar ndonjë “lajm”, ai sillet si pacienti pa oksigjen, apo si tjetri pa mend! Shkurt e shqip – çartet!***

***Nga Vildane Qamili***

Shaqir Fetai nuk është dhe as që ka këllçe të jetë ashtu siç ka qejf ai: autokrat, diktatorçiq, njeri i dhunshëm, njeri i pushtetit policor që nuk pjerdhë për asgjë!

Shaqir Fetai as që e kupton se çka do me thënë teknokrat, as burokrat, as autokrat, as diktatorë, as pushtet. Shaqir Fetai është, thjesht, servil, është hipokrit i llojit të vet, është specie që është stërvitur për ta ruajtur b... e vet!

Shaqir Fetai ka dëshmuar se është i pamend, se është vegël adaptabile për çdo dorë të pistë, por, edhe se është “ekspert” i sajimit të “lajmeve” me qëllim për të qenë “ylli i opinionit”; ai është në gjendje që të durojë shqelëm apo hu b... vetëm e vetëm që të bëhet një lajm që do të perceptohet si “aktivitet” i tij.

Sëkëndejmë, Shaqir Fetai përçarjen në BFI, acarimin e raporteve deri ne konflikt fizik në Myftininë e Tetovës nuk e bën sepse na qenka ndonjë farë “autokrati”, apo diktatori! Ai këtë degradim të BFI-së e shkakton vetë, sepse nga kjo situatë e pistë kërkon të përfitojë, të paktën, vëmendje publike.

Shaqir Fetai ndjehet i vetmuar, si në shoqëri ashtu edhe në shkelje ortodokse kushtetutare! Shaqir Fetain e trishton deri në çmendri ky izolim që i është bërë nga të gjithë faktorët. Shaqir Fetai është si ujku që kërkon mjegull për të ardhur deri te gjahu i tij! Shaqir Fetai tashmë po i pret dy përfitime: njërin do ta “mbajë” sekretet e tjetrin do ta publikojë!

Shaqir Fetai pret të ndërhyjnë faktorët e jashtëm për pajtim të

situatës! Faktorin e brendshëm (hoxhallarët e Tetovës) tashmë e injoroi!

Shaqir Fetai ka kohë që ndjehet i braktisur nga faktori politik, BDI-ja, që e instaloi gabimisht në krye të Institucionit! Madje ai tashmë e di fort mirë se pikërisht strukturat më të larta partiake u kanë dhënë leje “puçistëve” që nëse i kanë numrat t’i hynë procesit të largimit të Shaqir Fetait. Ai po e shkakton këtë situatë të pistë pikërisht në prag të zgjedhjeve, i bindur se kjo do ta faktorizojë te BDI e cila do të shkojë tek ai për të kërkuar ndihmë për t’i fituar zgjedhjet! Shaqir Fetai vazhdimisht po thotë “vjen cjapi te kasapi”! Ai veçmë ka filluar të agjitojë dhe të kërkojë nga “hoxhallarët” që të rrinë gati dhe, kur t’iu japë shenjë Shaqir Fetai, të gjithë të angazhohen në shërbim të BDI-së. Pra, ky angazhim i hoxhallarëve varet nga shenja e Shaqir Fetait, ndërsa shenja pozitive do të varet nga përulja e strukturave të BDI-së para këmbëve të tij si dhe nga gatishmëria partiake për ta përkrahur Shaqir Fetain për të qëndruar deri në vdekje në krye të BFI-së! Aktualisht, strukturat partiake nuk janë të bindura se Shaqir Fetai mund t’ua sigurojë votat e katundarëve të tij në Çegran.

Dhe, përfitimi i dytë, të cilin Shaqir Fetai e pret nga kjo lojë e pistë me dinjitetin e hoxhallarëve të Tetovës, lojë këtë që po e luan deri në acarim të raporteve me pasojë të fraktionimit, të fragmentarizimit e të përçarjes fatale të BFI-së, pas së cilës, dukuritë edhe më fatale do të jenë të pashmangshme dhe përfundimisht të pakontrollueshme, pra, përfitimi që e pret nga kjo zallamahi, është shtimi i interesimit nga faktorët e jashtëm, nga diplomatët, nga ambasadorët! Shaqir Fetai vdes që të vizitohet nga ambasadorët dhe që t’i vizitojë ata! Natyrisht, gjithmonë kur në BFI ka pasur turbulenca, interesimi i korit diplomatik për informata burimore dhe institucionale ka qenë i shtuar. Pra, tani Shaqir Fetai pret që para kabinetit të tij të presin radhe-radhe diplomatët që do ta “vizitojnë” e qe do të flasin fjalë miradie për “lidërsipin dhe koperivitëtin” e tij! Ndërkombëtarët do të angazhohen për zgjidhje, për rrugëdalje, për qetësim të situatës, ndërsa Shaqir Fetai i intereson vizita e tyre, qoftë kjo e cytur edhe nga situatat ekstremisht fraktioniste, të cilave po u frynë Shaqir Fetai!

***/Fakte/07.03.2024/***

## ***Iftari i Shaqir Fetait për pushtetin aktual***

***Me paratë e myslimanëve, me paratë e fukarave,  
me paratë e djersës të dhënë fitër e zeqat,  
Shaqir Fetai shtron iftar për pasanikët e për  
jomuslimanët, për atesitë e për komunistë. Kaq e  
padhimbshme është paraaja të cilën besimtarët e  
japin për zhvillim të jetës fetare islame?!***

***Nga Sihana Sulejmani***

Shaqir Fetai vazhdon me këmbëngulje që të krijojë një traditë të çoroditur, të keqe e shumë të poshtër: të shtrojë iftar për njerëz të pasur, për qeveritarë e për njerëz të pushtetit. Madje thotë se iftari i tillë na paska “simbolikë domethënëse”! E po përveçse simbolikës së falënderimit për të gjithë ata që e instaluan në krye të BFI-së tjetër simbolikë nuk mund të ketë. Është iftar i nëpërkëmbjes së dinjitetit të myslimanit të varfër e të ngratë, është iftar i nëpërkëmbjes së dinjitetit të hoxhallarëve të vendit që janë të vetmit meritore për zhvillimin e islamit në vend, si dhe, është iftar i përçarjes, i refuzimit të opozitës për shkak se ia lodhin elementet e pushtetit që e lëshuan si parashutë në krye të Instituconit fetar islam në vend.

Po ku i merr Shaqir Fetai të gjitha ato lekë për ta paguar një iftar gllamuroz që ua shtron pushtetarëve, priftërinjëve, atrestëve, komunistëve, si dhe ndonjë hoxhe që është binaku sijamez i tij në veprimtari policore, i cili pranon të ftohet në iftar pa hoxhallarët tjerë pleq të cilët janë njëmilionia herë më kontribues se sa Shaqir Fetai në islam! Ku i merr paratë për ta paguar iftarin e qindra të ftuarve me meny prej më së paku 20 euro për person!? Kur ua kërkoi paratë myslimanëve të vendit, a u tha të kontribuojnë për mirëmbajtjen e Medresesë, apo për iftar të pushtetarëve të cilët as që kanë bërë hapin më të vogël për ta akredituar Medresenë?

Pse në këtë iftar mungoi kandidati për president, Arben Taravari? Pse mungoi opozita e qeverisë së kryeministrit teknik shqiptar, Talat Xhaferi? Kënaqësi e madhe për Shaqir Fetain që paskan marrur pjesë

në iftar dy dekanë të uiversiteteve shqiptare në Maqedoninë e Veriut!  
Ndërsa nuk i ka ftuar dekanët e Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup!

Mbi dhjetë mij euro iftar, të cilin Shaqir Fetai nuk e paguan nga xhepi i vet por nga arka e BFI-së! A ka keqpërdorim më të mëdh se ky fakt? Po pse Shaqir Fetai nuk e shtron një iftar të tillë gllamuroz për nja 3-4-500 të varfër nga tërë vendi? Pse nuk e shtron një iftar të tillë për të gjithë hoxhallarët e vendit, të cilët, natë e ditë japin kontribut për zhvillimin e fesë islame, të cilët natë e ditë i ftojnë e i lusin si lypësa myslimanët që fitrin dhe zeqatin ta japin në BFI, aty ku pastaj Shaqir Fetai e keqpërdor duke ua shtruar “darkën tradicionale” qarqeve që u bënë sebeb që ai të vinte në një vend në të cilin, në kushte normale, as që guxonte ta ëndërronte veten në atë pozitë!

Shaqir Fetai, në emër të “rijasetit” të vet është dashur që të hap disa guzhina popullore ku do të hanin iftar të varfërit e vendit, një muaj rresht dhe, në fund, as që do të shpenzonte aq sa shpenzoi për iftarin e shtruar për pushtetarë e të pasur të cilëve as që u bën veshi “tërrt” për të varfërit e vendit.

Pas kësaj tradhëtie që ia bën parasë së myslimanëve të vendit, a ka fytyrë Shaqir Fetai që po këtyre myslimanëve t’ua kërkojë fitrin dhe zeqatin? Apo do t’i joshë me hurmat e Arabisë Saudite që na qenkan dhuratë e siguruar nga servilizmi i ulët i Shaqir Fetait që ia shpreh dhuruesve të hurmave pa të cilat edhe mund të shtyhet krejt Ramazani! Apo, siç e ka qejf të tallet Shaqir Fetai duke thënë: “ai që çel iftar me hurma, fitrin e ka më të lartë”! Turp!

***/IKlikLarg/15.03.2024/***



## **Gënjeshtria e radhës e Shaqir Fetait**

*Kur është në pyetje kredibiliteti, autoriteti dhe interesi personal i Shaqir Fetait, ky nuk e ka për problem që të gënjejë madje edhe mu në mës të Muajit të Agjërimit; nuk e ka për dert që të heq dorë nga parimet e besimit të vet dhe të vihet në funksion të propagandës së ulët partiake*

*Nga Valbon Osmani*

Dikush i ka premtur Shaqir Fetait duke e frymëzuar që të gënjejë në të mirë të partisë sepse, vetëm nëse partia ngelë në pushtet ai mund të vazhdojë me “reisllëkun” e grabitur tinëzisht dhe me tradhëti. Do me thënë që, Shaqir Fetait, po e ndjenë që lojërave të tij të pista po i vie fundi, pandaj, ka nevojë për premtim, të cilin e siguron në këmbim të vënies në shërbime që aspak nuk kanë të bëjnë me interesat e përgjithshme myslimane e aq më pak me fenë islame.

Rrena e radhës e Shaqir Fetait ishte se, në mbledhjen e fundit të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, mbajtur më 26 mars, qenka vendosur të akreditohet “Medresja Isa Beu”, dëshirë kjo e kahershme e të gjithë myslimanëve të vendit.

E para, në asnjë rend të ditës së kësaj mbledhje të Qeverisë nuk është bërë fjalë për akreditim të Medresesë (këtë e dëshmojnë edhe ministrat e tjerë). Veçse nëse nuk e kanë vendosur korridoreve të qeverisë kryeministri teknik dhe ministri i arsimit!

E dyta, ky vendim “qenka sjellë” në ditën kur u shtrua një iftar edhe për veteranët e UÇK-së! Meqë kështu paska mundësi të veprojë kryeministri teknik, po pse nuk solli vendim për pensione të veteranëve të UÇK-së dhe këtë vendim t’ua kumtonte në çastin e iftarit?

E treta, çështja e akreditimit nuk është kompetencë e kryeministrit teknik, nuk është kompetencë as e kryeministrit “fuqplotë”, madje as e kryetarit të shtetit! Shkollat e mesme në Maqedoninë e Veriut janë të lidhura me Kushtetutën, me Ligjin për arsimin e mesëm, shkollat

fetare me Ligjin për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze, pra, i përket Parlamentit të Maqedonisë së Veriut, i cili, më përpara do t'ia dilte ta akreditojë “Bogoslllovinë” se sa Medresenë!

E katërta, shkollat e mesme fetare janë profesionale dhe prodhojnë kuadër teologjik për bashkësitë fetare respektive. Shteti i përcaktuar me Kushtetutë si shtet laik, e ka shumë të vështirë që të ndërhyjë në këtë aspekt pa e ndërruar Kushtetutën. Nuk mundet që shteti laik të prodhojë kuado fetar!

E pesta, pushteti, për t'i përforëuar pozitat e veta edhe për një mandant, ka kërkuar angazhim konkret nga Shaqir Fetai. Ndonëse e dinë që autoriteti i tij ka rënë për toke, atëherë, ja, pushteti, ia jep një “joker” në dorë dhe kërkojnë që të rrejë shlrishëm, sepse, të gjithë mendojnë se kjo temë është mjaft sensitive dhe se mund të kalojë nën një eufori që duhet ta përgatisë Shaqir Fetai. Dhe ky del dhe rrenë ashfaqare, ju thotë medresantëve “urime, u akreditua Medresja”! Ky akt nuk është gëzim personal i Shaqir Fetait, sepse, i përke mbarë myslimanëve të vendit, të cilët, pa dyshim, nëse do t'i besonin Shaqir Fetait, lajmin do ta shndërronin në “festë popullore”! Madje, kësaj gënjeshtrë nuk i beson as vetë Shaqir Fetai, prandaj e kumtoi me gjysëm goje!

E gjashta, stafi i Medresesë, duke pasur kujdes që mos të bie nën kurthin e të poshtrit Shaqir Fetai, nuk pranon që të lëshohet në pozita të gënjshtritarit, porse, vetëm e kumton një mundësi reale: “Me vendim qeverie zgjidhet problemi i “Medreses Isa Beu”. Nxënësit të cilët do ta kryejnë arsimin e mesëm në Shkollën e mesme islame “Medreseja Isa Beu” do të mund të regjistrojnë studimet universitare në fakultetet e vendit. Me këtë u zgjidh problemi shumë vjeçar për të cilin kishte kërkesa të vazhdueshme me vite të tëra. Urime për medresantët.”, thuhet në komunikatën e Medresesë “Is Beu”! Pra, këta askund nuk e përmendin fjalën “akreditim” dhe as që e fuqizojnë rrenën e Shaqir Fetait, porse, lajmërojnë për një mundësi që ka qenë edhe në kohën e ish-reisul ulemasë H. Sulejman ef. Rexhepi, kur medresantët regjistroheshin pa problem në të gjitha fakultetet e universiteteve të vendit!

E gjashta, as Shaqir Fetai dhe as instaluesit e tij nuk e kanë për dert që të rrejën dhe të luajnë me ndjenjat e myslimanëve të vendit, sepse, më e rëndësishmja për këta është që të fitohet pushteti. Natyrisht, kjo strukturë qeveritare nuk do të mbetet! Do të vie një kryeministër i ri, do të vie një ministër i ri, do të kontestohet vendimi në fjalë (nëse ekziston!) si vendim antikushtetues dhe, sërish do të vihen barrierat si për medresantët ashtu edhe bogoslllovistët!

Me rëndësi është që t'i jepet në dorë një “alet” Shaqir Fetait i

cili është i dëshmuar si rrenc profesonist dhe i cili me shumë lehtësi lëshohet në provokim të hoxhallarëve për t'i vënë në funksion të partisë së cilës i ka borxh imoral! Ndërsa, si për dreq, po atë ditë, u publikua lajmi se ish-myftiu i Strugës pranoi aderimin në krahun e Taravarit! Shaqir Fetai nuk mund të gënjejë aq shumë sa ta bind opinionin partiak se, në mesin e hoxhallarëve dhe xhemateve të Strugës ndikimi i Shaqir Fetait është më i madh se sa ai i ish-myftiut!

Një gjë është e qartë: me Shaqir Fetain të gjithë do të dalin humbës, madje edhe ata që e motivojnë për të gënjyer trishtueshëm!  
***/Fol/28.03.2024/***

## **Pendesa**

*“Nuk është pendim (i pranueshëm) i atyre, që bëjnë punë të këqija vazhdimisht dhe vetëm atëherë kur u vjen vdekja, thonë: “Unë tashti u pendova!”. Ndaj tyre kemi përgatitur dënim të ashpër.” (En Nisa, 18)*

*Nga Mr. Eset Shaqiri*

Në prag të Muajit të Agjërimit, instalacioni ideologjiko-politik në krye të BFI-së, Shaqir Fetai, do të deklarojë se, ky muaj do të jetë i begatë me aktivitete spektakolare të përgatitur nga “rijaseti” i tij! Në fakt, nën shprehjen “aktivitete spektakolare” u përfshinë edhe iftaret e shtruara atyre që nuk agjërojnë!

Bashkësia Fetare Islame e RMV-së, kurrë, madje as në periudhat e robtimeve, okupimeve e të sistemit komunist, nuk ka hyrë në Muajin Ramazan pa përgatitje serioze institucionale për ta shënuar sa më denjësisht Muajin e Agjërimit si dhe për t’ua lehtësuar sa më denjësisht ibadetet e ndryshme që kryhen për këtë Muaj të shenjtë! Pra, janë sjellje tipike të një të mashtruesi përpjekjet për t’u imponuar si risi apo si “reformator” me të cilin nisë një epokë e rë e devotshmërisë nën këtë nënqiell.

### **Dry Medresesë tradicionale, themelohet gjimnazi “Medresja Isa Beu”**

E vetmja risi, i vetmi aktivitet spektakolar i “rijasetit” qesharak të Shaqir Fetait, që do të mbahet mend përgjatë historisë së myslimanëve të këtij vendi, do të jetë ai i shuarjes së “Medresesë Isa Beu”, të Medresesë tradicionale që den baba den është marrur me prodhimin e kuadrit të nevojshëm për BFI-në dhe për bartësit dhe organizatorët e jetës fetare islame në Maqedoninë e Veriut. Ky aktivitet i Shaqir Fetait po që ishte spektakolar! E vetmja shpresë mbetet në refuzimin e botës akademike të myslimanëve të vendit për ta mbyllur Medresenë si dhe për ta themeluar gjimnazin “Medreseja Isa Beu”, refuzim ky që duhet

të manifestohet me protesta, demonstrata e me pengim kategorik që të realizohet ky skenar i antiislamistëve në këtë vend.

Askujt nuk i duhet “akreditimi” i Medresesë pasi të shuhet tradicionalja dhe të themelohet gjimnazi “Medresja Isa Beu”, sepse, kjo do t’i jepte shkas “bashkësive të tjera islame” të regjistruara në regjistrin qendror në vend që të themelojnë medrese tradicionale që do të prodhonin hoxhallarë dhe jo si do të prodhojë gjimnazi “Medresja Isa Beu” hoxhallarë gjysmakë e pseudo-teologë!

## **Aktivitetet dikur dhe sot**

Aktivitetet në terren, vizitat e xhemateve si në vend ashtu edhe jashtë, manifestimet fetare, të cilat Shaqir Fetai i ka ndërmarrë në këtë Muaj të Agjërimit, janë kopje e zbehtë e atyre aktiviteteve, vizitave e manifestimeve të ndërmarrë ndër vite nga kryesia dhe nga organet e BFI-së. Madje më parë përgatiteshin edhe më profesionalisht më me seriozitet dhe më me shpirt. Në terren ishin të angazhuar edhe medresantët, të cilët ishin mburrja e myslimanëve të vendit, ishin garancë e perspektivës së shëndoshë islame të vendit, ishin arsye më shumë që myslimanët e vendit të japin kontributin dhe taksat fetare për mirëmbajtjen e kësaj Shkolle të hoxhallarëve dhe të islamit në vend. Ishin hoxhallarë, profesorë e nxënës, të gjithë në mesin e xhemateve, duke pasqyruar një unitet të lakmueshëm të këtij komuniteti. Me çfarë uniteti hyri Shaqir Fetai në këtë Muaj? Le të publikoj Rijaseti listën e anëtarëve të komisionit të vizitave dhe të shofim sa prej tyre nuk janë teologë e hoxhallarë! Mëse 40 për qind të xhamive nuk i ka nën kontroll, xhami këto në të cilat Shaqir Fetai nuk guxon të shkelë e as të dërgojë përfaqësues! Tërë ky realitet e paraqet një “spektakël” të cilën kurrë nuk do ta dëshirojnë myslimanët e devotshëm të vendit.

## **“Kapaciteti intelektual i kukullës”**

Për t’ju qëndruar karshi atyreve që nuk e duan Shaqir Fetain dhe për t’ju dëshmuar se Muaji i Ramazanit mund të shënohet edhe pa angazhimin e tyre, Shaqir Fetai u kujdes për një “spektakël” i cili dëshmon për dy gjëra: Shaqir Fetai nuk ka nevojë për hoxhallarët e vendit, sepse këtë Muaj ai e shënon përmes një “shkrimi epik” që e publikon në disa vazhdime dhe, e dyta, refuzimin që ia bënë dhjetra teologë për të shkruar për vlerat e këtij muaji e që ky aktivitet do të shprehte angazhimin e hoxhallarëve të vendit që i përgjigjen kërkjes së Shaqir Fetait, ky mundohet ta “amortizojë” duke e plotësuar atë

mungesë shkrimesh me një “shkrim serik” të tij! Nën titullin “MUAJI I RAMAZANIT – NGRITJE E LARTË SHPIRTËRORE”, Shaqir Fetai publikoi shkrimin në mbi 20 vazhdimë, jo studim, jo analizë, jo zbërthim, porse, siç vlerësojnë lexuesit e kthjellët, vetëm “persiatje” të shpalosura përmes teknikës së kompilimit dhe plagjiaturës që “lulohet” nga një përkthim që çalon rëndë në sintaksën e gjuhës shqipe.

Aty ku përpiqet të shesë mend e të tregohet se çfarë “iluministi” që është, pikërisht aty del për askund! Si rrjedhojë kemi edhe fraza të këtilla të bajatshme: “gjatë formimit të përsosshmërisë së lartë të tij” (pse a paska përsoshmëri të mesme, të ulët – pjesa e hyrjes), ose “femra me fëmijë për gjiri”, “ka për qëllim plakun e mbetur” (pjesa III), ose, “andaj agjërimi i muajit të Ramazanit nuk është obligim i parë për njerëzimin, për arsye se gjithmonë, edhe në kohërat shumë më të hershme, njerëzit agjëruan”(pjesa IV), ose, “Ky element në Islam paraqet të vetmen masë të çdo përparësie dhe privilegje”, “synimi thelbësor i agjërimit është tek njereiu të ndërtohet shtylla kryesore e jetës individuale dhe shiqërore”, “domethëniet dhe dobitë nga agjërimi do të jenë të panumërta.” (pjesa V), ose, “thellë në shpirtë dhe zemër që reflekton në Jetën praktike dhe formon unitet të qëllimit, mendimit dhe praktikës, dhe tek njeriu kultivon vlerën e një qasjeje të realtë” (pjesa VI), ose “Nuk ka agjërim pa qëndrueshmëri durim dhe adaptim të kushteve më të rënda dhe jo të zakonshme”, “Nisur nga fakti se agjërimi është veprim jasht kushteve të zakonshme dhe normale” (pjesa VII), ose, “Agjërimi është rast më i volitshëm për të shijuar nevojën e të tjerëve” (pjesa VIII), ose, “dhe formoi njëherë e përgjithmonë metodologjinë e të njohurit të krijimtarisë që e rrethon” (pjesa XII), ose, “Prishja e këtij ekuilibri, sjell në njëanshmëri të njëjës apo tjetrit element dhe në deformimin e konceptit të shëndosh që drejton rrugëtimin e jetesës origjinale të zhvillimit njerëzor”, (pjesa XIV), ose “agjërimi tregon po at koncept që e kërkon Islami”, “në momentin kur nga vërbësia e materiales shmangën moralen, shpirtin dhe Zotin” (pjesa XVII), ose, “Ditët e fundit janë rast i vendosshmërisë sonë për formimin e koncepteve që forcojnë dinjitetin tonë kombëtar, fetar, moral, ekonomik, kulturor, shkencor, etj.” (pjesa XIX) etj.

## **Si shprehet pendesa (teube)**

Në një prej pjesëzave të një shkrimi më të gjatë, të cilin Shaqir Fetai mundohet ta paraqesë si “shkrim shkencor” të ndarë në disa pjesë, aty flet për Natën e Kadrit, të cilën duhet ta kërkojmë brenda

dhjetë ditëve të fundt të Muajit të Ramazanit e në të cilën duhet të hyjmë me një teube të bërë paraprakisht. Shaqir Fetai thotë: “Begatitë e muajit të Ramazanit nuk mundet të arihen nëse hyjmë në te jo të përgatitur. Përgatitja më e madhe për të është nëse e presim me zemra plot të mbushura me pendim- teube”!

Po a u pendua Shaqir Fetai ndonjëherë në jetën e vet! A ka për çfarë të pendohet dhe t’i kërkojë të falura edhe Zotit Fuqilpotë por edhe njerëzve të ndershëm të cilëve u bëri dëm të parikuperueshëm!

A u pendua Shaqir Fetai për misionin që ua kreu të tjerëve në interes të ideologjive dhe politikave të tyre antikombëtare e antifetare?

Islami kërkon transparencë, edhe pendesën e do në mënyrë transparente – të pendohet njëherë për manipulimin që e bëri në emër të islamit dhe mori më qafë njerëz duke i akuzuar me pa të drejtë dhe pa kurrfarë baze se e paskëshin dëmtuar fenë dhe shoqërinë. Le ta listojë vetëm një fakt nga ato që po i ruajkëka Shaqir Fetai! Apo, të djallëzuarin nuk e lë të dëshmojë djalli!

Në fakt, pendesa e Shaqir Fetait mund të demonstron vetëm me largimin urgjent të tij. Ikja e Shaqir Fetait nga ky mision do të thotë pendesë e sinqertë dhe kthim i tij në Rrugë të Zotit, për më tepër kur tashmë, nën heshtjen absurde të teologëve të vendit, e kreu misionin – e “akreditoi” Medresenë duke u pajtuar të themelojë një gjimnaz që, për nderë të lavdisë së Shkollës së Mesme Profesionale “Medresesë Isa Beu”, do ti thonë “Medresja Isa Beu”! Pendesa e tij do ta pengonte edhe këtë manipulim ku ka rënë apo që do ta zhvillojë me përpikmëri, deri në fund!

***/Kombetare/02.04.2024/***

## ***Kur të plasë cipa e turpit***

***“Rijaseti” i Shaqir Fetait na paska dalur me do tallona të cilat ia drejton opinionit të gjërë me titullin***

***“JINI NË SHËRBIM TË MEDRESES ISA BEU DHE FAKULTETIT TË SHKENCAVE ISLAME”!***

Çka është kjo paturpësi e Shaqir Fetait? Si i drejtohet opinionit që të ketë kujdes për Fakultetin e Shkencave Islame të cilën vetë ai e bojkoton tash e një vit, sepse aty na qenka një person (dekani) i cili nuk e do dhe nuk pajtohet me politikat destruktive, me hajninë, me veprimet shkatërruese dhe me poshtërsitë e Shaqir Fetait!

Fakulteti i Shkencave Islame është i akredituar, ai merr financa nga shteti! Është problem më vete frika e Shaqir Fetait për ta nervozuar pushtetin duke i kërkuar buxhet respektiv për këtë Fakultet! Shaqir Fetai e ka më për zemër ta dëmtojë buxhetin e myslimanëve të varfër se sa ta nervozojë shtetin e pasur duke i kërkuar financa respektive për FSHL.

Ai tashmë me pompozitet lajmëroi se “e ka akredituar edhe Medresenë”! Tani financa ka nga shteti! Pse këkon që paratë t’ia mbledhë popullit! Pse nuk thotë që i duhen për rrogën e tij që na e paska më të madhe në vend, në Ballkan e në Evropën Jugperëndimore!

Për cilën Medrese apelon Shaqir Fetai i cili tashmë ka dhënë pëlqimin për themelimin e një “medrese” të re e cila do të akreditohet, porse vetëm pasi të themelohet si një gjimnaz i cili do ta mbajë emrin “Medresa Isa Beu” e që do të financohet nga buxheti i shtetit.

Shaqir Fetai po manipulon me buxhetin që po formohet nga taksat e myslimanëve të vendit duke u bërë “reisi” më i pasur nga myslimanët më të varfër, madje edhe në botë!

Shaqir Fetai e ka ngritur çmimin e haxhit në nivele stratosferike! Ai me atë buxhet që duhet t’i ngelë nga ky çmim enorm duhet t’i mbajë pesë-gjashtë medrese si kjo e “Isa Beut”! Ku janë paratë e këtij zëri financiar? Kush po i vjedh? A mos po mendojnë Shaqir Fetai e hajnat e tij se bota është aq shumë e madhe sa kurrë nuk mund të takohen kontraktuesit arabë të cilët ashiqare shprehin turpin dhe



habinë me lehtësinë e pashoqe të shaqiristëve për të bërë dallavere e për të vjedhur para nga haxhi, ashu edhe siç vjedhin nga kurbanët e nga taksat e detyrueshme fetare!

Tashmë FSHI dhe Medresja janë akredituar dhe duhet të financohen nga buxheti i shtetit, ashtu siç financohen të gjitha shkollat e akredituara, që funksionojnë nën siglën “shkollat shtetërore”! Pra, e ka humbur këtë “joker” Shaqir Fetai dhe nuk mund të ftojë në grumbullimin e parave për mirëmbajtjen e këtyre dy vatrave arsimore!

Duhet ta tregojë të vërtetën: na duhen fitrat dhe zeqati për t’i marrur rrogat e majme të gjithë shaqiristët, me oreksin e të cilëve fyhet e shahet fitri, zeqati, kurbanët, haxhi, kontributet vullnetare...  
***/LMR në BFI/05.04.2024/***

## ***Shaqir Fetait i duhet strehim në Rabita***

***Shaqir Fetai paska kërkuar strehim nën organizatën prestigjioze pikërisht dy-tre ditë pasi vendosi që ta mbyll “Medresenë Isa Beu” dhe të themelojë një gjimnaz me të njëjtin emër të cilin mund ta akreditojë, sepse, komunistët e tij nuk pranojnë që të akreditohet një shkollë fetare e cila prodhon hoxhallarë për nevoja të BFI-së***

***Nga Osman Zimeri***

Bota shqiptare tashmë e njeh mirë Shaqir Fetain, e di fort mirë se kush paska qenë, si deshti t’i manipulojë myslimanët e Maqedonisë së Veriut duke u bërë myfti i Gostivarit, si ia nguli thikën pas shpine njeriut që kishte besim “absolut” tek Shaqir Fetai dhe, krejt në fund, si u bë vegël e elementeve antishqiptare e antiislame në vend.

Shaqir Fetait i ra tërë boja, krejt fasada, doli açik dhe gjithnjë e më shumë po dëshmohej si njeri shumë i rrezikshëm, si njeri që nuk i intereson asgjë tjetër përveç karrierës së errët.

Së fundmi Shaqir Fetai njohton se qenka bërë anëtarë i Këshillit të Jurisprudencës islame të RABITA-s së Arabisë Saudite! Njeri më i ligë ndër myslimanët e Maqedonisë kërkon strehim nën këtë organizatë prestigjioze?! Po kush e propozoi atje, kah morën vesh juristët e Arabisë Saudite se kush na qenka Shaqir Fetai, apo, krejt kjo u arrit falë linjës jugosllave që edhe më tej me gjasë po ia del të ndikojë nëpër disa shtete!

Po si nuk i vie turp Shaqir Fetait? Po ku shkon Shaqir Fetai në organizata ku flitet arabisht apo anglisht, të cilat Fetai nuk i ka haber! Një mysliman i denjë a do të kishte pranuar role të cilat nuk i njeh dhe nuk i di! Po shaqir Fetai njihet si njeriu më antiikushetues, si njeriu më anti-ligj, si njeri që deri më tani i ka humbur të gjitha proceset gjyqësore që i ka montuar vetë; si njeri që nuk ka lidhje me islamit si fe, shkencë e si drejtësi. Madje, me gjestin miratues të Shaqir Fetait, ai mundohet që ta bëjë të ligjshëm tërë veprimtarinë e vet të

kriminalizuar, prej idesë për ta tradhëtuar njeriun që e rriti e deri në mometet aktuale, kur tërë pasurinë e myslimanëve të vendit po e shpenzon në të mirë të veglave pushtetare që e instaluan në krye të BFI-së.

Veprimtaria karrieriste e Shaqir Fetait nuk ka lidhje me jurisprudencën islame! Nuk po flasim për atë veprimtari spiuneske në UDB për të cilën flet shoku i tij i ngushtë që në bankat shkollore, teologu i mirënohur Dr. Nexhat Ibrahim, por, po flasim për iniciativën e tij për ta instaluar tradhëtinë më të madhe në BFI, duke ia ngulur thikën ish-reisit të vet të cilin kishte nisur ta thërriste edhe “baba”!

Shaqir Fetai sapo u instalu nisi të “riorganizojë” Oranizatën e BFI-së duke shkëlur Kushtetutën, rregulloret dhe tërë dispozitivin e BFI-së!

Shaqir Fetai, për të treguar se nuk ka lidhje me jurisprudencën islame, për të treguar se as që do me ia ditë për këtë jurisprudenc, gjënë e parë që bëri e ngulfati Këshillin për Fetva që funksiononte në kuadër të BFI-së!

Shaqir Fetai për të dëshmuar se është despot, njeri antiligjor, ndërmori sërë masash personale kundër të punësuarve në BFI, të cilat lëndë më pastaj do t’i humb si procese gjyqësore një nga një.

Shaqir Fetai paska kërkuar strehim nën organizatën presigjioze pikërisht dy-tre ditë pasi vendosi që ta mbyll “Medresenë Isa Beu” dhe të themelojë një gjimnaz me të njëjtin emër të cilin mund ta akreditojë, sepse, komunistët e tij nuk pranojnë që të akreditohet një shkollë fetare e cila prodhon hoxhallarë për nevoja të BFI-së.

Pra, Shaqir Fetai është njeriu dhe fakti më plastik që dëshmon për një veprimtari antiligjore që rrjedh falë mbështetjes së strukturave antiislame e antikombëtare që e instaluan në krye të BFI-së, si shpërblim për veprimtarinë e tij antishqiptare në UDB, si “ORAO” nën komandën e oficerit serb, Stanko Dragoviqit!

Shaqir Fetai ka nevojë ta gënjejë edhe Zotin por edhe popullatën! Thellësisht, ndjenë nevojë të madhe për rrefimin se ky është njeri i mirë, i rregullt dhe i parimeve! Sepse, e di fort mirë se edhe zogjtë e malit e dinë që është shpirtzi! Prandaj, ky anëtarësim i SPONSORIZUAR (nga strukturat shumë të dyshimta) në këtë Këshill juridik të Rabita-s, i ka ardhur mirë, dhe i ka dhënë motiv për t’u krekosur edhe një herë si gjeli në maje të plehut.

Pa dyshim, këtë pasurim të “CV”-së së mjerë e ka si peshqesh për përkrahjen e iniciativave për ta thyer traditën ligjore të funksionimit vetëm të një Institucioni të Bashkësie Fetare Islame dhe të regjistrimit të të tjera “bashkësive islame” në RMV që u interesojnë ekskluzivisht “sponsorizuesve” të karrierës së mjerë të Shaqir Fetait

*/1KlikLarg/08.04.2024/*

## ***Eventet e lojës “hedhje hi syve”***

***Shaqir Fetai kërkon dhe stimulon incidente me pasoja tragjike vetëm e vetëm që të defokusohet vëmendja nga skandali i turpshëm i “akreditimit” të Medresesë***

***Nga Valbon Osmani***

Shaqir Fetai ky farë instalacioni i turpshëm në krye të BFI-së nga subjektet politike të dëshmuara antiislame, paska marrur pjesë në një event në Myftininë e Tetovës! Akoma pa e sqaruar situatën, akoma pa e definuar se kush është myfti i Tetovës dhe ku është selia zyrtare e kësaj myftinie, Shaqir Fetai organizon evente në këtë territor dhe futet aty, si “triumfalist” nën përcjelljen e një “togu zyrtar” njerëzish të armatosur deri në dhëmbë me të vetmin qëllim që të provokojë eskalim të situatës dhe të defokusohet qoftë edhe për një çast vëmendja nga skandali i turpshëm i mbylljes së Medresesë tradicionale si SHKOLLË E MESME ISLAME! Shaqir Fetai e provokon edhe ndonjë situatë që t’i tekërlitet shalli e të turpërohet skajshmërisht, sepse, e di që vetëm kësisoj do ta përjetojë “mëshirën” eventuale të masës dhe nën këtë “mëshirë” do ta gëzojë përfundimisht “përkrahjen” e myslimanëve të vendit! Pra, Shaqir Fetai e ëndërron një shuplakë e një tëkërlitje të shallit në këmbim të një “mirëkuptimi popullor”.

Shaqir Fetai merr pjesë me krejt suitën e vet qesharake në një event përgatitur nga medesantet e Tetovës; merr pjesë me “profesorë”, me “akademikë”, me anëtarë të “rijasetit” të vet dhe, tërë kjo tufë “ulemashë” promovon eventit e titulluar “ARTET E BUKURA”, titull ky i denjë ekskluzivisht për një institucion që enkas merret me artet e bukura! Ta titulloshë ekspozitën e veprave të medresanteve me titull “Artet e bukura”, duhet të jeshë ose skajshmërisht pretendues naiv ose terësisht injorant! Ekspozitat gjithnjë kanë një emërtim simbolik që del nga lajtmotivi i trajtuar në vepra artistike, si në pikturë, skulpturë, grafikë, kollazh etj. Është e njëjtë sikur një përmbledhje me poezi t’ia vëshë titullin “Artet e bukura”!

Dakord, marin pjesë Shaqir Fetai me myhybtë e tij në një event për të cilin nuk mund të shprehin qoftë vetëm një fjalë estetike! Nisë fjalën Shaqir Fetai, i cili e rrumbullakson duke i përshëndetur të gjithë shoqëruesit e vet, me emër e mbiemër, pastaj e merr fjalën drejtori i emëruar dhunshëm i Medresesë, i cili, edhe ky nis fjalinë duke e përshëndetur “reisul ulemanë” Shaqir Fetain, si dhe të gjithë, me emër e mbiemër, shoqëruesit e “reisit”, pastaj merr fjalën myftiu, viktimë e interesave meskine të Shaqir Fetait dhe, edhe ky e rrumbullakson fjalimin duke e përshëndetur “reisin” si dhe të gjithë të tjerët, me emër e mbiemër, që e kanë shoqëruar “reisin”, i cili bukvalisht i dhunon duke i detyruar që të marrin pjesë aty ku është vetë ai! Asnjë fjalim recensues mbi veprat e mrekullueshme të nxënësve të Medresesë! Asnjë vlerësim eseistik, asnjë kritikë përkrahëse! Asnjë fjalë profesionale mbi këtë traditë kaq fisnike për ekspozimin e veprave artistike të medresanteve tona! Vetëm përshëndetje dhe urime (mbase për intriga) për myhybët e Shaqir Fetahit, i cili duhet të “madhërohet” madje edhe aty ku nuk është as vendi e as kuvendi! “Madhërimi” i Shaqir Fetait është poshtrim i shoqërisë sonë, është reflektim i injorancës totale i atyreve që e parapëlqejnë nënshtrimin. Ta “madhëroshë” Shaqir Fetain nëpër “evente” do të thotë tallje me të VËRTETËN E MADHE!

Si përfundim, nga fjalimi idiotik i Shaqir Fetait del puna se ai ka nevojë për ta dëshmar BDI-zimin e Bashkësisë Fetare Islame, ka nevojë për ta theksuar kontributin e kësaj partie në “akreditim” të Medresesë! Mbi të gjitha, ka nevojë për ta justifikuar përqafimin politik të mbylljes së Medresesë tradicionale. Ai do ta theksojë gjithnjë e më shumë këtë “akreditim” të rrejshëm, sepse një ditë, kur do të zbresë me këmbë në tokë, do të duhet t’i përgjigjet pyetjes: po pse na rrejte o mahluk! Përgjigja do të jetë: “po unë kam qenë i sigurtë se është akredituar, nuk e kam ditur se më kanë mashtruar këta të BDI-së! Rrenë më kanë thënë, rrenë ju kam thënë”! Tamam si Nasradin Hoxha!

Shaqir Fetai po përpiqet të rrejë dhe ta mashtrojë opinionin me këtë “mashtrim të BDI-së”, sepse e vërteta është shumë e çapë! Si ditën kur ia ka dorëzuar “akreditimin” kryeministri teknik i Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, si ditën tjetër kur i shkoi në zyre Artan Grubi për t’ia dhënë “çertifikatën”, i kanë thënë shumë mirë: duhet të themelohet shkolla publiko-private gjimnazi “Medresja Isa Beu”! Pra, mbyllet Medresja aktuale, tradicionale, themelohet gjimnazi (që nuk titullohet SHKOLLA E MESME ISLAME) dhe, pastaj do të miratohet plan-programi në harmoni me plan-programet e shkollave të mesme shtetërore ku, eventualisht, do të mund të mësohen dy-tri lëndë fakultative “islame”! Ja pra çfarë “medrese” na ka akredituar Shaqir

Fetai! Në takimin e dytë iu dha “çertifikata e verifikimit të njohurive” që do të merren në gjimnazin e sapothemeluar! E kush do ta verifikojë këtë dituri? Ministria e arsimit? Komisionet e BDI-së? Prandaj duhet të ndihmohet BDI, sepse do të na ngelin në provim komisionet e partisë – ky është mesazhi i Shaqir Fetait që do të përcillet këto ditë sa herë që do të prezantojë nëpër “evente” naive!

Shaqir Fetai nuk guxon që edhe më tej të përpiqet ta manipulojë opinionin duke shkruar e rishkruar, duke përmirësuar e duke censuruar lajme nëpër paçavurat e tij mbi “akreditimin” e Medresesë! Në vend të këtyre “përprjekjeve titanike” Shaqir Fetai do të bënte mirë që ta publikojë dokumentin origjinal dhe zyrtar mbi “akreditimin” dhe të na tregojë se cila është strategjia e tij nëse kryeministri i radhës dhe ministrat e arimit, por dhe dekanët e fakulteteve do të refuzojnë që ta vënë në zbatim një vendim të “kryeministrit” teknik i cili na u tregu edhe një herë pehlivan mu në fushatë të zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare!

Në fund të komunikatës së Shaqir Fetait me rastin e pjesëmarrjes së tij në ekspozitën “Artet e bukura”, ai thotë: “Në fund të programit, Reisul Ulema H. Hfz. Shaqir ef. Fetait, drejtorit të Medresesë si dhe Muftiut të Tetovës nga ana e drejtorisë së SHMI Medreseja Isa Beu, paralelja e vajzave – Tetovë, iu nda nga një eksponatë (çka nënkupton injoranti me këtë fjalë?!) të përgaditur enkas nga nxënëset e po kësaj shkolle.” Po shoqëruesve të tjerë të Shaqir Fetait, myftinjë e drejtorë të tij?! Ku mbeti këtu morali të cilin po e mbështetkëka kaq shumë BFI-ja e Shaqir Fetait? Gjithçka imorale dhe dilentantizëm!

***/Kombetare/18.04.2024/***

## ***Shërbimi për shërbime të ulta***

***Kur një organizatë “prestigjioz” të përzgjedh për anëtarë të rregullt, ndërsa vetë nuk je as me përgatitje profesionale, as me aftësi komunikuese-gjuhësore dhe as me ndonjë famë që shtrihet përtej mëhallës, atëherë, kjo përzgjedhje bëhet ekskluzivisht në shenjë mirënjohje për ndonjë shërbim që ke kryer! Cili është shërbimi i Shaqir Fetait që ka kryer për Rabita-n?!***

***Nga Rasim Ismaili***

Është paralajmëruar më herët se, “reisi” i dhunshëm, i instaluar në krye të BFI-së nga organet shtetërore antiislame e antishqiptare, do të përzgjidhet si anëtar i Këshillit të lartë për çështje të jurisprudencës islame të Ligës botërore islame – RABITA! Pra, Rabita është një organizatë islame në kuadër të së cilës veprojnë disa sektore, pra, edhe ky Këshill ku qenka anëtarësuar Shaqir Fetait!

Më i lumturi për këtë anëtarësim na paska qenë puleni i Shaqir Fetait, njeriu më i dyshimtë i punësuar në BFI me intervenim të njerëzve të dyshimtë (të shërbimeve sekrete, këtë e dëshmon punëdhënësi i tij, Sulejman ef. Rexhepi). Ky farë puleni shpreh gëzimin e vet në këtë formë: “Urime haxhi Reis për përzgjedhjen e juaj anëtarë i Akademisë së Jurisprudencës Islame tek RABITA- Liga Botërore islame, kjo është hera e parë që RABITA zgjedh një Reis të jet anëtarë i Akademisë së Jurisprudencës Islame.”

Shaqir Fetait nuk ka lidhje me Jurisprudencën islame! Shaqir Fetait nuk ka lidhje me gjuhën arabe! Shaqir Fetait nuk ka lidhje me botën akademike, sepse, më tepër është “profesor autodidakt”, se sa që është ndonjë alim i njohur, madje edhe titullin “profesor medreseje” e ka dhuratë nga ish-resi i tij, të cilit ia nguli thikën pas shpine.

Shaqir Fetait nuk është shquar me asnjë fetva, Shaqir Fetait nuk ka bërë ndonjë emër që do ta dallonte nga një duzinë profesorësh e akademikësh teologë që janë nja një milion vite larg intelgjencës së Shaqir Fetait!

Mbi të gjitha, Shaqir Fetai, akoma nuk po ia del të shpëlahet nga e kaluara e tij e dyshimtë, për të cilën u publikuan dokumenta e deklarata që flasin për angazhimin e tij nëpër shërbime të huaja e, mbi të gjitha, antinjerëzore.

Atëherë, si i bëhet që Shaqir Fetai, deri më sot na qenka i vetmi “reis” që na qenkësh përfshirë si anëtarë i një Këshilli aq prestigjioz, në të cilin kontributi i Shaqir Fetait nuk mund ta kalojë vlerën e zero-s!

Çka e dalloi, cila vlerë intelektuale, profesionale e karrieriste e dalloi Shaqir Fetain sa që e detyroi RABITA-n ta përzgjedh si “reis të parin” në Këshillin e Jurisprudencës Islame? A mos na qenka reis i paparë, trim, intelektualisht i guxmshëm, tradicionalist në qëndrime islame, a mos e dënoi sulmin izraelit mbi Palestinën, a mos si “reis” ofroi zgjidhje të kënaqshme të problemeve të ndryshme në botën islame? Çka është ajo që e tronditi botën turko-arabe dhe, përgjithësisht, islame, saqë RABITA qe detyrimisht e obliguar që ta anëtarësojë Shaqir Fetain, këtë farë bereqeti rusofil, në një sektor prestigjioz të RABITA-s!

Apo, mbase ky anëtarësim vjen si rrjedhojë e zhytjes symbylltazi të Shaqir Fetait nëpër ujërat e turbullta të vëhabizmit! Apo, ndoshta, ky anëtarësim vjen si rrjedhojë e shprehjes së mirënjohjes për anëtarin vëhabist që Shaqir Fetai e mbanë në kabinetin e vet. Apo, krejt në fund, mos ky anëtarësim vjen si rrjedhojë e pajtimit të Shaqir Fetait që në territorin e Maqedonisë së Veriut t’u mundësojë aktivitete zyrtare “pipthave” të vëhabizmit, të cilat tashmë me pajtimin e këtij farë “akademiku” janë regjistruar edhe nëpër organet gjegjëse shtetërore për veprimtari fetare, për kundër faktit që për këtë veprimtari këtu është BFI-a!

Sido qoftë, është vetëm një arsye që e di komuniteti vëhabist se pse, Shaqir Fetai, duhet të anëtarësohet në Këshillin e Jurisprudencës islame si i vetmi “reis” deri më sot, pa përgatitje profesionale e gjuhësore adekuate! Pra, nuk u anëtarësua sepse u dallua nga reisët me këllqe nëpër botë, nuk u anëtarësua se në botën islame u dallua me ndonjë qëndrim unikat, nuk u anëtarësua se në botën akademike islame la ndonjë gjurmë të paarritshme, jo se në sferën e Jurisprudencës bëri dallimin, as se gjuhësisht është komunikativ me botën arabe! Thjesht, ai u anëtarësua aty, përkundër të gjitha kritereve, vetëm sepse kësaj organizate prestigjioze i kreu ndonjë shërbim të cilin ata nuk po e gjenin këtu tash e tri dekada nën drejtimin e REISUL ULEMASË TË BFI-së, H. Sulejman ef. Rexhepit.

***/IKlikLarg/22.04.2024/***



## ***BFI-ja po e shton numrin e rasteve sociale***

*Në BFI të privilegjuarit e Shaqir Fetait po ia dalin që të bëhen me shtëpi “përallore”, me oborr të denja për shesh-xhirime filmi, me makina lluksoze, ndërsa kundërshtarët dhe kritikuesit, si dhe ata ndaj të cilëve Shaqir Fetai ka frikë paranojake, nënçmohen, nuk përfillen dhe nuk përfshihen në paketat sociale as të rrogës 13, as të shpërblimeve dhe as të rrogës plus që duhet t’i jepet të gjithë të punësuarve. Natyrisht, tërë kjo nga fitri, nga zeqati, nga kafshata e myslimanëve të vendit dhe diasporës*

*Nga Ferat Myrtezani*

Në BFI në përfundim e sipër qenka procesi i dorëzimit të fitrit dhe taksave të tjera fetare të grumbulluara gjatë Muajit të shenjtë të Ramazanit. Po sa para është grumbulluar? A dihet kjo shumë? Kush e ka shumë e saktë, pse nuk bëhet kurrë transparente, pse nuk tregohen zërat e buxhetit vjetor të BFI-së për të ditur se si shpenzohen këto para, të cilat myslimanët e vendit i japin për zhvillim të jetës fetare islame në vend. Shaqir Fetai dhe tajfa e tij të babzitur këto para i grumbullojnë në emër të Medresesë Isa Beu, në të cilën gjithnjë e më pak po regjistrohen nxënës, kjo do me thënë se gjithnjë e më shumë ulet nevoja për buxhet për këtë shkollë të mesme islame siç e kishte në fillimet e saj. Paratë po shtohen kryesisht falë vetëdijësimit islam të besimtarëve tanë, po mblidhen më shumë, ndërsa nevoja për shpenzime në këtë Medrese bie! Nuk regjistrohen më në paralelen e vajzave në Gostivar 20-30 nxënës por vetëm pesë, siç ishte sivjet! Në Medresenë qendrore nuk regjistrohen si më parë nga 80-90 nxënës por nga 20-30! Për Fakultetin e Shkencave Islame nuk ka nevojë buxhet të madh si në fillimet e tij, pasi që tashmë Fakulteti është i akredituar dhe financohet pjesërisht edhe nga buxheti i shtetit. Tash e tutje pa dyshim, edhe buxheti i Medresesë, i siguruar nga BFI-ja, do të zvogëlohet

dukshëm, meqë, pavarësisht akreditimit katastrofal e skandaloz, edhe kjo vatër e mesme do të financohet nga shteti!

Atëherë, ku po shpenzohen paratë e grumbulluara nga kafshata e mylimanëve të vendit, nga djersa e punëtorëve tanë në diasporë?

Një shumë e konsiderueshme (me qindra e mijëra euro) po shpenzohet, siç po shihet e po flitet, në përpjekje për ta “rregulluar” imazhin e reisit më të kotë në historikun e BFI-së, Shaqir Fetait! A mund të na thonë se sa kushtoi iftari partiak, shtetëror e antifetar të cilin Shaqir Fetai e shtroi kah fundi i Ramazanit, në restorant ekskluziv, ku menyja shkon edhe deri në 30 euro (më së paku për 500 mysafir të ftuar)! Po ai i “bakllavës”? Po qejfet e myftinjëve që kanë dëshirë ta imitojnë Shaqir Fetain me “aktivitete” të kota nëpër extra-restorante? Cili do të ishte ai sevap sikur ky iftar dhe këto qejfe super të kushtueshme t’u shtroheshin të varfërve të vendit dhe jo subjekteve partiake e shërbimeve të dyshimta që e instaluan Shaqir Fetain në krye të BFI-së?

Shaqir Fetai si dhe pulenët e tij duhet të tregojnë se sa i kushtojnë BFI-së vetëm në shpenzim të makinave zyrtare si dhe të karburantit që e shpenzojnë ditë për ditë Gostivar-Shkup-Gostivar, Tetovë-Shkup-Tetovë! Po mëditjet dhe shpenzimet e tjera për shëtitje (me familje, madje edhe me dashnore) nëpër Bullgari e Turqi? Shaqir Fetai i nënshkruan me lehtësinë më të madhe të mundshme faturat e këtyre qejfeve, sepse bëhen nga ata që ia fërkojnë b...t, kënaqësi dhe nevojë këtë të cilën Shaqir Fetai kurrë nuk e fsheh!

Në BFI ka qenë praktikë që, meqë është “organizatë private” të mos i nënshtrohet ligjit për pagim të rrogës së 13, porse, në vend të saj, të marrin nga një rrogë plus pas çdo Ramazani, kjo si hejdie për angazhimin e të gjithëve që ky Muaj i shenjtë të kalojë sa më mirë e mbarë! Madje, këtë shpërblim e merrnin që të gjithë, sepse ish-reisul ulema, H. Sulejman ef. Rexhepi, nuk dëshironte që të ndjehen të diskriminuar nëpunësit e tjerë të cilët nuk përfshiheshin nëpër komisione i cili merrte mëditje të majme për angazhimin mujor!

Shaqir Fetai e ka ndërprerë këtë traditë, ndërsa pa kurrfarë trishtimi se po bën diskriminim të tmerrshëm, edhe antiligjor por edhe antifetar! Brenda BFI-së ka shumë të punësuar që ankohen se pse nuk ua ka dhënë akoma këtë shpërblim, kompaktibil me rrogën 13, të cilën ligjërisht e marrin të gjithë të punësuarit në vend! Nëse nuk e marrin këtë rrogë organet përkatëse shtetërore i sanskionojnë organizatat dhe firmat. Po pse tolerohet me kaq nonshalancë Shaqir Fetai? Si guxon të tolerohet Shaqir Fetai të bëjë selekcionimin e nëpunësve? Si guxon ky shpirtzi që t’i shpërblejë të gjithë ata që prej Ramazani në Ramazan i kanë shprehur lojaleitet, përkrahje e fërkim të topthave, ndërsa ata që

nuk pajtohen me politikat diskriminuuese, devaluuese e shkatërruese të Shaqir Fetait, të ndëshkohen haptazi me këtë masë antisociale? Çka thonë ligjet përkatëse të vendit për diskriminimet e tilla kundër punëtorëve? Apo, i lejohet Shaqir Fetait të shkelë ligje si në BFI ashtu edhe në shtet! Po pse?

Mediat e vendit, por edhe inspektoratet e ndryshme duhet të interesohen dhe të shohin se si, derisa Shaqir Fetahat e BFI-së vetëpaguhen me shifra astronomike, gjithnjë e më shumë po shtohet numri i hoxhallarëve që po paraqiten në agjencitë shtetërore përkatëse për ndihmë sociale! Egoizmit dhe idiotësirave të Shaqir Fetait dikush duhet t'i thotë stop, sa nuk është bërë shumë vonë dhe sa nuk ka shpërthyer ndonjë revoltë e cila, jo se mund të ndalet aq shpejtë dhe kollaj! Një sidikatë e hoxhallarëve apo një lëvizje e imamëve mund të jetë e kobshme për të gjithë!

***/IKlikLarg/24.04.2024/***

## **Rekordet e “sukseve”**

***Edhe kriminaliteti dhe korrupsioni për sukses e llogarit rezultatin përfundimtar që i sjell kënaqësi bartësit, ushtruesit dhe kontrolluesit të këtyre dukurive imorale! Një shoqëri shumëfish më e lumtur do të ishte me zero buxhet por me virtyte të larta, se sa me buxhet miliardëshe dhe me etiketën “komunitet i shprishur”***

***Nga Alma Shabani***

Çdo organizatë, çdo firmë, institucion e komunitet i organizuar, e ka një moment kur ndalet dhe e bën rekapitulimin e një viti, me ç’rast nxjerr rezultatin përfundimtar, nxjerr konkluzat dhe, mbi to pastaj bën strategjinë për vitin e ardhshëm. Kjo, zakonisht bëhet në fundvit, por, ka organizata që këtë e lidhin edhe me një aktivitet të tyre jetik vjetor. Ja, Shaqir Fetai këtë po e lidhë me Muajin e Shenjtë të Ramazanit. Sapo publikoi në fb-un e vet paçavurë informataatën se “rijaseti” i tij paska analizuar aktivitetet e muajit të Ramazanit dhe paska konstatuar se “rezultatet e Muajit të Ramazanit të sivjemë dukshëm tejkalojnë rezultatet e Ramazanit të kaluar”!

Për çfarë rezultatesh e ka fjalën Shaqir Fetai? Me gojë të vet e dëshmon se ai është i interesuar vetëm për vjeljen e taskave fetare të myslimanëve të këtij vendi dhe, për asgjë më shumë! Rezultat ai e llogarit nëse ka arritur që të manipulojë plus ndonjë mysliman më shumë se vitin e kaluar dhe t’ia zhvasë ndonjë lekë.

Pra, Shaqir Fetai na del të jetë zhvatësi më i madh në historinë e BFI-së! Ai përkujdesin e vet e aktivizon vetëm kur është në pyetje leku dhe, për asgjë tjetër nuk i intereson atij!

Edhe në rastin konkret Shaqir Fetai rrenë sa është i madh dhe, shyqyr Zotit që nuk është i gjatë fort se, rrenat e tij do të preknin retë dhe nuk do të shiheshin, ose do të pezullonin si të mjegullta!

Muajin e shenjtë të Ramazanit Shaqir Fetai e llogarit si të suksesshëm apo jo, varësisht sa fitra e sa zeqat ka mbledhur!

Shaqir Fetai, për dallim nga dy-tre vitet e fundit, vetëm sivjet

i ka minus qindra klasë nëpër shkollat shqiptare, që do me thënë se, kanë emigruar jashtë shtetit me mijëra e mijëra myslimanë! Kjo dukuri pa dyshim që ndikon edhe në zvogëlimin e buxhetit që krijohet ekskluzivisht nga taksat fetare të qytetarëve myslimanë!

Shaqir Fetai sivjet e ka pasur një Myftini të tërë jashtë sistemit, që do me thënë se, burimin më të madh të financave e ka pasur jashtë kontrollit të tij.

Shaqir Fetai jashtë kontrollit të vet ka edhe nja 200-300 xhami, të cilat nuk i dorëzojnë taksat fetare tek ai!

Shaqir Fetai tashmë me politikat e tij destruktive dhe amatoreske ka lejuar që të regjistrohen edhe nja dy-tre “bashkësi fetare” të cilat kanë xhematin e tyre (e që shkon në mijëra e mijëra xhemat) të cilët taksat fetare nuk i paguajnë te “bashkësia e Shaqos”!

Shaqir Fetai u ka borxh shumë njerëzve dhe shërbimeve që e mbajnë si qyp në BFI, kështu që, krejt kjo paguhet në të zeze dhe, sukses i sukseseve do ta llogariste nëse ia arrinë t’u dalë borxhit!

Shaqir Fetai i ka borxh jetik BDI-së, ndaj dhe, po vlojnë akuzat dhe ankesat se, Shaqir Fetai, Myftinitë si dhe tërë BFI-në, nga filialja e BDI-së e ka shndërruar në shtab të BFI-së dhe, dihet që shtabet janë shpenzuesit më të mëdhenj të buxheteve “të zeza”!

Në këtë aspekt, pra, në aspekt të tubimit të taksave fetare në të mirë të BFI-së, Shaqir Fetai po rrenë me “rezultatet e veta” dhe, e vërteta është se ka dështuar tërësisht! Këtë e vërtetojnë edhe kompetentë të ndryshëm që kanë dy lidhje me financa e me ekonomi!

Por, nëse për pikë referimi për rekapitulim të ecurive të punëve të përgjithshme merret një aktivitet ekskluzivisht fetar, siç është Muaji i shenjtë i Ramazanit, atëherë, rezultati duhet të kërkohet në arritjen e një niveli më të lartë të devotshmërisë, arritjes së besueshmërisë më të lartë, arritjes së ndikimit më lartë tek popullata që do të reflektonte në ngjeshjen e radhëve, në ruajtjen e unitetit, në paprekshmërinë e tij!

E vërteta është dhe këto fakte i vërtetojnë të gjitha analizat objektive, madje edhe ato të përriptat se, Shaqir Fetai gjatë këtij muaji të agjërimit ka pasur kujdes vetëm për gushën e vet! Me aktivitete steriotipe, të njohura, pa kurrfarë kreativiteti dhe të shabllonizuar, ai nga pozita vendnumëro ka shënuar zbrapsje të theksuar!

Shaqir Fetai kaloi një Ramazan me umetin e përçarë, me një Myftini jashtë sistemit dhe që ka funksionuar paralelisht!

Shaqir Fetai nuk ka guxuar që të vizitojë disa xhami e xhemate (me qindra sish në tërë territorin);

Shaqir Fetai nuk ka pasur vullnet që të jetë në mesin e xhmateve e të të varfërve gjatë këtij muaji (mos të harrojmë pamjet e tashmë ish-presidentit Pendarovski, i cili, për çdo Ramazan zgjedh një familje

muslimane për të hëngër së bashku një iftar! Keni parë apo keni dëgjuar ndonjëherë se këtë gjë e ka bërë edhe Shaqir Fetai?!)

Shaqir Fetai shkon për vizita vetëm aty ku ka ndonjë mëditje të majme, përndryshe, vizitat e xhamive të vendit nuk i ka fort në huj!

Shaqir Fetai ia arriti që të pozicionohet partiakisht dhe ta partizojë BFI-në deri në nivel të nëndegëve partiake! Sot, pesha dhe detyra e BFI-së ka rënë në nivelin e një nëndege partie të një katundi të izoluar!

Shaqir Fetai ia arriti që të dëshmojë se aty ku prezanton ai aty ikin të gjithë dhe, për këtë fakt, tashmë edhe vetë ai është i vetëdëshëm. Edhe në diasporë prezenca e tij shkakton neveri! Avdalli “lavdërohet” se paska marrur pjesë në një event në diasporë, i shoqëruar me shefin e kabinetit të vet (kjo i bie sikur një drejtor të thotë se isha i shoqëruar me sekretarëshën time!!!) si dhe me shumë “imamë e drejtues fetar”, ndërsa në atë event qenkan grumbulluar 500 mij euro për ndërtim të një xhamie! Kurse, aty ku nuk prezanton Shaqir Fetai, siç kemi lexuar nga informatat e më hershme të BFI-së, vetëm në një xhemat të vogël, brenda një ore grumbullohen 2 milion euro!

Shaqir Fetai është dëm dhe shumë i dëmshëm gjithkund ku prezanton! Shaqir Fetai ka shkatërruar autoritetin e BFI-së, ka minimizuar ndikimin e BFI-së, ka depersonalizuar rolin dhe peshën e BFI-së si dhe ka fragmentarizur dhe segmentarizuar unitetin e BFI-së duke e shndërruar në një organizatë “të përfillshme” vetëm në prag të zgjedhjeve politiko-partiake.

Shaqir Fetai është njolla më e turpshme që i ka ndodhur BFI-së në historikun e vet!

Së këndejmi, a është ky rezultati i duhur, ai sukses që e pret Shaqir Fetai – avancimin financiar dhe degradimin institucional! Financat rriten edhe me paranë e zezë, edhe me kriminalitet, edhe me tregëtinë e zezë, por ama ngritja institucionale arrihet vetëm me integritet të palëkundur, vetëm me ngritje të nivelit të moralit dhe vetëm me ruajtje të unitetit. Nuk ka kapital, nuk ka buxhet, nuk ka financa që mund ta mbulojnë dezorganizimin, dezorientimin dhe defaktorizimin e BFI-së!

Tërë kjo që u tha këtu, dokumentohet me deklaratën e Shaqir Fetait që thotë: “Andaj, edhe ky Ramazan i tejkaloi të gjitha rekordet e Ramazaneve të kaluara”! Flet për rekordet në shumës! Shikuar grafikisht, bëhet fjalë për rënien e kurbës nën vijën horizontale që shënon bazën e rekordeve! Çdo “rekord” të Shaqir Fetait ka kuptimin e negativitetit, fatkeqësisht!

Si myslimanë na ngelë që t'i lutemi Zotit Mëshirëplotë që kurrë në historinë e myslimanëve të vendit të mos përsëriten këto rekorde e këto “rezultate” për të cilat Shaqir Fetaj ndjehet i lumtur! Kjo lumturi është karakteristikë vetëm e njerëzve të ligë, e njerëzve që kanë mision shkatërrimin!

***/Kombetare/30.04.2024/***

# **A kemi mjete të informimit ose pse mungojnë debatet**

## *Editorial i Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI*

Debati është formë gazetareske që sjell informacione burimore, autentike dhe të pamohueshme. Të gjithë ata që i shmangen debateve, në fakt i shmangen zbardhjes së dukurive, i shmangen së vërtetës, i shmangen si kryefrikacakë zhveshjes morale! Kujt i duhen, pra, këta frikacakë

A kemi elitë fetare në mesin e shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut, siç kemi elitë politike? Nëse elita politike vazhdimisht është përballur, madje edhe deri në debate, për ta propaguar të vërtetën dhe për të ngjadhnyer e vërteta mbi dukuri të ndryshme në këtë sferë, elita fetare sikur ka rënë në gjumë. Apo, nuk e kemi fare elitën fetare?

Tashmë botërisht dihet se elita politike në Maqedoni ka futur duart thellë edhe në elitën fetare dhe është determinuese e zhvillimeve dhe aktiviteteve fetare. Pra, ashtu siç do politika ditore, ashtu edhe zhvillohen aktivitetet fetare! Jo rastësisht, sot, e vetmja orgnizatë që sulmohet si filiale apo si shtab politik është Bashkësia Fetare Islame në RMV. Pse?

Sepse, u djegur politikisht! Tash e katër vite radhazi kjo Bashkësi sulmohet si bastion politik; tash e katër vite nëpër portale kombëtare “shëtitet” një dokument i lëshuar nga shërbimet sekrete serbe si shantazhë ndaj atyre që lehtësisht mundohen të ikin nga këto shërbime dhe, deri më sot, asnjë debat, asnjë ngjarje gazetareske mbi zbardhjen e këtij dokumenti apo mbi ata që e përkrahin personazhin e këtij dokumenti të UDB-së – Shaqir Fetain!

Të gjithë mediat e dinë se Shaqir Fetai është produkt i veprimeve të dyshimta politike të shërbimeve sekrete ndërkombëtare si dhe të vendit! (Ndërkombëtare, sepse, jo njëherë është fërkuar dhe ka dalur si përkrahës i politikave ruse të Putinit, saqë në kurth e ka futur edhe kryeministtrin teknik shqiptar të RMV-së, Talat Xhaferin)! Deri më



sot, asnjë debat, asnjë përpjeke mediale për ta zbardhur këtë të vërtetë! Kjo dëshmon se mediat tona (sidomos portalet) janë me themelues politik të personave që e duan megjellën informative. Mediat nuk duhet të jenë shantazhistë, as vjelës të taksave kundër atyreve që u pezullon mbi qafë gijotina! Thjesht, duhet të jenë dhe të bëhen zgjidhës të litarit të gijotinës që pezullon mbi qafën e të akuzuarve me fakte e me argumente (jo sipas politikave të inkuzicionit).

A debatuan ndonjëherë mediat e vendit (mediat shqiptare) mbi mënyrën se si u instalua Shaqir Fetai në krye të BFI-së? A debatuan ndonjëherë mediat shqiptare mbi aktivitetin spiunesk të Shaqir Fetait, qoftë kjo për ta zbardhur si të vërtetë apo si të pavërtetë këtë fakt! A debatuan ndonjëherë mediat shqiptare të RMV-së për ta zbardhur të vërtetën e Shaqir Fetait si produkt i shërbimeve politiko-policore të vendit dhe më gjërë? A u debatua ndonjëherë mbi të vërtetat (apo të pavërtetat) që shpërthejnë nga brendia e BFI-së? Jo, sepse, që të gjitha janë të shantazhuara, që të gjitha mediat janë të blera prej Shaqir Fetait me paratë e fitrit, ose, që të gjitha mediat e vendit janë nën direktivat e politikave të pushtetit që janë shumë të mëkatshme në rastin “Shaqir Fetai”!

Shaqir Fetai është rast unikat që duhet të studiohet në fusha të ndryshme, sidomos në fushën e shërbimit sekret si hoxhë klasik! Shaqir Fetai duhet të analizohet si dukuri politike e cila shkaktohet ekskluzivisht për t'i bërë dëm fushës fetare! A është analizuar ky dëm kolosal kolateral nga mediat shqiptare të vendit? Natyrisht që jo, sepse, ky hulument sot për sot gjendet nën “regjimin” politik si dhe të parave të pista!

Mediat e vendit, e kanë të gjallë personazhin politik (Nexhat Ibrahim) të cilin e paska spiunuar Shaqir Fetai! Pse nuk i ballafaqojnë të dy personazhet që të zbardhet e vërteta! Pse anashkalohe ky debat, i cili do të duhej ta zbardhte të vërtetën? Në mungesë të këtij debati, apriori opinioni duhet ta besojë si të vërtetë rrëfimin e Nexhat Ibrahimit, mikut studentor të Shaqir Fetait! Sepse akoma është gjallë pala e dëmtuar para të cilit heshtë si qyqar Shaqir Fetai, apo, duhet të heshtet sepse do të dëmtohet shumë subjekti politik-policor i cili e instaloi Shaqir Fetain në krye të BFI-së! Atëher, kjo flet se të gjithë mediat, të gjithë portalet, që e kursejnë Shaqir Fetain, janë në shërbim të dëmtimit të Bashkësisë Fetare Islame (për të mos thënë në krah të shërbimëve sekrete ku gjendet Shaqir Fetai) e cila ka arritur pozitën të cilën nuk e ka pasur kaq të mjerë në asnjë etapë të historikut të vet! Një ditë, kur do të studiohen këto etapa, pa dyshim do të diskutohen edhe faktorët që sollën deri në këtë pozitë të mjerë, madje do të fajësohen edhe më shumë se vetë Shaqir Fetai i

cili, asnjëherë nuk e ka mohuar se është njeri i keq, se është shpirtzi,  
se është i rrezikshëm, se është krenaria e UDB-së serbe!  
***/Kombetare/03.05.2024/***

## ***Kriza e pushtetit***

***Pushteti i pacënueshëm i drejtësisë është ai garanci e fuqishme e bashkëjetesës në harmoni në mes të shoqërisë dhe të gjitha pushteteve të tjera. Vetëm prishja e këtij balanci sjell krizën e pushtetit. Dhe krizat e tilla kurrë nuk përfundojnë pa largimin-ikjen e pushtetit. Historikisht, lëvizjet janë ato që ngjadhbnjejnë mbi çdo pushtet me krizë identitare***

***Nga Afrim Tahiri***

Këndvështrimet prej të cilave u qasemi fenomeneve, mënyra e qasjes, sasia e informacionit, pasojat e shkaktuara dhe të trashëguara nga fenomenet, dhe një sërë elementesh të tjerë, bëjnë që, vëllimi i trajtesave të jetë shumëfish më i madh se sa vëllimi i trajtesave të “shkarravitura” për bartësin apo shkaktarin e fenomenit. Sëkëndejmi, zhurma e bartësit të fenomenit është absolutisht shurdhuese në raport me zhurmën që ngritet në përpjekje për ta eliminuar fenomenin. Ç’është e vërteta, në shoqërinë tonë shumë shpesh ngatërrohet fenomeni me dukurinë, sepse, në fakt dukuritë edhe kur shkaktohen ato bëhen me qëllim që të marrin epitelin e fenomenit, si diçka e natyrshme, si diçka që nuk është në fuqinë tonë, ndaj dhe, si diçka që detyrimisht duhet të ndodhë!

Fundloja e dukurisë që “mëton” të marrë trajtat e fenomenit, arrihet përmes krizës identitare të “kujdestarëve” të së mirës së përgjithshme, përmes humbjes së fillit të së mirës. Kjo krizë identitare i hap udhë krizës së pushtetit dhe – këtu pastaj fillon lufta e domosdoshme e vënies së një rendi të ri, të një pushteti të ri, të një force racionale e cila do të di të përballet, ta eliminojë dhe t’i sanojë të gjitha pasojat e asaj krize të pushtetit.

Kriza e pushtetit nuk mund të vie pa vënë dorë mbi drejtësinë. Kur të kapet drejtësia, kur të gjitha dispozitat ligjore, të gjitha ligjet, të gjitha kodet, të gjithë gjyqtarët e prokurorët do të lidhen si “tespilh” në dorën e “mbretit”, kokrrat-rruzat e të cilëve ndërrohen me një gisht,

atëherë në zyren e pushtetarit instalohet “liria absolute” e veprimt diktatorial, pushtet ky i cili, pahetueshëm, e konsumon, e shpenzon, duke e sjellë në buzë të çmendisë pushtetmbajtësin.

Kriza e pushtetit, pra, vjen me kapjen e pushtetit të drejtësisë! Kjo bëhet për ta vjelur pushtetin—shoqërinë pa dhënë përgjegjësi-raport para askujt! Qëndrimi më i gjatë në pushtet farkëton dhe e bën të pathyeshëm lakminë për pushtet mbi thesarin e shtetit. Në ndërnie frymon edhe bindja racionale se tani erdhi koha për ikje nga pushteti. Kur ndodhë kjo ikje? Vetëm atëher kur pushtetmbajtësi nis e bindet se, ky pushtet që e ka lodhur, do të duhet t’ia kthejë borxhin, t’ia kompensojë këtë lodhje, duke i hapur dyert e thesarit të përgjithshëm. Pushtetmbajtësi nuk ik nga pushteti pa e sakatosur thesarin e shtetit, ndërsa kjo “sakatosje” është proces i gjatë, është si sharrimi i krahut – dhembja e trishtë të plandë gjysëm të vdekur kur të hasë sharra në kockë!

Pra, kriza e pushtetit, kriza e një ideologjie, kriza e një pune të shenjtë, shfaqet në momentin kur shfaqet edhe oreksi për vetëshpagim, kur të pjell djalli në tru e të bindë se, tani ka ardhur koha që t’i shijoshë përfitimet nga të qenurit në pushtet dhe nga drejtimi i gjatë i tij. Vetëshpagimi bëhet në mënyrë konkrete, “jo në natyrë” por, në të mira materiale që dalin nga thesari i shtetit, nga pasuria e përgjithshme, nga ajo që më së shumti u takon atyreve që u shërben si pushtetar.

Këtu pastaj zënë fill revoltat gjithëpopullore, zënë fill lëvizjet, të cilat nuk shuhet përdërisa nuk merr fund keqmenaxhimi me pushtetin dhe përdërisa nuk kryhen reformat e thella dhe gjithëpërfshirëse. Shoqëria sërish duhet të jetojë, e lumtur, e respektuar dhe me dinjitet. Pushteti i pacënueshëm i drejtësisë është ai garanci e fuqishme e bashkëjetesës në harmoni në mes të shoqërisë dhe të gjithë pushteteve të tjerë. Vetëm prishja e këtij balanci sjell krizën e pushtetit. Dhe, krizat e tilla kurrë nuk përfundojnë pa largimin-ikjen e pushtetit. Historikisht, lëvizjet janë ato që ngjadhnejnë mbi çdo pushtet me krizë identitare.

***/TS/07.05.2024/***

## **Shaqir Fetai i organizon kurbanët**

*Serioziteti dhe profesionalizmi i çdo subjekti, i çdo institucioni, i çdo personi publik, varet nga komunikimi me opinionin e gjërë. Pra, sa di të komunikoshë, sa je i gatshëm të komunikoshë, në ç'nivel je i prirur të komunikoshë, e gjithë kjo, tregon për synimet e mëdha dhe të shëndetshme që mund t'i ketë një institucion apo një person publik! E kundërta e kësaj – kemi të bëjmë me analfabet funksional*

*Nga Besijana Izairi*

Komunikimi është korniza e pasqyrës e cila reflekton angazhimin dhe punën e përpiktë (apo të dështuar) të një subjekti! Nëse raporti publik, komunikimi me opinionin është nonshalant, madje edhe përtej standardeve të amatorizmit, nëse ky komunikim është i nivelit të ulët, ndërsa vjen prej një subjekti me peshë, atëherë kemi të bëjmë me sabotim, ose me injorancë, ose me analfabetë funksional, të cilët, janë të prirur që më tepër të tallen me opinion se sa të ruajnë relacione të shëndosha dhe të ndërtojnë bazën e një historie që do të flasë për një periudhë të caktuar të një institucioni, subjekti etj.

Çka do të flasin komunikimet e të vetëquajturit “reis”, i cili në këtë post të rëndësishëm u imponua dhunshëm nga forca politike kombëtarisht e fetarisht shumë të dyshimta, ç'ka do të flasin “informatat për opinion” të tij të cilat janë diletanteske dhe tallje me realitetin.

Ja për shembull, le ta analizojmë përciptazi “informacionin” e fundit të Shaqir Fetait që e paskësh postuar në paçavurën e tij (fb) e që flet për “mbledhjen e rregullt të rijasetit”! Paskan “diskutuar gjërë e gjatë mbi këto pika të Rendit të ditës”! (kujdes! Fjalën “rendi” e nis me “R” të madhe!!!)

## **Analiza e Procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**

Edhe procesverbalin e shkruan me “P” të madhe, thuase kemi të bëjmë me “shkrim të shenjtë”! Pastaj, vetëm diletantëve, vetëm analfabetëve funksional mund t’u rrapëllojë mendja se në mbledhje mund të “analizohet Procesverbalit” nga mbledhja paraprake! Procesverballi dorëzohet me ftesën dhe materialet tjera të përgatitura për mbledhjen e thirrur. Anëtarët e organit i lexojnë materialet, përgatiten, analizojnë dhe, në mbledhjen e thirrur E MIRATOJNË, ose jo, procesverbalin!

Informim mbi aktivitetet dhe rezultatet e Muajit të Ramazanit;

Kush kë e informoi?! Kësisoj informohen vetëm oganizatat nëntokësore, ato struktura kriminale që bëjnë bilancin e një aktiviteti të poshtër që kanë ndërmarrë sa për t’i forcuar pozitat në një botë të dyshimtë e të pistë!

Rezultatet nga Muaji i Ramazanit janë të personalizuar ekskluzivisht për “boss”-in Shaqir Fetai, apo, janë për mbarë opinionin e vendit! Duke i bërë transparente, duke i publikuar këto rezultate, edhe vetë xhematet e vendit do të vërejnë se ku janë, se kush më mirë i kryen obligimet fetare, kush nga xhematet është më korrekt për sa i përket taksave fetare; vërehet se kush është më dobët, alizohet se pse aty ngecin punët, jepen propozime si të punohet me atë xhemat, si të shtohen rezultatet, si të gritet sa më shumë vetëdija fetare.

Vite më parë, çdo cent që hyntë në BFI bëhej transparent. Dihej se sa kontribute kanë hyrë nga mërgimtarët, nga komuniteti ynë i vendosur nëpër qytete e qendra të ndryshme perëndimore. Krejt kjo jo vetëm për lavdërim, por edhe për kritikë publike ndaj atyreve që përgjigjen dobët në zbatimin e obligimeve fetare.

Kështu siç vepron Shaqir Fetai, në këtë mënyrë kaq “sekrete”, krijohet terreni ideal për vjedhje, për humbje të gjurmëve, për manipulime e keqpërdorime, pa dhënë përgjegjësi para askujt! Ky është i vetmi synim i Shaqir Fetait!

Analizë e punëve në organizimin e Haxhit 2024 dhe obligimet tjera deri në nisjen e haxhinjëve;

Edhe zogjtë e malit e dinë se Haxhi i vitit të kaluar ishte me çmim astronomik, i përcjellë me shumë vjedhje, që nga udhëtimi e deri te kontratat me pronarët e hoteleve. Asnjëherë nuk i zbardhën këto vjedhje, ndonëse analizat e pavarura flasin për një vjedhje pej 250-300 mij euro!

Nuk u tha publikisht e zyrtarisht akoma, madje as në këtë mbledhje se, cili është çmimi i sivjemë i Haxhit! Kjo do të thotë se ka ngelur i njëjti çmim! Nga haxhi i vitit të kaluar e deri në haxhin e

sivjemë inflacioni ka prekur gjithandej nëpër botë, janë rritur çmimet, është rritur standardi, ndërsa Shaqir Fetai e mbanë të njëjtin çmim astronomik të vitit të kaluar! Pse? A ishte çmimi i vitit të kaluar shumë i lartë sa që e përballon edhe inflacionin e sivjemë, apo ka vendosur që sivjet të jetë “më korrekt” dhe të vjedhë sa më pak, me qëllim që të mbulohen shpenzimet e haxhit!

Projekti i grumbullimit, therrjes dhe ndarjes së mishit të kurbanëve;

Phu, çfarë fjalie e poshtër, çfarë “pike e rendit të ditës”! Kjo flet vetëm për komplekset e një sharllatani kur të gjendet në mesin e sharllatanëve të tjerë ku vërenë se megjithatë në atë mes gjendet edhe një i urtë! Atëherë avdalli ia këputë fjalive duke bluar edhe një të tillë si kjo e pikës katër të rendit të ditës!

Grumbullimi, therrja dhe ndarja e mishit po na u bëka me projekt?! Në tërë këtë aktivitet “projekti” zë vend vetëm në vjedhje të mishit! Dihet sa mish jepet për të varfërit, sa ndalet për nevojat e Medresesë me nxënës gjithnjë e më të paktë dhe, se sa mish vidhet! Natyrisht, vidhet më shumë se shpërndarja për fukatratë, se ndarja për Medresenë! Paramendoni grumbullimin e mishit me projekt! Paramendoni therrjen e kurbanëve me projekt! Shaqir Fetai duke dashur të tregohet sa më “profesional” e më “institucional” në fakt del kokrra e sharllatani! Aq shumë ka diletantizëm e sharllatantizëm te Shaqir Fetai sa, lirisht mund të gatuhet një brum për mijëra barcaleta humoristike dhe, ky brum, fatkeqësisht, nuk mund të shërbejë si materie serioze arkivi i një Institucioni serioz! BFI-në, fatkeqësisht, Shaqir Fetai e ka shndërruar në një “organizatë” sharllatanësh me qëllim që të ketë një “falore” ku do të lavdërohet e madhërohet kryesharllatani, siç do të ngelë përjetë ky farë “reisi” prototip i analfabetit funksional.

Po kush mund të shkruajë përveçse një analfabet funksional se, mbledhja na qenka mbajur “në një ambient të gjallë”! Po pse këta të “rijasetit” të Shaqir Fetait po mbakëkan mbledhje edhe në “ambient të vdekur”! Ja si na informon Shaqir Fetai: “Mbledhja u mbajtë në një ambijenti të gjallë, diskutime konstruktive dhe racionale, dhe pas të cilave u sollën kinluzat edhe ate me sa vijon...”

Kurse “kinluzat” (konkluzat) janë “fenomen” më vete, janë argumenti më plastik që flet se, këtyre të “rijasetit” të Shaqir Fetait u ka ikur mendja për lesh! Po a mund të jetë konkluzë fjalia “Çështja e haxhit tashmë ka marrur rrugën e vet të mbarë”? A mund të jetë konkluzë “U caktua komisioni republikan i organizimit të kurbanëve”? Organizimi i kurbanëve? Veç Shaqir Fetai, ky farë analfabeti funksional, di t’i “organizojë kurbanët”!

Dhe fare në fund të “informatës” së Shaqir Fetait, vjen fjalia “Reisul Ulema i BFI e RMV ju shprehi falënderime të përzemërta të gjithë faktorëve, prej atyre republikan e deri tek besimtarët.” Cilët faktorë republikan i falënderon Shaqir Fetai, kur dihet që faktorë republikan mund të jenë ushtria, policia, shërbimet sekrete, kryeministri, kryetari i shtetit, apo edhe partitë në pushtet! Mos e ka nënvizuar këtë gafë Shaqir Fetai qëllimisht, sepse, apo, nesër i duhet që t’i shpreh falënderime të gjithë atyre faktorëve republikanë që e instaluan dhunshëm në krye të BFI-së?

Kur jemi te këta faktorë – a diskutoi diçka në këtë mbledhje Shaqir Fetai pikërisht për vërejtjet aktuale të këtyre faktorëve republikanë, të cilët, e akuzuan Shaqir Fetain se BFI-në e ka shndërruar në filiale dhe në shtab të BDI-së? Madje këto vërejtje e këto akuza janë regjistruar edhe në bllokun e shënimeve të faktorëve ndërkombëtarë që kanë monitoruar zgjedhjet e 24 prillit dhe 8 majit? Pse nuk pati një pikë në këtë rend të ditës ku do të debatohej mbi këto akuza të padenja për BFI-në, si dhe, pse nuk u tha asnjë fjalë për akuzat e opinionit se njerëz e bashkëpunëtorë të Shaqir Fetait kanë blerë vota me paratë e fitrit (madje pati edhe të burgosur nga këta bashkëpunëtorë)!

Dështimet flagrante, të njëpasnjëshme si dhe skandalet e turpshme nuk mundet Shaqir Fetai t’i mbulojë me mbledhje ku do të theksojë “rezultate të paimagjinueshme” të Muajit Ramazan, dhe as me “organizim të kurbanëve”! Shaqir Fetai duhet të mbajë mbledhje madje edhe të kërkojë që “organet e tij” të debatojnë për dështimet e njëpasnjëshme, për vjedhjet e fitrit, të zeqatit, të haxhit, të kurbanëve si dhe vjedhjet e vakëfit, të hyrat nga vakëfi apo nga letrat në vlerë vlere e të cilave asnjëherë nuk u bë publike. Megjithatë, ndëshkimi gjithnjë i ka zënë hajnat, fajtorët, kriminelët.

Vjedhsit e vakëfit, nuk mund që këtë dëm ta fshehin me dëmet e eskavatorëve që po punojnë e po rrënojnë këto ditë brenda oborrit të Xhamisë Mustafa Pasha! Askush nuk di se çka po punohet aty dhe pse me makineri të rëndë, si dikur Pasko Kuzmani i Gruevskit në Kalanë e Shkupit! Aq e rëndë është vjedhja e vakëfit sa duhet të mbulohet me eskavatorë?!

***/1KlikLarg/08.05.2024/***



## **Të departizohet dhe depolitizohet BFI-ja**

*Pushteti aktual tashmë është i detyrueshëm që të reagojë dhe ta çlirojë sa më parë Bashkësinë Fetare Islame nga procesi i bdezimit të saj. Pushteti aktual i detyrohet myslimanëve të vendit që t'ua rikthejë dhe t'ua sigurojë një Institucion të blinduar nga çfarëdo neo-tentative të partive për t'i ngulur thonjtë e interesit në këtë Institucion; t'ua rikthejë dhe t'ua lëshojë në dorë subjekteve reformuese dhe progresiste tërë atë shkëlqim të pastër fetar islam që e ka pasur dhe që i takon ta ketë BFI-ja*

*Nga Mr. Eset Shaqiri*

Ndërrimi i pushtetit nuk nënkupton vetëm ndryshim qeveritar por, ky ndërrim prek “pushtetet” e ngritur në çdo digaster, në çdo eshalon, madje edhe në çdo organ e institucion të themeluar përgjatë qeverisjes. Mund edhe të mbyllen, varësisht nga konceptimi politik i pushtetit të cilin e ka ideuar partia që fiton të drejtën e drejtimit të qeverisë.

Me rastin e ndërrimit të pushtetit preken edhe ato institucione e organizata që nuk kanë të bëjnë asgjë me politikën dhe me organet politike të shtetit por që në krye të tyre janë instaluar drejtues të instrumentalizuar nga pushteti paraprak. Më së rëndi ky proces i spastrimit politiko-partiak zhvillohet nëpër institucionet fetare ku politika ditore, për interesa partiake, ka ngritur një konstrukt, një instalacion hibrid, i cili, me patjetër duhet që të dekonstruohet deri në gjendjen si ka qenë pa i futur duart politika.

Dua të shtroj pyetjen dhe të ngris çështjen e Bashkësisë Fetare Islame në RMV, të këtij Institucioni fetar mbi të cilën, politikat partiake të pushtetit që po ikë, ia dolën ta shndërrojnë në filiale e në shtabe të papërfillshme të nëndegëve partiake! Askush nuk guxon të shpresojë në amnesti, e aq më pak të amnistohet! Forcat e reja të pushtetit të ardhshëm duhet të dëshmojnë se janë për reforma të thella

shoqërore, se janë të gatshme ta luftojnë korrupsionin, padrejtësinë dhe instalimet e mekanizmave degjeneruese pikërisht duke filluar nga shpëlarja e institucioneve fetare prej llumit partiak që, nëse vazhdon si i pa prekur, atëherë, do ta kemi skajshmërisht të radikalizuar sektarizimin e institucionit fetar.

LSDM tashmë kaloi në opozitë! BDI-ja, e cila, për 23 vjet rresht drejtoi me fatet e shqiptarëve në RMV, tashmë sikur po pajtohet me faktin që është e drejtë absolute e VMRO-së të bëjë koalicion qeveritar me ato parti me të cilat mendon se mund ta qeverisë vendin pa problem! Pra, edhe BDI-ja, si prijatë e Frontit Evropian, po bëhet gati të kalojë në opozitë! Kalimi në opozitë e një partie përcillet me porosinë e nënkuptueshme që thotë se, të gjithë drejtuesit e instaluar nga kjo parti, do ta kenë fatin e të kaluarit në opozitë, si matrica e tyre! Dhe, pjesa dërmuese e drejtuesve të institucioneve, organiztave, organeve e enteve të ndryshme, ose japin dorëheqje, ose e presin “afërën e kurdisur” e cila ua përshpejton shkarkimin nga posti drejtues! BDI nuk do të guxojë t’i drejtohet që të tërhiqet, por as që do të mundohet ta mbajë edhe më tej si instalacion të pësthirë Shaqir Fetain në krye të BFI-së, sepse, me autmatizëm dhe publikisht do të pranonte fajësinë fatale të saj mbi degradimin deri në këtë derexhe të papërballueshme të BFI-së.

Shaqir Fetai, si marionetë e BDI-së, duhet ta ketë kuptuar deri më tani se, momentet e tij në krye të BFI-së po përfundojnë, se sa më parë që do të vetëlargohet aq më mirë do të jetë për të dhe për Institucionin.

Sepse, pushteti aktual tashmë është i detyruar që të reagojë dhe ta çlirojë Bashkësinë Fetare Islame nga procesi i bdizimit të saj. Pushteti aktual i detyrohet qytetarëve të vendit me përkatësi fetare islame, që t’ua rikthejë dhe t’ua sigurojë një Institucion të blinduar nga çfarëdo neo-tentative të partive për t’i ngulur thonjtë e interesit në këtë Institucion. Pushteti aktual duhet t’ua rikthejë dhe t’ua lëshojë në dorë subjekteve reformuese dhe progresiste tërë atë shkëlqim të pastër fetar islam që i takon ta ketë BFI-ja. Pushteti aktual duhet që urgjentisht, madje, që nga ky Institucion, të dalë me konstatime mbi ndikimet dhe tendencat e ish-pushtetit për të degraduar, degjeneruar dhe shkatërruar çdo aset të shenjtë të shoqërisë së këtij vendi. Pushteti i ri, nëse nuk ka informacione të mjaftueshme, duhet të ulet me drejtues të Lëvizjes Myslimane për Reforma në BFI dhe të jetë sa më e qartë mbi tendencat sektariane dhe mbi radikalizimin e strukturave të caktuara që pushteti i cili sapo iku kishte planifikuar t’i ndërmerre dhe t’i zhvillonte në dëm të fesë islame dhe të myslimanëve të vendit. Pushteti aktual duhet të interesohet dhe të hedhë dritë mbi shumë raste që flasin për korrupsion, për vjedhje dhe për veprimtari subversive që

do ta dëmtonin shtetin, shoqërinë por që do ta “lartësonin” strukturën politike që sakaq do të na dilte si “shpëtimtare e vendit”! Për të manipuluar situata duhet njerëz të manipulueshëm!

Mbi të gjitha, janë të mjaftueshëm faktet e pamohueshëm që gjatë fushatës zgjedhore u diskutuan në opinion për “rijasetin” e Shaqir Feait, për BFI-në, si për shtabe zgjedhore të BDI-së! U zunë hoxhallarë me paratë e fitrit në xhep duke blerë vota, u fotografuan e u inçizuan makinat zyrtare të BFI-së, të Myftinisë së Shkupit, të Tetovës, të Gostivarit etj. të parkuara natë e ditë para shtabeve partiake të BDI-së. U përcollën e u identifikuan qindra bashkëpunëtorë të Shaqir Fetait duke u angazhuar në animimin e xhemeve për të votuar sa më masovikisht për BDI-në, ndërkohë që në vetë Çegranin e tij nuk ia doli të ndikojë për ta votuar BDI-në.

Askush asgjë nuk ka kundër BDI-së! BDI-ja e ka të drejtën absolute për të zgjeruar shtabe e veprimtarë nga profile të ndryshëm, pra, edhe hoxhallarë. Por, ja që hoxhallarët, institucionet fetare, nuk e kanë të drejtën, madje kategorikisht duhet të qëndrojnë sa më larg institucioneve fetare dhe sa më larg të ushtruarit të profesionit hoxhë nëse pranojnë që të instrumentalizohen nga cilado parti! Së këndejmi, Shaqir Fetai i instrumentalizuar partiakisht, sa më parë duhet të ecë që të deinstrumentalizohen edhe nëpunësit e tjerë si dhe të marrin fund praktikat e përzierjeve politike-partiake në Bashkësinë Fetare Islame, sepse, në të kundërtën, ky institucion do të shndërrohet në bastion të përhershëm të bastardëve partiakë. Këta “bastardë” duhet të deklarohen qartë nëse janë për profesionin e shenjtë të hoxhës apo parapëlqejnë të vazhdojnë si marionetë partiakë. Pushteti i fuqishëm dhe i sinqertë nuk ka nevojë për marioneta, porse, ka nevojë për institucione stabile, për shoqëri të qetë dhe për strategji afatgjate që do ta ngrisin cilësisht standardin e jetës. Vetëm këssoj, si dhe duke e çrrënjosur korrupsionin, padrejtësinë, depolitizimin dhe departizimin e institucioneve, pushteti do të shtojë forcën e vet dhe, me këtë, edhe mirëqenien në vend.

***/TS/13.05.2024/***

## **BFI në fazën e fundit të degradimit!**

Nuk ka gjasa të jeshë i sinqertë e të keshë marëdhënie pune në këtë BFI që punon në kundërshtim me Kushtetutën e vet! I sinqertë në BFI mund të jeshë vetëm nëse i nënshtrorësh rregullave të lojës së BDI-së të cilës i përkasin të gjithë anëtarët e Rijasetit, pa përjashtim (megjithatë, me përjashtim të njërit që është me LSDM).

Gjithsesi, janë me dhjetra nëpunës të BFI-së që u punësuan me rekomandim të partisë, duke filluar madje që nga Shaqir Fetaj!

Në BFI-në aktuale mund të llogaritesh i sinqertë vetëm nëse i shërben partisë, nëse ia puthë dorën një kandidati partiak, nëse me para vakëfi blenë vota, nëse zyret e vakëfit shndërrohen në kuvende partiake ku zyrtarë partiak dhe policor gostiten me “sheqerpare”, nëse me makinat zyrtare zhvillohen aktivitete partiake, nëse iftaret (madje edhe syfyret) organizohen për t’ua mundësuar dhe lehtësuar fushatën partisë!

Nëse mendoni se jemi gabim, parashtrohet pyetja:

Cili nga anëtarët e Rijasetit, cili myfti, cili drejtor, dekan ose profesor i Medresesë, FSHI-së etj. e tha të paktën gjysëm fjale kundër gjithë asaj çfar po ndodh me BFI-në?!

***/LMR në BFI/15.05.2024/***

## Mania për të gënjyer

Bashkësia Fetare Islame e Shaqir Fetait jeton dhe funksionon nën incencionin e manisë së vetme psikopatike – për të gënjyer! Mjermanët e BFI-së së Shaqir Fetait, për t’u rrëfyer si “punëtorë”, gënjeshtren e thurrin dhe e ndërtojnë në funksion të vetëlavdërimit! Opinioni i gjërë i kritikon për vjedhje, për tradhëti, për veprime antiislame, për degjenerim, për degradim, ndërsa honxho-bonxhot e Shaqir Fetait thonë

“BASHKËSIA FETARE ISLAME NË MESIN E INSTITUCIONEVE MË TË BESUESHME NË RMV”!

Me këtë titull e ilustruan “informacionin” që kishte të bëjë rreth anketës së fundit të zhvilluar nga IRI mbi besueshmërinë e qytetarëve në institucionet e vendit.

Kjo anketë ka nxjerrur përfundimin se qytetarët e vendit besueshmërinë më të madhe e kanë në bashkësitë fetare. Kështu thotë IRI, kurse marionetat e Shaqir Fetait thonë se, Bashkësia Fetare Islame qenka ndër institucionet më të besueshme të vendit.

Natyrisht, kjo rrenë i ka irituar tej mase drejtuesit e këtij Instituti me renome botërore dhe, t’ia shtrembëroshë faktet, t’ia imputoshë “pëfundimet” që dalin nga kokat psikikisht të parehatueshme, kjo është idiotizëm. Kurse me idiotizma asnjëherë nuk është marrur ky Institut amerikan.

Në Maqedoninë e Veriut funksionojnë (sipas listës së Agjencisë për Kishën dhe bashkësitë fetare) 13 Kisha si bashkësi apo komunitete fetare dhe, 10 bashkësi fetare, pra, gjithësej 23 bashkësi fetare, prej të cilave komunitetit mysliman u takojnë tri bashkësi fetare islame (Bashkësia Fetare Islame, Bashkësia Fetare e Bektashinjëve si dhe Bashkësia Islame Selefiste “Dar el Hadis”)!

Veç kësaj, anketat zakonisht kryeh në një kampion prej 1030-1300 qytetarë dhe, në rastin konkret, sipas duduëve të Shaqir Fetait, po na del që IRI i paska pyetur të gjithë qytetarët myslimanë, sepse, të tjerët nuk mund të përgjigjen se Bashkësia Fetare Islame qenka institucioni më i besueshëm! Dhe, kësaj gënjeshtre i bashkangjitet edhe Shaqir Fetai, i vetëquajturi “reis”!

Edhe “reis” edhe rrencak – kjo i ngjanë vetëm Shaqir Fetait!

Në këtë anketë, shihet se bashkësive fetare në vend u besojnë shumë 25 për qind e qytetarëve të anketuar. Nëse në vend funksionojnë 23 bashkësi fetare, atëherë po i bie që këtyre institucioneve fetare po u besuaka mesataisht vetëm nga 1 për qind e përfaqësuesve të tyre! Pra, bashkësisë fetare islame i beson vetëm 1 për qind e qytetarëve të vendit të anketuar, aq sa u besojnë edhe të tjerave dhe, në total, kjo besueshmëri arrinë përqindjen prej 25 % të qytetarëve që u besojnë shumë këtyre bashkësive fetare.

Kështu duhet të lexohen anketat dhe jo të shtrembërohen sipas qejfeve të Shaqir Fetait, i cili nuk e ka për dert edhe të gënjejë fort vetëm e vetëm që të hedh pak pluhur mbi skandalet që po e përcjellin në çdo hap të tij të dyshimtë. Si mund të besohet shpirtërisht një institucion, qoftë si subjekt fizik qoftë si subjekt juridik, nëse brenda tij vlon nepotizmi, vlon vjedhja, tradhëtia, militantizmi partiak, veprimet sektariane politike, degradimi, shkatërrimi dhe, mbi të gjitha, mania për rrenën?

Kjo përqindje e besueshmërisë së qytetarëve në bashkësitë fetare të vendit duhet të jetë mjaft e frikshme dhe shumë alarmante dhe, assesi të kuptohet si barometër e mirë e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve fetare. Të pyeten në një anketë anëtarët e 23 komuniteteve fetare të regjistruara në vend dhe, përgjigja në grafën “i besoj shumë” të jetë vetëm 25 për qind, kjo duhet të jetë mjaft brengosëse, sepse, besueshmëria e lartë nuk e kalon 1 përqindëshin e komuniteteve ndaj institucionit të vet fetar. Kësaj mund t’i gëzohet vetëm Shaqir Fetai dhe marionetat e tij lehtësisht të manipulueshme !  
***/LMR në BFI/16.05.2024/***

## ***Kolltuku i shtrenjtë mbi kurriz të popullit***

***Po flitet se, Shaqir Fetai, ky farë intslacioni i dhunshëm në krye të BFI-së nga forcat destruktive e antiislame dhe antishqiptare, na e paska rrogën shumë të madhe, sa katërfishi i kryetarit të shtetit!***

***Zatën, për këtë rrogë ia nguli thikën pas shpine ish-“babait” të vet! Për këtë rrogë tradhëtoi e po tradhëton. Tradhëtia ndaj idealit është shumëfish më e tmerrshme se ndaj individit! Kë nuk e tradhëtoi Shaqir Fetai?***

***Nga Venera Mahmuti***

Ju kujtohet ish-reisul ulemaja i BFI-së? Trim po, i guximshëm po, politikan i regjur po, drejtues dhe menaxher shumë i suksesshëm po, por, kishte një të metë! Nuk i zinte besë askujt? Gjithnjë ndërmerre masa, gjithnjë shtonte, freskonte, ripërtërinte ekipin, sepse, e kishte droje kolltukun! Do t’ia merrte dikush! Ndaj, gjithnjë sillte “forca të reja” që do t’ia garantojnë lojalitetin dhe besnikërinë! Në fund, po këta njerëz, të cilëve ua kishte lënë në dorë shpirtin e vet, të cilëve u besonte më shumë se çdokujt tjetër, pikërisht këta, ia ngulën thikën pas shpine! Iu bindën shërbimeve sekrete, urdhërave antiislame dhe antinjerëzore dhe, u tubuan me një urdhër nëntokësor, brenda natës, për ta spostuar nga karriga e reisit, madje e turpëruan, madje e dëbuan, madje sollën vendim që, kush flet me të në telefon “nuk është prej nesh”!

Borxhliu gjithnjë mendon se si ta likuidojë personin të cilit i ka borxh, gjithnjë e mendon lirim prej tij, pra, jo kthimin e borxhit por, si të lirohet prej tij! Belaxhiu që ka plagosur ndonjë të pafajshëm gjithnjë i ruhet, i ka peng plagët e tij, ose, ai që ka rënë në gjakë, që ka vlarë dikë, gjithnjë ruhet, nuk do takim e kontakt as me pjesëtarët e largët të familjes së viktimës, sepse, i ka borxh material, borxh moral, e borxh gjaku! Mu si Shaqir Fetai Sulejman Rexhepit!

Prandaj Shaqir Fetai natë e ditë i përcjell njerëzit se kush flet,

apo kush kontakton me Sulejman Rexhepin, apo me njerëzit e tij! Sulejman Rexhepi e bëri njeri, e bëri profesor, e bëri drejtor sektori, e bëri myfti, ndërsa Shaqir Fetait syri i kishte ngelur te rroga e tij! Në fakt, këtë punën e rrogës e ka shpikur kohëve të fundit, sa për ta kamufluar tradhëtinë që e bëri! Më mirë të quhet lakmitar i kolltukut se sa tradhëtar i idealit!

Tani, meqë Shaqir Fetai nuk di të funksionojë ndryshe përveçse ta imitojë ish-reisin e vet, të bëjë po ato punë që i bënte ai, të veprojë po ashtu siç vepronte ai, të marrë po atë rrogë që e kishte edhe ai, pra, meqë është tërësisht i varur nga mësimet dhe veset e tij, ka filluar të bëhet një Sulejman Rexhepi i vogël, të bëhet kopja e tij e zbehtë, me një dallim që ai (Sulejman Rexhepi) ishte lider karizmatik e ky (Shaqir Fetai) është analfabet funksional! Kontrollon telefonatat, paguan njerëz që t'i përcjellin dhe t'i fotografojnë eventualisht nëse takohen me Sulejman Rexhepin, ka nisur të punësojë dhe t'i avancojë njerëzit e vet, mu ashtu siç paska pas bërë pararendësi i vet! Po flitet se Shaqir Fetai po blenë përkrahje dhe siguri të kolltukut duke ua dhënë nga një rrogë ekstra njerëzve të vet. Pra, Shaqir Fetai sjell vendim “në Rijaset” për t'i paguar ekstra vetëm ata për të cilët ai shpreh dëshirë, ndërsa ata për të cilët ka dyshime se janë në komunikim me Sulejman Rexhepin, nuk ka dhuratë, nuk ka ndonjë pagesë ekstra, nuk ka rritje të rrogave, nuk ka mëditje, nuk ka lëvizje në terren.

Nga BFI-ja qarkullojnë muhabetë se të gjithë ata që dëshirojnë ndonjë pare xhepi, duhet të jenë pulena të Shaqir Fetait, ndryshe, ata që nuk pajtohen me “politikat e tij” antiislame dhe antishqiptare ata, jo që nuk kan shpërblime por edhe mund të ecin nga puna! Shaqir Fetai mendon se BFI-ja është firmë e tij private dhe se të punësuarit aty i paguan nga malli i vet. Pra, tërë buxheti i grumbulluar nga fitri, nga zeqati, nga kontributet e ndyshme islame, nga kafshata e gojës së myslimanëve të ngratë, Shaqir Fetai mendon se janë të vetat ndaj dhe, nga aty mund të “marrin” vetëm ata që japin përkrahje, lojalitet dhe dashuri të pederaftë ndaj Shaqir Fetait.

Pra, nëse Sulejman Rexhepi punësonte njerëz që do t'ia shprehin përkrahjen, Shaqir Fetai këtë përkrahje e “siguron” përmes punësimeve të reja (kryesisht analfabetë funksionalë) dhe përmes kushtëzimeve të poshtra ndaj të punësuarve që nga koha e Sulejman Rexhepit, të cilët, nëse dëshirojnë ngritje të rrogave, shpërblime e rrogën e trembëdhjetë, duhet të rrinë sa më larg efendi Rexhepit dhe t'ia shprehin krejt dashurinë “efendi” Fetait, këtij farë “ORAO”-s (kjo paska qenë nofka e Shaqir Fetait si bashkëpunëtor i UDB-së).

Shaqir Fetai e ka degraduar BFI-në deri në një “sipërmarrje” të kotë e fiktive, ka punësuar dhe ka “betonuar” plotë analfabetë



funksionalë, lojalistë marioneta, të cilët i ka të lidhur për gisht të mesëm dhe, të cilët, do të lëviznin vetëm kur Shaqir Fetaj do ta lëvizte këtë gisht! Këtij avdalli nuk i intereson profesionalizmi, nuk i intereson kualiteti i punës, nuk i intereson misioni i shenjë, avancimi i jetës fetare islame, por, thjesh, i intereson vetëm që të përceptohet si “mesi”, si “shpëtimtar” e si “misionar” rreth të cilit duhet të sillen të gjithë të tjerët, mu si mizat poshte bishtit të kalit.

Po këtyre mirë t’ju bëhet, sepse, hoxhallarët janë e vetmja kategori që nuk kanë sindikatë të tyre që do t’ia mbronte të drejtat dhe që do t’ua siguronte liritë elementare të një punëtori apo nëpunësi. Dhe nuk e kanë e nuk e krijojnë vetëm për shkak se duhet të paguajnë anëtarësi, nga një tarifë simbolike mujore apo vjetore! Prandaj, aty ku mungon maçoku minjtë bëjnë dasëm!

***/1KlikLarg/20.05.2024/***

## ***Institucioni me zero autoritet***

***Institucioni fetar (i cilës do fe qoftë ai) është apartiak dhe mbipartiak, është i të gjithëve dhe të gjithë duhet të jenë në obrellën e tij, qofshin këta edhe militantë partiakë apo drejtues partish, sepse, janë përkatës të komunitetit fetar! Kur institucioni fetar nuk përfillet fare nga populli, nuk është problemi te populli por te vetë institucioni dhe te drejtuesit e tij***

***Nga Mr. Eset Shaqiri***

Partitë politike, përgjatë kësaj periudhe të sistemit plural, jo që nuk kanë hedhur emra teologësh nëpër lista kandidatësh për deputetë, jo se kanë qenë inferior ndaj kësaj kategorie të shoqërisë sonë, porse, ja që asnjëherë nuk ia kanë dalur të kenë sukses, do me thënë, nuk ia kanë arritur ta bindin elektoratin për t'i votuar hoxhallarët për deputetë. Kandidatë të tillë ka pasur si në taborrin opozitar ashtu edhe në atë të pushtetit.

Bashkësia Fetare Islame në RMV, si gjithnjë, ose “nuk është përzier fare”, as nuk e ka përkrahur dhe as nuk e ka luftuar, ose e ka kundërshtuar “heshturazi” kandidatin teolog të propozuar nga partitë! Kjo për faktin se, këta kandidatë, nuk e kanë pasur “bekimin” e Institucionit fetar islam! Kjo u provua qysh me ish profesorin e Medrese “Isa Beu”, Sabaudin ef. Mahmuti, i cili nga PDSH-ja opozitare u propozua si kandidat për deputet!

Po çka ndodhë nëse teologët kandidatë për t'u bërë deputet marrin bekimin e BFI-së! Çka ndodhë me (mos)suksesin zgjedhor aty ku sot përzihet apo vullnetarisht angazhohet BFI-ja?

Dështimi i BFI-së (por edhe i subjektit për të cilin angazhohet ky Institucion) është i garantuar, sepse:

1. BFI-ja aktuale është pa matricën e vet gjenetike,
2. BFI-ja është pa autoritet, e papërfillshme në opinion dhe,
3. BFI-ja ka zero ndikim në popullatën e vet.

Zgjedhjet e fundit dëshmuar për një fenomen shumë të çuditshëm

dhe, njëherazi, edhe shumë të vërtetë! Myslimanët e devotshëm të Maqedonisë së Veriut, kjo që gjithnjë dhe masovikisht i ke nëpër xhami, kjo që gjithnjë dhe masovikisht i përgjigjen obligimeve fetare, kjo që gjithnjë dhe masovikisht i paguajnë taksat fetare – tërë kjo nuk do të thotë se pajtohen me politikat naive të analfabetëve që po na shiten si “shpëtimtarë”, por, thjesht, dëshmojnë devotshmërinë e vet dhe ndërgjegjësimin e tyre fetar. Ndërsa, barometër se sa kjo popullatë është me BFI-në le të shërbejnë pikërisht këto zgjedhjet e fundit presidenciale dhe parlamentare!

Si asnjëherë më parë në këto zgjedhje të fundit BFI-ja u shndërrua në “shtab qendror” të pushtetit LSDM-BDI! Nën siglën e BFI-së haptazi u përhapën parullat “është haram të votohet”, të gjithë subjekti fetar i Maqedonisë Lindore u ngrit në këmbë për ta ndihmuar teologun që pati “bekimin” e BFI-së, Sulejman Baki, kandidat ky i Frontit Evropian, por që nuk ia doli, humbi! Myftinia e Tetovës në krye me Qani Nesimin u shndërrua në shtab kryesor të BDI-së ku madje qeraseshin edhe me sheqerpare për ta ëmbëlsuar bashëpunimin në mes të kësaj “myftinie” dhe strukturave policore të pushtetit në Tetovë! Makina zyrtare e Myftinisë së Shkupit, vendparkim kishte gjetur te shtabet e BDI-së. Makinat zyrtare të pushtetit e të BDI-së vendparkim kishin gjetur nëpër oborret e muftinive të BFI-së gjithandej Maqedonisë së Veriut. Tërë kjo përzjerje e BFI-së rezultoi me fiasko, me një humbje të turpshme. Me tërë atë infrastrukturë shtetërore nuk ia doli që të ketë një përfaqësues të vetin në Parlament! A nuk është kjo një dëshmi e gjallë se popullata e vendit nuk i nënshtrohet urdhërave të BFI-së, se kjo popullatë nuk e ka as më të voglin respekt ndaj këtij Institucioni të padinjitetshëm dhe pa integritet?

Nga ana tjetër, “armiqtë” e BFI-së, teologët e respektueshëm, si ish-myftiu i Strugës, Salim Sulejmani, i shkarkar nga Shaqir Fetai, ashtu (me gjasë) edhe Adnan Azizi, të dy këta kandidatë në listën e koalicionit shqiptar VLEN, e cila shumë ashpër u luftua si nga BDI ashtu edhe nga BFI, ia dolën që të bëhen përfaqësues të popullit shqiptar e mysliman në Parlamentin e Maqedonisë së Veriut!

Cilat do të jenë të mirat që do t’i gëzojë BFI-j nga këta dy teologë? Aktualisht, ky Institucion këta dy deputetë të VLEN-it i llogarit si armiq të vetin. Dhe, shtrohet pyetja, sa është islamikisht e pranueshme që t’i nënshtrohesh me kërkesa islame “armikut antiislam”? Nëse i nënshtrohesh – humb dinjitetin (nëse e ke), nëse nuk do t’i nënshtrohesh “pushtetit të armikut”, bota e ka shpikur kaherë shpëtimin – emigrimin, ose azilin!

Është shumë e rëndë jeta pa dinjitet dhe pa integritet. BFI-ja nuk mund të emigrojë, por ama, drejtuesit e saj aktual duhet të “emigrojnë” një orë e më parë dhe të nisin vegjetimin brenda avllisë së tyre të thurur me intriga.

***/Kombetare/22.05.2024/***

## ***Si të shpëtohet BFI-ja nga kthetrat partiake***

***Bashkësia Fetare Islame, si asnjëherë më  
parë, gjendet në një pozitë shumë të keqe!  
Shkurtpamësia politike si dhe përpjekjet e  
segmenteve antiislame për ta kontrolluar dhe  
degraduar këtë institucion, kanë bërë që sot të  
kemi një BFI pa dinjitet e pa integritet. Si askujt  
tjetër, na takon ne, teologëve, e për më tepër, neve  
teologëve më të moshuar, që të angazhohemi për  
ta nxjerrur nga situata e mjerueshme ku na e  
kanë zhytyr subjektet politike të papërgjegjshme***

***Nga Mulla Nazmi Jashari***

Bashkësia Fetare Islame gjithnjë ka qenë cak i segmenteve të caktuara të pushteteve për të vënë kontroll dhe, mundësisht, për ta degraduar deri në një subjekt fetar pa kurrfarë ndikimi! Luftën propagandistike e filluan kundër forcave imagjinare që kinse përpiqeshin për ta “shqiptarizuar BFI-në”! Pastaj u shprehën përpjekjet e parreshtura (sidomos të LSDM-së) për ta maqedonizuar (së paku me mentalitet) BFI-në! Në fund, kur subjektet politike shqiptare menduan se ky Institucion “tashmë i shqiptarizuar” do të duhet të vihet në shërbim të “partive patriotike”, sakaq u përpoqën që të ndikojnë edhe politikisht mbi BFI-në!

Janë të freskëta përpjekjet e LSDM-së (përmes elementit shqiptar më 2019) që, nëpërmes puçeve klasike, ta kapin BFI-në, porse, çuditërisht nuk ia dolën t’i instalojnë njerëzit e vet! Ky dështim pastaj u amortizua përmes pazareve politike! Meqë “projekti” i LSDM-së ishte që ta largojnë Sulejman Rexhepin dhe të sjellin njeriun e tyre dhe, meqë ky angazhim nuk u dha rezultat, atëherë kompromisi i tyre me BDI-në ishte që, të largohet Sulejman Rexhepi dhe në krye të vie njeriu që është 50:50, fifti-fifti, do me thënë, sa i maqedonasëve aq edhe i shqiptarëve! Dhe, këtë prototip e gjetën te Shaqir Fetai!

Shaqir Fetai, për ta kamufluar këtë lojalitet politik të dyfishtë, në

fakt, i hendikepuar dhe i kompleksur nga kjo dyfytësi, shpëtimin do të mudohet ta kërkojë duke u hedhur në prehërin e BDI-së! Kur jemi këtu, brenda BFI-së pati të atillë që BDI-së i dëshmuar se janë më BDI se Shaqir Fetai, dhe me aminin e BDI-së, dy vitet e fundit pati dy tentativa të dështuara për puç! Dihen emrat e të përfshirëve, pasojat dhe thellimi i përçarjes së BFI-së!

Bashkësia Fetare Islame tashmë është e partizuar skajshmërisht, tashmë është shndërruar në “agjenci” e pushtetit dhe, gjithkush që do të vie në pushtet, do ta synojë këtë “agjenci”! Do me thënë, a do të pajtohemi që BFI-në ta lëmë në duart e partive në pushtet? A duhet që BFI-ja të jetë synim i partive politike, apo duhet të jetë problem që do zgjidhje edhe nga partitë politike. Në fakt Bashkësia Fetare Islame duhet të jetë Institucion fetar islam që duhet ta gëzojë përkrahjen dhe ndihmën e subjekteve politike, si në pushtet ashtu edhe në opozitë! Instalimi i partive politike në terrenin e BFI-së do të thotë sektarizim i këtij institucioni dhe, për më tepër, i komunitetit të gjërë të tij.

Tani, është “sekret publik” fakti që “reisi” aktual ishte i instaluar në krye të BFI-së nga pushteti LSDM-BDI! Është fakt i pamohueshëm se në zgjedhjet e fundit presidenciale dhe parlamentare, Shaqir Fetai dhe “institucioni” i tij u vunë tërësisht në shërbim të pushtetit që tashmë po kalon në opozitë. Këtë sjellje të BFI-së e të Shaqir Fetait e kritikuan edhe ASH-ja e Arben Taravarit, edhe mandatarin për kryeministër Mickovski, edhe strukturat policore të angazhuara për rend e siguri në këtë proces. Por, edhe vëzhguesit e huaj! Pra, angazhimi i Shaqir Fetait dhe i strukturave të tij ishte kundër opozitës shqiptare dhe që ta dëmtojë sa më shumë VLEN-in! Tani që këto përpjekje të Shaqir Fetait dështuan katërcipërisht (madje BDI-ja humbi në vetë fshatin e Shaqir Fetait), a do të thotë kjo që, tashmë e drejtë absolute e VLEN-it është që “t’i hakmerren” Shaqir Fetait duke e larguar atë dhe duke sjellë njeri të VLEN-t? Ja pra, ja se si do të sillemi në një rreth vicioz që nuk na bën nder, të paktën neve hoxhallarëve, të cilët duhet që BFI-në ta ndjejmë si amanet të trashëguar. Edhe pse, është “e drejtë” absolute e VLEN-it që t’i spostojë kundërshtarët e vet, megjithatë, unë si hoxhë, i pensionuar nga BFI duke qenë një jetë të tërë në shërbim të xhematit tim, do të kisha dashur që këto marifetllëqe të merrnin fund. Ndaj, për zgjidhjen e problemit, propozoj:

## 1.

Të zgjidhet një Trupë Nderi prej hoxhallarëve më të vjetër të vendit të cilët do ta kthenin situatën në pikën zero: do me thënë, të kthehet ish-reisi, pa të drejta ekzekutive, i cili, në afat prej gjashtë

muajve do ta përgatiste infrastrukturën dhe zgjedhjet për reis, i cili do të zgjidhej nga teologët dhe jo nga strukturat partiake dhe, e dyta

## 2.

Të dorëhiqet Shaqir Fetaj, duke ia dorëzuar mandatin Këshillit të Nderit, i përbërë prej hoxhallarëve të vjetër të vendit (5-7 hoxhallarë) dhe, bashkarisht të përgatisnin zgjedhjet e reisit të BFI-së jashtë çdo ndikimi apo përzierje partiake! Do të ishte në vetë nderin e partive që të rrinin sa më larg përzierjes në këtë Institucion.

Nëse nuk ndodhë ky ndërgjegjësimit i ynë, atëherë, edhe VLEN do ta ketë gjithë të drejtën e vet që në krye të këtij Institucioni ta instalojë njeriun e vet, nga radhët e hoxhallarëve që i ka me bollëk! Por, druaj se ky do të ishte fundi i BFI-së në vend se të ndërmerrej hapi i parë dhe gjigant për ta shpëtuar këtë Institucion nga kthetrat partiake.

Personalisht, unë, autori i këtij shkrimi, propozuesi, nuk jam pretendent për atë post, madje as që kam të preferuar dhe, as që po jap ndonjë emër potencial. Thjesht, po propozoj një rrugëdalje, si kontribut timin në zgjedhjen e këtij problemi mjaft delikat. Do të doja që BFI-ja ta ketë autoritetin, dinjitetin dhe integritetin e dikurshëm, kur ishte subjekt që kontrollonte madje edhe veprimet fetare e kombëtare të partive që llogariteshin si të “bllokut mysliman”!  
*/IKlikLarg/24.05.2024/*

## ***Llumi i elitës kombëtare***

***Kur elitës kombëtare i imponohen dhunshëm persona, sidomos nga ana e shërbimeve sekrete, dhe kjo dukuri mjaftueshëm ka qenë prezente në komunizëm, atëherë kemi të bëjmë me llumin e elitës. Spiuni, hipokriti, sharlatani, sado që mund të instalohen në krye të organizatave jetike për një shoqëri, megjithatë, ndikimi i tyre është zero, ndërsa besdija prej tyre është si prej llumit kur ngjitet në këpucë***

***Nga Mirdi Veseli***

A mund të thuhet se Shaqir Fetai, zgjedhja e shërbimeve sekrete për ta instaluar dhunshëm në krye të BFI-së, është element përbërës i elitës kombëtare! Kush e mendon një gjë të tillë ai nuk është mirë me trutë e kokës! Në cilën shtresë të kësaj elite mund të rangohet ky farë bereqeti?! Cilat vlera intelektuale, cilat kapacitete kombëtare, cilat kode fetare islame i posedon Shaqir Fetai përmes të cilave do të mund të definohej si pjesë e një shtrese elitare! Nuk ka, sepse, sharlantizmi dhe hipokrizia nuk merren si vlerë që të garanton vend në shoqëri. Kush mud t'i qëndrojë mbrapa sharlatanit dhe t'ia garantojë vendin në komunitetin elitar? Vetëm ai person (me nofkën "SKOPSKO"), i cili tek ky sharlatan sheh makinerinë e realizimit të interesave të tij meskine. Sharlatanët e kanë këtë afinitet, pra, dijnë të bëhen edhe urë kaluese për të shkelur mbi të lloj-lloj ndyrësire, vetëm që të mbahet në pozita që i takojnë ekskluzivisht intelektulit të ndershëm, të respektuar e të dashur prej shoqërisë.

Llumi i elitës, sharllatani pra, ka të vetmën brengë – të pranohet dhe të konsiderohet prej pjesëtarëve të familjes së vet si "elitë". Pra, nëse jo shoqëria, të paktën familja e ngushtë ta pranojë si "elitë". Dhe, cila familje e gushtë do ta refuzonte pjesëtarin e vet si sharlatan apo si diletant? Nëse avdalli i thotë vetes "mbret" edhe familja e ngushtë do ta thërrasin me përgëdheli (si një të sëmurë mendërisht) "mbret"!

Megjithatë, llumi i elitës, siç konsiderohet edhe Shaqir Fetai, nuk



mund të qëndrojë përherë i pjekur si llumi për këpucë! As për këpucën e grisur nuk mund të jetë i shëndetshëm llumi, dhe jo më për elitën. Prandaj, edhe prej elitës, si prej këpuce, llumi pastrohet, gërryhet, hiqet me presion të ujit, mu si një mikrob i rrezikshëm.

Këtë përfundim po e ndjenë Shaqir Fetai, madje e ka ndjerë gjithnjë, që kur u instalua prej shërbimeve të dyshimta, por që së fundmi, as gjumin nuk po e bën të qetë. Është shumë i vetëdëshëm se ka shumë borxhe, se tërë “ngitja elitare” e tij është përmes borxheve dhe vjedhjes së meritave të huaja dhe se, tashmë i ka adhur koha ta përjetojë fatin e llumit të ngjitur për këpucë. Gjithnjë në të tilla situata, në opinion ka nisur të paraqitet si “qenie që viktimizohet” për hirë të një interesi “për fe e për vatan” e që, në fakt, kurrë nuk ka pasur lidhje as me fe e as me vatan! Edhe fetar edhe vatanli edhe “ORAO”, sikur nuk shkon! Pra, në të tilla situata na del me “mesazhe meditative”, për t’u dëshmuar si “alim”, si “personalitet” që di të lë “amanete” dhe që “porositë” e tij janë shumë të vlefshme, për të gjithë, si për miqtë ashtu edhe për armiqtë.

Pasi u trimërua para nëpunësve të vet që i thanë se, po flitet që së shpejti do të fluturojë si lakuriq nate, duke ju thënë “le të urdhërojnë kushdo që dëshiron të masë forcë me mua, të shikojnë se janë ata apo unë i fortë”, megjithatë, është ndjerë si llum i pështirë, ndaj dhe ka nisur që të na lërë “amanete”! Në paçavurën e vet (fb) paska dalur me një “amanet” si ai shqelmi i kalit në prag të ngordhjes, përmes të cilit paska dashur që t’i theksojë dy “cilësitë” që i paska ky farë mahluku: respektin dhe bërjen e veprave të mira! Dhe, kërkon nga miqtë e shokët, nga anëtarët e famijes, nga nipër e mbesa, që me “lajke” e me komente t’ia vërtetojnë dy cilësitë që më përpara do t’i kishte ujku e gjarpëri se sa Shaqir Fetai.

Shaqir Fetai po e respektuaka dikë? Dy herë në jetë paska pasur rast që të ketë para kujt të shpreh respektin: para teologut, Nexhat Ibrahimit, të cilin e paskësh përcjellë dhe spiunuar në llogari të UDB-së qysh kur paskan qenë studentë dhe, para Sulejman Rexhepit të cilit ia ka borxh tërë karrierën e vet prej diletanti, por që këtë borxh ia ktheu ashtu siç e di i madh e i vogël në këtë vend – duke ia ngulur thikën pas shpine!

Respekt paska pasur ndaj atyreve që e instaluan me intriga në krye të BFI-së dhe që, këtë respekt ia paska shprehur duke e vënë tërë BFI-në, për zgjedhje presidenciale e parlamentare, me organe e me kapital, në shërbim të BDI-së, me të cilën i ka lidhur interes e veta të ulta!

Ky ndonjëherë paska bërë vepra të mira? Ky, tamam si nazistët, tamam si Hitleri me politikat e veta për “racë arianite”, i largoi nga

puna të gjithë ata që nuk e honepsnin! Ata që nuk e duan, nuk e llogarisin për kurrfarë vlere Shaqir Fetain, ky brithyer, vetëm pse ka fuqinë e shërbimeve sekrete i largon nga puna, duke i hedhur në rrugë, duke mos i interesuar se ata nëpunës kanë familje që varen nga rroga e nëpunësve të BFI-së! BFI-në Shaqir Fetai e ka shndërruar në pronë personale, ndaj dhe kjo i duket vepër e mirë. A është vepër e mirë degradimi i BFI-së dhe shkatërrimi i saj duke i larguar elementët elitari të kombit dhe duke i zëvendësuar ata me analfabetë funksionalë?!

Shaqir Fetai është naivi më i madhë që ia ka dalur të ketë fatin e të katapultohet në Intitucion të rëndësishëm fetar e kombëtar. Njeriu më antifetar e më antikombëtar në krye të një Institucioni të tillë?

Ora po ecë tik-tak, tik-tak...

***/1KlikLarg/25.05.2024***

